BIBLIOTEKA KOHA DITORE
SHEKULLI XX
13

Titulli: Këlthitja dhe mllefi
Autori: Uiliem Fokner

Titulli i origjinalit: *The sound and the fury*
Përkthimi: *Abdullah Karjagdiu*

This translation published by arrangement with Random House,
an imprint of Random House Publishing Group, a division
of Random House, Inc.
© Abdullah Karjagdiu
© 2005 Mediasat Group, S.A. /
Mediasat Rights Kft. për këtë botim

Shtypur në Itali
Grafica Veneta S.p.A. - Italy

ISBN 84-9819-043-6
ISBN 84-9819-032-0 (ja e tërë koleksionit)

Shitet vetëm me gazetën "Koha Ditore".
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

Uiliem
FOKNER
Këlthitja dhe mllefi

Biblioteka Koha Ditore
Prishtinë, 2005

Më 7 prill, 1928

Nga vrimat formë kaçurrelash të luleve rrokëza të gardhit, vështroja sesi e qëllonin topin në lojën e golfit. Derisa ata zunë t'i qaseshin flamurit, unë fillova t'i përcjell duke ecur pas gardhit. Llestëri kërkonte diçka më bar, afër pemës që kishte çelur behar. Ata e nxorën flamurin dhe e qëlluan topin. Pastaj, e ngulën flamurin përsëri dhe shkuan kah ledhi, me ç'rast, më parë ai e qëlloi topin, e pastaj, ai tjetri. Vazhduan të ecin më tej, kurse unë, s'ju ndahesha. Llestëri m'u afrua, kështu që ne ecnim rrëzë gardhit. Kur u ndalën, u ndalëm edhe ne. Ndërkaq, unë vazhdova të vështroj nga gardhi, ndërsa Llestëri po kërkonte diçka në bar.

"Kedi,[1] këtej!" Ai e qëlloi topin. Shkuan matanë livadhit. I mbështetur për gardh i kundroja sesi po shkonin.

"Pa dëgjo një herë", tha Llestëri. "Po çfarë leshkoje më je ti? I ke mbushur të tridhjetëetretat e më sillesh si i çakërdisur. Kurse unë e kalova tërë rrugën nga qyteti deri këtu, të ta blej pastën. Mos cfilit më! *A s'do* të më ndihmosh ta gjej atë monedhë që të mund të shkoj sonte në shfaqje?"

Matanë livadhit kohë pas kohe e qëllonin topin. Iu afrova vendit ku ishte ngulur flamuri. Po valonte në barin vezullues.

"Pa eja", tha Llestëri. "Mjaft kërkuam këtu. Ata s'kthehen aq herët. Të shkojmë poshtë te përroska e ta gjejmë monedhën derisa s'e kanë gjetur zezakët!"

Flamuri ishte i kuq dhe po valonte në livadh. Në atë çast ia behu një zog dhe u ndal mbi të. Llestëri e gjuajti me guralec. Flamuri valonte me fëshfërimë në barin e shkëlqyeshëm, nën lis. Unë mbahesha për gardh.

[1] Kedi, çuni që i mban shkopinjtë.

"Mos cfilit më", tha Llestëri. "Se mos mund t'i shtrëngoj unë të vijnë, nëse s'duan? Në mos pushofsh së cfilituri, mama s'do ta kremtojë ditëlindjen tënde. Nëse nuk e kyç gojën, di se çdo të të bëj? Do të ta ha tërë pastën që ta bleva. Edhe qirinjtë do t'i ha. Do t'i ha tridhjetë e tre qirinj, po, qe besa. Të vemi në përroskë. S'kam çare pa e gjetur monedhën time. Ndoshta gjejmë ndonjë top të tyre. Pa shiko! Ja ku janë, a i sheh?" Iu afrua gardhit dhe m'i tregoi me dorë. "I sheh? S'do të kthehen më këtu. Eja".

Ecëm rrëzë gardhit. Arritëm te gardhi i kopshtit ku ndodheshin hijet tona. Në gardh hija ime ishte më e gjatë se e Llestërit. Arritëm në një pjesë të hapur të gardhit dhe kaluam nëpër të.

"Prit pak", tha Llestëri. "Përsëri u ngatërrove për atë gozhdë. E po, s'bën të përvidhesh këtej pa u kapur për atë gozhdë?"

Kedi[2] m'i shkatërroi petkat nga gozhda dhe kaluam matanë gardhit. Xha Mori na ka pas thënë se s'bën të na shohë asnjeri, andaj më mirë ta kalojmë gardhin të përkulur, tha Kedi. Përkulu Benxhi. Ja, kështu. U përkulëm, e kaluam gardhin, e, dolëm në lulet që na gudulisnin. Trualli ishte forcuar. E kapërcyem gardhin, pas të cilit derrat po ungronin e po nuhatnin. Me gjasë u vjen keq ngase njërin syresh e prenë sot, tha Kedi. Trualli ishte shumë i fortë, i plasaritur, me buca.

Mos i nxirr duart nga xhepat, tha Kedi. Se të ngrihen. S'ke qejf të të ngrihen duart në Kërshëndella, apo jo.

"Jashtë bën shumë ftohtë", tha Vershi. "S'do të dalësh tash".

"Ç' ngjau", pyeti Nëna.

"Dëshiron të dalë jashtë", tha Vershi.

"Le të dalë de", tha Xha Mori.

"Bën shumë ftohtë", tha Nëna. "Më mirë mos të dalë. Benxhamin. Mjaft më".

"S'i bën keq", tha Xha Mori.

"Mor, Benxhamin", tha Nëna. "Nëse s'rri urtë, të shpie në kuzhinë".

"Mamaja[3] tha që sot të mos i shkojë në kuzhinë", tha Vershi. "Tha se sot paska shumë punë aty".

[2] Kedi quhet edhe motra e Benxhit e marrtuar para 18 vjetësh. Me ta dëgjuar këtë emër, Benxhi ulurin...

[3] Mammy. Kështu e quajnë zezakët nënën ose gjyshen. Në Shtetet e Jugut të SHBA-së, të bardhët e quajnë kështu vajzën, zezaken, shërbyesen.

"Lëre të shkojë, Kerolajn", tha Xha Mori. "Merakosesh aq shumë për të saqë mund të sëmuresh".

"E di", tha Nëna. "Zoti më ka dënuar. Nganjëherë as vetë s' di".

"E di, e di", tha Xha Mori. "Ruaje shëndetin. Të bëj një todi[4]".

"Nga ajo shqetësohem edhe më tepër", tha Nëna. "A s'e ditke ti këtë?"

"Do ta ndiesh veten më mirë", tha xha Mori. Mbështille mirë dhe qite jashtë një copë herë".

Xha Mori shkoi. Iku edhe Vershi.

"Praj më, të lutem", tha Nëna. "Bëjmë çmos të të qesim jashtë sa më parë. S'dua të sëmuresh".

Vershi m'i mbathi galloshet e ma veshi pallton, e morëm kapuçin tim dhe dolëm. Xha Mori po vinte një shishe në një raft të dhomës së ngrënies.

"Shëtite nja një gjysmë ore, çun", tha Xha Mori. "Mos u largoni nga oborri".

"Si të urdhëroni, zotëri", tha Vershi. "Kurrë s'e lëshojmë jashtë.

Dolëm, Dielli ishte i ftohtë, por i ndritshëm.

"Kah ia mban", tha Vershi. "Mos kujtove se po shkon në qytet, apo jo". Po ecnim barit shushuritës. Porta ishte e ftohtë. "Më mirë t'i mbash duart në xhepa", tha Vershi. "Do të të ngrihen nëse s'i largon nga porta. Si ia bën pastaj. Prit të kthehemi në shtëpi". M'i futi duart në xhep. Dëgjoja sesi po i shkilte gjethet shushuritëse. Kundërmoja erën e ftohtë. Porta ishte e ftohtë.

"Ja ku paska disa arra të hikojit. Sa mirë! Ngjitju. Shiko atë gerë, Benxhi!"

S'i ndieja grilat e portës, por e kundërmoja të ftohtët e vezullueshëm.

"Më mirë e ke t'i futësh duart në xhepa".

Po vinte Kedi. Papritur e papandehur, ia dha vrapit. Çanta e saj me libra, në shpinë, po i lëkundej.

"Si të kam, Benxhi", tha Kedi. Ajo e hapi portën, hyri brenda dhe u ul galuç para meje. Kedit i vinte era e gjetheve. "Dole të më presësh", tha ajo. "Dole ta presësh Kedin tënd. Versh, pse ke lënë që t'i ngrihen duart kështu"?

[4] Toddy, sherbet i përzier me alkool.

"I thashë t'i mbante në xhepa", tha Vershi. "Zakonisht kapet për grilat e portës".

"Dole ta presësh Kedin", tha ajo, duke m'i fërkuar duart. "Ç' ke? Ç'deshe të thuash, Kedit"? Kedit i vinte era e peméve dhe si e asaj gjëje që i vjen era, si thotë ajo kur flemë.

Pse rënkon, tha Llestëri. Do t'i vështrosh përsëri si të arrijmë te përroska. Ja, merre këtë eshak. Më dha një lule. E kapërcyem gardhin, dolëm në livadh.

"Ç'ndodhi", tha Kedi. "Ç'do t'i thuash Kedit? A e qitën jashtë, Versh"?

"S'mund ta mbanin në shtëpi", tha Vershi. "Kërkonte të dilte patjetër derisa s'e lanë të dalë, e fill pastaj erdhi këtu të vështronte nga porta".

"Ç' ke", tha Kedi. "Kujtove se do të jenë Kërshëndellat si të kthehem nga shkolla. Kështu mendove. Kërshëndellat janë pasnesër. Mixha, kërshëndellat, Benxhi. Hajde të rendim deri në shtëpi e të nxehemi". Më rroku për dore dhe vrapuam nëpër gjethet shushuritëse. U ngjitëm me vrap shkallëve duke ikur nga të ftohtit e errët. Xha Mori po e kthente shishen në sergjen. I bëri zë Kedit. Kedi tha:

"Çoje te zjarri, Versh. Shko me Vershin", tha ajo. "Menjëherë po vij".

Iu afruam zjarrit. Nëna tha:

"A po nerth, Versh"?

"Jo", tha Vershi.

"Zhveshja pallton e zbathja galloshet", tha Nëna. "Sa e sa herë të kam thënë të mos e sjellësh në shtëpi me galloshe".

"Po, zonjë", tha Vershi. "Mos lëviz, tash". Ai m'i zbathi galloshet e ma shkopsiti pallton. Kedi tha:

"Prit, Versh. A s'mund të dalë ai sërish me mua, Nëno. Dua të vijë me mua".

"Më mirë lëre të qetë", tha xha Mori. "Sot ka dalë mjaft".

"Mua më thotë mendja se është më mirë që të dytë të mos dilni", tha Nëna. "Po bëhet edhe më ftohtë, thotë Dilzi".

"Oh, Nënoke", tha Kedi.

"Marri", tha xha Mori. "Gjithë ditën e lume ishte në shkollë. I nevojitet ajri i freskët. Dil e vrapo pak, Kendas".

"Lëre të vijë me mua, Nëno", tha Kedi. "Të lutem. E di se tash zhgrehet në vaj".

"E pse i zë ngoje këto para tij", tha Nëna. "Ç' deshe këtu? Që t'i japësh mundësi që të më bezdisë përsëri. Sot ishe jashtë sa deshe. Më mirë rri këtu e luaj me mua".

"Le të dalin, Kerolajn", tha Xha Mori. "Nëse narthin pak, s'prish punë. Mos harro, edhe ti duhet ta marrësh veten".

"E di", tha Nëna. "Askush s'ka haber sesa i druaj Kërshëndellat. Askush. S'jam nga ato gratë që bëjnë gajret. Ah, sikur, të paktën, për hir të Xhesonit e të fëmijëve të isha pak më e fortë".

"Duhet të bësh çmos e të mos u japësh shkas që të mërziten për ty", tha Xha Mori. "Ju të dy, hajde, vraponi, por mos u vononi. Nëna do t'ju brengoset".

"Mirë", tha Kedi. "Eja Benxhi. Të dalim përsëri". Ajo e kopsiti pallton time. U nisëm kah dera.

"A e qet jashtë atë të shkretë pa galloshe", tha Nëna. "Do që të sëmuret, kur të kemi plot e përplot mysafirë në shtëpi".

"Harrova", tha Kedi. "M'u bë se i kishte të mbathura".

U kthyem. "Dija hallin vetes", tha Nëna. Tash mos lëviz, tha Vershi. "Benxhamin, pa eja këtu e puthe Nënën".

Kedi më çoi te karrigia e Nënës. Nëna më mori ngrykë.

"Xhani im i gjorë", tha ajo. "Ti e Vershi, përkujdesuni për të, loçkë".

"Posi", tha Kedi. Dolëm. Kedi tha:

"Në daç, mos dil, Versh. Rri unë me të do kohë".

"Po mirë", tha Vershi. "As që më dilet jashtë në këtë acar". Ai iku, kurse ne u ndalëm në paradhomë. Kedi u gjunjëzua dhe më përqafoi duke e mbështetur fytyrën e saj të ftohtë e të ndritur për timen. I vinte era e lisave.

"I gjorë s'je. Apo jo? E ke ti Kedin tënd. S'të lë ty Kedi. Apo jo"?

Rrudhe gojën më e mos u përçurrav, tha Llestëri. S'të vjen turp, bën gjithë këtë shamatë. Kaluam para haurit ku gjendej pajtoni. Kishte një rrotë të re.

"Ngjitu këtu tash e mos bëj gëk me gojë derisa s'të vjen mama", tha Dilzi. Më rrasi në pajton. T. P.[5] i mbante frerët. "Ja ku jua them se s'marr vesh pse Xhesoni s'blen një llandon të ri", tha Dilzi. "Ky shkatarraq, një ditë prej ditësh do të bëhet copë e thërrime para jush. Pa shikojani rrotat".

[5] T. P. Inicialet e emrit të një zezaku.

Doli Nëna me vello të lëshuar. Kishte disa lule.

"Ku është Roskusi", tha ajo.

"Sot, Roskusi s'mund t'i lëvizë duart", tha Dilzi. "Edhe T. P. di ta ngasë goxha mirë pajtonin".

"Kam frikë", tha Nëna. "Një herë në javë, do të mund të më gjenit një pajtonxhi të mirë. Vetë zoti e di se kjo s'është kërkesë e madhe".

"Mis Kehlajn, ju dini po kështu mirëfilli se Roskusi ka një reumatizëm të keq, andaj s'është në gjendje të punojë më tepër sesa mundet", tha Dilzi. "Vetëm hyni në pajton. T. P. e nget atë si Roskusi".

"Kam frikë", tha Nëna. "Me këtë kalama", tha Nëna.

Dilzi iu ngjit shkallës së pajtonit. "Këtë gdhë e quani kalama", tha ajo. Ajo e kapi Nënën për dore. "Është zdap si T. P. Ngutuni, ngjituni në pajton, nëse doni të niseni".

"Kam frikë", tha Nëna. Zbritën nga shkallët. Dilzi i ndihmoi Nënës të hipte në pajton". Ndoshta kjo është e mira e së mirës për të gjithë ne", tha Nëna.

"S'ju vjen turp të flitni fjalë të tilla", tha Dilzi. "S'dini se do të duhen më se tetëmbëdhjetë vjet që zezaku plakuç ta bëjë zapt e ta ngasë pelën Kuini. Ajo është më e moçme se T. P. e Benxhi tok. Ruaju se bën ndonjë karaxhozllëk me Kuinin, more vesh, T. P. Nëse s'e nget mirë pajtonin, ta tregon qejfin Roskusi ty. S'e ka lënë takati krejt, ta ndreq samarin ai".

"Si urdhëroni, zonjë", tha T. P.

"Po parandiej se do të na zërë ndonjë taksirat", tha Nëna. "Pusho, Benxhamin".

"Jepjani ta mbajë një lule", tha Dilzi. "Lulen e do ai". Ajo e shtriu dorën.

"Mos, mos", tha Nëna. "Do t'i shkapërderdhësh".

"Mbajini fort", tha Dilzi. "Unë ia nxjerr një lule". Ma dha lulen dhe e largoi dorën.

"Nxitoni tash se mos ju dikton Kuentina se edhe ajo do të kërkojë të vijë me ju", tha Dilzi.

"Po ku është ajo", tha Nëna.

"Atje në shtëpi, po luan me Llestërin", tha Dilzi. "Hajde T. P. jepi, përpara. Ngaje pajtonin ashtu si të ka mësuar Roskusi".

"Mirë", tha T. P. "Përpara, Kuini".

"Kuenitina", tha Nëna. "Hapi sytë se".

"Posi, përkujdesem për të", tha Dilzi.

Pajtoni po lëkundej e po korkolitej në kalldërm. "Kam frikë ta lë Kuentinën", tha Nëna. "Më mirë të mos shkoj T. P." Dolëm nga porta. Tash pajtoni s'korkolitej. T. P. i ra kamxhik Kuinit.

"Or, T. P.", tha Nëna.

"Ndryshe s'ecën". tha T. P. "Lypet ta mbajë të zgjuar derisa të mos e kthejmë në stallë".

"Kthehemi", tha Nëna. "Kam frikë ta braktis Kuentinën".

"S'kam si ta kthej këtu", tha T. P. Atëherë shtegu ishte më i gjerë.

"A s'mund ta kthesh këtu", tha Nëna.

"Po mirë", tha T. P. Filluam të kthehemi.

"Kij kujdes, or T. P.", tha Nëna duke më rrokur.

"S'kam çare pa u kthyer disi", tha T. P. "Hajt, të paça Kuini". U ndalëm.

"Do të na përmbysësh", tha Nëna.

"Si t'ia bëjmë pra", tha T. P.

"Kam frikë nga ajo mënyra sesi e kthen ti pajtonin", tha Nëna.

"Përpara, Kuini", tha T. P. E vazhduam rrugën.

"E di se Dilzi do ta lërë Kuentinën të bëjë ndonjë sherr derisa s'do të jem aty", tha Nëna. "Të ngutemi e të kthehemi".

"Jepi Kuini", tha T. P. I ra kamxhik Kuinit.

"Or T. P.", tha Nëna duke më rrokur. E dëgjoja trokun e Kuinit dhe i shihja figurat e ndriçuara që shklisnin pareshtur nga të dy anët, ndërsa hijet e tyre po binin mbi kurrizin e Kuinit. Po shklisnin rrëmbimthi, si majet e vezullueshme të rrotëve. Pastaj, ato, u ndalën pranë shtyllës së lartë ku gjendej një ushtar. Mirëpo, nga ana tjetër, shklisnin pandarë, po disi më ngadalë.

"Ç'do", tha Xhesoni. Duart i mbante në xhepa, kurse lapsin pas veshit.

"Po shkojmë në varreza", tha Nëna.

"Mirë", tha Xhesoni. "As që desha t'ju ndal. Apo jo? Vetëm këtë deshe të më thoshe, vetëm këtë".

"E di se s'ke qejf të vish me ne", tha Nëna. "Më rehat do të isha po të vije".

"Si më rehat", tha Xhesoni. "Babai e Kuentina s'guxojnë të të prekin".

Nëna e futi shallin nën velë. "Mjaft më, Nëno". tha Xhesoni. "Mos deshe që ky budallai i mallkuar t'ia nisë piskamës midis sheshit. Vazhdo rrugën T. P."

"Përpara, Kuini", tha T. P.

"Zoti më ka dënuar", tha Nëna. "Por, as unë s'e kam të gjatë".

"Pa dëgjo", tha Xhesoni.

"Ua", tha T. P. Xhesoni tha:

"Xha Mori do t'i marrë edhe pesëdhjetë dollarë në bankë në emrin tënd. Ç'ke ndër mend të bësh"?

"Pse më pyet", tha Nëna. "S'kam ç'të them unë. Rrekem të të mos mërzis ty e Dilzin. Unë, së kam të gjatë, pastaj ti".

"Graje, T. P.", tha Xhesoni.

"Hajde, Kuini", tha T. P. Figurat rridhnin edhe më tutje. Ata të anës tjetër zunë të lëshojnë dritë, rrëmbimthi e panda, ashtu si thotë Kedi kur do të flemë.

Qaj mor qaraman i vogël, tha Llestëri. Si s'të vjen turp. Kaluam pranë plevicës. Grazhdet ishin të hapura. S'ke më ponin pullali që ta kalërosh, tha Llestëri. Dyshemeja ishte e thatë e plot pluhur. Çatia desh kishte rënë. Plasaritjet e pjerrta ishin zbehur nga rrjetat e merimangave. Pse do të shkosh atje. Mos deshe të ta këpusin kokën me ato topa.

"Mos i nxirr duart nga xhepat"! - tha Kedi. "Se do të ngrihesh. S'ke qejf t'i kesh duart e ngrira në Kërshëndella, apo jo".

I binim plevicës rreth e përqark. Lopa e madhe dhe e vogla ishin afër derës. Dëgjonim sesi Princi, Kuini e Fensi po shkelnin me patkonj në plevicë. "Po të mos ishte ftohtë, do ta shalonim Fensin", tha Kedi. "Sido që të jetë, sot e bën, ngase bën shumë ftohtë". Atë çast, pamë përroskën, ku çohej njëfarë tymi. "Ja, atje po thernin një derr", tha Kedi. "Vemi andejza dhe i shohim". Zumë të lëshoheshim kodrës tatëpjetë.

"Ti dëshiron ta mbash letrën", i tha Kedi. "Mund ta mbash". E nxori letrën nga xhepi i saj dhe e futi në timin. "Është dhuratë për Kërshëndella", tha Kedi. "Xha Mori dëshiron ta befasojë zonjën Peterson me të. Se mos na diktojnë. Tash, mos i nxjerr duart nga xhepat". Arritëm te përroska.

"Qenka ngrirë", tha Kedi, "Shiko"! E theu sipërfaqen e ujit, mori një copë dhe e vuri për fytyrën time. "Akulli. Kjo të tregon sesa ftohtë bën". Më ndihmoi të ecnim, pastaj zumë t'i ngjiteshim kodrës. "S'mund t'i themi as Nënës as Babait. E di ti se ç'ka brenda. Mendoj se është befasi për Nënën, Babanë e zonjën Peterson, meqë zotëri Petersoni t'i ka dërguar disa

sheqerka. Të kujtohet kur zotëri Petersoni t'i ka pas dërguar ato sheqerka verën që shkoi".

Aty ishte një gardh. Hardhitë ishin tharë, ndërsa era i bënte të shushurisnin.

"Veçse s'di pse Xha Mori s'e dërgoi Vershin", tha Kedi. "Vershi s'do t'i thoshte askujt". Zonja Peterson po shikonte nga dritarja. "Ti, prit këtu", tha Kedi. "Prit mu këtu, tash. Kthehem brenda një minute. Ma jep letrën"! E mori letrën nga xhepi im. "Futi duart në xhepa". Ajo e kapërceu gardhin me letër në dorë dhe zuri të ecte mes luleve ngjyrëkafeje që shushurisnin. Zonja Peterson doli te dera, e hapi derën dhe u ndal.

Z. Peterson po prashiste mes luleve të gjelbra. Pushoi së prashituri dhe ma hodhi një shikim. Zonja Peterson rendi nëpër kopsht. Me t'i parë sytë e saj, ia krisa vajit. Oh idiot, tha zonja Peterson, i thashë të të mos dërgonte vetëm. Ma jep. Shpejt. Zotëri Petersoni ia behu me vrap, me shat. Zonja Peterson u përkul mbi gardh dhe e zgjati dorën. U mundua ta kapërcente gardhin. Ma jep, tha ajo, ma jep. Zotëri Petersoni, iu ngjit gardhit. E mori letrën. Fustani i zonjës Peterson u ngatërrua për gardh. Përsëri i pashë sytë e saj u bëra erë dhe u lëshova tatëpjetë kodrës.

"Atje tej s'ka asgjë tjetër përveç shtëpive", tha Llestëri. "Po trupojmë kah përroska".

Në përroskë po lanin petka. Njëra petkalarëse ia thoshte këngës. U vinte era teshave që valonin dhe tymit që vërtitej mbi përroskë.

"Prit këtu", tha Llestëri. "Ti s'ke punë atje. Ata të rrahin, me siguri".

"Po ç'do ai"?

"S'di se ç'do as vetë", tha Llestëri. "Mendon se ka qejf të shkojë atje tej ku e qëllojnë atë top. Trus këtu e luaj me eshakun tënd. Në daç të shikosh gjë, atëherë shikoji fëmijët që lozin në përroskë. E po si s'di të sillesh si të tjerët". U ul në breg, ku i lanin petkat dhe ku çohej një tym ngjyrë blu.

"Mos e gjeti kush rastësisht një monedhë", tha Llestëri.

"Çfarë monedhe"?

"Atë që e kisha sot në mëngjes", tha Llestëri. "E humba diku. Ka rënë nga kjo vrima e xhepit tim. Po s'e gjeta, s'mund të shkoj sonte në shfaqje".

"Ku e fshine atë monedhë, or çun? Me gjasë ia more nga xhepi ndonjë të bardhi pa e diktuar ai".

"E mora atje ku mund ta marrësh", i tha Llestëri. "Atje ku e mora këtë ka edhe shumë të tjera. Por, s'kam çare pa e gjetur këtë. Mos e gjeti kush"?

"S'jam ngusht për monedhën tënde. I kam punët e mia".

"Eja këtu", tha Llestëri. "Eja të më ndihmosh për ta gjetur".

"S'do të dinte se ç'është monedha edhe po ta gjente".

"Edhe ai mund të më ndihmojë", tha Llestëri. "Shkoni të gjithë në shfaqje sonte".

"Mos më llomotit për shfaqje. Si ta kryej punën me këtë kacë, do të jem i rraskapitur e i lodhur".

"Vë bast se do të vijsh", tha Llestëri. "Jam i bindur se do të vini të gjithë si të hapet ajo tenda".

"Do të ketë atje plot zezakë, pa mua. Unë qeshë mbrëmë".

"Kujtoj se paraja e zezakut është e mirë si e të bardhit".

"Të bardhët u japin para zezakëve, meqë dinë se i bardhi i parë që do t'ia behë me një orkestër do t'ua marrë sërish paratë, andaj zezakët do të robtohen përsëri së punuari që të fitojnë ndonjë dysh".

"E po askush s'të detyron të shkosh në shfaqje".

"Ende s'më detyrojnë, jo, po më duket".

"Çfarë ke kundër të bardhëve"?

"Asgjë s'kam kundër tyre. Shkoj rrugës sime dhe i lë të bardhët të shkojnë rrugës së tyre. Aq më bën për atë shfaqje".

"Në shfaqje, një njeri i bie sharrës. Si ta lozte benxhon".

"Ishte mbrëmë", tha Llestëri. "Unë shkoj sonte. Nëse e gjej atë monedhë".

"Mos po e merr edhe këtë me vete".

"Ta marr me vete", tha Llestëri. "Mendon se kollaj e kam kur t'ia nis ulurimës".

"E ç'bën atëherë"?

"E rrah", tha Llestëri. Ai u ul, i përvoli mëngët e pantallonave. Filluan të loznim në përroskë.

"Ende s'keni gjetur asnjë top", tha Llestëri.

"Ç'dërdëllitje janë këto. Më mirë të të mos dëgjojë gjyshja se ç'dëngla thua".

Llestëri hyri në ujë. Zuri ta kërkonte monedhën skaj përroskës.

"E kisha sot në mëngjes kur ishim këtu", tha Llestëri.

"Ku e humbe"?

"Më ka rënë ja nga ky xhepi", tha Llestëri. Po kërkonin nëpër lumë. Pastaj, të gjithë u drejtuan, pushuan së kërkuari dhe filluan ta stërpikin njëri-tjetrin e të lozin. Llasteri e gjeti monedhën, pastaj u ulën galiç në ujë e zunë ta vështrojnë kodrën me gëmusha.

"Ku janë", tha Llasteri.

"Ende s'duken".

Llasteri e futi monedhën në xhep. Ata po vinin nga kodra.

"Mos ra këtejza një top"?

"Do të jetë në ujë. Mos e ka parë ose dëgjuar ndonjëri nga ju, djelmosha"?

"S'dëgjova që të ketë rënë asgjë këtej pari", tha Llasteri. "Dëgjova sesi e goditi diçka atë lis atje. S'di se ku ra".

E shikuan përroskën.

"Të vejë në djallë. Kërkoni në përroskë. Ra këtejza. E pashë".

Zunë të kërkonin në përroskë. Paskëtaj, iu ngjitën kodrës.

"E ke ti topin", tha një vogëlush. "Ç'më hyn në punë topi", tha Llasteri. "S'kam parë kurrfarë topi".

Vogëlushi hyri në ujin e përroskës. Shkoi më tutje. U kthye dhe e shikoi Llasterin përsëri. U lëshua tatëpjetë përroskës.

Ai njeriu në kodër tha "Kedi". Vogëlushi doli nga uji dhe iu ngjit kodrës.

"Tash, më dëgjo", tha Llasteri. "Rrudhe gojën".

"Pse rënkon tash?"

"Një zot e di", tha Llasteri. "Kështu ia nis avazit. Cfiliti tërë paraditen. Mbase për shkak se e ka ditëlindjen".

"Në ç'moshë është".

"Tridhjetë e tre", tha Llasteri. "Sot në mëngjes i mbushi të tridhjetëetretat".

"Deshe të thuash se para tridhjetë vjetëve ka qenë trevjeçar".

"Unë i përmbahem asaj që më ka thënë mami", tha Llasteri. "S'di" sidoqoftë, në pastë, do të kemi tridhjetë e tre qirinj. Pastën e vogël. Mezi do të ketë vend për qirinjtë. Kyçe të shkretën. Eja këtu". U afrua e më rroku për dore. "Mor i cokatur", tha ai. "Të kruhet shpina. Do dacka".

"Vë bast se do ta rrahësh".

"E rraha. Mbylle gojën", tha Llasteri. "A s'të thashë se s'mund të shkosh atje. Ja ku të them, ta këpusin kokën si të zogut me ndonjë top. Eja këtu". Më tërhoqi. "Ulu". U ula kurse

ai m'i zbathi këpucët dhe i përvoli pantallonat e mi. "Hyr në ujë e luaj se ndoshta pushon së cfilituri e s'përçurravesh më".

Heshta dhe hyra në ujë, kurse Roskusi erdhi e tha të vija në darkë e Kedi tha:

Ende s'është kohë e darkës. Unë s'vij.

Ajo ishte bërë qull. Po loznim në përroskë, ndërsa Kedi u ul galiç, e lagi fustanin dhe Vershi, tha:

"Mami do të të rrahë për shkak se e ke lagur fustanin".

"Ajo s'e bën një gjë të tillë", tha.Kedi.

"Ku e di", tha Kuentini.

"E di unë mirëfilli", tha Kedi. "Po ti, ku e di"?

"Ajo i tha kështu", tha Kuentina. "Pos kësaj jam më e moçme se ti". Jam shtatë vjeç", tha Kedi. "Më duket se di".

"Unë jam më i moçëm", tha Kuentini. "Unë shkoj në shkollë. Apo jo, Versh"?

"Unë do të shkoj në shkollë mot", tha Kedi. "Kur ta kem kohën. Apo jo, Versh"?

"Ti e di se ajo të rrahë kur e lag fustanin", tha Vershi.

"S'është lagur", tha Kedi. U drejtua dhe e vështroi fustanin. "Do ta zhvesh", tha ajo. "Pastaj, teret".

"Hajt, nëse ta mban", tha Kuentini.

"E ja ku të them se ma mban", tha Kedi.

"Më mirë e ke të mos e zhveshësh", tha Kuentini.

Kedi na u afrua mua e Vershit dhe e ktheu shpinën.

"Shpërthekoma fustanin, Versh", tha Kedi.

"Mos, Versh", tha Kuentini.

"S' është fustani im".

"Shpërthekoma, Versh", tha Kedi. "Ose i them Dilzit për atë që bëre dje". Kështu, Vershi ma shpërthekoi fustanin.

"Pa provo ta zhveshësh fustanin", tha Kuentini. Kedi e zhveshi fustanin dhe e flaku në breg. Tash ishte vetëm me krahole e me brekë, Kuentini ia dha një shpullë dhe ajo ra në ujë. Si u ngrit, zuri ta stërpikte Kuentinin dhe Kuentini po ashtu filloi ta stërpikte atë. Disa stërpikë na stërpikën Vershin e mua, andaj, Vershi më nxori nga uji e më çoi në rërën e bregut. Tha se do të kallëzonte atë që kishin bërë Kedi e Kuentini dhe atë çast, Kedi e Kuentini, u kthyen e t'ia nisën ta stërpiknin Vershin sa mundën. Ai u struk pas gëmushave.

"S'e lë pa i kallëzuar mamës se ç'keni bërë", tha Vershi.

Kuentini doli në breg dhe deshi ta zinte Vershin, mirëpo

Vershi i iku. Me t'u kthyer Kuentini, Vershi u ndal dhe filloi të këlthasë se do t'i kallëzonte mamës. Kedi i tha se nëse s'bën zë, do ta linte të kthehej. Vershi ia dha fjalën se s'do t'i thoshte askujt, kështu, e lanë të kthehej.

"Tash ma ha mendja se je e kënaqur", tha Kuentini. "Tash hamë dajak të dytë".

"Punë e madhe", tha Kedi. "Ua mbathi këmbëve".

"Posi, ua mbath", tha Kuentini.

"Marr ikën e kurrë s'kthehem më", tha Kedi. Unë ia plasa vajit. Kedi u kthye dhe tha — "Mbylle". Heshta. Pastaj, sërish luajtën në përroskë. Edhe Xhesoni po luante. Ai ishte më tutje, në përroskë. Vershi erdhi nga gëmusha dhe më çoi tek uji. Kedi ishte bërë qull dhe e përbaltur nga pas, andaj unë fillova të qaja, ndërsa ajo erdhi dhe u ul galiç në ujë.

"Mos kij marak", tha ajo. "S' ikën". Unë e mora veten. Kedit i vinte era e lisave në shi.

Ç'ke, tha Llasteri. A s' pushon së çjerri e s'luan në përroskë me fëmijët.

Pse s'e çon në shtëpi. A s'të kanë thënë ta çosh në shtëpi.

Ai ende mendon se kullosa është e tyre, tha Llasteri. Nga shtëpta askush s'e sheh kullosën.

Ne e shohim. Gjindja s'e shikojnë me andje të rrokaturin. Kjo s'të sjell fat.

Erdhi Roskusi e tha se duhej të vinim në darkë, kurse Kedi tha se ende s'ishte koha e darkës.

"Po, është", tha Roskusi. "Dilzi thotë se të gjithë duhet të vini në shtëpi. Silli, Versh". Ai iu ngjit shpatit ku buluronte lopa.

"Ndoshta teremi para se të arrijmë në shtëpi", tha Kuentini.

"Vetëm ti e ke fajin", tha Kedi. "Si duket, do të hamë dajak". E veshi fustanin. Vershi ia përthekoi.

"S'do të marrin vesh se jeni lagur", tha Vershi. "S' shihet. Nëse unë e Xhesoni s'kallëzojmë".

"A kallëzon, Xheson", tha Kedi.

"Ç'të kallëzoj"?

"S'kallëzon", tha Kuentini. "Apo jo, Xheson"?

"Vë bast se do të kallëzojë", tha Kedi. "Do t'i kallëzojë mamës".

"S'ka si", tha Kuentini. "Ajo është e sëmurë. Nëse ecim ngadalë, do të jetë errësirë e s'do të shohin".

"Aq.më bën nëse shohin ose jo", tha Kedi. "Unë vetë do t'u them. "Çoje përpjetë shpatit, Versh".

"Xhesoni s'kallëzon", tha Kuentini. "Të kujtohen harku e shigjeta që t'i bëra".

"M'u thyen", tha Xhesoni.

"Le të kallëzojë", tha Kedi. "S'i jap unë pesë para. Merre Morin me vete në shpat, Versh". Vershi u ul galiç, unë i hipa në shpinë.

Sonte shihemi në shfaqje, tha Llasteri. Ejani, të shkojmë. S' kemi çare pa e gjetur atë monedhë.

"Nëse s'ngutemi, do të errësohet kur të arrijmë atje", tha Kuentini.

"Mua edhe s'më ngutet", tha Kedi. Ne iu ngjitëm kodrës, por Kuentini s'erdhi me ne. Ai ende gjendej atje ku kundërmonte era e derrave. Derrat ungronin dhe turfullonin në koritën në këmb. Xhesoni erdhi pas nesh me duar në xhepa. Roskusi e milte lopën afër derës së plevicës.

Lopët po dilnin nga plevica duke kërcyer.

"Vazhdoni", tha T. P. "Buluroni përsëri. Edhe unë do të buluroj. Muuu". Kuentini i ra shqelm T. P. I ra aq sa T. P. ra në koritën ku hanin derrat. "Ah qen, bir qeni", tha T. P. "Sërish më goditi. A shihni se si më goditi ai njeriu i bardhë kësaj here. Muuuu".

S'u zhgreha në vaj, por s'munda të përmbahesha. S'qaja, po trualli s'ishte i qetë, andaj, ia krisa vajit. Trualli po pjerrej përpjetë, gjithnjë më tepër, kurse lopët po i ngjiteshin shpatit, T. P. bëri të çohej. Ai ra përsëri, kurse lopët morën pikën e vrapit tatëpjetë shpatit. Kuentini më rroku për dore dhe ne u nisëm kah plevica. Në atë kohë plevica s'ishte aty, prandaj na u desh të prisnim derisa s'u kthye. S'pashë se kur u kthye. Erdhi pas nesh, kurse Kuentini më vuri në grazhdin ku ushqehen lopët. U kapa për të. Ai po ikte, andaj s'e lëshoja. Lopët po rendnin përsëri tatëpjetë shpatit, duke dalë nga dera. S'mund të ndalesha. Kuentini e T. P. po vinin nga shpati duke u përfytur. T. P. po rrokullisej tatëpjetë shpatit, kurse Kuentini e tërhiqte përpjetë shpatit. Kuentini ia dha një grusht T. P.-së. Unë s'mund të ndalesha.

"Çohu", tha Kuentini. "Mos luaj nga vendi. Rri këtu derisa të kthehem".

"Unë e Benxhi shkuam në dasmë", tha T. P. "Muuuuu".

Kuentini e goditi sërish T. P.-në. Pastaj, filloi ta përplaste për mur T. P.-në. Ky i fundit po qeshte. Sa herë që Kuentini e përplaste për muri, ai rropatej të bënte muuu, por, s'ia dilte dot të thoshte, s'e linte gazi. Unë pushova së qari, por, s'mund të ndalesha. T. P. u plandos mbi mua, kurse dera e plevicës u rrëzua. U rrëkëllye tatëpjetë kodrës, kurse T. P. po rrahej me vetveten, pastaj, ra përsëri. Ende po kikirisej së qeshuri, ndërsa unë s'mund të ndalesha, bëra të çohem, po rashë përsëri dhe s'ish punë të ndalesha. Vershi tha:

"Kyçe më gojën. Mjaft! Mos u çirr më!"

T. P. po kakarisej ende. U përplas për derë gjithë duke qeshur.

"Muuuu", bënte ai. "Unë e Benxhi po kthehemi në dasmë. Sasprillah[6]", tha T. P.

"Rrudhe", bëri Vershi. "Se ku e gjete".

"Në bodrum", tha T. P. "Muuuu".

"Epo mbylle të shkretën", tha Vershi. "Në çfarë bodrumi"?

"Kudo" tha T. P. Ai po shkulej së qeshuri. "Ka edhe nja njëqind shishe. Më se një milion të tjerë. Shiko zezak, tash do të ulëroj".

Kuentini tha: "Çoje".

Vershi më ngriti.

"Pije këtë, Benxhi", tha Kuentini. Shishja ishte e nxehtë. "Rrudhe gojën më", tha Kuentini. "Pije".

"Sassprillah", tha T. P. "Ma jepni ta pi unë, zoti Kuentin".

"Rrudhe të shkretën", tha Vershi. "Se të ra zoti Kuentin".

"Kape, Versh", tha Kuentini.

Më kapën. Mjekrën dhe këmishën i kisha të nxehta. "Pije", tha Kuentini. Ma kishin shtrënguar kokën. Brenda si të më digjte njëfarë zjarri, andaj ia nisa përsëri. Tash po qaja, dhe në mua po ngjante diçka, andaj qaja edhe më tepër, me dënesë, ndërsa ata s'më lëshonin derisa e ndjeva veten mirë. Atëherë pushova. Ende më sillej vërdallë çdo gjë, atë çast zura të vëreja disa hije. "Hape ahurin, Versh". Mos po ecnin ngadalë. "Shtriji ata thasë të zbrazët

[6] Sassprillah është fjalë spanjolle sabsaparilla, lla, këtu e shqiptuar keq. Me këtë bimë tropike në Amerikë bëjnë njëfarë pijeje; alkoolike.

për dysheme". Tash po ecnin më shpejt, madje goxha shpejt. "E tash. Kape për këmbe". Ato vazhdonin të ecnin më tutje, të shkathëta e të shkëlqyeshme. Dëgjova sesi po kikirisej së qeshuri T. P. Shkova me ta deri te kodra e vezullueshme.

Në majë të kodrës Vershi më lëshoi për toke. "Eja këtu, Kuentin", bërtiti ai, duke lëshuar një vështrim tatëpjetë kodrës. Kuentini ende ndodhej buzë përroskës. Ende po groponte në hijet ku ishte përroska.

"Lëre të qetë atë hajvan", tha Kedi. Më rroku për dore, pastaj vazhduam të ecnim. Kaluam pranë plevicës dhe derës. Në mes të kalldërmit nga tullat ishte një bretkosë. Kedi e kaloi me kujdes që të mos e shkilte dhe më tërhoqi pas.

"Eja, Mori", tha ajo. Ajo ende rrinte aty derisa Xhesoni s'e çiku me gishtin e këmbës.

"Do të të dalë lythi", tha Vershi. Bretkosa kërceu.

"Eja, Mori", tha Kedi.

"Sonte kanë mysafirë", tha Vershi.

"Epo ku e ditke", tha Kedi.

"Shiko sa dritat janë ndezur", tha Vershi. "Në çdo dritare".

"Më thotë mendja se edhe ne, në daçim, mund t'i ndezim të gjitha dritat, pa mysafirë", tha Kedi.

"Vë bast se kanë mysafirë", tha Vershi. "Më mirë të përvidhesh nga pas e t'u ngjitesh shkallëve fët e fët".

"Aq më bën", tha Kedi. "Do të hyj drejt në sallën e mysafirëve".

"E prite pastaj dajakun nga babai", tha Vershi.

"Punë e madhe", tha Kedi. "Shkova drejt në sallë. Shkova në odën e ngrënies për të ngrënë darkë".

"Ku do të ulesh", tha Vershi.

"Në karrekillën e gjyshes", tha Kedi. "Ajo ha në krevat".

"Kam uri", tha Xhesoni. Kaloi me nxitim afër nesh dhe rendi monopatit. Duart i kishte në xhepa, kështu, u rrëzua. Vershi iu afrua dhe e ngriti.

"Në daç të qëndrosh më këmbë, nxirri duart nga xhepat", tha Vershi. "S'ke si t'i nxjerrësh shpejt, për t'u kapur për toke, meqë je trashaluq i madh".

Babai i gjendej te shkallët e kuzhinës.

"Ku është Kuentini", tha ai.

"Ja, po vjen", tha Vershi. Kuentini po vinte dalngadalë. Këmisha e tij ishte një njollë e bardhë.

"Oh", bëri babai. Nga shkallët e kishte ndriçuar drita e llampës.

"Kedi dhe Kuentini u stërpikën me ujë", tha Xhesoni.

Ne prisnim.

"Ashtu", tha babai. Kuentini arriti, kurse baba tha: "Sonte mund të hani bukë në kuzhinë". U ndal, më mori mua në prehër, ndërsa drita u lëshua edhe mbi mua, kështu që nga lart mund t'i shihja Kedin, Xhesonin, Kuentinin dhe Vershion. Babai u kthye kah shkallët. "Por, rrini urtë, hë", tha ai.

"Pse, baba", tha Kedi. "Mos kemi mysafirë".

"Po, kemi", tha babai.

"A s'të thashë", tha Vershi.

"Ti s'thâ gjë", tha Kedi. "Unë thashë se ka mysafirë. Thashë se...

"Kyçeni gojën", tha babai. Ata heshtën, babai e hapi derën, ne kaluam nëpër verandën e pasme, hymë në kuzhinë. Aty ishte Dizli, andaj, babai më vuri në karrige, më vuri një salvetë, karrigen e shtyri afër tryezës, ku ndodhej darka. Darka ishte e nxehtë.

"Kij kujdes tash, Dilzi", tha Babai. "Mos lër të bëjnë shamatë. Dilzi".

"Si urdhëroni, zotëri". Babai u nis.

"Mos harroni, ta dëgjoni Dilzin", tha pas nesh. E afrova fytyrën kah darka. I dilte avulli.

"Thuaju të më dëgjojnë mua sonte, Baba", tha Kedi.

"Unë s'të dëgjoj", tha Xhesoni. "Unë do ta dëgjoj Dilzin".

"Do të më dëgjosh medoemos, nëse të urdhëron Babai", tha Kedi. "Urdhëroju, Baba, të më dëgjojnë".

"Unë s'të dëgjoj", tha Xhasoni. "S'ta var torbën".

"Heshtni", tha Babai. "Në qoftë ashtu, atëherë, të gjithë ta dëgjoni Kedin. Si ta hanë darkën, çoji lart Dilzi, nëpër shkallët e pasme".

"Si urdhëroni, zotëri", tha Dilzi.

"Ashtu pra", tha Kedi. "Mbase, tash do të më dëgjoni".

"Ta ruani qetësinë tash", tha Dilzi. "Sonte duhet të rrini urtë të gjithë".

"E pse të rrimë urtë sonte", pëshpëriti Kedi.

"Pse je aq kurreshtare". tha Dilzi. "Do të marrësh vesh kur e do zoti". Ajo e solli pjatën time. Avulli ngrihej nga ajo dhe ma guduliste fytyrën. "Hajde këtu, Versh", tha Dilzi.

"E kur do të dojë zoti", tha Kedi.

"Të dielën", tha Kuentini. "Ti s'di gjë prej gjëje".

"Shshsht", tha Dilzi. "A s'ju tha zoti Xheson të mos bërtitni. Tash, hani bukë. Versh, merre lugën e tij". Dora e Vershit, me lugë, hyri në pjatë. Luga iu afrua gojës sime. Avulli ma guduliste gojën. Tevona, e lamë darkën, e shikuam njëri-tjetrin, të heshtur, pastaj, përsëri e dëgjuam atë dhe unë fillova të qaja.

"Ç'ishte ajo", tha Kedi. Dorën e saj e vuri mbi timen.

"Nëna", tha Kuentini. Luga u ngrit, unë zura të ha, pastaj sërish po qaja.

"Pusho", tha Kedi. Unë s'praja së qajturi, andaj ajo m'u afrua e më përqafoi. Dilzi shkoi dhe i mbylli dyert, kështu s'dëgjohej më asgjë.

"Mjaft më", tha Kedi. Unë pushova së qajturi dhe flilova të haja bukë. Kuentini s'hante, ndonëse Xhesoni hante.

"Ishte Nëna", tha Kuentini. Ai u ngrit.

"Mos luaj nga vendi", tha Dilzi. "Atje kanë mysafirë, kurse ti i ke rrobat e përbaltura. Edhe ti Kedi, ulu e ha darkë".

"Ajo vajtonte", tha Kuentini.

"Dikush po këndonte", tha Kedi. "Apo jo? Dilzi".

"Tash, hani darkë të gjithë si tha zoti Xheson", tha Dilzi.

"Çdo gjë do të merrni vesh kur të dojë zoti". Kedi u kthye te karrigia e saj.

"Ju thashë se kishin gosti", tha ajo.

Vershi tha: "I hëngri të gjitha".

"Ma jep pjatën e tij", tha Dilzi. E morën pjatën.

"Dilzi", tha Kedi. "Kuentini s'e ha darkën. A s'është i detyruar të më dëgjojë".

"Haje darkën, Kuentin", tha Dilzi. "Ngutuni të gjithë dhe dilni nga kuzhina ime".

"S'më hahet më darka", tha Kuentini.

"Nëse të them unë, ti s'ke çare pa e ngrënë", tha Kedi. "Apo jo, Dilzi".

Nga pjata, avulli çohej e ma guduliste fytyrën, dora e Vershit e futi lugën në pjatë, kurse avulli po e guduliste gojën time.

"S'dua të ha më", tha Kuentini. "Si mund të shtrojnë ndejë kur gjyshja është e sëmurë".

"Ndejën do ta kenë poshtë", tha Kedi. "Ajo mund të dalë, te shkallët e t'i shohë. Edhe unë do të dal të shoh si ta vesh këmishën e natës".

"Nëna po qante", tha Kuentini. "A s'qante, Dilzi".

"Mos më qit kajde", tha Dilzi". Duhet të përgatis darkën për të gjithë ata si të hani ju bukë".

Pas një copë here edhe Xhesoni hëngri darkë dhe ia plasi vajit.

"Tash ia nis edhe ti të ulurosh", tha Dilzi.

"Që kur u sëmur gjyshja dhe ai s'flë më me të, kështu qan për natë", tha Kedi. "Qaraman".

"Do t'i kallëzoj atij se ç'ke bërë", tha Xhesoni.

Ai po qante. "I the", tha Kedi. "S'ke ç't'i kallëzosh më".

"Tash, të gjithë të shkoni të flini", tha Dilzi. Ajo m'u afrua, më ngriti nga karrigia, me fundin e ngrohtë m'i fshiu duart e fytyrën. "Versh, a mund t'i çosh atje nëpër shkallët e pasme. Ti Xheson, mos qaj më".

"Është herët të flemë. tha Kedi. "S'është e thënë të flemë kaq herët".

"Por, sonte do të fleni herët". tha Dilzi. "Babai ju tha që sa më parë të shkoni të flini, fill pas darke. A s'e dëgjuat".

"Tha të më dëgjojnë mua", tha Kedi.

"Unë s'të dëgjoj", tha Xhesoni.

"Patjetër do të më dëgjosh", tha Kedi. "Hajde. Do të bësh atë që ta them".

"Le të rrinë urtë, Versh", tha Dilzi. "Të gjithë të rrini urtë, a morët vesh".

"Pse mos të bëjmë zë, sonte", tha Kedi.

"Mamën e keni pak pa qejf", tha Dilzi. "Tash të gjithë të shkoni me Vershin".

"Unë ju thashë se Nëna po qante", tha Kuentini. Vershi më mori me vete dhe e hapi derën e verandës së pasme. Me të dalë, Vershi e mbylli derën pas nesh. Unë ia kundërmoja erën Vershit dhe e ndieja trupin e tij. "Mos bëni zë. Ende s'u ngjitemi shkallëve. Zoti Xheson tha se duhet të shkoni përnjëherësh atje, për të fjetur. Ju tha të më dëgjoni. Ty unë s'ta var torbën. Por, ai tha kështu për të gjithë, apo jo, Kuentin". Mund ta çikja kokën e Kuentinit. Mund ta dëgjoja veten tonë. "Apo jo, Versh. Po de, ashtu është. Thashë, të dalim edhe për një hop. Hajdeni". Vershi e hapi derën dhe ne dolëm.

Po zbrisnim shkallëve.

"Më duket se e mira së mirës është të shkojmë te shtëpia e

Vershit, atje do të rrimë urtë", tha Kedi. Vershi më ngriti, Kedi më mori për dore dhe zumë të ecim kalldrëmit me tulla.

"Hajde", tha Kedi. "Bretkosa paska ikur. Ka ikur në kopsht deri tash. Ndoshta hasim në një tjetër". Roskusi ia behu me vedrat e qumështit. E vazhdoi rrugën. Kuentini s'vinte me ne. Ishte ulur te shkallët e kuzhinës. Ne zbritëm te shtëpia e Vershit. E doja kundërmimin e shtëpisë së Vershit. *Atje brenda ndizej një zjarr, kurse pranë tij T. P. ishte ulur galiç me këmishën e rreckosur dhe po e shpupurishte zjarrin.*

Atë çast u ngrita, kurse T. P. më veshi dhe ne shkuam në kuzhinë për të ngrënë. Dilzi ia thoshte këngës, andaj, unë ia plasa vajit, kështu që ajo pushoi së kënduari.

"Qite jashtë, në shëti", tha Dilzi.

"Andejza s'bën të shkojmë", tha T. P.

Po luanim te përroska.

"S'mund të shkojmë matanë", tha T. P. "A s'e ditke që s'na lë mamaja".

Dilzi po këndonte në kuzhinë, andaj fillova të qaja.

"Hesht".,tha T. P. "Hajde, të shkojmë në plevicë".

Roskusi po i milte lopët në ahur. Po milte me një dorë dhe po rënkonte. Disa zogj, pranë derës së ahurit, po e vështronin. Një zog zbriti dhe zuri të hante me lopët. E shikoja Roskusin duke mjelë, ndërsa T. P. po i ushqente Kuinin dhe Princin. Viçi ishte në tharkun e derrave. E rraste turirin në të dhe po pëlliste.

"T. P.", tha Roskusi. T. P. iu përgjigj nga ahuri. Fensi e qiti kokën nga dera, meqë T. P. ende s'e kishte ushqyer. "Kryeje punën", tha Roskusi. "Mile më. Unë s'mund ta përdor krahun tim të djathtë".

T. P. erdhi dhe filloi të milte.

"Pse s' shkon te mjeku", tha T. P.

"S' ka si të më ndihmojë mjeku", tha Roskusi. "Të paktën këtu, s'ka si".

"Pse, ç'ka kjo shtëpi", tha T. P.

"I kanë bërë magji, s'ka fat në të", tha Roskusi. "Lëshoje atë viç si të jesh gati".

S'ka fat në këtë shtëpi, tha Roskusi. Flaka ngjitej dhe binte pas tij e Vershit duke shkëlitur nëpër fytyrën e tij e të Vershit. Më në fund, Dilzi më çoi në krevat. Krevatit i vinte era e T. P. Më pëlqente kjo erë.

"Ç'di ti lidhur me të", tha Dilzi. "Çfarë ekstaze të kapërtheu".

"Ç'më duhet ekstaza", tha Roskusi". "A s'është prova këtu, në këtë krevat. A s'e kanë parë provën njerëzit këtu për më se pesëmbëdhjetë vjet".

"Ta zëmë se po", tha Dilzi. "Por, kjo s'të prish punë as ty as të tuve. Vershi punon, Froni u martua, kurse T. P. do të rritet ende dhe do ta zërë vendin tënd si të të kaplojë e të dërrmojë reumatizmi".

"Tani janë dy", tha Roskusi". "Do të ketë edhe një. E pashë shenjën, edhe ti".

"Atë natë dëgjova këngën e hutit", tha T. P. "As qeni Den nuk erdhi në darkë. S'guxon t'i afrohet ahurit. Me t'u ngrysur filloi të cfilisë. Vershi e ka dëgjuar".

"Do të ketë edhe një tjetër", tha Dilzi. "Tregomë atë që s'do të vdesë, bekuar qoftë Jezusi".

"Vdekja s'është kurrfarë kapaku", tha Roskusi.

"E di se ç'mendon", tha Dilzi. "S'do të kenë fat, edhe nëse e përmendin këtë, por duhet të jesh me të kur ia kris vajit".

"Kjo shtëpi është pa fat", tha Roskusi. "Këtë e kam pas vënë re qëkur, mirëpo, si ia ndërruan emrin, atëherë qeshë i sigurt".

"Kyçe të shkretën", tha Dilzi. Ajo e tërhoqi jorganin. I vinte era si e T. P. "Heshtni pak derisa ta zërë gjuimi".

"E kam parë shenjën", tha Roskusi.

"Shenjën se T. P. e ka zënë taksirati e do ta ketë barrë punën tënde", tha Dilzi. *Çoje, atë e Kuentinën atje në shtëpi. T. P., të lozin me Llasterin. Froni i ruan, kurse ti kthehu t'i ndihmosh babait.*

Hëngrëm bukë. T. P. e mori Kuentinën në supe, pastaj vajtëm te shtëpia e T. P. Llasteri po luante në baltë. T. P. e lëshoi, kështu që edhe ajo zuri të lozte në baltë. Llasteri i kishte disa rrotka, andaj ai e Kuentina u përleshën për shkak të tyre, e tekefundit, i shtiu në dorë Kuentina. Llasteri zuri të qante. Atë çast, erdhi Froni dhe ia fali një kuti konserve për lojë, e pastaj, rrotkat i mora unë, Kuentina u rrah me mua, unë ia plasa vajit.

"Hesht". tha Froni. "Si s'të vjet turp. Ia rrëmben lodrën fëmijës". Ajo i mori rrotkat nga unë dhe ia ktheu Kuentinës.

"Mjaft", tha Froni. "Pusho kur të them".

"Mbylle gojën", tha Froni. "E ke hak kamxhikun, po qe besa". E mori Llasterin e Kuentinën. "Eja", tha ajo. Shkuam te ahuri. T. P. po milte lopën. Roskusi ishte ulur mbi një arkë.

"Ç'e gjet tash", tha Roskusi.

"Duhet ta mbani këtu", tha Froni. "Rrahet me fëmijët përsëri. Ua rrëmben lodrat. Rri këtu pak me T. P. se mos pushon së qari njëherë".

"Pastroje mirë atë gji", tha Roskusi. "Dimrin e shkuar, e mole më kot atë lopë. Nëse edhe këtë s'di ta mjelësh do të mbetemi pa qumësht".

Dilzi po këndonte.

"Jo matanë", tha T. P. "A s'di se mamaja ta ka ndaluar të shkosh atje".

Po këndonin.

"Eja", tha T. P. "Të lozim me Kuentinën e Llasterin. Ejani".

Kuentina e Llasteri po loznin me baltë para shtëpisë së T. P. Në shtëpi, ishte ndezur zjarri, flaka ngjitej e lëshohej, kurse pranë saj Roskusi dukej i zi pis.

"Lavdi zotit, tre janë", tha Roskusi. "Të thashë para tre vjetësh. Fati e ka lënë këtë shtëpi. Është e nemur".

"Pse rri këtu pra", tha Dilzi. Ajo zuri të më zhveshte. "Me pallavrat e tua mbi fatkeqësinë u bëre shkak që Vershi të shkonte në Memfis. Si duket t'u ka bërë qejfi".

"Po të kishte qenë vetëm kjo fatkeqësia e Vershit", tha Roskusi.

Ia behu Froni.

"I kreve punët", tha Roskusi.

"Do t'i kryej T. P.", tha Froni. "Zonjusha Kehlajn kërkon që ta vesh në gjumë Kuentinën".

"Po ngutem sa po mundem", tha Dilzi. "Do të duhej ta dish se unë s'kam krah".

"Këtu e pata edhe unë", tha Roskusi. "S'ka fat në shtëpinë ku s'përmendet emri i ndonjë fëmije të tyre".

"Mbylle", tha Dilzi. "Mos deshe t'ia nis avazit".

"E rrit fëmijën e ky s'ia di emrin as së ëmës", tha Roskusi.

"Pse e vret mendjen për të", tha Dilzi. "Unë i rrita të gjithë, ndaj mendoj se mund të rris e të mbaj edhe një fëmijë. Lëri dënglat. Le të flejë kur t'i teket".

"Si t'i di emrat", tha Froni. "Ai s'di emrin e askujt".

"Vetëm thuaji pa të shohim se a i di apo jo", tha Dilzi. "Thuaji kur të flejë e ja ku të them se do të të dëgjojë".

"Di më shumë se ç'pandehin njerëzit", tha Roskusi. "Dinte kur erdhi çasti i tyre i fundit, si ndonjë zagar. Po të dinte të fliste do të qe në gjendje të ta thotë se kur do të vijë çasti i tij i fundit. Apo i tij. Ose imi".

"Merre Llasterin nga ai krevat, mami", tha Froni. "Ai djalë mund t'i bëjë magji".

"Rrudhe të shkretën", tha Dilzi. "Ku i ke mendët? Mos lojte? Pse i dëgjon dokrrat e Roskusit. Flij, Benxhi".

Dilzi më shtyri, unë u shtriva në krevat ku ishte Llasteri. Ai flinte. Dilzi mori një dërrasë të gjatë dhe e vuri mes Llasterit e meje. "Mos kalo në anën tjetër", tha Dilzi". Llasteri është i vockël, prandaj ruaju se e nguc".

Ende s'bën të shkosh", tha T. P. Prit.

Po vështronim pas qipit të shtëpisë çejzen që po nisej.

"Ashtu", tha T. P. E mori Kuentinën. Filluam të ngarendim kah qoshku i gardhit duke mos i shqitur sytë nga çejza që po largohej. "Ja ku është", tha T. P. "Shikoje atë me syze. Pa shikoje. Ja ku është. Shikoje".

Vemi, tha Llasteri, unë e marr këtë top në shtëpi, atje s'e humbas dot. Jo, zotëri, s'bën ta merrni ju. Nëse ata e diktojnë te ju topin, do të thonë se e keni vjedhur. Eja në vete. S'mund ta jap. Ç'do të bëje me të, tekefundit. Ti s'di të lozësh me top.

Froni dhe T. P. luanin me baltë pranë derës. T. P. kishte xixëllonja në shishe.

"Si dolët jashtë sërish", tha Froni.

"Kemi mysafirë", tha Kedi. "Baba tha se sonte duhet të më dëgjoni të gjithë. Shpresoj se edhe ti me T. P. do të më dëgjoni".

"Unë s'ta var torbën", tha Xhesoni. "S'janë të detyruar të të dëgjojnë as Froni e T. P.",

"Do të më dëgjojnë, nëse u them unë", tha Kedi. "Por, mbase s'u them të më dëgjojnë".

"T. P. s'ia var veshin askujt", tha Froni. "Ia nisën funeralit".

"Ç'është funerali", tha Xhesoni.

"A s'të ka thënë mami që mos t'u flasësh për këtë", tha Vershi.

"Atje ku rënkojnë", tha Froni. "Dy ditë rënkuan e vajtuan për motrën Bejlah Klej".

Rënkonin në shtëpinë e Dilzit. Qante edhe Dilzi. Derisa po

qante Dilzi, Llasteri tha: Rrudheni, ndaj, ne heshtëm, dhe atë çast unë u zhgreha në vaj, kurse Bluji zuri të këlthiste te parmakët e shkallëve. Atëbotë Dilzi, pushoi së vajtuari, kështu, pushuam edhe ne.

"Oh", tha Kedi, "Kështu e kanë adet zezakët". "Të bardhët s'kanë funerale".

"Mami ma ka thënë të mos u flasim për këtë, Froni", tha Vershi.

"Përse të mos flisni", tha Kedi.

Dilzi gjëmonte dhe me të arritur në shtëpi. Unë ia plasa vajit, e edhe Bluji po këlthiste nën shkallë. Froni tha nga dritarja: Llaster, çoji poshtë në stallë. S'kam si ta bëj gjellën në këtë farë vigme. Merre edhe qenin. Çoji poshtë.

S'shkoj poshtë, tha Llasteri. Atje bën vaki e gjej babushin tim. Mbrëmë e pashë duke bërë me dorë në plevicë.

"Dua të di se çfarë s'guxoj t'u them", tha Froni. "Edhe të bardhët vdesin. Ma ha mendja se gjyshi yt ka vdekur ashtu si mund të vdesë çdo zezak".

"Qentë ngordhin", tha Kedi, "dhe kur Nensi ra në hendek dhe Roskusi e vrau, gjeraqinat ia behën e filluan ta copëtojnë".

Skeleti dukej në hendek ku kishte bimë të zeza në atë hendekun e zi. Skeleti kishte dalë nën dritën e hënës, si të ishin ndalur disa shajni. Atëherë, u ndalën të gjithë, gllabëroi errësira, dëgjova mamën dhe rrapëllimën e hapave të saj sesi po largoheshin me nxitim, këtë mund ta kundërmoja. Pastaj, ia behu dhoma, por, sytë m'u mbyllën: S'u ndala. Mund ta kundërmoja. T. P. e nxori gjilpërën nga çarçafët.

"Hesht", tha ai. "Shshsht...".

Mirëpo, unë mund t'ia merrja erën. T. P. më rroku e fët e fët më veshi.

"Rri urtë, Benxhi", tha "Po shkojmë poshtë, në kasollen tonë. Ti ke qejf të vijsh atje, në kasollën tonë ku banon Froni. Hesht. Shshsht".

M'i lidhi tojat e këpucave, ma vuri kapelen dhe dolëm. Në korridor drita ishte e ndezur. Në skajin e korridorit mund ta dëgjoje Nënën.

"Shshsht, Benxhi", tha T. P. "Dolëm sa hap e mbyll sytë".

U hap një derë, kurse unë mund ta kundërmoja më fort se kurrë, një kokë u dukë. S'ishte Babai. Babai ishte i sëmurë, i shtrirë, atje.

"A mund ta qesësh pak nga shtëpia".

"Shi tash po dalim", tha T. P. Dilzi iu ngjit shkallëve.

"Mbylle", tha ajo. "Hesht. Çoje në shtëpinë tonë, T. P. Froni ia rregullon krevatin. Ruajeni. Rrudhe, Benxhi. Shko me T. P.

Shkonte andej ku e kishimi dëgjuar Nënën.

"Më mirë mbaje atje". S'ishte Babai. Ai e mbylli derën, mirëpo unë ende mund t'ia jmerrja erën.

Po zbrisnim shkallëve. Shkallët lëshoheshin në errësirë, ndaj T. P. më mori për dore, ne dolëm jashtë, nga errësira. Deni kishte ngecur dhe çirrej në kupë të qiellit.

"Ai e kundërmon atë", tha T. P. "Kështu e zbulove ti".

Zbritëm shkallëve, atje ku i kishim hijet tona.

"Harrova pallton tënde", tha T. P. "Të nevojitet. Por, s'është punë të kthehem e ta marr".

Deni çirrej.

"Rrudhe të shkretën", tha T. P. Hijet tona lëviznin po hija e Denit s'lëvizte, pos kur çirrej.

"S'mund të të çoj në shtëpi, po ulurove ashtu", tha T. P. "Kemi pasur me ty kokëçarje edhe para se ta lëshoje atë kuakamë prej bretkose. Vemi"!

Po ecnim monopatit të shtruar me tulla, ndërsa hijet tona s'na ndaheshin. Stela e derrave kundërmonte erë derrash. Lopa gjendej në livadh duke na shikuar e duke përtypur. Deni po çirrej.

"Do ta zgjosh tërë qytezën", tha T. P. "A s'bën të pushosh së çjerri".

E pamë Fensin që po kulloste buzë përroit. Hëna po pasqyrohej në ujë kur arritëm atje.

"Hej, zotërote", tha T. P. "Shumë afër e kemi. S'mund të ndalemi këtu. Shkojmë. Pa shikohu njëherë. E ke lagur tërë këmbën. Shkojmë. "Deni po sokëllinte.

Hendeku qiste krye nga bari gumëzhitës. Skeleti shihej në hardhitë e zeza.

"E mirëpra", tha T. P. "Çirru në daç sa të duash. Ke tërë natën e njëzet pendë livadhi për të uluritur".

T. P. u shtri në hendek, kurse unë u ula e fillova ta shikoj skeletin ku kaçubetat hanin Nensin, sesi po eponin herë duke u lëshuar, herë duke u ngritur mbi hendekun ashtu të zi, të ngathët e të rëndë.

E kisha kur qemë këtu, më parë, tha Llasteri. Bile ta tregova. A s'e ke parë. E nxora nga xhepi, pikërisht këtu e ta tregova.

"Kujton se kaçubetat do ta zhvatin gjyshen", tha Kedi. "Ti paske lojtur mendsh".

"Ti je hajvan", tha Xhesoni. Ai u zhgreh në vaj.

"Ti je i krisur", tha Kedi. Xhesoni qante. Duart i kishte në xhepa.

"Xhesoni bëhet i pasur", tha Vershi. "Ai ngaherë i mban paratë në xhep".

Xhesoni vajtonte.

"Tash ti e detyrove të qante", tha Kedi. "Qetësohu, Xheson. Si mund të hyjnë kaçubetat atje ku ndodhet gjyshja. Babai s'do t'i lëshonte. As ti s'do ta lejoje kaçubetin të të hante. Mos ashtu".

Xhesoni pushoi së vajtuari. "Froni tha se pat funeral", tha ai.

"Por, s'ka funeral". tha Kedi. "Është ndejë. Froni s'di gjë. Ai ka qejf të t'i grabisë xixëllonjat e tua: T. P. le t'i mbajë një grimë".

T. P. ma dha shishezën me xixëllonja.

Vë bast, në shkofshim të shikojmë nga dritarja e sallonit, do të diktojmë diçka", tha Kedi. "Atëherë, do të më besoni".

"E di mirë", tha Froni. "S'ka nevojë t'i shoh".

"Më mirë rrudhe gojën, Froni". tha Vershi. "Mami do të ta ndreq samarin".

"Ç'ka ngjarë", tha Kedi.

"Di atë që di", tha Froni.

"Hajdeni", tha Kedi, "shkojmë para shtëpisë".

U nisëm.

"T. P. i lyp xixëllonjat e tij", tha Kedi.

"Le t'i mbajë edhe pak, T. P.", tha Kedi. "T'i kthejmë".

"Kurrë s'do t'i shtini në dorë", tha Froni.

"Në thënça se ti dhe T. P. mund të vini po ashtu, a i lë edhe pak", tha Kedi.

"Asnjëri s'më ka thënë as mua dhe as T. P. që duhet të të dëgjojmë", tha Froni.

"Në thënça të mos më dëgjoni, a ia lini edhe pak", tha Kedi.

"Në rregull", tha Froni. "Le t'i mbajë. Jepja, T. P. Shkojmë t'i shohim sesi gjëmojnë".

"S'gjëmojnë", tha Kedi. "Ja ku ju them se kanë ndejë. A gjëmojnë, Versh"?

"Duke qëndruar këtu s'do të dimë se ç'bëjnë", tha Vershi.

"Shkojmë", tha Kedi. "Froni dhe T. P. s'është e thënë të më dëgjojmë. Mirëpo, të tjerët, s'kanë çare pa më dëgjuar. Më së miri e ke ta marrësh atë, Versh. Po bie terri".

Vershi më mori dhe u nisëm në kuzhinë.

Në çastin që shikuam pas qoshkut, i vumë re dritat që vinin nga rruga, T. P. u kthye kah dera e bodrumit dhe e hapi.

Dini se çfarë ka brenda, tha T. P. Sodë. E pashë zoti Xhesonin duke shkuar lart me plot e përplot shishe. Pritni një hop.

T. P. shkoi ta shihte derën e kuzhinës. Dilzi i tha, çka i fut këtu turinjtë. Ku e ke Benxhin.

Këtu jashtë është, tha T. P.

Hajde, ruaje, tha T. P.

Mos e lër të hyjë në shtëpi.

Mirë, tha T. P. A ia nisën.

Shko e çoje diku çunin, tha Dilzi. Unë jam shumë e zënë, s'di si t'ia bëj.

Nga një vrimë, nën shtëpizë, zuri të zvarisej një gjarpër. Xhesoni tha se s'ua kishte frikën gjarprinjve, kurse Kedi tha se ai kishte frikë, ndërsa ajo s'ua kishte frikën, ▪ Vershi tha se kishin frikë të dytë, kurse Kedi tha të rrinin urtë, ashtu si kishte urdhëruar babai.

Mos ia nis sfilitjes, tha T. P. A do pak sasprillah?

M'i guduliste hundën dhe sytë.

Nëse s'e pi, ma jep, tha T. P. Ja pra. Më së miri të marrim edhe një shishe derisa s'na pengon askush. Por, kij kujdes e rri urtë.

U ndalëm nën drurin e dritares së sallonit. Vershi më lëshoi në barin e lagësht. Bënte ftohtë. Në të gjitha dritaret, kishte dritë.

"Atje është gjyshja", tha Kedi. "Tash, për ditë, e sëmurë është. Si të shërohet, do të shkojmë në piknik".

"E di atë që di". tha Froni.

Drurët po zukatnin, si bari.

"Në atë dritaren pranë asaj, ne e morëm fruthin". tha Kedi. "Po ti e T. P. ku e morët fruthin, Froni"?

"Mendoj se e morëm këtu, ku ndodhemi tash", tha Froni.

"Ende s'ia kanë nisur", tha Kedi.

Tash ia nisin, tha T. P. Prit ti këtu derisa ta sjell atë arkë kështu që do të mund të shikojmë nga dritarja. Ta pimë këtë sasprillah. Brenda e ndiej veten si orli.

E pimë sasprillahun, kurse T. P. pastaj e shtyri shishen nëpër kangjella nën shtëpi, e dikur, shkuam. Mund t'i dëgjoja në sallon, ndaj u mbështeta me duar për muri. T. P. e solli arkën. U rrëzua dhe ia plasi gazit. Kishte rënë e po qeshte në bar. U ngrit, e tërhoqi arkën nën dritare, duke mos qeshur më.

"Pata frikë se do t'ia plaste vajit", tha T. P. "Ngjitu në arkë e shiko se mos kanë filluar".

"S'ia kanë filluar ende, ngaqë muzika s'ka arritur", tha Kedi.

"S'do të ketë muzikë", tha Froni.

"Ku e di ti", tha Kedi.

"E di atë që di", tha Froni.

"Ti s'di asgjë prej gjëje", tha Kedi. Iu afrua trungut të drurit. "Më ndihmo të ngjitem në të, Versh".

"Babai të tha t'i shporresh atij druri", tha Vershi.

"Kaherë e ka thënë këtë", tha Kedi. "Kujtoj se tashmë e ka harruar. Fundja, tha se sonte më dëgjoni mua. A s'ju ka thënë se sonte lipset të më dëgjoni".

"Unë s'ta var torbën", tha Vershi. "Ti do të hash dajak, unë jo". U afrua dhe e ngriti Kedin në degën e parë të drurit. Ia pamë brekët e saj të papastra. Pastaj, s'e pamë më. Dëgjuam se si kërcëllente druri.

"Zoti Xhesoni tha se nëse e then atë dru, ai do të të rrahë", i tha Vershi.

"Do ta kallëzoj atë", tha Xhesoni.

Druri s'kërcëllinte më. I shikonim gjethet e pashitura.

"A sheh gjë", pëshpëriti Froni.

I pashë. Atëherë e pashë Kedin, me lule në flokë dhe me vellon e gjatë si pubia e shkëlqyeshme. Kedi Kedi.

"Hesht", tha T. P. "Të dëgjojnë. Zbrit shpejt". Më tërhoqi. Kedi. Unë e mbështeta me duar Kedin përmuri. T. P. më tërhoqi.

"Hesht", tha ai. "Hesht. Eja këtu, menjëherësh". Ai më tërhiqte më tutje. Kedi "Rrudhe gojën, Benxhi. Do të të dëgjojnë. Të pimë edhe një grimë sasprillahun, e pastaj, kthehemi nëse ri urtë. Më mirë të marrim edhe një shishe, përndryshe do të ulurojmë të dytë. Më duket se Deni u bë tapë. Zoti Kuentin thotë se Deni qenka shumë inteligjent, ndaj mund të themi se di ta pijë edhe sasprillahun".

Hëna po binte tatëpjetë shkallëve të bodrumit. Ne ende, e pinim sasprillahun.

"Dini se ç'do të doja unë", tha T. P. "Do të doja që t'ia behte dera e bodrumit një ari. Dini se ç'do të bëja. Do të brofja e do t'i pështyja në sy. Ma jep atë shishe ta mbyll gojën qe besa fillova të uluroj".

T. P. ra. Zuri të qeshte, kurse dera e bodrumit dhe hëna, kërcyen e mua më goditi diçka.

"Mos bëzaj", tha T. P., duke e përmbajtur të qeshurit. "Pasha zotin, do të na dëgjojnë të gjithë. Horë u bëmë. Çohuni", tha T. P. "Çohu mor Benxhi, shpejt". Ai po valavitej në bar e po qeshte, ndërsa unë doja të çohesha. Shkallët e bodrumit po vraponin kodrës së hënës, kurse T. P. po rrëkëllehej kodrës, në hënë, ndërsa unë vrapoja gardhit, e T. P. s'më ndahej duke më thënë: "Hesht, rrudhe". Atëherë ai ra në lule duke u kikirisur së qeshuri, kurse unë mora n'thua në arkë. Mirëpo, kur bëra të hipja mbi të, arka kërceu e më qëlloi në qafë, kurse unë ia plasa vajit, e po në atë çast, ulurova. Përsëri u çova, prandaj, s'doja të ngrihesha, ndërsa T. P. më tërhiqte. Ai zë më dilte gjithnjë, kështu që unë s'dija në qaja apo jo, e T. P. m'u turr duke qeshur, ndërsa gërmazi im s'pushonte, ■ Kuentini e qëllonte T. P. me shkelm, kurse Kedi më përqafoi me duar ■ me vellon e saj të shkëlqyeshëm, mirëpo, unë s'e ndieja më erën ■ drurit, ndaj fillova të qaja.

Benxhi, tha Kedi, Benxhi. Më përqafoi përsëri, mirëpo, unë u largova. "Ç'ka ngjarë, Benxhi", tha. "Është kjo kapelë". E hoq kapelën, përsëri erdhi por unë u largova.

"Benxhi", tha, "ç'ka ngjarë. Ç'bëri Kedi".

"Ai s'i do ato rroba të pispillosura", tha Xhesoni. "Pandeh se je e ritur, hijerëndë". Kujton se je më e mirë se të tjerat. Moj zuskë". "Qepe ti atë të shkretën", tha Kedi. "Ti je një gdhë e asgjë tjetër, Benxhi".

"Vetëm pse i ke mbushur të katërmbëdhjetat, kujton se u rrite apo jo", tha Xhesoni. "Beson se je dikushi. Apo jo".

"Mbylle, Benxhi", tha Kedi. "Do ta merakosësh nënën. Qepe"!

Mirëpo, unë s'pushoja, e, kur u nis ajo, unë s'iu shqita, prandaj ajo u ndal te shkallët, priti një copë herë. U ndala edhe unë.

"Ç'ka ndodhur, Benxhi", tha Kedi. "Thuaji Kedit. Ajo të dëgjon. Vetëm thuaji".

"Kandas", thirri Mama.

"Urdhëro, Mamë", bëri Kedi.

"Pse e nguc", tha Mama. "Sille këtu".

Shkuam te dhoma e Mamës ku ajo ishte shtrirë e sëmurë, me fund mbi kokë.

"Ç'ndodhi kësaj radhe", tha Mama. "Benxhamin".

"Benxhi", tha Kedi. Erdhi përsëri, por unë shkova.

"Duhet t'i kesh bërë diçka", tha Mama. "Pse s'e lë të qetë që të jem rehat edhe vetë. Jepja atë kuti, eja këtu të lutem e mos e nga".

Kedi e mori kutinë, e vuri në dysheme dhe e hapi. Në të kishte shumë yje. Kur mija urtë, yjet s'lëviznin. Sapo lëvizja, ato shkëlqenin e xixëllonin. Unë gjëmoja.

Atë çast e pashë Kedin duke u larguar, ndaj ia krisa avazit përsëri.

"Benxhamin", tha Mama. "Eja këtu". Shkova pranë derës. "Mor Benxhamin", tha Mama.

"Ç'ndodhi", tha babai. "Kah po ia mban"?

"Çoje poshtë dhe gjeje dikë që të kujdeset për të, Xheson", tha nëna. E di se jam e sëmurë, megjithatë s'më lë rehat".

Babai e mbylli derën pas nesh.

"T. P.", tha ai.

"Urdhëroni", tha T. P. nga poshtë.

"Benxhi po vjen", tha babai. "Shko me.T. P."

Kalova afër derës së banjos. E dëgjova gurgullimën e ujit.

"Benxhi", tha T. P. nga poshtë.

E dëgjoja gurgullimën e ujit. Mbaja vesh.

"Benxhi", tha T. P. nga poshtë.

E dëgjoja ujin.

Tash s'mund ta dëgjoja më gurgullimën e ujit dhe sakaq Kedi e hapi derën.

"Hej, Benxhi", tha ajo. Më hodhi një vështrim, unë bëra të nisem, kurse ajo më përqafoi. "A e gjetët përsëri Kedin", tha ajo. A mos kujtove se të ka ikur Kedi". Kedit i vinte era e lisave.

Hyj në dhomën e Kedit. Ajo u ul para dritares. I largoi duart dhe më shikoi.

"Mor, Benxhi, ç'ke", tha ajo. "Mos qaj. Kedi s'të ikën. Pa shih se ç'ka këtu", tha ajo. Ajo e mori një shishe, ia nxori shtupën dhe ma ofroi në hundë. "Erë e këndshme. E mirë".

Unë zura të largohesha pa bërë gëk me gojë, kurse ajo ende e mbante shishen në dorë dhe nuk e shqiste shikimin nga unë.

"Oh", tha ajo. Ajo e lëshoi shishen dhe më përqafoi përsëri. "Ashtu na qenka puna. Doje t'i tregoje Kedit tënd për hallin që kishe, por s'ia dole dot. U përpoqe të më thuash diçka, por nuk pate se si. U mor vesh, Kedi s'e bën këtë punë. Ta merr mendja Kedi s'të lë në baltë. Prit një çast sa të vishet".

Kedi u vesh, mori shishen përsëri dhe ne zbritëm në kuzhinë.

"Dilzi", tha Kedi, "Benxhi të ka sjellë një peshqesh". Ajo u përkul dhe e vuri shishen në dorën time. "Jepi Dilzit". Kedi e çoi dorën time dhe Dilzi e mori shishen.

"Pa shih pashë zotin", tha Dilzi. "Çuni im ia fali Dilzit një shishe me parfum. Pa shiko, Roskus".

Kedit i vinte era e lisave. "Ne s'i kemi në qejf parfumet", tha Kedi.

Asaj i vinte era e lisave.

"Mjaft më", tha Dilzi. "Ti je tepër i madh që të flesh me dikë. Je çun i rritur. I ke mbushur të trembëdhjetat. Mund të flësh vetëm në dhomën e xha Morit", tha Dilzi.

Xha Mori ishte i sëmurë. I kishte të sëmurë syrin dhe gojën. Vershi ia çoi darkën atje, me tavëll.

"Mori thotë se do ta vrasë pushkë atë rezil", tha babai. "Unë i thashë se më mirë e ka të mos ia përmendë këtë punë Petersonit". Ai po pinte.

"Xheson", tha nëna.

"Kë do ta vrasë, baba, tha Kuentini. "Pse xha Mori kërkon ta vrasë dikë"?

"Sepse ai nuk e ka kuptuar shakanë", tha babai.

"Xheson", tha nëna, "si mund të mendosh një gjë të këtillë. Do të rrish duarkryq e do ta bësh sehir xha Morin në pusi duke buzëqeshur".

"Atëherë Mori e ka më mirë të mos ia zërë pusinë", tha babai.

"Kë do ta vrasë, baba", tha Kuentini. "Kënd do ta vrasë xha Mori"?

"Askënd", tha babai. "Unë s'kam as revole".

"Nëna u zhgreh në vaj. "Nëse të dhimbset buka që ia jep Morit, pse s'bëhesh burrë e s'i thua sheshazi në fytyrë. S'ka kuptim ta përqeshësh para fëmijëve, pas shpinës së tij".

"U mor vesh se s'po e përqesh", tha babai. "Unë e admiroj Morin. Ai është njeri i rrallë sipas ndjenjës sime të superioritetit racial. Unë s'do ta fyeja Morin. A e di përse, Kuentin".

"Jo, zotëri", tha Kuentini.

"Et ego in arcadia, kam harruar si i thonë sanës në latinishte", tha babai. "Mirë de, mirë", tha ai, "u mahita". Ai po pinte e pastaj e la gotën, iu afrua nënës dhe e preku me dorë në sup.

"Kjo s'është kurrfarë mahie", tha nëna. "Edhe pjesëtarët e familjes sime janë po aq sojnikë si familja jote. Janë krijesa të gjalla, gjallojnë në kalbësirë, Versh".

"Urdhëroni", tha Vershi pas karriges sime.

"Merre shishen dhe mbushe".

"Thuaji Dilzit të vijë ta marrë Benxhaminin e ta çojë për të fjetur", tha nëna.

"Ti je çunak i rritur", tha Dilzi, "Kedi u mërzit më duke fjetur me ty. Mos bëzaj dhe eja të flesh". Dhoma u zhduk, mirëpo unë nuk pashitesha, prandaj dhoma u kthye, Dilzi u kthye dhe u ul në krevatin tim duke më shikuar.

"A po bëhesh djalë i mirë, a po e mbyll gojën", tha Dilzi. "Ti s'po hesht, apo. Më prit një copë herë".

Ajo iku. Në derë nuk shihej asgjë. Pastaj, pa pritur e pa kujtuar Kedi ia behu nga dera.

"Rrudhe", tha Kedi. "Erdha".

Unë heshta, kurse Dilzi e ktheu jorganin, e Kedi u rras mes jorganit dhe çarçafit. Ajo nuk i kishte zhveshur kostumet e larjes.

"Ja pra", tha ajo. "Ja ku jam". Dilzi iu afrua me jorgan dhe e shtriu mbi të duke e mbështjellë atë mirë e mirë.

"Tash e zë gjumi", tha Dilzi. "Në dhomën tënde po e lë dritën të ndezur".

"Ani mirë", tha Kedi. Ajo mbështeti kokën për kokën time në jastëk. "Natën e mirë, Dilzi".

"Natën e mirë, shpirt", tha Dilzi. Dhomën e kaploi errësira. Kedit i vinte era e lisave.

Ne po e shikojmë atë atje në lis.

"Ç'shikon ajo, Versh", pëshpëriti Froni.

"Shhhhhhh", tha Kedi nga lisi. Dilzi tha:

"Pa eja këtu". Ajo iu afrua këndit të shtëpisë. "Pse nuk shkoni lart, të gjithë, si u tha babai, në vend që të përvidheni pas meje. Ku është Kedi dhe Kuentini".

"I thashë të mos kacavaret në atë lis", tha Xhesoni. "Do t'i kallëzoj babait".

"Kush në çfarë lisi hipi", tha Dilzi. Ajo u afrua dhe e shikoi lisin. "Kedi", tha Dilzi. Degët e lisit filluan të shkundeshin përsëri.

"Moj, shejtane", tha Dilzi. "Hajde, zbrit".

"Hesht", tha Kedi, "a s'të kujtohet se ç'na tha babai. Ai na

tha se mos bëjmë shamatë". U dukën felat e saj, kurse Dilzi u kacavar deri te ajo dhe i ndihmoi të zbriste nga lisi.

"A s'ke punë tjetër më të mençur se t'u lejosh që të vërtiten këtejza". tha Dilzi.

"S'dija ç'të bëja me të", tha Vershi.

"Epo ç'dreqin po bëni këtu", tha Dilzi. Kush ju tha të vini në shtëpi".

"Ajo", tha Froni. "Ajo na tha".

"Kush ju tha ta dëgjoni atë", tha Dilzi. "Hajdeni në shtëpi tash". Froni dhe T. P. shkuan. Ne nuk i pamë më.

"Jemi jashtë në mesnatë", tha Dilzi. Ajo më mori me vete dhe shkuam në kuzhinë.

"Po përvidheni pas shpinës sime", tha Dilzi. "Edhe pse e di se, të ka kaluar koha e gjumit".

"Pëssssss, Dilzi", tha Kedi. "Mos fol me zë të lartë. Duhet të kemi kujdes".

"Rrudhe ti gojën e mos fol", tha Dilzi. "Ku është Kuentini"?

"Kuentini është e mllefosur, sepse mbrëmë iu desh të më dëgjonte", tha Kedi. "Ende s'ia ka kthyer xixëllonjat T. P.".

"Ma ha mendja se T. P. bën edhe pa to", tha Dilzi. "Shko e gjeje Kuentinin, Versh. Roskusi thotë se e ka parë duke shkuar kah Plevica", vazhdoi Vershi. Ne s'na ra në sy.

"Epo s'kam kurrfarë pune atje", tha Kedi. "Ulen vetëm dhe shikojnë".

"S'kanë nevojë për ndihmën tënde", tha Dilzi. Ne po shëtisnim afër kuzhinës.

Kah do t'ia mbash, tha Llasteri. A shkon t'i shikosh sesi e godasin topin. Ne i pamë atje. Prit një çast. Prit këtu derisa të kthehem e ta marr topin. Më ra në mend diçka.

Kuzhinën e kishte kapluar errësira. Lisat ishin të errët në qiell. Deni u degëdis duke dalë nën shkallë dhe filloi ta përtypte nyjën e këmbës sime. Unë iu afrova pjesës së kuzhinës ku gjendej hëna. Deni m'u qep pas, duke shikuar hënën.

"Benxhi", tha T. P. nga shtëpia.

Pema afër dritares kishte çelur behar dhe nuk ishte e errët, mirëpo lisat e trashë ishin të errët. Bari shushuriste nën dritën e hënës aty ku hija ime po bridhte në bar.

"Hej, Benxhi", tha T. P. nga shtëpia. "Epo ku po fshihesh. Po dredhon. E di".

Llasteri u kthye. Prit, tha ai. Këtu. Mos shko atje. Zonjusha Kuentin dhe jarani i saj janë në atë çrregull... Eja këtej. Ktheu mor, Benxhi.

Nën lisa kishte kapluar errësira. Deni nuk po vinte. Ai qëndronte nën dritën e hënës. Si e pashë çrregullinë ia plasa vajit.

Mos shko atje Benxhi, tha Llasteri. Ti e di se zonjusha Kuentin do të hidhërohet pamasë.

Tash ishin dy veta, por befas mbeti vetëm njeri në çrregull. Kedi erdhi me vrap, ashtu e bardhë në errësirë.

"Benxhi", tha ajo. "Kah pike këtu? Ku është Vershi"?

Ajo më përqafoi, unë heshta, u ngjita për fustanin e saj dhe po orvatesha që ta tërhiqja pas vetes.

"Mor, Benxhi". tha ajo. "Ç'të gjeti? T. P.", bërtiti ajo.

Ai në çrregull u çua dhe na u afrua, unë ia plasa vajit dhe fillova ta ngre Kedin për fustani.

"Benxhi", i tha Kedi. "Është Çarli. A s'e njeh Çarlin"?

"Ku është zezaku i tij", tha Çarli. "Pse e lënë të endet vetëm"?

"Mjaft më, Benxhi", tha Kedi. "Hajt Çarli, largohu. Ai s'të do". Çarli bëri disa hapa dhe heshti. Unë ende e tërhiqja Kedin për fustanit.

"Dëgjo, Benxhi", tha Kedi. "A s'më lë pak të rri këtu e të kuvendoj me Çarlin një grimë".

"Thirre atë zezak", tha Çarli. Ai u kthye përsëri. Unë zura të çaja edhe më tepër e ta ngrehja Kedin për fustamit.

"Ik, Çarli", tha Kedi. Çarli iu afrua Kedit dhe e preku, kurse unë ia krisa avazit. Çaja me zë të lartë.

"Mos, mos", tha Kedi. "Mos. Aman".

"S'mund të flas", tha Çarli. "Kedi".

"A mos ke luajtur mendsh", tha Kedi. Ajo filloi të merrte frymë shpejt e shpejt. "Na sheh. Mos. Mos". Kedi po mbrohej. Që të dy po merrnin frymë disi shpejt. "Të lutem, të lutem", po belbëzonte Kedi.

"Le të qërohet prej këtu, thuaj", tha Çarli.

"Tash i them", tha Kedi. "Lëshomë".

"A e largon prej këtu", tha Çarli.

"Po", tha Kedi. "Lëshomë". Çarli u largua. "Hesht", i tha Kedi. "Ja, iku". Unë heshta. Mund ta ndieja atë dhe gjoksin e saj që po fryhej orë e çast.

"Duhet ta çoj në shtëpi", tha ajo. Më rroku për dore. "Vij përsëri", pëshpëriti ajo.

"Prit", tha Çarli. "Thirre zezakun".

"Jo", tha Kedi. "Kthehu. Hajde, Benxh".

"Kedi", pëshpëriti Çarli. Ne e vazhduam rrugën. "Më mirë e ke të kthehesh. A kthehesh". Kedi dhe unë u vumë në pikë të vrapit. "Kedi", tha Çarli. Ne po rendnim nëpër dritën e hënës, drejt kuzhinës.

"Kedi", tha Çarli.

Kedi dhe unë nuk po e ndalnim vrapin. U ngjitëm me vrap shkallëve të kuzhinës, hymë brenda, ku Kedi u gjunjëzua në errësirë dhe më shtrëngoi. Mund ta ndieja atë dhe fryrjen e gjoksit të saj. "S'bëj më", tha ajo. "Kurrë s'do të bëj më". Benxhi, Benxhi, Benxhi". Tash po qante, kështu që fillova të qaj edhe unë ashtu si ishim të shtrënguar për njëri-tjetrin". "Mos", tha ajo. "Mjaft. S'bëj më kurrë". Unë heshta, Kedi u ngrit, ne hymë në kuzhinë, e ndezëm dritën, Kedi e mori sapunin dhe filloi ta shplante gojën mbi lavaman. Kedit i vinte era e lisave.

A s'të thashë të mos shkosh atje, tha Llasteri. Ata sapo ishin ulur në çrregull. Kuentina i mbante duart në flokë. Ai kishte kravatë të kuqe.

Mor i çmendur, tha Kuentina. Do t'i them Dilzit se si ti i lejon që të më përcjellë kudo që shkoj. Ajo do të ta ndreqë samarin.

"S'pata si ta ndal". tha Llasteri. "Eja këtu, Benxhi".

"Ke mundur ta ndalësh". tha Kuantina. "As që të ka vajtur nga mendja". Të dytë më qepeni pas dhe më përgjoni. A s'u ka dërguar gjyshja që të më përgjoni". Ajo kërceu nga çrregulla. "Nëse nuk e largon menjëherë dhe e mban larg meje, do t'i them Xhesonit të të rrahë".

"S'kam ç't'i bëj", tha Llasteri. "Provo ti pale a do të mundesh".

"Mbylle atë çakallë", tha Kuentina. "A do ta lësh që të humbet"?

"Ah, le të rrjë", tha ai. Ai kishte një kravatë të kuqe. Dielli ishte i kuq në të. "Pa shiko, Xhek". Ai ndezi një shkrepës dhe e futi në gojë. Fill pastaj e nxori nga goja. Shkrepësa ishte ende e ndezur. "Pse s'po provon edhe ti", tha ai. Iu afrova. "Hape gojën", tha ai. Unë e hapa gojën. Kuentina preku shkrepësen dhe ajo u fik.

"Të marrtë djalli", tha Kuentina. "A mos deshe që t'ia nis përsëri avazit. A s'di ti se mund të çirret gjithë ditën e lume. Do t'i kallëzoj Dilzit se si po sillesh". Ajo u largua me vrap.

"Eja këtu, çun", tha ai. "Hej, kthehu. S'do ta nguc më".

Kuentina hyri me vrap në shtëpi. Ajo filloi të bënte varavinga nëpër kuzhinë.

"Bëre kokrrën e qejfit, Xhek", tha ai. "Apo jo"?

"S'të merr vesh", tha Llasteri. "Është shurdhmemec".

"Ashtu", tha ai. "Ka kohë që është i këtillë".

"Sot mbushen 33 vjet", tha Llasteri. "Ka lindur budalla. A mos jeni ju nga ata të cirkut"?

"Pse", tha ai.

"Me sa më kujtohet s'ju kam parë kurrë këtu", tha Llasteri.

"Po mirë, ani", tha ai.

"Jo, kurrgjë", tha Llasteri. "Sonte vij t'ju shoh".

Ai më shikonte.

"Mos je ti ai që loz me sharrë", tha Llasteri.

"Do të të duhet një çerek dollari që ta marrësh vesh këtë", tha ai. Ai më vështronte. "Pse s'e mbyllin diku këtë", tha ai. "Pse e merrni me vete".

"Kot e ke të flasësh me mua", tha Llasteri. "S'kam si t'ia bëj. Erdha këtu për ta kërkuar atë monedhë një çerekdollarëshe që e humba që të vij sonte në cirk. Si duket s'do të mund të vij fare". Llasteri po shikonte dheun. "Mos ke një çerekdollarëshe, rastësisht", tha Llasteri.

"Jo", tha ai. "S'kam".

"Mbase duhet ta gjej atë farë monedhe", tha Llasteri. Ai e futi dorën në xhep.

"Mos deshët të blenit një top të golfit", tha Llasteri. "Çfarë topi", tha ai.

"Top të golfit", tha Llasteri. "Më nevojitet vetëm një çerek dollari".

"Pse", tha ai. "Ç'të bëj me të"?

"S'mendoja se ju duhet", tha Llasteri. "Eja këtu mor kungull", tha ai. "Eja këtu të shohësh se si qëllohet topi. Ja diçka me të cilën mund të luash bashkë me atë tatulën tënde". Llasteri e mori dhe ma dha. Ajo shkëlqente.

"Ku e gjete", tha ai. Kravata e tij ishte e kuqe në diell kah po ecte.

"E gjeta këtu nën këtë kaçubë", tha Llasteri. "Pandehja se ishte monedha që e kisha humbur".

Erdhi dhe e mori atë.

"Mjaft", tha Llasteri. "Ta kthen me ta shikuar".

"Agnes Mejbëll Beki", tha ai. Në atë çast po e shikomte shtëpinë.

"Mos ki gajle", tha Llasteri. "Ta kthen patjetër".

Ai ma dha dhe unë heshta.

"Kush erdhi të shihet me të mbrëmë", tha ai.

"S'di", tha Llasteri. "Vijnë disa veta përnatë sa herë që ajo hip në atë lis. Unë s'u bie pas".

"Pse mos t'u biesh pas". tha ai. Po e shikonte shtëpinë. Fill pastaj shkoi dhe u ul në çrregull. "Qërohu", tha ai. "Hiqmu sysh".

"Eja këtu", tha Llasteri. "Ke bërë kokrrën e sefasë. Tash zonjusha Kuentinë do të qahet prej teje".

Iu afruam gardhit dhe filluam t'i shikojmë lulet. Llasteri po kërkonte diçka në bar.

"Pikërisht këtu më ka rënë", tha ai. E pashë flamurin se si po valonte dhe rrezet e diellit që po luanin në bar.

"Tash vijnë ata", tha Llasteri. "Janë edhe disa aty, por po shkojnë, më duket. Eja këtu e më ndihmo ta gjej atë".

Ne po ecnim pranë gardhit.

"Mjaft", tha Llasteri. "Si mund t'i detyroj të vijnë këtu, nëse nuk janë duke ardhur. Pa prit pak. Brenda disa minutash vijnë disa. Shiko. Ja ku vijnë".

Po ecja bri gardhit, kah porta, para së cilës kalonin vogëlushët me çantat e tyre. "Hej, Benxhi", tha Llasteri. "Kthehu mor".

Kot e ke që shikon prej parmakëve të portës, tha T. P. Zonjusha Kedi ka marrë një rrugë të gjatë. Është martuar dhe të ka lënë ty. S'ke si ta bën, mbahu sa të duash për parmakët e portës dhe qaj sa të mundesh. Ajo s'të dëgjon.

A thua ç'ju ka tekur, T. P., tha nëna. A s'mund të luash me të e ta paqtosh.

Kërkon të shkojë atje poshtë për të shikuar nga parmakët e portës, tha T. P.

Bah, s'ka sesi të shkojë, s'bën, tha nëna. Po bie shi. Më mirë luaj me të e ai s'bën zë. A, or Benxhamin.

S'është punë që të qetësohet, tha T. P. Ai kujton se nëse pret te dera, zonjusha Kedi mund të kthehet.

Budallallëk, tha nëna.

Dëgjoja zhabullimën e hapave të tyre. Dola para derës, por për çudi nuk i dëgjova më, prandaj shkova te porta, ku vogëlushet po kalonin me çantat e tyre. Ato po më shikonin duke ecur shpejt e shpejt, duke mos më shikuar fare. Desha t'u them diçka, mirëpo ato nuk ndaleshin, ndërsa unë po ecja pranë gardhit, duke u orvatur të them diçka, edhe pse ato ecnin edhe më shpejt. Në atë çast ato filluan të vrapojnë derisa unë arrita në qoshkun e gardhit, kështu që nuk mund të shkoja më tutje, prandaj u mbështeta për gardhi duke i vështruar ato dhe duke u munduar t'u them diçka.

"Hej, Benxhi", tha T. P. "Ç'bën or, aty; mos po ua mbath këmbëve. A s'di ti se Dilzi do të bëjë shpinën më të butë se barkun".

"Kot e ke të gjëmosh e të përqurravesh aty te gardhi", tha T. P. "Ua fute tmerrin fëmijëve. Pa shiko tash se si po kalojnë skajit tjetër të rrugës".

Si doli jashtë, tha babai. A mos e ke lënë derën e hapur kur hyre, Xheson.

Afër mendsh, jo, tha Xhesoni. Ti e di se unë s'jam aq i krisur. Mos kujton se m'u bë qejfi që ndodhi kjo. Kjo familje i ka punët sa s'ka më keq, veç zoti e di këtë. Unë do të të thosha ndoshta, por nuk e dija saktë. Ma merr mendja se tash e dërgon në atë çmendinë në Xhekson. Nëse s'e vret më parë Zonja Bargs.

Mbylle, tha babai.

Epo si s'të thash, tha Xhesoni.

Ajo ishte e hapur kur e preka, prandaj e mbaja në mugëtirë. Nuk qaja, po përpiqesha të ndalesha duke i vështruar vogëlushet që po bredhnin në mungëtirë. Nuk po qaja.

"Ja ku është".

Ato u ndalën.

"S'mund të dal. S'është i rrezikshëm, mos kini merak".

"Kam frikë, kam frikë. Kam frikë ta kaloj rrugën".

"S'mund të dal jashtë".

"Unë nuk po qaj".

"Mos u bëj si macja frikacake. Eja".

Ato po shëtisnin në mugëtirë. Unë nuk po qaja, isha mbështetur për derë. Ato po ecnin më rigadalë.

"Kam frikë".

"S'të bën gjë. Kaloj këtej pari përditë. Ai ecën vetëm përbri gardhit".

Po afroheshin.

Unë e hapa portën ndërsa ato u ndalën duke kthyer kokën në anën tjetër. Mundohesha të them diçka, gati e zura atë për t'i thënë diçka, mirëpo ajo këlthiti, kurse unë përpiqesha gjithmjë të them diçka, ndërsa trajtat e shkëlqyeshme zunë të ndalen dhe unë u përpoqa të dilja. U rropata t'u shporrem atyre trajtave, ta fsheh fytyrën time, mirëpo ato trajta të bardha po vërtiteshin përsëri rreth meje. Ato po i qepeshin kodrës prej nga rrokulliseshin kurse unë, i trembur, orvatesha të bërtisja. Por, si mora frymë mirë, u mbusha me frymë, vura re se nuk mund të lëshoja zë dhe u ruajta që të mos rrokullisesha tatëpjetë kodrës e të mos plandosesha në ato trajta të bardha, gjeratore.

Hej, kungull, tha Llasteri. Ja ku po vijnë disa. Mos rënko e mos bëj avaz.

Ato iu afruan flamurit. Ai e nxori flamurin ato e qëlluan atë, kurse ai përsëri e ktheu flamurin në vend.

"Zotëri", tha Llasteri.

Ai shikoi rreth e rrotull. "Çfarë", tha ai.

"Doni të bleni një top golfi", tha Llasteri.

"Ta shoh", tha ai. Ai iu afrua gardhit dhe Llasteri ia shtriu topin nga një vrimë e gardhit.

"Ku e more", tha ai.

"E gjeta", tha Llasteri.

"E dija", tha ai. "Ku? Në çantën e dikujt"?

"E gjeta atje në oborr", tha Llasteri. "Kërkoj një çerek dollari për të".

"Pse kujton se është yti", tha ai.

"E gjeta", tha Llasteri.

"Atëherë gjeje për vete një tjetër", tha ai. E futi topin në xhep dhe u largua.

"Sonte duhet të shkojmë në cirk", tha Llasteri.

"Ashtu", tha ai. Ai u largua pak. "Kape, çun", tha ai. Ai e qëlloi.

"Mo pashë zotin", tha Llasteri. "Ti ia nis avazit kur i sheh ato e kukat edhe kur nuk i sheh. Pse nuk hesht njëherë. A s'di ti se gjindja lodhen duke të dëgjuar tërë kohën, pareshtur. Merre. E kishe harruar tatulën tënde". Ai e ngriti nga dheu dhe

ma ktheu. "Të duhet një tjetër. Kjo t'u ka sosur". Ne qëndronim afër gardhit dhe po i vështronim ata.

"Zor të dilet në krye me atë njeri të marrë", tha Llasteri. "A pe sesi ma rrëmbeu topin". Ato po largoheshin. Ne po ecnim bri gardhit. Iu afruam kopshtit dhe u ndalëm. U mbështeta për gardh dhe zura t'i shikoj lulet. Ato po nguteshin dikah.

"Tash s'ke arsye të çirresh", tha Llasteri. "Rrudhe gojën, more. Unë duhet të çirrem, jo ti. E po pse s'e mban atë tatule. Përsëri do t'ia krisësh vajit". Më dha një lule. "Kah po ia mban tash"?

Hijet tona po shëtisnin nëpër bar. Ato arritën te lisat para nesh. Hija ime arriti e para. Pastaj ne arritëm, kurse hijet ikën prej nesh. Në shishe ishte një lule. Vura edhe një lule tjetër në të.

"A s'u rrite, a", tha Llasteri. "Ja po luan me dy lule në një shishe. A di ti or shul se ç'do të bëjnë me ty si të vdesë Zonjusha Kahlinë. Do të të dërgojnë në çmendimë, në Xhekson, atje ku e ke vendin. Zoti Xheson thotë jo. E ti atje kapu për parmakë sa të duash gjithë ditën e lume me torollakët edhe me qurramanët e tjerë. Po, qe besa".

Llasteri i preku lulet me dorën e tij dhe i rrëzoi ato. "Kështu do të sillen me ty në Xhekson kur t'ia nisësh ti vigmës".

Zura t'i mbledh lulet. Llasteri u përkul dhe i mori dhe ato u zhdukën. Unë u zhgreha në vaj.

"Çirru", tha Llasteri. "Çirru sa të duash. Hajde, çirru, Kedi". Pëshpëriti ai "Kedi. Bërtit deri në kupë të qiellit".

"Llaster", bërtiti Dilzi ngia kuzhina.

Lulet u kthyen në vendin e tyre.

"Trus", tha Llasteri. "Ja ku i ke lulet. Shiko. U kthyen aty ku ishin më parë. Pusho të them".

"Or, Llaster", tha Dilzi.

"Urdhëroni", tha Llasteri. "Erdhëm. U kënaqe së luajturi. Çohu". Ai më rrëmbeu për krahu dhe unë u çova. U larguam nga lisat. Hijet tona kishin marrë ikën.

"Rrudhe", tha Llasteri. "S'ke turp, po të shikojnë gjithë ata njerëz. Mbylle".

"Sille këtu", tha Dilzi. Ajo zbriti nga shkallët.

"Çka i bëre a thua", tha ajo.

"Po s'i bëra asgjë", tha Llasfteri. "Vetë ia nisi të çirret".

"Po, ti e nguce", tha Dilzi. "I bëre diçka. Ku ishit"?

"Atje nën ato qitra", tha Llasteri.

"Veç po e gërgitja Kuentinën", i tha Dilzit. "Pse nuk e largon nga ajo. A s'di ti se ajo s'ka qejf ta shohë këtë kur ha bukë".

"Mund të përkujdeset për të si unë", tha Llasteri. "Ai s'është daja im".

"Mos u bëj i pafytyrë, or zezak i dreqit". tha Dilzi.

"S'i kam bërë asgjë prej gjëje", tha Llasteri. "Ai luante atje dhe pa pritur e pa kujtuar ia krisi vajit".

"Me gjasë ia ke prishur atë varr që e ka bërë me duart e tij", tha Dilzi.

"S'ia kam prekur", tha Llasteri.

"Mos më gënje, or dejuz", tha Dilzi. Iu ngjitëm shkallëve e hymë në kuzhinë. Dilzi e hapi deriçkën e koftorit, afroi një stol pranë tij në të cilin u ula unë. Unë s'bëja gëk me gojë.

Pse e hidhëron atë, tha Dilzi. Pse s'e mban jashtë.

Ai po ■ shikonte zjarrin, tha Kedi. Nëna i tregonte sesi e kishte emrin e ri. Ne s'deshëm ta hidhëronim.

E di se s'ke dashur, tha Dilzi. Atë duhet mbajtur në një skaj të shtëpisë, kurse këtë në skajin tjetër. Mos i prekni lodrat e mia. Mos prekni asgjë derisa të kthehem.

"Të të vijë turp", tha Dilzi. "E nguc atë". Ajo e vuri tortën në tavolinë.

"Nuk e kam ngucur", tha Llasteri. "Ai luante me atë shishe përplot me bar dhe pa pritur e pa kujtuar ia krisi vajit. E dëgjove vetë".

"S'ia ke prekur lulet", tha Dilzi.

"S'ia kam prekur as varrin që e ka bërë nga dheu", tha Llasteri. "Ç'më duhen lodrat e tij. Unë e kërkoja atë monedhë".

"E paske humbur, apo jo", tha Dilzi. Ajo i ndezi qirinjtë mbi tortë. Disa prej tyre ishin të vegjël. Disa të tjerë ishin të mëdhenj, por të prerë në disa copa. "Të thashë që t'i lësh diku tjetër. Tash ndoshta t'u ka tekur që të marrë një tjetër prej Fronit".

"Duhet të shkoj në shfaqje, me Benxhin ose pa të". tha Llasteri. "S'kam ndërmend t'i lyhem pas ditë e natë".

"Do të bësh atë që kërkon nga ti, mor zijosh", tha Dilzi. "A më dëgjove".

"A s'e kam dëgjuar gjithmonë", tha Llasteri. "A s'e bëj gjithnjë atë që i teket atij. Apo jo, Benxhi".

"Atëherë vazhdo ta dëgjosh", tha Dilzi. "Kurse ti e sjell këtu,

që të çirret me qëllim që ta hidhërosh atë. Hajt tash, hani këtë tortë, para se të vijë Xhesoni. S'kam qejf që të më qortojë për këtë tortë të cilën e bleva me paratë e mia. Kur unë e bëj këtu pastën, ai njeh çdo vezë që gjendet në kuzhinë. Lëre të qetë tash djalin, mos e nga se përndryshe sonte nuk shkove në atë shfaqje".

Dilzi u largua.

"Ti s'ke takat t'i shuash qirinjtë". tha Llasteri. "Shikomë mua sesi do t'i shuaj". Ai u përkul dhe i fryri buçkat. Sakaq, qirinjtë u fikën. Unë ia plasa vajit. "Mbylle gojën", tha Llasteri. "Shikoje zjarrin derisa ta prej këtë tortë".

Unë e dëgjoja orën dhe mund ta dëgjoja Kedin që rrinte pas meje, mund ta dëgjoja edhe pullazin. Ende po bie shi, tha Kedi. E urrej shiun. Urrej çdo gjë. Në atë çast ajo e mbështeti kokën në prehrin tim duke vajtuar, më përqafoi, kurse unë fillova të qaja. Pastaj zura ta shikoja zjarrin përsëri derisa trajtat e bardha e të lëmuta ia behën përsëri. Mund ta dëgjoja orën, pullazin dhe Kedin.

Fillova të ha një copë tortë. Dora ■ Llasterit rrëmbeu edhe një copë tjetër të tortës. Dëgjoja sesi po mbllaçiste. Zura ta shikoj zjarrin.

Një copë e gjatë teli kaloi mbi shpatullën time. Arriti deri te dera e po në atë çast zjarri u shkim. Unë ia plasa vajit.

"Pse kukat tash", tha Llasteri. "Shiko". Zjarri përsëri gjendej aty. Unë heshta. "A s'mund të trusësh aty e ta shikosh zjarrin ashtu si të ka thënë mamaja", tha Llasteri. "Duhet të të vijë turp. Merre edhe një copë tortë".

"Çka i bëre tash". tha Dilzi. "Pse s'e lë të qetë".

"U mundova ta qetësojë e mos ta shqetësojë zonjushën Kahlinë", tha Llasteri. "Diçka e hidhëroi përsëri".

"E di se çka e hidhëroi atë", tha Dilzi. "Tash i them Vershit ta marrë atë shkop e të të rrahë si të kthehet në shtëpi. Vetë e lype. Vetë e kërkon belanë gjithë ditën e lume. A e çove te përroska"?

"Jo", tha Llasteri. "Gjithë ditën e gjatë ishim në oborr, ashtu si thatë ju".

"Dora e tij u zgjat të merrte edhe një copë tjetër të tortës. Dilzi e qëlloi dorën e tij. "Guxo preke edhe një herë tortën se pasha zotin ta preva me këtë thikë të kasapit", tha Dilzi. "Vë bast se s'ka ngrënë asnjë copë ky i shkreti".

"Po ka ngrënë", tha Llasteri. "Ka ngrënë dy herë më shumë se unë. Në daçi pyeteni".

"Preke edhe një herë tortën", tha Dilzi. "Se ta kallëzoj qejfin".

Ashtu, tha Dilzi. Ma merr mendja se herën tjetër duhet të qaj unë. Besoj se Mori do të më lejojë që të vajtoj edhe unë një grimë.

Tash i thonë Benxhit, tha Kedi.

Si është e mundshme, tha Dilzi. Ende s'e ka harruar atë emrin me të cilin e pagëzuan në mituri.

Emri Benxhamin rrjedh nga bibla, tha Kedi. Është emër më i mirë se sa Mori.

S'është e mundshme, tha Dilzi.

Nëna thotë se është e mundshme, tha Kedi.

Jo more, tha Dilzi. Emri s'ka si të ndihmojë. As nuk ka si të dëmtojë. Gjindja s' kanë fat nëse i ndërrojnë emrat. Mua më quajnë Dilzi që kur mbaj mend për vete dhe do të mbetet Dilzi edhe kur do të më harrojnë.

Si do të dinë se quheshe Dilzi, kur të të harrojnë, Bilzi, tha Kedi.

Do të jetë në liber, shpirt, tha Dilzi. I shënuar.

A mund ta lexosh, tha Kedi.

S'do të jem e detyruar, tha Dilzi. Do ta lexojnë të tjerët në vend timin. Unë duhet të them vetëm, ja ku më kënì.

Teli i gjatë u shtri përsëri mbi shpatullën time dhe zjarri u shua. Ia plasa vajit.

Dilzi dhe Llasteri zunë të rrahen.

"Të pashë". tha Dilzi. "Posi, të pashë". Ajo e shtynte Llasterin kah këndi, duke e shkundur atë. "S'i bëre asgjë të keqe, apo jo. Prit sa të kthehet babai në shtëpi. Sikur të isha e re si dikur, do të t'i shkulja veshët. Kam qejf të të mbyll në bodrum e të mos shkosh sonte në atë shfaqje".

"Kuku, mamë! tha Llasteri. "O, medet".

E zgjata dorën atje ku gjendej zjarri.

"Mos e lër", bërtiti Dilzi. "Ktheje, mule"!

Dora ime u zmbraps me hov, unë e futa dorën në gojën time, kurse Dilzi më shtyu. Ende e dëgjoja orën në mesin e zërit tim. Dilzi u kthye me rrëmbim dhe e goditi Llasterim në kokë. Zëri im sa vinte po bëhej gjithnjë më çjerrës.

"Sillma atë sodë", i tha Dilzi. Ajo e mxora dorën time nga

goja ime. Unë po çirresha dhe po mundohesha që ta fusja dorën përsëri në gojë, por nuk më linte Dilzi.

Ajo zuri të hidhte ujin e sodës mbi dorën time.

"Shko në qilar dhe merr një copë lecke të varur në gozhdë", tha ajo. "Mjaft de. Mjaft se po e zgjon nënën e sëmurë përsëri. Ja, shikoje zjarrin. Tash të ndihmon Dilzi e të kalon dhimbja e dorës saora. Shikoje zjarrin". Ajo e hapi deriçkën e koftorit. Unë zura ta shikoj zjarrin, mirëpo dora më dhimbte, prandaj nuk pushoja së vajtuari. Dora ime donte përsëri të kthehej në gojën time, mirëpo Dilzi s'më linte se s'më linte.

Ajo e mbështolli dorën time. Nëna tha,

"Ç'ndodhi. Nuk mund të kem rehati as kur jam e sëmurë. A jam e detyruar të çohem nga krevati e ta paqtoj djalin tim, edhe pse i kam dy zezakë të rritur që përkujdesen për të".

"Tash qetësohu", tha Dilzi. "Tash pushon. E dogji dorën një grimë".

"Jeni të dy zezakë të rritur, s'ka kuptim ta sillni në shtëpi duke u çjerrë", tha nëna. "Me qëllim po e ngucni, ngaqë e dini se jam e sëmurë". Ajo m'u afrua dhe u ul afër meje. "Mjaft", tha ajo. "Hesht pra, menjëherë. A ia dhatë ndonjë copë torte".

"Unë e kam blerë", tha Dilzi. "Nuk ka dalë nga qilari i Xhesonit. Unë ia gatova për ditëlindje".

"A mos deshe ta helmosh me atë torte të lirë të tregtizës", tha Nëna. "Mos deshe këtë. Kur do të kem një minutë rehatie".

"Ngjitu shkallëve dhe shtrihu", tha Dilzi. "Dhimbja i kalon menjëherë. Eni".

E t'ju lë këtu vetëm me të që t'i bëni përsëri ndonjë sherr", tha Nëna. "Si mund të shtrihem derisa ai çirret sa mundet. Benxhamin. Hesht kur të them".

"S'kemi ku ta çojmë", tha Dilzi. "Atë dhomë që e kishim nuk e kemi më. Nuk mund të rrijë vetëm në oborr duke vajtuar, sepse e shohin të gjithë fqinjët".

"E di, e di", tha Nëna. "Unë e kam fajin. Së shpejti shkoj edhe unë, kurse ju me Xhesonin do të kaloni më mirë". Ajo zuri të qante.

"Mos qani", tha Dilzi. "Shtrihuni përsëri. Kthehuni atje. Llasteri e shpie në bibliotekë ku do të lozë me të, kurse unë e përgatis darkën".

Dilzi dhe Nëna dolën jashtë.

"Pusho de", tha Llasteri. "Mjaft më se ma lodhe. Mos deshe të ta djeg edhe atë dorën tjetër. S'të ka gjetur gjë. Mjaft".

"Mirë de", tha Dilzi. "Mos qaj, merre". Ajo ma dha një pandofle dhe unë heshta. "Çoje në bibliotekë", tha ajo. "E nëse e dëgjoj edhe një herë, do ta të rrah unë vetë me dorën time".

Shkuam në bibliotekë. Llasteri e ndezi dritën.

Dritaret u nxinë, kurse ai vendi i trashë dhe i errët në mure m'u duk i afërt, prandaj unë e preka. Ishte si dera, mirëpo derë nuk ishte.

Ndjeva se zjarri ishte pas meje ndaj iu afrova zjarrit, u ula në dysheme duke e mbajtur pandoflen në dorë. Zjarri po rritej. Ai arriti deri, në jastëkun e karrekllës së Nënës.

"Pusho", tha Llasteri. "A s'mund të prajsh për një çast, për një copë herë. Unë ta ndeza zjarrin, kurse ti as që e shikon atë".

Ty të thonë Benxhi. Tha Kedi. A më dëgjon. Benxhi. Benxhi.

Mos i thuaj kështu, tha Nëna. Sille këtu.

Kedi më mori nën sqetull.

Çohu, Mo... desha të them Benxhi, tha ajo.

Mos u mundo ta mbash, tha Nëna. Nuk mund ta sjellësh këtu. Mjaft e ke që po mendon për të.

Mund ta mbaj, tha Kedi..

"Më lini ta mbaj unë, Dilzi".

"Hajt, provo moj çamarroke", tha Dilzi. "Je aq picirruke sa s'mund ta mbash as pleshtin. Rri urtë e mos bëj zë, si tha zoti Xheson".

Në maje të shkallëve u duk një dritë. Atje ishte babai, veshur me këmishë. Pamja e tij të thoshte se duhet të heshtësh. Kedi pëshpëriti:

"A është e sëmurë Nëna".

Vershi më lëshoi në dysheme dhe ne hymë në dhomën e Nënës. Aty gjendej zjarri. Zjarri zvogëlohej dhe bymehej në mure. Në pasqyrë gjendej edhe një zjarr tjetër. E nuhasja sëmundjen. Në kokën e Nënës ishte njëfarë pëlhure e mbështjellë. Leshrat e saj ishin mbi jastëk. Zjarri nuk arrinte aty, por shndriste në shuplakën e saj ku vezullonin unazat e saj.

"Eja këtu e thuaji Nënës natën e mirë", tha Kedi. Iu afruam krevatit. Zjarri iku nga pasqyra. Babai u ngrit nga krevati. Më ngriti, kurse Nëna ma preku kokën me dorën e saj.

"Sa është ora", tha Nëna. Sytë i kishte të mbyllur.

"Shtatë pa dhjetë", tha babai.

"Është herët ta vësh në gjumë", tha Nëna. "Do të zgjohet herët në mëngjes, kurse unë nuk do të mund ta duroja edhe një ditë të këtillë".

"Mirë, mos u mërzit", tha Babai. Ai e preku fytyrën e Nënës.

"Unë e di se jam bërë barrë për ju", tha Nëna. "Por, së shpejti s'do të më keni më. Atëherë s'do t'ju mërzis më".

"Lëri ato", tha Babai. "Unë e çoj poshtë për do kohë. Ai më mori ngrykë. "Hajde jaran. Të shkojmë pak poshtë. Të mos bëjmë zë derisa Kuentini po mëson".

Kedi shkoi dhe u përkul mbi krevat, ndërsa dora e Nënës u duk në dritën e zjarrit. Unazat e saj vezulluan në shpinën e Kedit.

Nëna është e sëmurë, tha Babai. Dilzi të vë në gjumë. Ku është Kuentini?

Vershi po e thërret, tha Dilzi.

Babai u ndal dhe po na shikonte derisa ne po largoheshim. E dëgjonim Nënën në dhomën e saj. Kedi tha: "Mjaft". Xhesoni ende po u ngjitej shkallëve. Duart i mbante në xhepa.

"Sonte të gjithë duhet të rrini urtë", tha Babai, "E të mos bëni zë, kështu nuk do ta shqetësoni Nënën".

"Do të rrimë urtë", tha Kedi. "Tash të mos bëni zë, Xheson", tha ajo. Ne zumë të ecnim në majë të gishtërinjve.

Mund ta dëgjonim pullazin. Unë mund ta shihja zjarrin në pasqyrë. Kedi përsëri më mori ngrykë.

"Hajde tash". tha ajo. "Pastaj kthehesh përsëri te zjarri. Pushon".

"Kendas". tha Nëna.

"Mjaft, Benxhi", tha Kedi. "Nëna të thërret një minutë. Sepse je djalë i mirë. Pastaj kthehesh përsëri, Benxhi. Kedi më lëshoi dhe unë heshta.

"Le të rrijë këtu, Nënë. Si të ngopet së shikuari zjarrin, atëherë ti i flet".

"Kendas", tha Nëna. Kedi u përkul dhe më mori ngrykë. U kolovitëm. "Kendas", tha Nëna.

"Mjaft", tha Kedi. "Ende mund ta shohësh atë. Pusho".

"Sille këtu", tha Nëna. "Është shumë i madh që ta mbash. Mos, lëre. Do ta lëndosh kolonën vertebrore. Të gjitha femrat tona kanë qenë belholla. Mos ke qejf të dukesh si petkalarëse".

"S'është aq i rëndë", tha Kedi. "Mund ta mbaj fare lehtë".

"Nuk dua ta mbash", i tha Nëna. Është pesë vjeç. Jo, jo. Mos në prehrin tim. Le të qëndrojë në këmbë".

"Nëse e mban, ai do të pushojë", tha Kedi. "Mjaft më", tha ajo. "Mund të kthehesh menjëherë. Merre jastëkun tënd".

"Mos, Kendas", tha Nëna.

"Le ta shikojë se ndoshta qetësohet", tha Kedi. "Prit një çast derisa ta nxjerrë jashtë. Ja, Benxhi. Shiko".

Unë e shikova atë dhe heshta.

"Ti po e llaston shumë", tha Nëna. "Ti me nënën tënde. Ti nuk e ke të qartë se unë po paguaj shtrenjtë për këtë. Gjysma e lazdroi Xhesonin në këtë mënyrë kështu që m'u deshën dy vjet që ta kandis atë, kurse tash nuk kam fuqi që të kem aso telashesh edhe me Benxhaminin".

"Nuk të hapen telashe me të", tha Kedi. "Unë dua të kujdesem për të. Apo jo, Benxhi".

"Kendas", tha Nëna. "Të thashë të mos e quash ashtu. Edhe baba bëri mjaft keq që nguli këmbë duke të quajtur me atë llagëp të marrë, kurse unë s'do të lejoj që ta quajë me llagëp edhe atë. Llagëpet janë vulgare. Vetëm njerëzit e thjeshtë i përdorin ato. Benxhamin", tha ajo.

"Shikomë", tha Nëna.

"Benxhamin", tha ajo. Ajo e zuri fytyrën time me të dyja duart dhe më shikoi në sy.

"Benxhamin", tha ajo. "Largoje atë jastëk, Kendas".

"Do të qajë", tha Kedi.

"Merre atë jastëk kur të them", tha Nëna. "Duhet të mësojë që të na dëgjojë".

Dikush e largoi jastëkun.

"Pusho, Benxhi", tha Kedi.

"Shko atje dhe ulu", tha Nëna. "Benxhamin". Ajo e kishte afruar fytyrën time me të sajën.

"Mos ashtu", tha ajo. "Mos".

Mirëpo, unë s'pushova së vajtuari, kurse Nëna më mori ngrykë dhe u zhgreh në vaj. Në atë çast jastëku u kthye përsëri, kurse Kedi e mbante atë mbi kokën e Nënës. Ajo e ktheu Nënën në karrige, kurse Nëna u mbështet për jastëkun e kuq e të verdhë gjithë duke qajtur.

"Mos, Nëno", tha Kedi. "Shko atje lart dhe shtrihu se do të sëmuresh. Unë shkoj e thërras Dilzin". Ajo më çoi afër zjarrit,

kurse unë fillova t'i shikoja trajtat e vezullueshme dhe të rrafshta të flakës. Mund ta dëgjoja zjarrin dhe pullazin.

Babai më ngriti. I vinte era e shiut.;

"Ani, Bemxhi", tha ai. "A ishe sot djalë i mirë"?

Kedi dhe Xhesoni po rraheshin në pasqyrë.

"Hej, Kedi", tha Babai.

Ata ende po rraheshin. Xhesoni ia plasi vajit.

"Kedi", tha Babai. Xhesoni po qante. Ai nuk po rrahej më, mirëpo ne mund të shihnim në pasqyrë se si po rrahej Kedi prandaj Babai më lëshoi në dysheme, shkoi në pasqyrë dhe filloi të rrahej. Ai e ngriti Kedin. Ajo filloi të rrahej. Xhesoni u shtri në dysheme dhe zuri të qante. Në duar mbante gërshërët. Babai e kishte zënë Kedin dhe nuk po e lëshonte.

"I ka grisur të gjitha kukullat e Benxhit", tha Kedi. "Do t'ia thyej tureçkën".

"Kendas", tha Babai.

"Tureçkën do t'ia thej", tha Kedi. "Po për nder". Ajo u turr përsëri. Baba e ndali. Ajo ia dha një shkelm Xhesonit. Ai iu rrotullua dhe doli nga pasqyra. Baba e solli Kedin afër zjarrit. Tash, të gjithë kishin dalë prej dritares. Vetëm zjarri ishte në të. Si të ishte zjarri te dera.

"Mjaft më", tha Babai. "A doni ta sëmurni Nënën në dhomë".

Kedi pushoi. "Ai i ka grisur të gjitha kukullat që i kishim bërë Mo Benxhi dhe unë", tha Kedi. "Është i poshtër".

"Jo, jo s'i kam grisur", tha Xhesoni. Ai po qante. "S'dija se janë të tijat. Kujtova se janë letra të vjetra".

"E ke ditur fare mirë", tha Kedi. "E ke bërë kastile".

"Mbylle gojën", tha Babai. "Xheson", tha ai,

"Nesër t'i bëj kukullat e tjera", tha Kedi. "Do të bëjmë plot e përplot kukulla. Ja, shikoje jastëkun".

Ia behu Xhesoni.

Të thashë ta mbyllësh gojën, tha Llasteri.

Ç'ke, tha Xhesoni.

"Veç po e mundon veten", tha Llasteri. "Kështu po bën gjithë ditën e lume".

"Pse s'e lini rehat", tha Xhesoni. "Nëse s'mund ta qetësoni, atëhorë mos e mbani në kuzhinë. Ne të tjerët nuk mund të mbyllemi në dhomë ashtu si u mbyll Nëna".

"Mamaja thotë që të mos e mbajmë në kuzhinë derisa ajo ta hajë darkën", tha Llasteri.

"Atëherë shkoni e luani me të dhe qetësojeni disi", tha Xhesoni. "A mos duhet të punoj gjithë ditën e lume e mandej të kthehem në çmendinë". Ai e hapi gazetën dhe zuri ta lexonte.

Mund t'i shikosh zjarrin, pasqyrën dhe jastëkun, tha Kedi. S'ka nevojë të presësh deri në darkë për ta shikuar jastëkun.

Mund ta dëgjonim pullazin. Edhe Xhesonin i cili po qante matanë murit.

Dilzi tha, "Eja Xheson. Lëre të qetë atë".

"Si urdhëroni", tha Llasteri.

"Ku është Kuentina", tha Dilzi. "Darka tash bëhet gati".

"S'kam haber", tha Llasteri. "S'e kam parë".

Dilzi u largua. "Kuentinë", tha ajo në korridor. "Kuentinë. Darka gati".

Mund ta dëgjonim pullazin. Kuentinit i vinte era e shiut.

Ç'bëri Xhesoni, tha ai.

I ka prishur të gjitha kukullat e Benxhit, tha Kedi.

Nëna ka thënë të mos e quajmë Benxhi, tha Kuentini. Ai u ul në shtrojën pranë nesh. Sikur të mos binte shi, tha ai. S'ke ç'të bësh.

Je rrahur, tha Kedi. Apo jo.

Jo aq shumë, tha Kuentini.

Trego de, prano, tha Kedi. Babait do t'i bjerë në sy kjo.

Punë e madhe, tha Kuentini. Sa e kam zët këtë shi.

Kuentina tha: "A nuk tha Dilzi se darka qenka gati".

"Si urdhëro", tha Llasteri. Xhesoni e shikoi Kuentinën fill, pastaj vazhdoi ta lexonte gazetën. Kuentina u afrua. "Ajo tha se tash do të jetë gati", tha Llasteri. Kuentina u ul në karrigen e Nënës. Llasteri tha:

"Zoti Xheson".

"Ç'është"? - tha Xhesoni. "M'i jepni dy monedha", tha Llasteri.

"Përse", tha Xhesoni.

"Për të shkuar në shfaqje sonte", tha Llasteri.

"Kujtova se Dilzi do të merrte një çerek dollari nga Froni e do të t'i jepte ty", tha Xhesoni.

"Ajo e mori", tha Llasteri. "Por e humba. Unë e Benxhi e kërkuam atë monedhë gjithë ditën e lume. Pyeti në daç".

"Në qoftë ashtu, merr hua prej tij", tha Xhesoni. "Unë e fitoj paranë me djersën e ballit". Ai gjithnjë e lexonte gazetën.

Kuentina po e shikonte zjarrin. Zjarri pasqyrohej në sytë dhe në gojën e saj. Gojën e kishte të kuqe.

"U përpoqa ta mbaj jashtë" tha Llasteri.

"Mbylle çakallën", tha Kuentina. Xhesoni e shikoi.

"Ç'të thashë unë, çka do të bëja nëse të shoh edhe një herë me atë farë jarani", tha ai. Kuentina po e shikonte zjarrin. "Me ty e pata", tha Xhesoni.

"Të dëgjova", tha Kuentina. "Bëj ç'të vijë ndoresh". "Mos ki gajle", tha Xhesoni.

"Jo. s'kam gajle fare", tha Kuentina. Xhesoni ende po e lexonte gazetën.

Ende dëgjoja pullazin. Babai u përkul dhe e shikoi Kuentinin.

Ani, tha ai. Kush fitoi?

"Kurrkush", tha Kuentini. "Na ndalën. Mësuesit".

"Kush", tha Babai. "A më thua".

"S'ndodhi gjë", i tha Kuentini. "Ai ishte i madh sa unë".

"Ashtu", tha Babai. "A më thua se çka ndodhi".

"E po pothuajse asgjë", tha Kuentini. "Ai tha se mund ta vinte bretkosën në bangën e saj, kurse asaj s'do t'ia mbante ta kundërshtonte".

"Oh", i tha Babai. "Asaj. Po pastaj".

"Po", tha Kuentini. "Në atë çast unë ia këputa një grusht".

Mund ta dëgjonim pullazin dhe zjarrin si dhe turfullimën jashtë derës.

"Ku do ta gjente bretkosën në nëntor", tha Babai.

"S'di", tha Kuentini.

Po e dëgjonim muhabetin e tyre.

"Xheson", tha Babai. Po e dëgjonim Xhesonin.

"Xheson", tha Babai. "Eja këtu e lëri ato".

E dëgjonim pullazin, zjarrin dhe Xhesonin.

"Mjaft më de", tha Babai. "A mos deshe të hash dajak përsëri". Babai e rrëmbeu Xhesonin dhe e uli në karrigen afër vetes. Xhesoni turfulloi. E vështronim zjarrin dhe pullazim. Xhesoni turfulloi edhe më fort.

"Veç të dëgjoj edhe njëherë", tha Babai. Mund t'i dëgjonim zjarrin dhe pullazin.

Dilzi tha, ani mirë. Tash të gjithë mund të vini te Babai.

Vershit i vinte era e shiut. I vinte edhe era e qenit. Mund t'i dëgjonim zjarrin dhe pullazin.

Mund ta dëgjonim Kedin duke ecur shpejt e shpejt. Babai dhe Nëna shikuan kah dera. Kedi kaloi me rrëmbim. As që u kthye të na shikonte. Eo te me nxitim.

"Kendas", tha Nëna. Kedi u ndal.

"Fol, Nënë", tha ajo.

"Mbylle më, Kerolinë", tha Babai.

"Eja këtu", tha Nëna.

"Mjaft më, Kerolinë", tha Babai. "Lëre të qetë".

Kedi iu afrua derës, u ndal dhe i shikoi Babain dhe Nënën. Ajo më hodhi edhe mua një vështrim e pastaj e treti vështrimin. Unë ia plasa vajit. Zura të çirrem dhe u ngrita në këmbë. Kedi m'u afrua, u mbështet për muri dhe zuri të më shikonte. Unë iu afrova duke vajtuar, kurse ajo u mbështet për muri dhe në atë çast vura re sytë e saj dhe zura të vajtoja me zë më të lartë duke e tërhequr atë për fustanit. Ajo i shtriu duart, ndërsa unë e ngreja fustanin e saj. Vështrimin s'mund t'ia zija.

Vershi tha, tash ti qubesh Benxhamin. A di se nga rrjedh emri Benxhamin. Do të të shndërrojnë në një njeri djallëzor me dhëmballë të mavita. Mamaja thotë se moti një katragjysh yti e paska ndërruar emrin e një zezaku, ishte bërë predikues, mirëpo, kur e shikuan atë, ç'të shohin, edhe ai qe bërë si qoftëlargu. Mirëpo, askush para tij nuk ishte bërë i tillë. Dhe kur graria e shikonin atë në sy kur ishte hëna e plotë, ai dukej si djalli vetë. Një mbrëmje, kur një duzinë djajsh po vraponin atypari, ai s'u kthye kurrë më në shtëpi. Gjahtarët e minjve e gjetën në pyll. A di se kush e kishte ngrënë atë, vetë djajtë.

Ndodheshim në korridor. Kedi nuk i shqiste sytë nga unë. Gojën e mbante me një dorë dhe unë si i diktova sytë e saj u zhgreha në vaj. U ngjitëm shkallëve. Ajo u ndal përsëri, afër murit duke më shikuar, kurse unë e vazhdoja avazin. Ajo m'u afrua, ndërsa unë po vajtoja, u mbështet për mur duke më shikuar. E hapi derën e dhomës së saj, mirëpo, unë nuk e lëshoja fustanin e saj kështu që hymë së bashku në banjo, kurse ajo u mbështet për dere duke më shikuar. Në atë çast, e kaploi fytyrën me dorën e saj, kurse unë e shtyra duke vajtuar.

Ç'jeni duke i bërë, tha Xhesoni. Pse nuk e lini të qetë?

S'i bëra gjë, tha Llasteri. Gjithë ditën e lume e ka këtë avaz. E ka hak dajakun.

Duhet dërguar në Xhekson, tha Kuentina. Si mund të jetojë njeriu në këtë shtëpi.

Nëse s'të pëlqen, lum zonjushe, më mirë e ke të dalësh jashtë, tha Xhesoni.

Po dal, tha Kuentina. Mos ki merak.

Vershi tha: "Largohu pak që t'i ter këmbët". Ai më shtyri pak. "Mos ia nis tash avazit. Ende mund ta shohësh atë. Vetëm kjo të duhet. Çka dreqin e lype në shi. Ke lindur me fat edhe pse nuk e di këtë". E kishte kthyer shpinën kah zjarri.

"Tash e di sesi ta dhamë emrin Benxhamin", tha Vershi. "Mamaja jote mburret me ty. Kështu thotë mamaja".

"Më lini të qetë që t'i ter këmbët", tha Vershi.

"Se e dini se ç'ju gjen. Ty ta rjep lëkurën.

Mund t'i dëgjonim zjarrin, pullazin dhe Vershin.

Vershi brofi më këmbë. Babai tha, "Mos u zemëro, Versh".

"Unë do ta ushqej sonte", tha Kedi. "Ngandonjëherë ai ia pëlcet vajit kur e ushqen Vershi".

"Merre këtë tepsi", tha Dilzi. "Ngutu dhe ushqeje Benxhin".

"A s'ke qejf të të ushqejë Kedi", tha Kedi.

A është i detyruar ta mbajë mbi tavolinë atë pandofle të rreckosur e të vjetër, tha Kuentini. Pse nuk e ushqeni në kuzhinë. Si të hajë bukë me derrin.

Nëse s'të pëlqen mënyra se si po hamë bukë, atëherë mos eja në tavolinë, tha Xhesoni.

Nga Roskusi po dilte avulli. Ishte ulur kundruall koftorit. Deriçka e koftorit ishte e hapur kurse Roskusi i kishte futur këmbët në të. Avulli po gufonte edhe nga tenxherja. Kedi e futi lugën në gojën time. Brenda tenxheres ishte një njollë.

Hajde, hajde, tha Dilzi. Mos ki merak s'të bezdis më.

Gjella ra nën njollë. Pastaj tenxherja u zbraz, u zhduk. "E paska zënë uria sonte", tha Kedi. Tenxherja u kthye. Tash nuk e vëreja njollën. Fill pastaj njolla më ra në sy përsëri. "Sonte paska uri të madhe", tha Kedi. "Pa shiko se sa shumë hëngri.

Posi, tha Kuentina. Ju të gjithë e dërgoni atë pas meje që të më përgjojë. E urrej këtë shtëpi. Do t'ia mbath dikah.

Roskusi tha: "Do të bjerë shi gjithë natën e gjatë".

Ke ikur për një kohë të gjatë, kështu thua ti, por kthehesh për shujtë, tha Xhesoni.

Do të shihni nëse s'ik, tha Kuentina.

"Unë s'di si do t'ia bëj", tha Dilzi. Më theri diçka në ije aq keq sa që mezi po lëviz. Më lodhën shkallët të cilave u ngjitëm tërë mbrëmjen".

Oh, oh, kjo s'do të më befasonte, tha Xhesoni. S'do të më befasonte asgjë që do të bëje ti.

Kuentina e flaku peshqirin në tavolinë.

Rrudhe gojën, Xheson, tha Dilzi. Ajo iu afrua Kuentinit dhe e përqafoi. Ulu, shpirt, tha Dilzi. Duhet t'i vijë turp, të padit për diçka që s'e ke bërë.

"S'është me qejf përsëri, apo jo", tha Roskusi.

"Jo, s'është", tha Dilzi. "Në kësi moti sëmuret çdokush. Kur do të ngopesh njëherë".

Të marrtë djalli, tha Kuentini. Djalli të marrtë. U dëgjuan hapat e saj derisa po vraponte tatëpjetë shkallëve. Shkuam në bibliotekë.

Kedi ma dha një jastëk, kështu që unë mund t'i shikoja jastëkun, pasqyrën dhe zjarrin.

"Të rrimë urtë meqë po mëson Kuentini", tha Babai. "Po ti, ç'bën, Xheson".

"Asgjë", tha Xhesoni.

"Ta zëmë se vjen këtu për të punuar", tha Babai.

Xhesoni u largua nga këndi.

"Ç'po përtyp" tha Babai.

"Asgjë", tha Xhesoni.

"Përsëri po përtyp letra", tha Kedi.

"Eja këtu, Xheson", tha Babai.

Xhesoni hodhi diçka në zjarr, ajo shushuriti, u bë tutël, u nxi. Pastaj, mori ngjyrën e përhime. Fill pastaj, u zhduk. Kedi, Baba dhe Xhesoni gjendeshin në karrigen e Nënës. Sytë e Xhesonit ishin të buhavitur, kurse goja e tij lëvizi si të kërkonte diçka. Kedi e kishte mbështetur kokën për shpatullën e Babait. Leshrat e saj ishin si zjarri, kurse në sy i vizullonin shkëndijat e vogla, kështu që unë iu afrova, Babai më ngriti pranë vetes, në karrige, kurse Kedi më mori në prehër. I vinte era e lisave.

Asaj i vinte era e lisave. Këndin e kishte kapluar errësira, ndonëse dritaren e shihja. U ula galiç aty duke mbajtur pandofle. Nuk mund ta shihja atë, por atë e shihnin duart e mia, mund ta dëgjoja se si po mërtiste nata, ndërsa duart e mia e shihnin pandoflen edhe pse vetë nuk e shihja, por duart e mia gjithnjë e shihnin atë, prandaj edhe u ula aty galiç duke dëgjuar natën që po binte.

Atë qenke, tha Llasteri. Shiko se ç'kam. Ma tregoi. E di se ku e kam marrë. Ma ka dhënë zonjusha Kuentinë. E dija se nuk mund të më mbanin jashtë. Ç'bën, aty, jashtë. Pandehja se ishe përvjedhur nga shtëpia. A s'gjëmove dhe a s'nënërove sot mjaft, pa u strukur në këtë dhomë të zbrazët, pa nënëruar edhe këtu. Eja në krevat, që të arrijë atje më kohë. Nuk mund ta kaloj me ty tërë natën. Para se të dëgjohet boria e parë, unë duhet të jem gati të zgjohem.

Nuk shkova në dhomën tonë.

"Këtu e kemi derdhur fruthin", tha Kedi. "Pse të flemë këtu sonte".

"Je ngushtë ti se ku do të flemë", tha Dilzi. Ajo e mbylli derën, u ul dhe filloi të më zhveshë. Xhesoni zuri të qante. "Mjaft", tha Dilzi.

"Dua të fle me gjyshen", tha Xhesoni.

"Ajo është e sëmurë", tha Kedi. "Fli me të kur të bëhet më mirë. Apo jo, Dilzi".

"Pusho de", tha Dilzi. Xhesoni pushoi.

"Këmishat e natës i kemi këtu". tha Kedi. "Si të shpërnguleshim diku".

"Më mirë e keni t'i vishni ato", tha Dilzi. "Xheson ti duhet të shkopsitesh".

Kedi e shkopsiti Xhesonin. Ai ia plasi vajit.

"I thua lepe dajakut", tha Dilzi. Xhesoni heshti.

Kuentin, bëri Nëna nga korridori.

Çfarë, tha Kuentini matanë murit. Dëgjuam se si Nëna e kyçi derën. Ajo e shikoi derën tonë, hyri brenda, u përkul mbi krevat dhe më puthi në ballë.

Si të flej, shko e pyete Dilzin se mos ka gjë kundër nëse e marr ujin e ngrohtë, tha Nëna. Thuaji se në mos pastë qejf, bëj unë edhe pa ujë të ngrohtë. Thuaji se duhet ta di këtë.

Si urdhëroni, tha Llasteri. Hajde. Zhvishni brekët.

Ia behën Kuentini dhe Vershi. Kuentini e kishte kthyer fytyrën në anën tjetër. "Pse qan", tha Kedi.

"Mjaft", tha Dilzi. "Tash zhvishuni të gjithë. Versh, ti mund të shkosh në shtëpi".

Unë u zhvesha, e shikova veten, fillova të qaj. Pusho, tha Llasteri. Kot i kërkon. Shkuan. Në vazhdofsh me këtë avaz, s'do ta kremtojmë ditëlindjen tënde. Ai ma veshi mintanin. Unë heshta për një copë herë, pastaj Llasteri u ndal afër dritares. Zuri të shikojë prej saj. U kthye dhe më zuri për dore. Ja tek

vjen, tha ai. Rri urtë. Iu afruam dritares dhe shikuam nga ajo. Diçka doli nga dritarja e Kuentinit dhe u kacavar në lis. Vumë re se si po shkundej lisi. Pastaj u duk diçka në lis, diçka që filloi të ecte edhe nëpër bar. Pastaj nuk pamë më asgjë. Eja, tha Llasteri. Hajde pra. A i dëgjon boritë. Futu në krevat sa s'u hidhërova.

Ishin dy krevatë. Kuentini u fut në tjetrin. Ai u kthye kah muri. Dilzi e mori Xhesonin me vete. Kedi u zhvesh.

"Shikoi si i ke brekët", tha Dilzi. "Më mirë u bë që Nëna s'të ka parë të këtillë".

"Unë i thashë asaj", tha Xhesoni.

"S'do të çuditesha", tha Dilzi.

"Dhe ja se ç'ke bërë", tha Kedi. "Llomotitëse".

"Epo se ç'bëra edhe unë", tha Xhesoni.

"Pse s'e vesh këmishën e natës", tha Dilzi. Ajo iu afrua Kedit që t'ia hiqte këmishën dhe brekët. "Pa shikohu njëherë", tha Dilzi. Ajo i bëri tutël brekët e saj dhe zuri ta fshinte prapanicën e Kedit. "Qenke bërë qull", tha Ajo. "Mirëpo, sonte s'do të lahemi". Ajo ia veshi Kedit këmishën e natës, Kedi u shtri në krevat, Dilzi iu afrua derës. U ndal pranë saj, me dorën te çelësi i dritës. "Tash të heshtni të gjithë, a dëgjuat", tha ajo.

"Ani mirë", tha Kedi. "Nëna s' vjen sonte", tha ajo. "Prandaj duhet të më dëgjoni mua".

"Po", tha Dilzi. "Tash të flini".

"Nëna është e sëmurë", tha Kedi. "Ajo dhe gjyshja janë të sëmura".

"Pushoni", tha Dilzi. "Të flini menjëherë".

Dhoma u errësua, pos derës. Pastaj edhe dera u nxi. Kedi tha: "Pusho, Mori". Duke më zënë për dore. Unë heshtja. E dëgjonim veten tonë. Edhe errësirën.

Errësira u zhduk teksa Babai na shikonte. I shikonte Kuentinin dhe Xhesonin, pastaj shkoi dhe e puthi Kedin dhe ma çiku ballin me dorë.

"A është Nëna shumë e sëmurë", tha Kedi.

"Jo", tha Babai. "A do ta ruani Morin"?

"Posi", tha Kedi.

"Babai shkoi te dera dhe na hodhi një vështrim. Dikur errësira u kthye, ai dukej i errët afër derës, kurse dera u nxi përsëri. Kedi më mbante, duke më çikur me dorë, unë e

dëgjoja secilin prej nesh si dhe errësirën dhe njëfarë ere që ma shqetësonte hundën. Pastaj, përsëri i pashë dritaret, ku gumëzhinin lisat. Pastaj errësira zuri të zhdavaritej, u dukën trajtat e bardha si ngahera, edhe atëherë kur Kedi thoshte se kam fjetur mirë.

Më 2 qershor, 1910

Kur hija e kanatave u duk në perde ora ishte diku mes 7 dhe 8 dhe në atë çast unë përsëri e dëgjoja orën. Ishte ora e babagjyshit dhe kur im atë ma fali, më pat thënë, Kuentin, po ta fal mauzoleumin e të gjitha shpresave dhe dëshirave; mjerisht do ta përdorësh që ta fitosh reducto aibsurdum e tërë përvojës njerëzore që mund ta kënaqë nevojën tënde individuale po aq sa edhe të atij apo të të atit të tij. Po ta jap këtë jo që ta përkujtosh kohën, por që ta harrosh atë herë pas here për një copë herë e mos të mbetesh teknefes duke u orvatur që ta pushtosh kohën. Sepse asnjë betejë s'u fitua deri më tash. As që ka pasur beteja. Fushëbeteja ia zbulon njeriut vetëm marrëzitë dhe zhgënjimin e tij, kurse ngadhënjimi është një iluzion i filozofëve dhe i të marrëve.

Ishte varur në kutinë varëse, kurse unë isha shtrirë dhe po e dëgjoja orën. Veç po e dëgjoja. S'ma merr mendja se dikush me gjithë mend e dëgjon orën ose sahatin. S'je i detyruar ta dëgjosh. Mund t'i harrosh të rënat e orës për një kohë të gjatë, pastaj, pa pritur e pa kujtuar, sa hap e mbyll sytë, veshi ta zë tiktakun, kurse në rradaken tënde krijohet menjëherë aradha e gjatë e kohës të cilën nuk e ke dëgjuar. Si pat thënë njëherë Babai, nëpër rrezet e gjata e të vetmuara të dritës ndoshta e pikas Jezu Krishtin duke ecur. Kurse Shën Francisi i mirë kishte thënë se Mordja ishte motra e vogël e tij, edhe pse nuk kishte pasur motër kurrën e kurrës.

Matanë murit mund ta dëgjoja kërkëllimën e matrasës së krevatit të Shrujit, pastaj zhapullimën e pandofleve të tij nëpër dysheme. U ngrita, iu afrova komos, e futa dorën në të, e çika orën time, e ktheva praptazi dhe u shtriva në krevat. Mirëpo,

hija e kanatave ende ndodhej aty kurse unë isha mësuar t'ia qëlloj orës sipas këtyre hijeve, prandaj m'u desh t'ua ktheja shpinën, duke e ndier veten ashtu si e ndiejnë veten kafshët që i kanë sytë pas kokës. Kjo më mundonte. Ky është një zakon i keq që e kisha mësuar për t'u penduar. Babai ma tha këtë. Ai tha se Krishtin nuk e kishin mbërthyer në kryq: atë e kishte shkatërruar tiktaku i rrotëzave me dhëmbëza. Ai nuk kishte pasur motër.

Kësodore, si mora vesh se nuk mund ta shihja orën, m'u tek të dija se sa ishte ora. Babai tha se shestimi i pareshtur rreth pozitës së akrepave mekanikë të një ore kokëfortë ishte njësoj si simptoma e funksionimit të rradakes. Ishte një lloj sekrecioni, tha Babai, si djersa. Unë i thashë, në rregull. Pa pikë dyshimi. Ec e çuditu.

Sikur të ishte moti me re do të shikoja nga dritarja, duke i përkujtuar fjalët e tij për përtacinë. Pandehja se nëse do të mbetej një mot i këtillë ata në Nju-Londër do t'i kishin punët mirë. Pse jo. Ishte muaji i nuseve, i zërit që belbëzonte. *Ajo iku nga dritarja, nga gostia. Trëndafile. Trëndafile. Zoti dhe zonja Xhezon Riçmond Kompson shpallin martesën e tyre.* Trëndafile, trëndafile. Jo virgjëresha si thanukla, lulequmështorja. Unë thashë se kisha bërë incest baba, thashë. Trëndafille, të hijshme e të bukura. Nëse një studenti të Harvardit një vit shkollor, nuk i rastis t'i shohë garat e barkave, atëherë ia kthejnë paratë. Le të ketë këso gjase Xhesoni. Le të shkojë ai një vit në Harvard.

Shrui gjendej te dera, duke rregulluar jakën, me syze, të kuqërremta si t'i kishte larë në fytyrën e tij. "Mos po merr mungesë sot në mëngjes"?" "A është aq vonë?"

Ai e shikoi orën. "Brenda dy minutave bie zilja".

"S'dija se qenka bërë aq vonë". Ende e shikonte orën e vet, duke i lëvizur buzët. "Duhet të ngutem. S'guxoj të marr edhe një mungesë. Javën e shkuar dekani më tha..." Ai e ktheu orën në xhepin e vet. Pastaj unë pushova së foluri.

"Më me mend bën nëse i vesh pantallonat dhe nxiton", tha ai. Ai iku.

Unë u ngrita, fillova të eci poshtë e lart dhomës duke e dëgjuar atë matanë murit. Ai hyri në dhomën e ndejës.

"A s'je gati ende?"

"Ende jo. Ngutu ti. Unë të zë".

Ai doli. Dera u mbyll. Hapat e tij u dëgjuan nëpër korridor.

Në atë çast unë përsëri e dëgjoja orën. Iu afrova dritares, i largova perdet dhe i dëktova sesi po nguteshin për të arritur më kapelë, po ata që kishin mëngë të përvjela të xhaketave, libra të njëjtë dhe jaka të njëjta epuese që po shkisnin si copat e drurit dhe bujashkat gjatë vërshimit dhe Spodin. Shruin e quajnë burrin tim. Le të shkojë, tha Shrui, në mos pastë punë më me mend sesa t'i ndjekë hallajkat e fëlliqta, le të shkojë, s'prish punë. Në jug është turp të jesh virgjine. Çunat. Burrat. Ata gënjejnë lidhur me këtë. Sepse kjo s'është gjë për gratë, tha Babai. Ai tha se burrat e kishin trilluar virgjinitetin e jo femrat. Babai tha se ishte si puna e vdekjes: vetëm një gjendje në të cilën mbeten të tjerët, kurse unë thashë, nuk prish punë nëse i beson asaj, kurse ai më tha, kjo është ana e pikëllueshme e çdo gjëje: jo vetëm e virgjinitetit, kurse unë thashë, pse mos të jem unë e jo ajo jovirgjine, kurse ai tha, edhe kjo është punë e pikëllueshme; nuk e vlen barra qiranë të ndërrosh asgjë, kurse Shrui tha se në mos pastë punë tjetër, le t'u qepet pas hallajkave të vogla e të fëlliqta, kurse unë i thashë, a mos ke pasur ti ndonjë motër? Mos ke pasur, mos ke pasur?

Spodi ndodhej mes tyre si breshka në një rrugë me plot e përplot gjethe të thata e të venitura, me jakë të ngritur deri te veshët, duke ecur me hijerëndësi dhe dalngadalë. Ai ishte absolvent nga Karolina e Jugut. Klubi i tij mburrej se ai nuk kishte shkuar i kurrë në kishë dhe kurrë nuk kishte arritur me kohë atje, kurrë nuk kishte munguar gjatë katër vjetëve të studimit dhe kurrë nuk kishe qenë as në kishë e as në ligjëratë me këmishë në shpinë dhe me çorapa në këmbë. Zakonisht kah ora 10 ai ia behte në kafenenë e Thomsonit, i porosiste dy filxhana me kafe, ulej, i nxirrte çorapat nga xhepi, i zbathte këpucët dhe i mbathte derisa i ftohej kafja. Aty kah mesdita e pikasje me këmishë dhe me jakë të pastër, si të gjithë të tjerët. Të tjerët e kalonin atë me vrap, nxitonin, mirëpo atij nuk i bëhej vonë kurrë. Pas një kohe oborri mbetej i zbrazët.

Në atë çast një trumcak ia behu nga rrezet e diellit, u ndal në pezulin e dritares dhe zuri ibë më vështronte për së kithi. Syri i tij ishte i rrumbullakët dhe i shkëlqyeshëm. N'e parë më shikonte në sy, pastaj paf! sa hap e mbyll sytë më shikonte me syrin tjetër derisa i rrahte pulsi me shpejtësi të madhe në gushë. Në atë çast zuri të binte ora. Trumcaku e stepi shikimin dhe m'i

nguli sytë me habi derisa pushuan të rënat e orës, si t'i dëgjonte edhe ai. Pastaj kërceu tnga pezuli dhe fluturoi.

Kaloi pak kohë para se të pushonte jehona e rënies së fundit. Ajo u përhap në ajër, më tepër u ndie sesa u dëgjua, për një copë kohë të gjatë. Tamam si të gjitha zilet që ushtrojnë dhe jehojnë në rrezet e gjata të dritës së perëndimit derisa Jezu Krishti dhe Shën Francisi kuvendojnë për motrën e tij. Sepse, të duket se ekzistonte vetëm ferri, kishte mbaruar çdo gjë. Si të kishte marrë fund çdo gjë. Askush tjetër nuk kishte mbetur aty pos asaj dhe meje. Sikur të kishim bërë diçka të tmerrshme s'do të prishte punë që të katandisesha në ferr, pos nesh. *Kam bërë incest thashë unë Baba unë bëra incest e jo Dalton Emsi,* dhe atëherë ai shënoi vetëm emrin e Dalton Emsit. Dalton Emsi. Dalton Emsi. Kur ma dha revolen unë s'bëra vetëvrasje. Ja se pse nuk bëra vetëvrasje. Ai do të ishte aty, ai do të ishte aty e edhe unë do të vija aty. Dalton Emsi. Dalton Emsi. Dalton Emsi. Po të bënim një punë aq të poshtër, dhe sikur Babai të thoshte se është punë e pikëllueshme, gjindja nuk mund ta bëjnë një punë aq të poshtër, ata s'janë në gjendje të bëjnë një paturpësi të tillë dhe atyre as që mund t'u kujtohet e nesërmja e jo më tmerri i sotëm, kurse unë thashë se mund të skapulloj disi, kurse ai tha: Ah, apo a. Dhe unë do të shikoj e do t'i shoh eshtrat e mi murmuritës dhe ujin e thellë si erën, si çatinë e erës dhe pas një kohe të gjatë gjindja s'do të jenë në gjendje t'i dallojnë as eshtrat në rërishten e vetmuar e të pashkelur. Deri në Ditën kur Ai do të thotë Çohuni vetëm yti do të dalë në siprinë. S'është më si atëherë kur e ke të qartë se asgjë s'të bën derman — as feja, as krenaria, asgjë prej gjëje — por është si atëherë ikur e ke të qartë se s'të duhet kurrfarë ndihme. Daltom Ems. Dalton Ems. Dalton Ems. Sikur të mos isha e ëma e tij e shtrirë me trup të hapur e të ngritur duke buzëqeshur, duke e shtrënguar po edhe duke e shtyrë të atin, duke e vështruar atë në grahmat e vdekjes para se të jetonte ai. *Për një çast ajo u ndal te dera.*

Iu afrova komos e mora orën, me faqe të kthyer teposhtë. E theva qelqin në qoshkun e komos, i mora copat e qelqit në dorë, i vura në taketuke, i lakova akrepat e orës dhe i vura në taketuke. Ende po dëgjohej tiktaku i orës. E ktheva faqen e orës, fushën me numra dhe me rrotëza të vogla e dhëmbë që po rrektonin pas saj, meqë nuk dija ç'të bëja tjetër. Jezui po

bridhte në Galile, kurse Uashingtoni nuk gënjente. Babai i solli një zinxhir të orës Xhesonit nga panairi i Shën Luisit: një dylbi të vogël përmes të cilës me një sy mund të pikasje një rrokaqiell dhe një rrotëz në formën e rrjetës së merimangës, ujëvarat e Niagarës në një kokë të gjilpërës. Në fushën e orës gjendej një njollë. Në të parë gishti im tregues zuri të më dhimbte. E lëshova orën, shkova në dhomën e Shruit, mora jodin dhe e leva gishtin e prerë. Copat e tjera të qelqit nga kornizat i dëlira me peshqir.

Nxora dy palë rroba me çorapa, këmisha, jakë dhe kravata dhe zura ta përgatis valixhen. Në të futa çdo gjë pos rrobave të mia të reja dhe një palë rrobave të vjetra si dhe pos dy palë këpucëve, dy kapelave dhe librave të mi. I çova librat në dhomën e ndejës dhe i vura mbi tavolinë, si ato që i kisha sjellë nga shtëpia, ashtu edhe ato *Babai kishte thënë se dikur zotërinë e njihte sipas librave të tij; sot atë e njeh sipas librave që nuk t'i kthen* dhe e mbylla valixhen duke shënuar adresën në të. Ra një çerek ore. U ndala dhe vështrova derisa nuk pushoi jehona.

U lava dhe u rrova. Uji qe shkaktar që në gisht ndjeva dhimbje përsëri, prandaj e leva përsëri me jod. I vesha rrobat e mia të reja, e mora orën, i palova rrobat e tjera, briskrruesin, brushat në një qese dore, e mbështolla çelësin e valixhes me një copë letre, e futa në një zarfë në të cilën e shkrova adresën e Babait, shkrova dy letra dhe i mbylla.

Hijet nuk ishin zhdukur ende nga tarraca. U ndala në prak të derës dhe zura të bëja sehir sesi po lëvizte hija. Ajo lëvizte thuajse pa i rënë në sy askujt, duke u zvarritur kah dera dhe duke e trembur hijen time te dera. *Mirëpo, ajo tashmë po nxitonte kur e dëgjova unë. Në pasqyrë ajo vraponte para se të kuptoja se çfarë kishte ndodhur. Duke marrë hov, me këndin e fustanit në parallërë, ajo doli me vrap nga pasqyra tamam si reja, kurse velloja i valonte duke vezulluar, hera-herës, derisa thembrat e brishta dhe të shpejta të saj po jehonin, me dorën tjetër e rroku fustanin në shpatull, gjithë duke vrapuar e duke ikur nga pasqyra, ndërsa i vinte era e trëndafilave, era tok me zërin që kishte jehuar dikur në parajsë. Pastaj, u zhduk, taket e saj nuk i dëgjoja më, pastaj si reja nën dritën e hënës, hija që eponte ngarendte nëpër bar, duke uluritur pa pushim. Doli nga petkat e saj, e zuri vellon e nusërisë dhe gjithë duke vrapuar e uluruar arriti aty ku gjendej T. P. në vesë, Hui Sasprillahu,*

Benxhi në sandëk, i cili po çirrej pa ndarë. Gjoksi i Babait po nxitonte i veshur me mburojë argjendi në formën e shkronjës F.

Shrui tha: "Si mor s'ke... A është dasmë apo darkë e përmortshme?"

"Nuk arrita", iu përgjigja.

"Ta merr mendja, kur pispillosesh aq shumë. Mos kujton se sot është e diel?"

"Ndoshta s'më arrestojnë në i paça veshur një herë rrobat e reja", ia ktheva unë.

"Unë mendova në studentët tipikë të Harvardit, të cilët nuk e shohin të udhës të marrin pjesë në ligjërata".

"Shkova të ha bukë njëherë". Nga tarraca, hija u zhduk vrik. Dola në diell dhe sërish e gjeta hijen time. Po zbrisja shkallëve mu para saj. Ra një gjysmë ore. Mandej, tiktaku pushoi, heshti.

As Dikoni nuk ishte në postë. Ngjita pulla postare në dy zarfa, njërën letër ia dërgova Babait, tjetrën Shruit, e futa në xhepin e brendshëm. Në atë çast më ra ndërmend se ku e kisha parë Dikonin për herë të fundit. E kisha parë në Ditën e Dekorimit, me rastin e përkujtimit të ushtarëve e të marinarëve të rënë në Luftën Civile. Ai kishte veshur uniformën e "Ushtrisë madhështore" të Republikës. Gjendej mes kortezhit. Nëse do ta prisja gjatë në një qoshe, do ta pikasja në ballë të kortezhit të parë që vinte rrugës. Ai kortezh përkujtimor, i parafundit, kishte qenë mbase i Kolombos apo i Garibaldit, apo, s'di në ditëlindjen e kujt tjetër. Me cilindër në kokë, me një flamurëz italian një centimetri në dorë, duke thithur duhan, ecte dhe krekosej mes metaleve dhe lopatave në togun e pastruesve të rrugës. Por, herën e fundit, me siguri e kam parë gjatë defileut të G. A. R.-it, ngaqë Shrui, më tha:

"Pa shiko se ç'ka bërë gjyshi yt me atë zezak plak e të gjorë".

"Po, ia ktheva unë". "Tash ai mund të marshojë përditë nëpër parada. Duhet t'ia di për nder gjyshit, se sikur të mos qe ai, ai do të këputej së punuari si të bardhët".

Asgjëkundi s'u pashë më me të. Mirëpo, unë nuk e njihja as zezakun e zellshëm të cilin mund ta gjeja kur më duhej, e jo më zezakun dembel. Ia behu një tramvaj. Iu ngjita tramvajit e me të shkova në qytet te Parkerët. Hëngra kaftjall dhe u ngopa mirë. Gjatë ngrënies veshi ma zuri tiktakun e orës. për atë të cilit i është dashur amshueshmëria që ta ndiente e ta

përjetonte kalimin mekanik të kohës, ngandonjëherë mjafton, më duket, vetëm një e rrahur e orës që ta humbë idenë e kohës.

Me të ngrënë mëngjes, bleva cigare. Shitësja më tha se cigarja më e mirë ishte ajo që kushtonte 50 senca. Bleva një cigare të tullë, e ndeza dhe dola në rrugë, u ndala, e thitha cigaren disa herë, paskëtaj, duke e mbajtur cigaren në dorë, u nisa kah këndi i rrugës. Kalova para vitrinës së orëtarit dhe argjendarit, mirëpo, e largova shikimin me kohë. Në këndin e rrugës, filluan të më bezdisin dy lustraxhinj këpucësh me zërin e tyre çjerrës e krrokatës si të sorrave, njëri nga një anë dhe tjetri nga ana tjetër. Njërit ia fala cigaren time, tjetrit ia fala një monedhë prej 5 sencash. Mandej, më lanë rehat. Ai me cigare tash orvatej t'ia shiste cigaren atij tjetrit për t'ia marrë atë monedhë.

"E theva orën".

Ai e mori në dorë. "Po për nder, e paskeni thyer. Si duket e paskeni shkelur me këmbë".

"Posi, mirë e keni zotëri. M'u rrëzua nga komoja dhe e shkela në errësirë pa e parë. Megjithatë, ende punon".

Ai e hapi kapakun dhe shikoi brenda mekanizmin e orës. "Si duket qenka në rregull. Ndonëse, pa e shikuar mirëfilli nuk e di saktë. E kontrolloj sot pasdite".

"E sjell më vonë", thashë unë. "A mund të më thoni se a janë të përpikëta orët në vitrinë?"

Ai e kishte ende orën time në shuplakën e dorës dhe më shikonte me syrin e tij shqetësues.

"Vura bast me një shok", thashë unë, "dhe i harrova syzet sot në mëngjes".

"Ani de, s'u bë kiameti", tha ai. Ai la orën time në tavolinën e tij gjysmë të kuqërremtë dhe shikoi kah vitrina. Pastaj shikoi kah muri. "Është ora".

"Mos më thoni", thashë unë, "Mosni ju lutem. Vetëm më thoni a janë të përpikëta ato orë atje".

Ai më shikoi përsëri. U ul në shkamin e tij dhe e çoi thjerrzën në ballë. Ajo kishte lënë një rreth të kuq rreth gropkës së syrit të tij dhe tash i dukej tërë fytyra. "Ç'po kremtoni sot?" - tha ai. "Garat e barkave janë javën tjetër, apo jo?"

"Jo, zotëri. Është një e kremte private. Një ditëlindje. A janë ato të përpikëta?"

"Jo. Mirëpo, nuk janë të rregulluara dhe nuk janë kurdisur ende. Në paçit qitur cekën të blini ndonjë orë."

"Jo, zotëri. S'më duhet ora. Kemi ne një sahat në dhomën tonë të ndejës. Këtë e ndreq kur të mundem". E shtriva dorën.

"Më mirë lëre këtu tash".

"E sjell unë më vonë". Ma dha orën. E futa në xhep. Në atë çast nuk mund ta dëgjoja nga tiktaku i orëve të tjera. "U jam shumë mirënjohës, Shpresoj se s'jua mora kohën".

"S'keni pse të më falenderoni. Silleni kur e shihni të udhës. Më mirë është ta shtyni atë kremtim derisa të mos dalim të parët në garat me barka".

"Po zotëri, jam dakord me ju".

Dola jashtë, duke mbyllur derën për të mos e dëgjuar atë tiktak. Shikova vitrinën edhe një herë. Ai më vështronte mbi banak. Në vitrinë kishte edhe një duzinë orësh të ndryshme, çdonjëra me siguri të njëjtë dhe garant kontradiktor çfarë kishte edhe ora ime, pa ndonjë tregues. Ishin në kundërthënie njëra me tjetrën. Unë mund ta dëgjoja "timen, duke bërë tik-tak në xhepin tim, ndonëse asnjëri nuk mund ta shihte, ■ edhe po ta shihte, ajo s'do të mund t'i thoshte, gjë.

Kështu, thashë me vete, ta marr pikërisht atë. Meqë Babai më kishte thënë se orët e vrasin kohën. Ai më tha se koha është e vdekur derisa ta kafshojnë dhëmbëzat; vetëm kur ndalet koha, atëherë koha ringjallet. Treguesit u zgjatën, pak horizontalisht me një kënd të vogël, si pulëbardha që pjerret dhe epon në erë. I kishte të gjithë ato për të cilat dikur më vinte keq si hëna e re që gjëja e mbante ujin, ashtu si thoshin zezakët. Orëtari e vazhdonte punën përsëri, i përkulur mbi tavolinën e punës dhe me thjerrëz në fytyrë. Rrahun në flokë e kishte aty ku ishte tullac, si moçali i shtjerur në dhjetor.

Hekurishten e pikasja në anën tjetër të rrugës. Nuk kisha haber se ujtitë apo hekurat i shisnin sipas peshës.

Shitësi më tha: "Këto peshojnë dhjetë funte". Mirëpo, ato ishin më të mëdha sesa ç'pandehja. Kështu i bleva dy ujti nga afro trekilogramëshe, meqë kur mbështillen duken si ndonjë palë këpucë. Të dy ujtitë së bashku ishin goxha të rënda, por më ra në mend sërish ajo që kishte thënë Babai rreth reductio ad absurdum të përvojës njerëzore si dhe për të vetmin rast që më mbetej për t'u regjistruar në Universitetin e Harvardit.

Ndoshta regjistrohem mot; mendoja, ndoshta mjafton t'i kalosh dy vjet në universitet për të mësuar diçka të hairit.

Mirëpo, ujtitë me të vërtetë ishin të rënda. Ia përspjeti tramvaji. Hyra brenda në tramvaj. Nuk e kisha vënë re pllakatën para tramvajit. Tramvaji ishte plot e përplot, kryesisht me njerëz që dukeshin me kamë dhe të cilët lexonin gazeta. E vetmja ulëse e lirë gjendej afër një zezaku. Ai kishte një kapele të stilit "bombë", kishte mbathur një palë këpucë të lustruar dhe mbante një duç të shuar të cigares. Kisha zakon të mendoja se jugori lipsej ta kishte gjithmonë parasysh problemin zezak. Pandehja se ata të veriut presin nga ai diçka të tillë. Ne parë, si arrita në lindje, mendoja pareshtur: Mos harro se ata duhet t'i heqësh si shumë të tjerët, e jo si zezakë, dhe sikur rastësisht të mos kisha rënë në kontakt me një numër të vogël syresh, do t'i kurseja vetes si kohën ashtu edhe telashet po të mësoja me kohë se mënyra më e mirë për t'u sjellë me njerëz, qofshin ata zezakë apo të bardhë, është t'i konsiderosh të atillë çfarë e mbajnë veten ata e pastaj t'i lësh rehat. Në atë kohë unë e kisha të qartë se zezaku nuk është ndonjë person i veçantë, por atë e dallonte mënyra e sjelljes, njëfarë qëndrimi hasmor i të bardhëve mes të cilëve jeton. Mirëpo, në fillim kujtoja se diçka më mungonte ngase nuk kisha një turmë zezakësh rrotull vetes, meqë më bëhej se veriorët prisnin nga unë një gjë të tillë. Ndërkaq, deri në atë mëngjes në Virxhinia, unë nuk kisha ditur se mund të përmallohesha për Roskusin, Dilzin dhe të tjerët. Kur u zgjova treni ishte ndalur, prandaj e ngrita perden e dritares dhe shikova jashtë. Një vagon po e bllokonte udhëkryqin ku dy gjerdhe të bardhë lëshoheshin tatëpjetë kodrës e pastaj shpërndaheshin në përpjetëze dhe përanash, si ndonjë brirë, pikërisht aty mes binarit ndodhej një zezak me mushkë, i cili priste nisjen e trenit. S'di se që kur ishte ai aty, mirëpo, ishte ulur çapras mbi mushkë kokën e kishte mbështjellë me njëfarë batanie si të ishin krijuar së bashku me gardhin dhe rrugën, apo edhe me kodrën, si të ishin gdhendur nga vetë kodra, si ndonjë shtyllë me tabelë që tregon rrugën që të thotë: Përsëri u ktheve në shtëpi. Nuk kishte samar kështu që këmbët gati e preknin tokën. Mushka dukej si ndonjë lepur. Unë e ngrita dritaren.

"Hej, xhaxha", thashë unë: "Kah po ia mban?"

"Zotëri?" Ai më hedhi një vështrim, e shliroi batanien e mbështjellë dhe e ngriti nga veshët.

"Dhurata për Kërshëndella!", i thashë.

"Erdha menjëherë", zotëri", zatëri. Më zutë ngushtë, apo?

"Kësaj here po ta fal". I nxora pantallonat që i kisha në një rrjetë dhe prej xhepit të tyre nxora një monedhë prej një çerek dollari. "E po, hapi sytë herën tjetër. Dy ditë pas vitit të ri do të kthehem këtej, atëherë ruaju, he". Ia hodha monedhën nga dritarja. "Blej diçka për Kërshëndellat".

"Po, zotëri", tha ai. Zbriti nga mushka, e mori monedhën dhe e fshiu për këmbë. "Ju rrit nera zotëri i ri. Ju rrit nera". Në atë çast treni u nis. U përkula nga dritarja, në ajrin e ftohtë dhe u ktheva pas. Qëndronte afër mushkës së tij që i ngjante lepurit, të dytë dukeshin të gjorë, të palëvizshëm dhe plot durim. Treni hyri pas lakut, teksa lokomotiva qiste tym me rektima të shkurtra, të rënda kurse ata të dy shklitnin nga shikimi tok me atë atmosferë që i gllabëronte, me atë gajretin e tyre zhelaman e jashtëkohor dhe me atë freski statike: me atë përzierje *të* paaftësisë së gatshme fëmijërore dhe të sigurisë që i ruante dhe i mbronte, i do pa arsye dhe i grabit, i mbron nga papërgjegjësia dhe obligimet me mjete jo gjithaq të maskuar që të mund t'i quash justifikime, kështu që si në vjedhje ashtu edhe në shmangie e gjykojmë me entuziazmin ■ sinqertë dhe spontan ngadhënjyesin ashtu si ndien Xhentëlmeni ndaj secilit që e mposht në luftën e ndershme; përveç kësaj, ata kanë edhe një tolerancë të paepur dhe skofiare ndaj marrëzive të të bardhëve çfarë ka edhe gjyshi kundrejt çapkënllëqeve të papritura dhe plot karagjozllëqe të nipave të vet. I kisha harruar të gjitha këto. Gjatë gjithë asaj dite, teksa treni lakadredhonte nëpër grykat e hatashme dhe përskaj shkëmbinjve të thepisur, ku të vetmet lëvizje ishin gjëmimi dhe rrapëllima e ventilave dhe kërkëllima e rrotave, derisa malet e lashta po zhdukeshin në qiellin me re, mua seç më vajti mendja te shtëpia ku kam lindur, te stacioni i zymtë, te balta, te zezakët dhe bashkëvendësit të cilët sillen sheshit, me majmunë lodra prej belushi, me karrocëza dhe me sheqerka në qese nga qesin krye "qirinjtë" romanë kur unë gati i qisja zorrët jashtë ashtu siç më ndodhte në shkollë sa herë që e dëgjoja zilen.

Unë nuk njehja derisa ora nuk binte tre. Paskëtaj, ia filloja të numëroja deri në gjashtëdhjetë dhe duke lakuar një gisht dhe

duke menduar në të katërmbëdhjetë gishtërinjtë, të cilët lipsej të lakoheshin, ose deri në trembëdhjetë ose dymbëdhjetë apo tetë apo shtatë, derisa papritur e papandehur nuk vija re heshtjen dhe shpirtrat e kujdesshëm dhe thosha "Zonjushë?" "Ju quheni Kuentin, apo jo?" thoshte zonjusha Laura. Pastaj përsëri pllakoste heshtja teksa shpirtrat e pamëshirshëm, të cilët nuk bënin tërr me sy dhe duart që dridheshin në heshtje. "Thuaji Kuemtinit kush e zbuloi lumin Misisipi, Henri". "De Soto". Fill pastaj shpirtrat zhdukeshin teksa unë kisha frikë se isha vonuar, kështu që lakoja edhe një gisht, e mandej kisha frikë të numëroja shpejt e shpejt, prandaj u përmbajta, por, përsëri u frikësova dhe zura të numëroja shpejt e shpejt. Ashtu nuk mund ta mbaja taktin me zilen, teksa valavitja e liruar e këmbëve kishte zënë të lakohej duke e çikur dyshemenë e vjetëruar, teksa dita si ndonjë xham i dritares godiste me të qëlluara spontane po të vrullshme, ndërsa barku im më mundonte edhe pse isha i ulur. *Të sillesh vërdallë, edhe pse je i ulur. Për një minutë u ndal te dera. Bersi. Duke uluritur e gërthitur. Po gjëmonte Bexhamini, evladi i pleqërisë sime. Kedi! Kedi!*

Unë do t'ua mbath. Ai zuri të qante teksa ajo iu afrua dhe e përkëdheli Shshsht! S'do t'ua mbath këmbëve. Shshsht. Ai heshti. Dilzi.

Ai e kundërmon atë që i thua kur t'i teket. S'ka nevojë as të dëgjojë dhe as të flasë.

A mund t'ia marrë edhe erën e emrit të ri me të cilin e quajnë? A është në gjendje ta kundërmojë fatkeqësinë?

Çka i kërcet atij për fatkeqësi? Fatkeqësia s'i bën zarar.

E pse ia kanë ndërruar emrin pra në mos për t'i ndihmuar që t'i shmanget fatkeqësisë së vet?

Tramvaji u ndal, pastaj u nis dhe përsëri u ndal! I shikoja kokat e kalimtarëve nën strehën e kapelave të reja të feltrës që akoma nuk ishin zbehur. Tashmë në tramvaj gjendeshin gra me shporta të pazarit, ndërsa numri i meshkujve në rroba të punës zuri të ritej e të bëhej më i madh se numri i atyre me këpucë të lustruara dhe me jaka të kollarisura.

Një zezak ma çiku gjurin. "Më falni", tha ai. I largova këmbët dhe ia lëshova rrugën. Po kalonim pranë një muri, teksa zhurma e tramvajit po përplasej për gratë me shporta të pazarit në gjunjë si dhe për njeriun, i cili në shiritin e kapelës

se papastër e kishite ngulur llullën. E kundërmoja ujin, ndërsa nga vrima e murit e pikasja vezullimin e ujit, dy shtylla dhe një pulëbardhë që thuajse nuk lëvizte në ajër, si në telin e dukshëm mes dy shtyllave. E ngrita dorën dhe nëpër kapotë i çika letrat të cilat i kisha shkruar. Me t'u ndalur tramvaji, unë dola.

Ura ishte hapur për ta lëshuar anijen e vogël. E tërhiqte rimorkiatori për të cilin ishte lidhur anija. Rimorkiatori linte një si hulli në ujë dhe njëherësh dukej se edhe anija po shkiste pa ndonjë fuqi të dukshme lëvizëse. Në pjesën e pasme të anijes një njeri i zhveshur deri në brez po zgjidhte konopin. Trupi i tij i nxirë e kishte ngjyrën e gjetheve të duhanit. Para timonit ndodhej një njeri tjetër, teksa më kokë e kishte kapelën të cilës i kishte mbetur vetëm rrethi i kapelës. Anija e vogël kaloi nën urë me shtylla të zhveshura si ndonjë fantazmë në pikë të ditës, teksa mbi pupë po eponin tri pulëbardha si lodra në telin e padukshëm.

Kur u mbyll ura, unë kalova në anën tjetër dhe u mbështeta për gardhin mbi shtëpizat për barka. Trapi ishte i zbrazët, kur dera kah shtëpiza jonë ishte e mbyllur. Anëtarët e ekipit zunë të rrëmihin pikërisht tash, pasdite vonë, pasi kishin pushuar. Hija e urës, shtyllat e gardhit dhe hija ime ishin shtirë rrafshtazi në ujë. Kështu e kisha mashtruar hijen time. Ajo s'më linte të qetë. Ishte e gjatë të paktën pesëmbëdhjetë metra. Të kisha, të paktën, diçka që ta mbysja në ujë dhe ta mbaja derisa të mbytej në të. Bile edhe hija e pakos, si dy këpucë të mbështjella, ishte shtirë në ujë. Zezakët thonë se hija e të mbyturit në ujë e ndjek atë këmba-këmbës mbi siprinën e ujit. Plapuritej dhe vezullonte, si të merrte frymë, edhe trapi ishte ngritur pak, si të merrte frymë, ndërsa mbeturinat gjysmë të zhytura, dukeshin në sipërfaqen e detit, kurse disa ndodheshin në shpellat e detit. Zhvendosja e ujit është diçka baraz me diçka Re ductio ad absurdum e çdo përvoje njerëzore dhe dy ujtitë me nga tre kilogramë janë më të rënda se ujtitë e rrobaqepësit. Çfarë plangprishjeje mëkatare, do të thoshte Dilzi. Benxhi dinte kur kishte vdekur gjyshja. Atëherë ai pat qarë. Ai e kishte kundërmuar. Ai ia kishte marrë erën.

Rimorkiatori u kthye tatëpjetë lumit duke e çarë ujin me cilindra të gjatë dhe të mpreftë e shkundi trapin me anë të valëve që i shkaktoi, kurse trapi me t'u shkundur u pjerr kah cilindrat dera u zmbraps me rrapamë të gjatë dhe nga ajo dolën

dy veta duke mbajtur një barkë të vogël. E lëshuan në ujë dhe po në atë çast doli Blandi me rrema. Kishte veshur pantallona prej flanelle, një xhaketë të përhime dhe kishte vënë një kapelë kashte po të fortë. Ai apo e ëma e tij kishin lexuar diku se studentët e Oksfordit rrëmihnin me pantallona prej flanelle dhe me kapela të forta prej kashte, kështu në fillim të marsit ia kishin blerë Xheraldit skifin, kështu që ai me pantallona të posaçme dhe me kapelë të fortë, kishte shkuar te lumi. Ata që e rianin depon e barkave iu kërcënuan se do ta thirrnin rojën, mirëpo, ai, megjithatë, rrëmihu. E ëma e tij, e veshur me gëzofe e peliçe, si ndonjë hulumtuese e Arktikut, erdhi ta përcillte me një veturë të huajtur, teksa stuhia po vërshëllente njëzet e pesë milje në orë, ndërsa një varg e copave të akullit po shkisnin si ndonjë tufë e papastër e dhenve. Që atëherë unë jam më se i bindur se Zoti i Madh jo vetëm që është xhentëlmen e sportist, por se e ka prejardhjen prej Kentakit. Si u nis ai, ajo i ra pak rrotull me veturë, pastaj përsëri iu afrua bregut të lumit dhe pastaj me marshin e parë zuri ta ngiste veturën paralelisht me të. Njerëzit thoshin, sesi duket, si të mos e kishin parë kurrë më parë njëri-tjetrin, si ndonjë Mbret apo Mbretëreshë, bile as që e vështronin njëri-tjetrin, po vetëm po shkisnin nëpër Masaçusets shtigjeve paralele si dy planetë.

U fut në barkë dhe filloi të rrëmihte. Tash po rrëmihte me rrëmbim. S'kishte çare. Thonë se e ëma ishte përpjekur ta kandiste që të hiqte dorë nga sporti i rremimit dhe të merrej me ndonjë sport tjetër me të cilin kolegët e tij nuk munden apo nuk duan të merren. Mirëpo, kësaj radhe ai qe kokëfortë. Nëse mund ta quash kokëfortësi uljen e tij me pozën e princit të mërzitur, me kaçurrelat e tij të verdha, me sytë ngjyrë vjollce dhe me çerpikët e tij të posaçëm, me ato rroba të tij të Nju-Jorkut, ndërsa e ëma e tij rrëfente për kuajt e Xheraldit për zezakët e Xheraldit dhe për femrat e Xheraldit. Burrat dhe etërit në Kentaki me gjasë duhet të jenë gëzuar kur atë farë Xheraldi e ëma e kishte shpënë në Kembrixh. Ajo zuri një banesë me qira në atë qytet, teksa edhe Xheraldi, përveç banesës që e kishte në kolexh, kishte edhe një banesë të veçantë në qytet. Ajo i lejonte Xheraldit që të shoqërohej me mua, ngase unë, ndonëse rastësisht, e kisha dëshmuar se kam mirëkuptim ndaj parimit noblesse oblige, meqë kisha lindur nën linien Meson Dikson, më linien në njerën anë të së cilës kishin mbajtur robër,

kurse në tjetrën, e kishin ndaluar mbajtjen e robërve. Ajo i lejonte atij që të shoqërohej edhe me disa studentë të cilët i plotësonin kushtet (minimale) gjeografike. Të paktën, nuk ia zinte për të madhe. Ose shtirej se nuk i shihte. Mirëpo, që kur u njoh me Spoudin, i cili dilte nga kisha e vogël numër një dhe i tha se ajo nuk ishte damë, ngase një damë nuk do të dilte në rrugë në atë orë të natës, ajo kurrë nuk mund t'ia falte që kishte pesë emra, bile një emër edhe të një duke të një familjeje të tashme angleze. Jam i sigurt se ngushëllohej me bindjen sesi një Meimgolt apo Mortemar i degjeneruar kishte lidhje intime me të bijën e portierit. Kjo duhet të jetë e mundshme, pa marrë parasysh se a e kishte trilluar ajo këtë apo jo. Spoudi ishte kampion botëror i djerrakohësisë, kurse në luftën për atë tituli çdo ndërmarrje është e lejuar teksa lojtari mund të përdorë çdo lloj dallaveresh.

Tash barka ishte shndërruar në një pikë, rremat e kapnin diellin në intervale dhe e reflektonin atë si të luante me sy barka duke shkitur. *Ke pasur ti motër? Jo, por të gjitha janë lavire. Ke pasur ti motër? Vetëm për një minutë. Laviret. Nuk ishte lavire veç për një minutë ajo që priste te pragu i derës.* Delton Eims. Delton Eims. Delton Shëts, këmisha të modës. Unë ngaherë kujtoja se janë nga stofi kaki, si këmishat ushtarake kaki, derisa kuptova se ishin nga mëndafshi kinez ose nga fanellata më *e* zgjedhur, ngase ia nxinin fytyrën kurse syve të tij ua jepnin ngjyrën blu. Deltan Eims. Ai s'e kishte elegancën e lakmuar. Shtirje. Diçka si nga letra, veç preke. Oh. Azbesti. Nuk qenka as nga bronzi. *Mirëpo, nuk do ta shihni në shtëpi.*

Edhe Kedi është femër, mos e harro këtë. Edhe ajo është e shtrënguar të bëjë disa gjëra nga instiktet e femrës.

Pse nuk e sjell në shtëpi, Kedi? Pse t'u desh të vësh ashtu si zezaket që bëjnë në livadh nëpër brazda në pyllin e errët të ndezura nga epshi e të fshehura në pyllin e errët.

Fill pastaj e dëgjova orën time për disa kohë dhe ndjeva sesi letrat që i kisha në pallto tash po shushuritnin duke u ndeshur me gardhin, prandaj u mbështeta për gardh dhe zura të vështroja hijen time të cilën e kisha mashtruar. Po ecja përbri gardhit, mirëpo rrobat i kisha ngjyrëmbyllura, kështu që mund t'i përkoja duart duke e vështruar hijen time të cilës ia kisha hedhur. E shpura deri në hijen e molos. *Harvard im bir student*

i Harvardit i Harvardit i Harvardit. Atë vogëlush me puçrra e njohu në ndeshjen me shirita lara-lara. Duke u fshehur si qyqar pas saj afër gardhit orvatej ta joshte me vërshëllim si ndonjë këlysh qeni. Si nuk e tërhoqën në dhomën e ngrënies. Nëna besonte se ai kishte një lloj fuqie magjike dhe se do t'i bënte magji si të mbeten vetëm. Megjithatë, çdo lloj lahpari. *Ai ishte shtrirë afër arkës nën dritare dhe po gjëmonte mund* të vozitej në veturë me lule në jakën e xhaketës. *Harvard. Kuentin, po të njohtoj me Herbertin. Im bir studion në Harvard. Herberti do të bëhet vëllai yt i madh, ai i ka premtuar Xhesonit punë në bankë.*

I hareshëm, celuloid si ndonjë tregtar endacak. Fytyra plot e përplot me dhëmbë të bardhë, por nuk buzëqeshën *Atje lart unë tashmë kam dëgjuar për të.* Veç dhëmbë, por nuk e vë buzën në gaz. *A po vozit ti?*

Hyr, Kuentin.

Ti po e nget.

Është automobili i saj a nuk mburresh me të motrën që e ka automobilin e parë në qytet dhuratë të Herbertit. Luisi e mësonte për çdo mëngjes a nuk e more letrën time. Zotëri Xheson Riçmond Kompson me bashkëshorten e martojnë të bijën e tyre Kendas me zotëri Sidni Herbert Hedin, ceremonia e martesës do të mbahet me njëzet e pesë prill të vitit një mijë e nëntëqind e dhjetë në Xheferson, në Shtetin Misisipi. Në shtëpi arrihet pas një gushti numri Falan Filani Falan Filan Lagjja Sauth Bend Indiana. Shrui ka thënë a nuk do ta hapësh? *Tri ditë. Tri herë.* Zotëri Xheson *Riçmond Kompsoni me bashkëshorten* Loçinvari i ri iku nga perëndimi pak para kohe, apo jo?

Unë jam nga jugu. Ti je shakaxhi.

E po, e di unë, kjo ka ngjarë diku në fshat,

Ti je shakaxhi i vërtetë. Do të duhej të bëheshe anëtar i cirkut.

Unë qeshë ai. Atje i prisha sytë derisa i ujitja pleshtat e elefantëve. *Tri herë.* Ato vajza të fshatit. S'dihet as puna e tyre. Sidoqoftë, lavdi zotit, Bajroni kurrë nuk mund t'i sendërtonte dëshirat e tij. *Megjithatë, s'ka kuptim ta godasësh njeriun në syze.* Kur do të vendosësh ta hapësh njëherë? *Gjendej në tavolinë qirinjtë ishin ndezur në çdo kënd në zarf dy lule artificiale të lidhura me një kordhele të ndyrë dhe të kuqërremtë.*

Provincialistë të shkretë më parë s'kanë parë kurrë veturë me sy, prandaj ishin mbledhur ashtu Kendasi i binte klaksonit të veturës kështu që *Ajo as që deshi të më shikonte* lipsej bërë rrugë *as që deshi të më shikonte* yt eti nuk do t'i vinte mirë sikur ta shkilte ndonjërin ndër këta ja ku të them se yt atë do të detyrohej tash të më gjente një veturë mua si të thuash më vjen keq që ti e solle këtu Herbert mua më vinte shumë mirë. Ne afër mendsh e kemi çejzen, mirëpo shpeshherë kur doja të shëtisja me të, zotëri Kompsoni u jepte zezakëve ndonjë farë pune, kurse unë mund ta humbisja kokën sikur t'u pengoja në punë ai thotë se Roskusin e paskam në dispozicion gjithherë, mirëpo unë e di mirëfilli se ç'do të thotë kjo e di imë se si njerëzit shpeshherë japin premtime për ta qetësuar ndërgjegjen e tyre. Herbert ashtu do të sillesh ti me vajzën time, por unë e di se ti nuk do të sillesh ashtu Herberti na ka llastuar të gjithëve a të kam shkruar Kuentin se ai do t'i gjejë punë Xhesonit në bankën e tij si ta kryejë Xhesoni shkollën e mesme. Xhesoni do të bëhet një bankier i shkëlqyeshëm, ai është i vetmi fëmijë imi që ka kuptim për jetën praktike për këtë duhet të ma dini mua, sepse ai i përngjan familjes sime të gjithë të tjerët janë Kompsonë të vërtetë. *Xhesoni gjeti miell me të cilin bënin tutkall për xhita. Xhitat i bënin në verandën e pasme dhe i shitnin nga pesë senca, ai dhe Patersoni i vogël. Xhesoni ishte arkatar.*

Në atë tramvaj nuk kishte asnjë zezak, ndonëse kapelat e pazbërdhylta valonin nën dritare gjatë nisjes. Të shkosh në Harvard. E shitëm livadhin e Benxhit. *Ishte shtrirë për tokë nën dritare duke uluritur. E shitëm livadhin e Benxhit në mënyrë që Kuentini të mund të shkonte në studime në Harvard.* Yt vëlla, Vëllaçkoja yt.

Do të duhej të blenit një veturë po shihni edhe vetë se sa mirë ju bëri vozitja a s'mendoni edhe ju ashtu Kuentin pa shih unë e thërras menjëherë Kuentin, e dini Kendasi më ka folur shpeshherë për të.

U mor vesh pse mos ta ftoni unë kam qejf që fëmijët e mi të jenë për njëri-tjetrin jo vetëm shokë po diçka më tepër që Kendasi dhe Kuentini të mos jenë vetëm miq. *Atë unë kam bërë incest* çfarë dëmi që ju s'keni as vëlla dhe as motër. *As motër, as motër* nuk patën. Mos e pyetni Kuentinin ai dhe zotëri Kompsoni ndihen pak të fyer kur unë jam aq e fuqishme

saqë të zbres në dhomën e ngrënies, unë tash jetoj nga vendosmëria ime, mirëpo kur të kalojnë të gjitha unë shtrenjtë do t'i paguaj, kurse ju e keni marrë bijen time. *Motra ime nuk e kishte fare. Sikur të guxoja të them Nënat. Nënat.*

Edhe sikur të mos e bëja atë që kam pasur ndërmend dhe ta merrja juve në vend të saj unë mendoj se zotëri Kompsoni nuk do të mund ta arrinte veturën.

Por Herbert a ke dëgjuar Kendas: *Nuk deshi të më shikonte këndi i ëmbël dhe kapricioz i fuqisë së saj nuk më përfilli.* Mirëpo, s'ka nevojë të jesh xheloze ai i bën lajka një plake bija e madhe dhe e martuar nuk mund t'i besojë asaj.

Marrëzi, ju dukeni si ndonjë vajzë, ju jeni shumë më e re se Kendasi faqet i keni të kuqe si të ndonjë vogëlushe. *Fytyrë tepër qaramane era e* kamforit dhe e lotëve, zëri qan pareshtur prajshëm pas derës së muzgut kundërmima e ngjyrosur e gjakut të dhisë. Arkat e zbrazëta të mbajtura tatëpjetë shkallëve të tavanit jehojnë si arkivolet e Frenç Likut. Nuk kishte vdekur në kriporen e Frenç Likut.

Kapela të pazbërdhylta, edhe pa kapela. Nuk mund të mbaj kapelë tre vjet. Nuk qeshë në gjendje. Ndonëse kam qenë në gjendje. Do të ketë kapela, që kur nuk isha unë, që kur nuk ishte Harvardi. Atje ku mendojnë më së miri, tha Babai, zënë si përdredhat e venitura të urthit mbi tullën e vdekur. Atëbotë s'do të ketë më Harvard. Përsëri. Gjëja më e pikëlluar se të gjithat. Përsëri.

Spoudi kishte veshur një këmishë; e pra ashtu duhet të jetë. Kur mund ta shoh përsëri hijen time nëse s'do të jem vigjilent dhe kur të më joshin në ujë të mos e shkel sërishmi hijen time të padepërtueshme.

Mirëpo, edhe po të mos kisha motër. Këtë, s'do ta bëja. *S'dëshiroj që ta përgjojnë time bijë.* S'do ta bëja këtë.

Si mund t'i frenoj ata kur ti i ke mësuar që të mos më respektojnë, që të mos i respektojnë dëshirat e mia. E di se ti e vështron nga lart familjen time, por a është kjo arsye që t'i mësosh fëmijët e mi që të vuajnë për shkak se s'më respektojnë. Shkelja me thembra të forta eshtrat e hijes sime që të mos hyjnë në çimento e në atë çast e dëgjova rënien e orës dhe i preka letrat në xhaketë.

S'dita të ma përgjosh bijën as ti as Kuentini dhe asnjëri tjetër çfarëdo që të bëjë ajo.

Në mos tjetër, të paktën ti vetë pranon se ka arsye që ta mbajmë nën vëzhgim.

Unë s'do ta bëja këtë punë jo s'do ta bëja. *E di se s'do ta bëja. S'pata ndërmend të flas aq rreptazi, mirëpo femrat s'e respektojnë dot njëra-tjetrën.*

Por, pse? Ora në kullën e orës zuri të binte kur unë e shkela hijen time, ndonëse ishte vetëm një çerek ore. Dikonin s'e vura re asgjëkundi. *Kur kujtova se do të mundja.*

Ajo nuk tha se ashtu bëjnë gratë ajo tha ashtu nga që e do Kedin.

Llambat e rrugës zbritnin tatëpjetë kodrës pastaj i ngjiteshin qytetit. Unë ecja nëpër barkun e hijes sime. Mund ta shtrija dorën pas saj, *Ndieja se Babai ishte pas meje jashtë errësirës së dendur të verës dhe të gushtit të llambës së rrugës.* Babai dhe unë i mbrojmë gratë nga njëra-tjetra dhe gratë tona nga ato *Gratë janë të atilla ato nuk i njohin meshkujt ndaj jemi ne ato janë lindur vetëm me prirje të begatshme për të dyshuar aq të begatshme saqë ngaherë i korrin të lashtat me bereqet që zakonisht MBËSHTETET Në të Vërtetën ato kanë njëfarë afiniteti*

për të ligën njëfarë instikti që ta pajisin të ligën me atë që i mungon asaj ato e joshin instinktivisht rrotull vetes ashtu si e' tërheq në kotje jorganin rreth vetes duke e pasuruar shpirtin me të, ndërsa e liga të arrijë qëllimin qoftë real ose të trilluar. Ecte mes dy studentëve të posaregjistruar. Ende ishte i kalpuar nga atmosfera e paradës, ngaqë më përshëndeti ushtarakisht, si ndonjëfarë oficeri.

"Dua të të shoh për një çast", i thashë, duke u ndalur.

"Mua të më shohësh? Ani. Mirupafshim, djelmosha", u tha duke u ndalur dhe duke ua kthyer shpinën; "më vjen mirë që bëmë një copë muhabeti". Ashtu e kishte Dikoni. Ndërsa ju më flitni për disa psikologë të talentuar. Thonë se brenda dyzet vjetëve nuk paska humbur asnjë tren në fillim të semestrit të çdo viti akademik dhe se do ta njihte jugorin me t'i hedhur një vështrim. Mjafton t'ju dëgjojë vetëm një herë sesi flitni, në mënyrë që aty për aty t'ia qëllojë se nga cili shtet jeni dhe kurrë s'gabonte. Ngaherë e vishte uniformën e rregullt në pritjen e treneve, dofarë lloj petkash si të "Kasolles" së Xha Tomit, me arna dhe të tjerat.

"Në rregull, zotëri, byrum, këtej, lum zotërie, ja arritëm", dhe ua merrte valixhen. "Hej, çun, pa eja këtu dhe merri këto valixhe". Në raste të këtilla lëvizte një grumbull i madh i stivuar i valixheve, ndërsa nën të do ta pikasnit djaloshin e bardhë pesëmbëdhjetëvjeçar. Dikoni do të hidhte edhe ndonjë valixhe në atë piramide dhe pastaj ë largonte. "Nisu e ruhu se të rrëzohet gjë". "Po, zotëri, lum zotërie i ri, i jepni zezakut plak numrin e dhomës dhe do t'ju presë çdo gjë në rregull si të arrini".

Që nga ai çast e derisa ju nënshtronit e ai e shkonte kohën duke hyrë në dhomën tuaj duke dalë nga ajo, kudo i pranishëm dhe i prirur për dërdëlisje. Megjithatë, sjellja e tij, me t'u përmirësuar petkat, i merrte disa manire të veriorëve, më në fund, kur ju mërziste aq tepër saqë fillonit t'i ruheshit, ai ju thërret Kuentina apo me emrin që e keni dhe kur do ta shihnit herën tjetër tashmë mbante rroba të mbajtura të Bruksit dhe kapele me fjongo s'kam haber se të cilit klub të Prinstaunit që ia kishte falur dikush, ndërsa ai i mbante me bindjen e thellë e të lumtur se ishin petkat ushtarake të Abë Linkolnit. Para shumë vjetësh, kur s'di as vetëse nga ia behu për herë të parë në Universitetin e Oksfordit, dikush e kishte

përhapur fjalën se Dikoni kishte diplomuar teologjinë. Kur e pat të qartë se ç'rëndësi kishte ai trillim për të, ishte aq i impresionuar me të saqë filloi vetë ta përhapte rreth e rrotull derisa më në fond u bind edhe vetë se ishte e vërtetë. S'do mend, tregonte barceletat e pakripa e të shumta mbi ditët studentore, duke i quajtur intimisht, e në të shumtën e rasteve, gabimisht, profesorët e ndjerë apo të pensionuar, me emrat e tyre. Sido që të jetë, ai ishte prijësi, mentori dhe miku i grupeve të tëra të studentëve të padjallëzuar e të vetmuar të vitit të parë, kurse unë mendoj se, përkundër të gjitha llomotitjeve dhe shtirjeve të tij ai para Zotit ishte njësoj si të tjerët.

"Ka tri-katër ditë që s'të kam parë", tha ai, duke më vështruar ashtu i kapluar nga solemniteti ushtarak. "Mos ishe i sëmurë?"

"Jo, s'isha. Jam shëndosh e mirë. Punova. Unë të kam parë".

"Me të vërtetë?"

"Në paradë, para disa ditësh".

"Oh, atje, posi. Po, isha në paradë. S'jam ngushtë unë për ato parada, por, burrat kanë qejf të jem me ta, veteranët. Leidit duan t'i shohin veteranët. S'ke çare pa ua bërë qejfin".

"A ke qenë i shtrënguar të marrësh pjesë edhe në atë festën italiane?" shtova unë. "Ma merr mendja se t'u desh të marrësh pjesë edhe në paradën e Ligës kundër alkoolizmit?"

"Në të a? Këtë e bëra për hir të dhëndrit tim. Ai dëshiron të hyjë në punë në qytet. Si pastrues. Unë i them se e mira e së mirës është ta gjej fshesën që të flej mbi të. Ani, më paske parë?"

"Madje, dy herë".

"Deshe të thuash, me uniformë? Si t'u duka?"

"I mrekullueshëm. Më mirë se të gjithë. Paj gjeneral të kisha bërë unë ty, Dikon".

E lëshoi ngadalë dorën e tij në muskulin tim, atë dorë të regjur, po të butë, si janë të gjitha duart e zezakëve. Dhe, m'i tha këto fjalë: "Dëgjo, mor, rixhanë ta kam, mos i thuaj askujt. Ty mund ta them açik, ngaqë ne jemi të një sorollopi". U mbështet pak tek unë, zuri të fliste shpejt e shpejt, por s'më shikonte. "Sapo ndërmora diçka. Më prit deri në vitin e ardhshëm. Vetëm pritëm. Atëherë do të shohësh se ç'vend do

të kem unë në paradë. S'është nevoja të ta them sesi ia bëj. Ja ku të them, lum djali, prit se ke ç'të shohësh". Pastaj, më shikoi përsëri, më preku lehtas në shpatull, u kolovit në thembra, ma bëri me kokë dhe vazhdoi: "Po, lum zotërie. Nuk u regjistrova më kot, para tre vjetësh, në Partinë Demokratike. Dhëndri im me punë në qytet, kurse unë... Po, lum zotërie. Sikur regjistrimi në Partinë Demokratike ta shtrëngonte atë qen bir qeni që t'i përvishej punës... Sa për mua: vetëm ti prit pardje e një vit më vonë në atë kënd të rrugës, e do të shohësh".

"Ashtu shpresoj. Me hak e ke, Dikon. Dhe, meqë ra fjala"... Nxora një letër nga xhepi. "Nesër, çoje këtë letër në dhomën time dhe jepija Shruit. Ai do të të jep diçka. Por, kija mendtë vetes mos para ditës së nesërme".

E mori letrën dhe filloi ta vështronte nga të gjitha anët. "Qenka e mbyllur".

"Po. Brenda është diçka e shkruar. Mirëpo, vetëm nesër të vlen".

"Bah", bëri ai. E shikoi plikon me buzë të shtrënguar. "Ti the se Shrui, do të më falë diçka?"

"Po, një peshqesh, nga unë".

Tash më vështroi përsëri duke e mbajtur plikon e bardhë në dorën e zezë, në diell. Sytë i kishte të butë, pa bebëza dhe të përhimë, dhe, në atë çast, papritur e papandehur e vura re Roskusin duke më shikuar me pozën e tij prej të bardhi me uniformën politikën dhe me sjelljen e tij të pabesueshme, sekrete, të përmbajtur e të pikëlluar. "Po bën shaka me zezakun plak, apo jo?"

"Ti e di se s'bëj shaka. A ka bërë hoka me ty ndonjë jugor?"

"Mirë e ke. Janë njerëz shumë të mirë. Mirëpo, s'ke si ta çosh jetën me ta".

"A je përpjekur ndonjëherë?" e pyeta unë. Roskusi, sa hap e mbyll sytë, u zhduk. Përsëri e mori atë mënyrë të sjelljes të cilën e ka pasur kaherë para të tjerëve, i krekosur, i kapardisur, po jo gjithaq i pagdhendur.

"Do t'i plotësoj dëshirat e tua, lum djali".

"Por, mos harro, kurrsesi mos para të nesërmes".

"U mor vesh. Të kuptova. E pra..."

"Shpresoj se..." ia ktheva unë. Më shikoi me patëkeq, duke m'i ngulur sytë. Në atë çast ia shtriva dorën, ai e toku me gjithë mend, i këndellë nga ëndrra e tij bashkiake dhe ushtarake. "Ti

je njeri babaxhan, Dikon. Unë kam shpresë se... Ti u ke ndihmuar shumë të rinjve, në ndonjëfarë mënyre".

"Gjithmonë jam përpjekur të sillem mirë me të gjithë", më tha ai. "Unë s'bëj aq dallime shoqërore. Për mua njeriu është njeri, kudo që të jetë ai".

"Shpresoj se ngaherë do të gjesh miq ashtu si deri tash".

"Të rinjtë. Me ta unë pajtohem shumë mirë. As ata s'më harrojnë". E tha këtë duke ma treguar plikon. E futi në xhep dhe e kopsiti pallton. "Po, lum zotërie", vazhdoi ai, "kam pasur miq me të vërtetë të mirë".

Ora në kullë, zuri të binte përsëri, gjysmë ore. Qëndroja në barkun e hijes sime dhe i dëgjoja të rënat e mëdha e të qeta nëpër rrezet e diellit, midis gjetheve të holla e të vogla. Të gjëra, të qeta, të prajshme, me atë tronditje vjeshte në tingujt e tyre siç e kanë ngaherë kambanat në kumbimet e tyre, bile edhe në muajin e nuseve. *Ishte shtrirë për tokë nën dritare duke kujtisur.* I hodhi vetëm një vështrim dhe ▪ kuptoi. Nga goja e fëmijës. *Lampionet e rrugës.* Të rënat ▪ kambanës pushuan. U ktheva në postë, duke ▪ luhatur hijen time në trotuar. *Lëshohen tatëpjetë kodrës pastaj i ngjiten qytetit si ato lampa të varura njëra mbi tjetrën në mur.* Babai tha se ajo e do Kedin, ngaqë i do njerëzit për shkak të të metave të tyre. Xha Morit, me këmbë të shtrira para vatrës, iu desh të shtrinte njërën dorë për ta ngritur dollinë për Kërshëndellat. Xhesoni ia behu me vrap me duar në xhepa, kështu që ra dhe mbeti i shtrirë si pula me krah të lidhur dhe me këmbë për gredel, e ngriti Vershi. *Kur rent pse nuk i nxjerr duart nga xhepat të paktën vetë do të mund të ngriteshe me të rënë.* E sillte kokën rreth e rrotull në djep pastaj e vërtiste pas. Kedi i ka thënë Xhesanit se Vershi kishte thënë se xha Mori s'punonte ngaqë kur kishte qenë i mitur, e kishte vërtitur kokën në djep.

Shrui po vinte rrugës duke u kalamendur, hijerëndë e trashallëk, ndërsa syzet i shkëlqenin nën gjethet vezulluese si hurdha të vogla.

"Dikonit ia dhashë një farë porosie. Ndoshta sot pasdite s'do të jem këtu, prandaj, mos i jep asgjë para ditës së nesërme, a më more vesh".

"Në rregull". Më lëshoi një vështrim. "Pa më thuaj, ç'ke vendosur të bësh sot? Sillesh vërdallë rreth e rrotull, i spitulluar,

tamam si prologu i ritit të djegies të vejushës me kufomën e burrit të ndjerë. A ishe sot në mëngjes në psikologji?"

"Asgjë s'kam ndër mend. Mos harro, mos para ditës së nesërme".

"Ç' mban aty?"

"Oh, asgjë. Këpucët që i çova për t'u ngjitur shoje. Mos para ditës së nesërme, more vesh?"

"Mirë. Mos ki merak. Ama, sesi më ra në mend, e more sot në mëngjes atë letër nga tavolina?"

"Jo!"

"Atëherë, ende qenka atje. Nga Semiramida. E solli shoferi para orës dhjetë"

"Mirë. E marr. Sikur të dija ç'kërkon përsëri".

"Me gjasë, përsëri ndonjë koncert xhazi. Ta ta bum ta, të lumtë Xherald. Kuentin, bjeri pak më fort daulles. O zot, sa i lumtur jam që s'jam xhentëlmen". E vazhdoi rrugën duke e mbajtur librin dhe duke u kalamendur, pakëz i shtrembëruar, duke e ndier të kënaqur ashtu si trashalluk që ishte. *Lampionat e rrugës* a mendon ti ashtu, ngaqë njëri ndër stërgjyshët tanë ka qenë governator, kurse tre të tjerë gjeneralë, ndërsa nga ana e Nënës, s'ka qenë askush.

I gjalli është më i mirë se i vdekuri, por asnjë njeri i gjallë apo i vdekur s'është shumë më i mirë se tjetri njeri i gjallë apo i vdekur. *Por, të paktën, sipas mendimit të Nënës. E pat, e pat. Atëherë të gjithë ishim të helmuar* ti e ngatërron mëkatin dhe moralin ose ndoshta as që i ka vajtur nga mendja.

Xheson unë s'kam çare pa ikur kurse ti kujdesu për të tjerët unë do ta marr me vete Xhesonin dhe do të shkojmë atje ku s'na njeh askush dhe ku do të ketë mundësi të rritet dhe t'i harrojë të gjitha këto, të tjerët s'më honepsin dot ata as që kanë dashur diçka me atë egoizmin e tyre tipik të Kompsonëve dhe me kryelartësinë e shtirur Xhesoni është i vetmi të cilit zemra ime mund t'i rrëfehet pa drojë.

Marrëzia Xhesoni s'e ka keq unë sapo mendoja që si ta ndiesh veten më mirë ti me Kedin do të duhej të shkonit në Frenç Lik kurse Xhesonin ta lini këtu vetëm me ty e me zezakë atëbotë ajo do ta harrojë atë dhe do të zhduken këto dëngla *ajo s'vdiq në kripore* ndoshta do të gjej një burrë për të *e jo vdekjen në kripore*

Tramvaji ia behu dhe u ndal. Kambanat ende kumbonin

përgjysmë. Hyra, tramvaji u nis, duke fshirë gjysmë ore. Jo, po tri të katërta. Edhe ashtu do të ishin dhjetë minuta. Të ikësh nga Harvardi *ishte ëndrra e Nënës tënde që ta shiste livadhin e Benxhit që të*

Vallë, ç'faj kam bërë që kam kësi fëmijësh Benxhaminin e kisha veç si Kastigim, kurse tash ajo s'më respekton aspak mua t'ëmën unë për të sa shumë kam vuajtur ëndrra kam parë plane kam bërë të zijtë e ullirit kam hequr kam zbritur në këtë luginë kurse ajo kurrë që kur i ka hapur sytë që kur erdhi në "botë nuk ka menduar në mua me gjithë qejf hove-hove e vështroj dhe e pyes veten athua ajo është fare fëmija ime vetëm Xhesoni s'më ka trishtuar për asnjë çast që kur e pata në prehër për herë të parë e dita menjëherë se ai do të bëhej hareja dhe salvimi im, pandehja se Benxhamini ishte dënim i mjaftueshëm për të gjitha mëkatet e mia mendoja se ai ishte dënimi për shkak të shkeljes së krenarisë sime dhe u martova me njeriun i cili e hiqte veten më superior se unë nuk qahem që e kam dashur mbi të gjithë bile pikërisht nga ndjenja e detyrës, ndonëse Xhesoni tërë kohën më kishte hyrë më së shumti në zemër por tash e kam të qartë se kam vuajtur gjithaq tash e kam të qartë se duhej të vuaj për mëkatet e tua si edhe të miat ç'ke bërë çfarë mëkatesh m'i ka veshur familja jote sojli dhe e fortë por ti përherë do të jesh në anën e tyre ti gjithmonë e ke arsyetuar gjakun tënd vetëm Xhesoni mund të gabojë ngaqë ai është më tepër Baskomb sesa Kompson, ndërsa bija jote ime bijëz bija ime ajo s'mundet ajo s'bën ashtu kur kam qenë vajzë kam qenë fatkeqe, kam qenë Baskomb më kanë pas mësuar se nuk ka rrethinë ku është femra femër ose damë ose se nuk është asgjë prej gjëje mirëpo as që më ka vajtur nga mendja kur e mbaja në prehër se ime bijë do ta harronte veten deri në atë shkallë a s'di ti se mjafton ta shikoj gozhdë në sy për të të thënë se ç'e ka gjetur ti ndoshta pandeh se ajo vetë të pranon por ajo nuk flet për veten e saj ajo është misterioze ti s'e njeh atë unë i di disa gjëra që i ka bërë ajo por unë më parë do të vdisja sesa që t'i kisha kallëzuar ti veç mos pusho së qortuari Xhesonin më padit sa të duash se si po e kandis që t'i qepet pas asaj e ta përgjojë si të ishte një punë e keqe ndërsa bija jote ajo mundet unë e di se ti atë nuk e ke në zemër dhe se mezi pret të dëgjosh shprrallime kundër tij askurrë as që e ke dashur përqeshe sa të duash si ke pasur zakon ta përqeshësh Morin nuk mund të më

pikëllosh aspak për aq sa më kanë pikëlluar fëmijët e tu e pastaj unë s'do të jem më, kurse Xhesonin s'do ta dojë më asnjeri askush më s'do ta mbrojë atë nga kjo e vështroj përditë e frikësuar që mos të qesë krye edhe tek ai gjaku i Kompsomëve kur është në shoqërinë e të motrës, e cila sa hap e mbyll sytë ikën vrik nga shtëpia që të takohet s'di me kë a s'e ke parë fare atë njeri a s'do të më lejosh që të marr vish se cili është ai s'e kam për vete unë do të duroja disi sikur ta shihja e kam për ty që të mbrohesh por kush do të luftojë kundër gjakut të papastër as që më mundëson të provojë të paktën detyrë jona është të rrimë kruspull në këmbë me duar të kryqëzuar, ndërsa ajo jo vetëm që ta njollosë emrin po e prish edhe ajrin që e dihasin fëmijët e tu. Xheson s'ke çare pa më dhënë leje të shkoj unë s'duroj dot më lënë ta marr me vete Xhesonin, kurse ti përkujdesu për të tjerët ata s'i kam të gjakut e të mishit tim ata i kam të huaj s'kanë asgjë timin ndaj ua kam frikën unë mund ta marr Xhesonin dhe të ik atje ku s'na njeh askush unë do të gjunjëzohem dhe do të lus që të më falen mëkatet të paktën ai të shpëtojë nga shpifja ç'nuk do të bëj që të harroj se kanë qenë të tjerët

Nëse ishin tri të katërtat e orës, tashmë s'ka as dhjetë minuta. Një tramvaj, sapo u largua, kurse gjindja e presin tramvajin tjetër. Kam pyetur, por s'ditën të më thonë, a shkon ndonjë tjetër para dite, ngaqë e dini si është zavalli me atë qarkullim të trafikut të paralagjes. I pari ishte përsëri tramvaji. Hyra. Të kapërthen heshtja, në mesditë. Sikur të dija, a thua njësoj ndiejnë edhe minatorët thellë nën tokë. Prandaj, jehojnë sirenat: për hir të atyre që derdhin djersë, dhe, nëse jemi mjaft larg nga djersa, nuk do ta dëgjoni fishkëllimën e sirenës dhe brenda tetë minutave, lipset të jeni në po atë distancë nga djersa në Boston. Baba ka pas thënë se njeriu është fryt i fatkeqësive të veta. Njeriu pandeh se edhe fatkeqësitë dikur do të kapiten e do të na lënë rehat, mirëpo atëbotë koha bëhet fatkeqësia e njeriut, thotë Babai. Pulëbardha po eponte hapësirës së lidhur për telin e padukshëm. Njeriu e ngre me vete simbolin e zhgënjimeve të veta në amshueshmëri. Atëherë krahët janë më të mëdhenj, tha Babai, vetëm ai që di ta lozë harfën.

Sa herë që ndalej tramvaji, e dëgjoja orën time, mirëpo jo aq shpeshherë, shkonin të hanë. *Kush do ta lozte* ngrënien

puna e hajës dhe hapësira hapësira dhe koha të përziera. Lukthi thotë mesdita. Rradakja thotë koha e hajes. Mirë de po sikur të dija sa është ora sa është me të vërtetë. Gjindja dilnin. Tani tramvaji nuk ishte ndalur aq shpesh i boshatisiur nga nevoja për ushqim.

Paskëtaj, mesdita kaloi. Zbrita dhe u ndala tek hija ime dhe pas një hopi ia behu një tramvaj, kurse unë hyra dhe u ktheva në stacionin e tramvajit në paralagje. Aty duhej të nisej një tramvaj ndaj gjeta vend përnjëherësh pranë dritares tramvaji u nis dhe unë bëja sehir sesi qyteti disi po shkëputej në ishujza të palëvizshme të shtëpive e pastaj edhe të lisave. Hera-herës e shikoja lumin dhe sesi më shkrepi dhe mendova se sa mirë do ta kishin ata atje poshtë në Nju-London sikur koha dhe barka e Xheraldit të lidheshin solemnisht për paraditën e molisur dhe mendoja vallë ç'kërkonte ajo plaka kur ma dërgoi letrën para orës tetë sot në mëngjes. Çfarë çehreje do të kishte Xheraldi sikur unë të isha njëri ndër ata *Dalton Eimsat* oh *azbesti Kuentini shtite në sfond.* Diku ku do të kishte edhe vajza. Gratë përnjëmend kanë *gjithmonë zëri i tij ishte mbi llakellaket zëri që belbëzonte* prirja ndaj të ligës, kundrejt besimit se asnjë femre s'i duhet zënë besë, porse disa meshkuj janë goxha të pashibla që të mbrohen vetë. Vajzat e rëndomta. Kushërirat e largëta, ilakatë pas gardhit dhe mikeshat e familjes të cilave vetëm njohja i lidh me farefis e gjini disi noblesse oblige. Ajo ishte ulur aty dhe para të gjithëve na fliste se ç'dëm i madh ishte që Xheraldi e kishte tërë bukurinë e familjes, ndërsa mashkullit s'i duhet një gjë e tillë, madje-madje, më mirë e ka pa bukuri, ndërsa goca pa bukuri është e humbur dhe e shfarosur. Na tregonte për dashnoret e Xheraldit *Kuentini shtiu në Herbertin ai e qëlloi zërin e tij nëpër dyshemenë e dhomës së Kedit* me një ton që e kishte në qejf. "Kur i kishte mbushur të shtatëmbëdhjetat, një ditë prej ditësh, i thashë: Ç'dëm i madh është që ti ke gojë të atillë të cilën duhej ta kishte ndonjë vashë" a mund të merrni me mend *perdet e mbështetura për mugëtirë mbi erën e mollës kokën e kishte të kthyer nga mugëtira duart pas kokës me krahët e kimonos, zëri që gurgullonte mbi parajsën rrobat në krevat afër erës mbi mollën* çka ka thënë? Sapo i kishte mbushur të shtatëmbëdhjetat, mos harroni. "Nëno", kishte thënë "kjo ngjan shpeshherë". I ulur aty me pozën prej mbreti po i kundronte nja dy-tre syresh nëpër

qerpikë. Qerpikët e tij, u ngjitën vrik përpjetë si dallëndyshet në vrundullin e fluturimit, qerpikët e tij. Shrai tha se nganjëherë *a përkujdesesh ti për Benxhin dhe Babanë.*

Sa më pak flet për Benxhin dhe Babanë aq më mirë e po kur të ka hëngër ty malli për ta

Ma jep fjalën

Mos u shqetëso ti për ta ti vete prej këti me faqe të bardhë Premto unë jam e sëmurë ma jep fjalën pyeti se kujt i vajti nga mendja ajo mesele e shkretë, por ai gjithmonë besonte se zonja Blend është grua e kolme dhe shtoi sesi ajo e kishte përgatitur të birin Xheraldin ashtu saqë bile nëse duhet mund t'ia merrte mendët edhe dukeshës. Shruin e quajti çunak topolak kanadez. Nja dy herë, pa më pyetur fare, ndërhyri që të kem shokun e ri të dhomës, njëherë m'u desh të shpërngulesha unë vetë, ndërsa herën e dytë

Në mugëtirë e hapi derën. Fytyrën e kishte si marmelata nga kungulli.

"Ja, do të të them nga zemra lamtumirën e fundit. Fati i pamëshirshëm mund të na ndajë, por unë s'do ta dashuroj askurrë tjetrin. Kurrën e kurrës".

"Përse e ke fjalën?"

"E kam fjalën për fatin shpirtkazmë të mbështjellë në shtatë metra mëndafshi ngjyrë kajsie, e cila, nëse llogarisim sipas peshës ka në vete më shumë metal sesa robi e dënuar *më* gali dhe se i vetmi çifligar i zinxhirit lidhës të sigurt dhe endacak të Konfederatës sonë të ndjerë". Mandej më dëftoi se si paska shkuar te proktori për disiplinë duke kërkuar që t'ia ndërronte vendin dhe se si proktori ishte treguar kokëngjeshur dhe i poshtër dhe kishte ngelur këmbë që më parë të bisedonte me Shruin. Pastaj, ajo i kishte propozuar që ta sillte Shruin përnjëherësh për të biseduar, kurse ai nuk kishte qenë dakord, kështu që paskëtaj ajo ishte sjellë pak më mirë me Shruin. "Kam parim të mos flas kurrë keq për femrat", tha Shrui, "por kjo grua ka më tepër karakteristika të lavires se çdo zonjushë në këto shtete tonat suvereoe dhe në dominione". Dhe tash Letra në tavolinë e sjellë nga dora e saj, urdhri i orkidesë së parfumosur të ngjyrosur Sikur të dinte ajo se unë mënt kalova nën dritare duke ditur se letra gjendej aty pa ato E ndershme dhe e dashura zonjë akoma s'pata rastin ta marr lajmin tuaj por ju lutem që më parë që të më ndjeni sot ose dje apo nesër apo

në çfarëdo dite tjetër. Me sa më kujtohet tregimi juaj i ardhshëm ka të bëjë me atë sesi Xheraldi e hedh zezakun e tij tatëpjetë shkallëve dhe sesi zezaku e lut që t'ia mundësojnë në Fakultetin Teologjik që të mund të mbetet pranë zotërisë së tij të dashur të vogël Xheraldit dhe sesi zezaku pastaj kishte vrapuar rrugës pareshtur deri në stacionin afër Uandonit me sy të përlotur kur ishte nisur imzot Xheraldi Do ta pres ditën kur do të më rrëfeni sesi ai burri pronari i uzinës së Sharrës ia kishte kafshuar pushkën me dhëmbë përgjysmë dhe ia kishte kthyer duke i fshirë duart me shaminë e mëndafshtë të cilën e flaku pastaj në demiroxhakun këtë mesele e kisha dëgjuar dy herë.

E kishte qëlluar nëpër ju vura re kur po dilnit ndaj përfitova nga rasti i volitshëm dhe erdha pandehja se do të mund të njohtoheshim, urdhëroni një cigare

Falemnderit, s'e pi

Me gjasë nuk duhet të kenë ndërruar shumë gjëra atje poshtë që kur ika unë më lejoni ta ndez unë një

Vetëm urdhëroni

Falemnderit kam dëgjuar shumë për ju unë mendoj se nëna juaj nuk do të hidhërohej nëse unë e hedh shkrepsën pas demiroxhakut shumë kam dëgjuar për ju Kendasi më ka folur shpeshherë në Liks me të vërtetë u bëra xheloz thosha me vete kush dreqi qenka ai Kuentini duhet të bindem personalisht sesi më duket ai burrë i dheut ngaqë unë isha mjaft i interesuar e dini si e pashë atë vajzë nuk më vjen turp t'ju them këtë as që më ka vajtur nga mendja se ai do të mund të ishte vëllai i saj për të cilin fliste pandarë nuk do të mund të flisja më shumë për ju se jeni i vetmi mashkull në botë qoftë fjala edhe për burrin ndoshta e ndërruat mendjen mos doni ta ndezni një

Unë s'e pi duhanin

Në qoftë ashtu s'do të ngul këmbë ndonëse është duhan i rrallë një pako më kushton njëzet e pesë dollarë pakoja me njëqind copa me shumicë te një mik në Havanë se unë mendoj se kanë ngjarë shumë ndryshime atje lart gjithnjë u premtoj se do t'i vizitoj por kurrë s'kam nge ta bëj këtë vizitë kam dhjetë vjet që punoj sa mundem nuk kam kohë të largohem nga banka ndërsa ka ligjërata në universitet shprehitë e njerëzve ndërrojnë punët që studentit i duken të rëndësishme, por më rrëfeni si janë punët atje

Nuk do t'u them Babait e Nënës nëse e ke fjalën aty

S'do t'u thoni s'do t'u thoni oh për këtë e paskeni fjalën më kuptoni se aq më bën në do t'u thoni apo jo një gjë e tillë s'ka kuptim por s'është kurrfarë krimi që dënohet me ligj nuk jam as i as i pari i fundit, por isha vetëm fat nopran ju ndoshta keni pasur në shumë fat

Po gënjeni

Mos u zemëroni unë nuk po rropatem që t'ju detyroj që të thoni diçka që s'e keni në qejf s'pata ndër mend t'ju fyeja një djalosh i çiftit tuaj do të kuptojë një punë të tillë tash shumë më seriozisht sesa pas pesë vjetësh.

Unë dallaveren e mas vetëm në një mënyrë dyshoj se Harvardi do ta ndërrojë këtë gjykim që kam

Këtë rol e luajtëm më mirë se do artistë të dramës do të kishit sukses eklatant në teatër keni të drejtë atyre s'u duhet folur aspak për këtë e kaluar e harruar s'ka kuptim që një cikërrim i tillë të bëhet pengesë mes nesh, unë ju dua Kuentin e dua pamjen tuaj ju s'dukeni si ata të pagdhendurit e tjerë mua më vjen mirë që këtë punë do ta rregullojmë ashtu unë i kam premtuar nënës suaj se do t'i ndihmoj disi Xhesonit por do të doja t'ju ndihmojë edhe juve Xhesoni do ta kishte mirë punën këtu por për një djalosh si ju në një birucë të tillë nuk ka ardhmëni

Ju falem nderit më mirë interesohuni për Xhesonin ai do të jetë më i mirë për ju se unë

Më vjen keq për atë mesele por asokohe unë isha axhami kurrë s'e kam pasur nënën çfarë e keni ju që të m'i mësonte parimet e mirësjelljes kjo do t'i shkaktonte një dhimbje të panevojshme sikur të merrte vesh se keni të drejtë s'është nevoja ta marrë vesh bota këtë mesele bile as Kendasi.

Unë u tregova Nënës dhe Babait

Më shikoni pa më shikoni mirëfilli ç'pandehni sa do të mund të keni punë me mua

S'do të duroj një kollë të gjatë në paçi mësuar edhe ju të rrahni në universitet provoni e do të shihni sesa do të duroj.

Mor picirruk i dreqit ç'kujtoni çfarë do të arrini me këtë

Provoni pa do të shihni

Zot i madh cigarja ime ç'do të thoshte nëna juaj sikur të gjente duçin në vatrën e saj tamam me kohë dëgjoni Kuentin duam të bëjmë diçka për të cilën të dytë do të pendohemi unë ju dua më pëlqyet si ju pashë thashë me vete duhet të jetë

shumë i hijshëm kushdoqoftë kur Kendasi ishte aq e dalldisur me të pa dëgjoni ka dhjetë vjet që jetoj në botë e pavarur ato punë s'çojnë kandar gjithaq ato do t'i mësoni edhe ju një ditë të pajtohemi ne të dy si fëmijët e universitetit të vjetër Harvardit dhe më duket se unë nuk do të dija të them se ku gjendet ai vend vendi më i mirë në botë për një çunak unë do t'i dërgoj fëmijët e mi atje ata do të jenë më fatlumë se unë pritni mos shkoni ende të bisedojmë shtruar për këtë nëse ndonjë student ka aso idealesh unë jam për idealet ato i hyjnë në punë derisa të jetë në universitet ia formojnë rëndësinë e tij sipas traditave të shëndosha të atij instituti por kur një njeri i tillë del në botë ai duhet ta çajë rrugën e jetës ashtu si di më së miri ngaqë do të shohë se edhe të tjerët veprojnë njësoj ngaqë jemi të dënuar me atë t'ia shtrëngojmë duart njëri-tjetrit e kaluar e harruar ndodhi se ç'ndodhi në interesin e nënës suaj mos e harroni gjendjen e saj shëndetësore ejani më jepni atë dorë të tokeni shikoni është nga manastiri tamam nuk ka kurrfarë njolle në të nuk është as e zbubravitur shikoni

Shkoni në djallë me paratë tuaja

Jo merrini unë tash i takoj familjes e dini e di unë se çfarë hallesh kanë studentët djemtë e rinj kanë një mori detyrash individuale dhe gjithmonë është zor t'i nxjerrësh paratë për punë të atilla nga babushi e di unë këtë edhe vetë jam ritur në kushte të atilla deri para do kohe por tash unë po martohem pikërisht me një nga ajo anë ama mos u bëni të çmendur më dëgjoni kur kemi rastin të bisedojmë me gjithë mend do të doja t'ju kallëzoj diçka për një të ve të hijshme të vockël atje matanë në qytet

Kam dëgjuar unë këtë mesele mbajini paratë tuaja të mallkuara

Merrini si hua të vogël mbyllni sytë për një moment dhe do të jetni më e pasur për pesëdhjetë dollarë

Ju lutem mos më prekni më mirë e keni ta flakni atë cigare nga mbështetësja e vatrës

Atëherë rrëfeni diçka për mua dhe vafshi në djall të mallkuar do të shihni se ç'do të arrini me të sikur të mos ishit i krisur do të kishit të qartë se e kam dinjitetin tim prandaj nuk do të lejoja të më fyente dijë axhami i çiftit të Galohadit kalorësit fisnik të dikurshëm të Tryezës së Rrumbullakët vëllait tuaj nëna juaj më ka thënë se ç'bluani në rradaken tuaj ndaj ajo

ju ka fryrë oh hyr hyr e dashur sapo u njohtuam Kuentini dhe unë biseduam për Harvardin m'u deshte diçka vogëlushja s'mund të qëndroj larg babait pse jo

Dil një copë here Herbert pata një fjalë me Kuentinin

Hyr hyr të bëjmë pak muhabet të gjithë të lidhim miqësi sapo e kisha fjalën për Kuentinin

Herbert pa dil për një hop të lutem

Ani mirë motër e vëlla duan të shihen edhe njëherë vetëm

A e largoni atë cigare nga vatra

Si zakonisht keni të drejtë çunak unë do ta thyej qafën prej këtu, kurse ata le të të qesëndisin sa të duan Kuentin që nga dita e pasnesërme do të duhet të kërkoj leje nga babushi apo jo zemër më puth thesari im

Pushoni më, lëreni për pasnesër

Atëherë unë do ta kërkoj kamatën e dashura ime mos lerë që Kuentini t'i hyjë ndonjë pune që s'mund t'i dalë mananë sapo më ra në mend a i kam treguar Kuentinit atë kallëzim për atë njeri dhe për papagallin e tij se ç'ndodhi kallëzimi i pikëlluar ma përkujtoi atë mos harro ta — ta mirupafshim në gazetat e mahisë

Bah

Ani

Se ç'të shkrepi tash

Kurrgjë

Përsëri përzihesh në punët e mia a s'u lodhe verës me ngatërresa të tilla

Kedi ty të kanë zënë ethet *Ti je e sëmurë, ç'ke moj*

Jam e sëmurë. S'mund të pyes.

E ka vrarë zërin e tij nëpër

Mos atë rezil Kedi

Herë pas here lumi shndriste mananë atyre gjërave duke i reflektuar shkëlqimet shkëlitëse pasdite dhe më vonë Shumë *më* vonë, ndoshta se ne e kaluam vendin ku ai ende po rrëmihte ujit teposhtë ashtu madhështor i vështruar nga zoti i zotrave. Më mirë. Zotrave. Zoti do të qe hor edhe në Boston Mesaçusets. Apo ndoshta burrë s'do të ishte. Lopatat e lagta si t'i bënin me shenjë me vezullimet dhe me gishtërinjtë femërorë. Puthador. Puthador në se burri s'e ka injoruar zotin. *Atë rezil, Kedi* Lumi shndriste në largësi pas kthesës së vrikshme.

Unë jam e sëmurë më premto

E sëmurë e po ç'ke

Po e sëmurë jam askush s'mund të pyesë megjithatë më premto se do të

Nëse lipset të kujdesesh për të atëherë për hir tëndin ç'ke Nën dritare e dëgjuam automobilin që shkonte në stacionin hekurudhor për ta zënë trenin e orës 8 dhe 10. Për t'i çuar motrat. Kokat. Rritet koka nga koka, por floktari s'është asgjëkundi. Vashat manikyre. Dikur kemi pasur një kalë të racës së pastër. Në stallë një hamshor të racës së pastër, ndërsa nën samar ishte një gërdallë zgjebarak. *Kuentini i vrau zëmt e të gjithëve nga dyshemeja e dhomës së Kedit*

Tramvaji u ndal. Dola në mes të hijes sime. Rruga kalonte mbi hekurudhë. Nën një strehë druri një plak hante diçka nga një qese letre, pastaj zhurma e tramvajit u zhduk diku larg. Rruga të shpinte te lisat ku duhej të kishte hije mirëpo gjethet e qershorit në Nju-Ingland nuk janë më të dendura se gjethet e prillit te ne në Misisipi. Vura re një oxhak. Ia ktheva shpinën duke shkelur hijen time në pluhur. *Kishte diçka të tmerrshme në mua hera-herës natën shihja sesi më zgërdhihej mund të shihja përmes tyre sesi më zgërdhihej nëpërmjet fytyrave të tyre tash ato s'i shoh kurse unë jam i sëmurë.*

Kedi

Mos më prek veç premto

Në qofsh e sëmurë nuk mundesh

Mundem atëherë çdo gjë do të jetë si duhet aq më bën mos lejo ta dërgojnë në Xhekson premto

Të premtoj Kedi Kedi

Mos më prek mos më prek

Ç'është ajo që i përngjan Kedit

Çka

Ajo që të zgërthihet gjëja që të vështron nëpërmjet tyre

Ende më binte në sy oxhaku. Atje do të duhej të ishte uji që nxiton kah deti dhe shpellave të qeta. Atje do të koloviten qetë-qetë dhe kur Ai të jep urdhër Çohuni do të paraqiten vetëm ujtijat. Kur unë dhe Vershi shkuam në gjah gjithë ditën e lume, nuk e morëm ushqimin me vete, në orën dymbëdhjetë mua më mori uria. Mbeta i uritur deri kah ora një, pastaj, papritmas më zuri uria. Lampionet e rrugës po zbrisnin kodrës, pastaj dëgjova sesi tramvaji kishte zbritur nga kodra. Pështetësja e karekllës së rrafshët të ftohtë të lëmuar nën ballin

tim formonte një karekllë pema e mollës mbështetej në flokët e mi mbi Kopshtin e Parajsës të cilën e pikaste hunda. Ti i ke ethet e ndjeva dje si të isha në furrë.

Mos më prek

Kedi s'ke si e bën atë punë në qofsh e sëmurë. Ai i poshtri i botës

Me dikë, sidoqoftë, duhet të martohem. *Atëherë më thanë se ashti, megjithatë duhej thyer për së dyti.*

Më në fund nuk kisha më mundësi ta shihja oxhakun. Rruga kalonte përbuzë murit. Lisat mbështeteshin për mur të ndriçuar nga rrezet e diellit. Guri ishte i ftohtë. Duke kaluar pranë tij, mund ta ndiej freskinë e tij. Vetëm vendi ynë nuk është si ai. Kur bridhje vendit tonë, kishe një ndjenjë të veçantë, ndieje njëfarë fuqie të qetë po frytdhënëse, e cila ngaherë ta hapte madje oreksin. Rridhte pranë teje dhe nuk ngurronte mbi çdo gur të fortë duke e lagur pa përtesë. Si të ishte ndihmesë për shtimin e gjelbërimit, të qarkullosh mes lisave ndonëse nuk ishte kimerë e begatshme. *Më thanë se ashti duhej thyer për herë të dytë dhe brenda meje u dëgjua Ah Ah Ah dhe mua më kaploi djersa. Punë e madhe e di unë se ç'është këmba e thyer nuk e vlen barra qiranë të flitet për këtë do të jem i shtrënguar të rri në shtëpi pak më tepër vetëm kaq dhe fulçijtë e mi shtangen, kurse goja ime thotë Pritni Pritni një çast nëpër djersë ah ah ah pas dhëmbëve të mi, kurse Babai i mallkuar ai kalë i mallkuar ai kalë. Pritni se fajin e kam unë. Çdo mëngjes vinte duke ecur pranë gardhit me shportë duke shkuar kah kuzhina duke zvarritur një shkop pëf gardh çdo mëngjes unë i afrohesha dritares me fashën nga gjipsi dhe çdo gjë tjetër dhe përgjoja atë me një copë thëngjilli. Dilzi tha po ashtu se do ta marrësh në qafë veten a je me një dërrasë marigu nuk kanë kaluar as katër ditë qëkur e theve këmbën. Prit se mësohem menjëherë saora prit një grimë unë do të*

Si duket heshti edhe tingulli në ajër, si të ishte e kapitur ajri duke i mbajtur tingujt për një kohë aq të gjatë Lehja e qenit depërton më tepër si sirena e trenit, të paktën në errësirë. Edhe zërat e disa njerëzve. Të zezakëve. Luis Haçeri as që e përdorte bririn që e mbante me vete me atë fener të vjetër. Unë *e* pyeta: "Luis, allahile, kur e ke pastruar atë fenerin tënd për herë të fundit?"

"Para do kohe e pastrova. A ju kujtohet kur ajo vërshimë i

rrëmbeu ata të ngratët matanë? Atë ditë e pastrova. Unë dhe plaka ime rrinim para oxhakut atë natë, sakaq ajo më pyeti: "Luis si ia bëjmë nëse vërshima arrin deri këtu?" Unë iu përgjigja: "Ke të drejtë, plakë. E mira e së mirës është ta pastroj unë fenerin". Kështu, atë natë e pastrova."

"Ajo vërshimë u bë larg në Pensilvani", i thashë unë. "Nuk ka mundur të depërtojë deri këtu tek ne"

"Ashtu thua ti", ma ktheu Luisi. "Unë mendoj se uji në Xheferson mund të jetë poaq i lartë dhe i lagshtë si në Pensilvani. Gjindja thonë se vërshima nuk mund të jetë e tillë saqë të arrijë në pullaz".

"A dole ti atë natë me Martën?"

"Po, dolëm. E pastrova fenerin, dhe ajo me mua e kaluam bashkë atë natë në atë farë kodre pas varrezave. Po të dija për ndonjë vend më të lartë, atje do të shkoja".

"Që atëherë s'e pastruat fenerin".

"Pse ta pastroja kur s'qe nevoja?"

"Do të thuash deri sa të bëhet vërshima tjetër?"

"Nga kjo, na shpëtoi".

"E mor xha Luis, si flet kështu", thashë unë.

"Po, qebesa, zotni. Ti ia bën me tënden, unë me timen. Nëse unë, për të skapulluar nga vërshima ■ ujit, e pastroj këtë fener, s'do të thotë se lipset te kem zënka me dikë".

"Xha Luisi s'mund të zërë asnjë peshk pa fenerin e tij", tha Vershi.

"Unë kam gjuajtur peshkun posum në këto anë, kur nëna jote ia lante me vajguri kokën e gjyshes tënde për t'ia mbytur morrat, lum baca", ia priti Luisi. "Bile sa shumë peshq kam zënë!"

"E vërtetë", tha Vershi. Mendoj se në këtë vend askush s'ka gjuajtur më shumë peshq se xha Luisi".

"Tamam e ke", tha Luisi, "kam unë boll dritë për t'i parë posumet. S'kam dëgjuar të qahet ndokush nga ata. Tash, heshtni. Qe peshku. Hej, kape dreqin!" Ishim ulur në gjethet e thata që fëshfërisnin ngapak nga dihama spontane e pritjes sonë si dhe nga dihama e ngadalshme e dheut dhe nga atmosfera e pashitur e tetorit të pagjethe, duke e ndier erën e tymit të fenerit që e prishte ajrin e kthjellët, duke dëgjuar lehjen e qenve si dhe jehonën e zërit të Luisit që po zhdavaritej e po tretej në largësi. Askurrë *s'e* ngriste zërin, ndonëse në natën e

qetë, e dëgjonim nga veranda jonë e përparme. Kur u bënte zë qenve, zëri i tij jehonte si ai biri që e mbante të varur në krah, edhe pse nuk e përdorte kurrë, veçse, megjithatë, zëri i tij ishte më i qartë, më i butë si të ishte pjesë e asaj errësire dhe qetësie, si të shqitej nga ato e si të kthehej e ngjizej sërish me to. Vuuuuu. Vuuuuuuu. *S'kam çare pa u martuar me dikë*

Ke patur shumë jaranë Kedi

Unë s'njoh shumë të tillë o kujdesesh ti për Benxhin dhe Babain

Ti s'ditke as e kujt është a di ai

Mos më prek a kujdesesh për Benxhin dhe për Babanë

Hasa në ujë para se të arrija te ura. Ura ishte nga gurët e përhimë, me likenë, e bërë pullali me njomësinë aty ku ngjiteshin kërpudhat. Nën urë uji ishte i kthjellët, i qetë nën hije, duke gurgulluar dhe duke shushuritur rreth gurëve *më* gjira të shpejtë të qiellit vërtitës. *Kedi duhej*

S'kam çare pa u martuar me dikë Vershi më kallëzonte për një njeri i cili e kishte sakatuar vetveten. Kishte shkuar në pyll dhe e kishte sakatuar veten me briskrrues në një hendek. Briskrruesin e thyer dhe ato që kishte prerë i kishte hedhur pas shpine, kurse po në atë hop kishte shpërthyer currili i vrullshëm i gjakut. Por halli s'ish këtu. S'është halli në i ke ato sende. Sikur të mos i kisha kurrë, atëherë do të mund të thosha O Ajo është, Ajo për mua është gjuha kineze kurse unë s'e marr vesh kinezishten. Ndërsa im atë më kishte thënë se kjo ngjan kështu ngaqë je virgjin: a s'e merr vesh? Femrat s'janë virgjine askurrë. Virgjëria është gjendje negative, prandaj është kundër natyrës. Natyra të mundon ty, e jo Kedin, ndërsa unë ia kthej keto janë llafe kunse ai ma pret Këshitu është puuna edhe me virgjërinë, ajo fjalë boshe është e unë i them ti s'i kupton këto mesele. Ti s'i di këto, kurse ai tha Po. Në çastin që e kemi të qartë se çfarë tragjedie është ajo merr rëndësi të dorës së dytë.

Aty ku binte hija e urës unë mund të dallojá se sa thellë ishte uji, por fundin s'e pikasja dot. Kur të mbetet gjethi për një kohë të gjatë sipër ujit, pas ca kohe indet e gjethit shprishen ndërsa disa fije të brishta të tij do të notojnë dalëngadalë si valët e gjumit. Ato s'e çikin njeri tjetrin, sado të gërshetuara të kenë qenë dikur, sado të afërta të kenë qenë dikur me kërcellin. Dhe ndoshta kur Ai të thotë Ngrehuni edhe sytë atëherë do të dalin në Siprinë nga qetësia e thellë dhe ëndrra për ta kundruar

lavdinë. Sakaq, pas pak kohe, do të dalin edhe ujtitë sipër ujit. I fsheha skaj urës u ktheva dhe u mbështeta për parmakët e urës.

S'mund ta pikasja fundin, por mund të shihja rrymën e gjatë të ujit derisa mund ta kapte syri, e pastaj e vura re hijen që po rrinte pezull si ndonjë shigjetë e trashë e drejtuar kundër rrymës. Kandrat e majit po futeshin e po dilnin nga hija e urës shi mbi siprinën e ujit. *Sikur atje tutje të kishte pasur skëterrë: flaka dhe ne të dytë që thuajse kishim mbaruar. Asokohe do të më kesh vetëm mua atëherë ne të dy mes mallkimit dhe lemerisë pranë flakës së vezullueshme* Shigjeta u rrit pa u lakuar, e po në atë çast me një hop të vetëtimshëm, trofta gëlltiti një mazë dhe u zhduk nën ujë, me atë farë oreksi çfarë ka edhe elefanti kur e gjen kikirikun. Vorbulla u zhduk tatëpjetë ujit, ndërsa unë e diktova përsëri shigjetën, me maje të kthyer kah rryma e ujit sesi po dridhej ritmikisht e me skofi mbi ujin mbi të cilin po eponin kandrrat e ujit dhe po zbrisnin hera-herës. *Vetëm ti dhe unë atëherë mes mallkimit dhe llahtarit të rrethakuar me flakë të vezullueshme* Trofta, skofiare dhe e palëvishme, rrinte pezull mes hijeve epuese. Tre kalamaj me kallame për peshkim, ia behën tek ura, prandaj të gjithë u mbështetën për parmakët e urës dhe zunë ta vështrojnë troftën. Ata e njihnin atë peshk. Ai ishte i njohur atypari.

"Ka njëzet e pesë vjet rrum që mundohen ta zënë atë peshk. Ka një tregtizë në Boston që ofron shkopin e peshkimit në një vlerë prej njëzet e pesë dollarësh atij që e zë atë peshk".

"Pse s'e zëni ju pra? S'do të kishit dashur ta keni kallamin e peshkimit prej njëzet e pesë dollarësh?"

"Po", thanë ata. U mbështetën për parmak duke i vështruar troftat. "Si jo", tha njëri.

"Unë s'do ta doja kallamin", tha i dyti. "Përkundrazi, paratë do t'i merrja".

"Ndoshta s'do t'i jepnin paratë", tha i pari. "Vë bast se kallamin ta japin me zor".

"Në qoftë ashtu, unë e shes atë".

"S't'i japin njëzet e pesë dollarë për të".

"Do të merrja atë që do të më jepnin. Mund të zë me këtë kallam po aq peshq si me atë prej njëzet e pesë dollarësh". Pastaj, filluan të bisedojnë se ç'do të bënin me të njëzet e pesë dollarët. Të gjithë flisnin njëkohësisht, zërat i kishin të fortë,

kontradiktorë dhe të padurueshëm, duke e bërë të mundshme atë që nuk ishte realitet, pastaj në probabilitet, mandej një fakt të pamposhtur, ashtu si bëjnë njerëzit kur dëshirat e tyre bëhen fjalë.

"Unë do ta bleja një kalë dhe një qerre", tha i dyti.

"Posi", thanë të tjerët.

"Ja ku ju them. Di se ku do të mund t'i bleja për njëzet e pesë dollarë. E njoh dikë".

"Kush është ai?"

"Kushdoqoftë. Mund ta blej qerren me kalë për njëzet e pesë dollarë".

"Po de", thanë të tjerët. "Ti s'njeh një njeri të tillë. Ai llomotit".

"Ashtu mendoni ju?" - ua ktheu ai. Ata vazhduan ta qesëndisin, mirëpo ai s'u përgjigjej më. U mbështet për parmakë, duke e vështruar troftën, paratë e së cilës tashmë i kishte shpenzuar. Në zërat e tyre nuk vërehej më ai konflikt dhe ashpërsi dhe si t'u bëhej edhe atyre se ai e kishte zënë peshkun dhe e kishte blerë kalin dhe qerren e vet, duke u bërë si madhorët që gjëja janë të bindur në diçka vetëm nëse dikush merr qëndrimin e superioritetit të heshtur. Unë besoj se njerëzit e mërzisin aq shumë vetveten dhe njëri-tjetrin me fjalë, saqë janë dakordë që ta nderojnë si të urtë fjalëpakun, kështu që për disa kohë ndieja se ata dy rrekeshin të gjejnë një shteg e mënyrë sesi do t'ia hedhnin atij të tretit, duke ia grabitur kalin dhe qerren.

"S'mund t'i nxjerësh kurrsesi njëzet e pesë dollarë për atë kallam", tha i pari. "Vë bast për ç'të duash se s'mundesh".

"Ende s'e zuri atë troftë," tha i treti papritur e papandehur, e po në atë çast bërtitën të dytë:

"Po de, a s'ju thashë? Si i thonë atij? Pa thuaj në e di. Ai s'ekziston fare".

"Rrudhe çakallën", tha i dyti. "Shiko. Ja ku ia behu përsëri". U përkulën nga parmakët, pa lëvizur njësoj, me kallame të njëllojshme, pak të pjerrëta kah dielli. Trofta doli në siprinë pa nxituar, hija e saj e zbehtë u rrit dhe u krodh me vorbulli u zhduk përsëri me ngadalë me ujin që rridhte. "Ah", nënëroi i pari.

"Ne as që përpiqemi ta zëmë atë", tha ai. "Po i presim bostonasit që të vijnë e të orvaten ta zënë".

"Ai është i vetmi peshk i këtij përroi?"

"Po. I ka trembur të gjithë të tjerët. Vendi më i mirë për peshkim këtej pari është atje në shakullinë te Edi".

"Jo, s'është", tha i dyti. "Është më mirë te Mulliri i Bigëlloit". Pastaj patën një zënkë lidhur me atë se ku ishte e mundshme të peshkoje më së miri dhe në atë çast papritmas pushuan së shikuari troftën sesi po i afrohej siprinës së ujit dhe sesi vorbulli i shprishur i ujit po thithte një copë qielli. Pyeta se sa kishte deri në qytetin më të afërt. Më treguan.

"Mirëpo, stacioni më i afërm i tramvajit është në këtë drejtim", tha i dyti duke më treguar rrugën tatëpjetë. "Kah ia mbani?"

"Kurrkah. Po shëtis".

"Jeni student kolexhi?"

"Po. Ka uzina në atë qytet?"

"Uzina?" Më shikuan.

"Jo", tha i dyti. "S'ka". M'i vështruan rrobat. "Punë kërkoni?"

"A doni të punoni në Mullirin e Bigëlloit?" tha i treti. "Ajo është uzinë".

"Çfarë uzine, ore! Ai mendon në fabrikën ■ vërtetë".

"Në atë me sirenë", thashë unë. "Ende s'dëgjova ndonjë sirenë".

"Oh", tha i dyti. "Në kambanaren e kishës së unitarianëve ka një orë. Atje mund të shihni sa është ora. S'keni orë në atë zinxhir?"

"E theva sot në mëngjes". Ua tregova orën. E shikuan me interesim.

"Ende po punuaka", tha i dyti. "Sa kushton një orë e këtillë?"

"E kam si dhuratë", thashë unë. "Ma fali im atë kur e mora maturën".

"Kanadez jeni?" - tha i treti. Ai ishte flokëkuq.

"Kanadez?"

"S'flet si ata", tha i dyti. "Kam dëgjuar si flasin. Ai flet si në ato shfaqje të bejtexhinjve zezakë".

"Pa dëgjo", tha i treti, "a s'ke frikë se ta këput shpullë?"

"Shpullë?"

"Ti the se flitka si zezakët".

"Kyçe gojën", tha i dyti. "Kambanaren do ta shihni si ta kaloni atë kodër atje".

Unë u falënderova. "Ju uroj fat e peshkim të mbarë. Veçse mos e kapni atë peshk të shkretë atje. Ai meriton të jetë i lirë".

"Askush s'mund ta kapë atë peshk", tha i pari. U përkulën mbi parmakë dhe zunë ta shikonin ujin, ndërsa të tri kallamet e tyre dukeshin si gjuhë të pjerrëta të flakës së verdhë të ndezura në diell. Ecja nëpër hijen time duke e gërshetuar me hijën lara-lara të pemëve. Rruga lakonte dhe largohej nga uji në teposhtëze. Ajo e kalonte kodrën dhe zbriste leqe-leqe duke e rrëmbyer syrin dhe mendjen nën tunelin e qetë e të gjelbër dhe të kubes katërqipëshe mbi drurët dhe të syrit të rrumbullakët të orës, por goxha larg. U ula skaj rrugës. Bari arrinte deri te leqet e këmbëve. Hijet në rrugë ishin aq të palëvizëshme, si të ishin vënë aty me ndonjë kallëp, me lapësat e pjerrëta të rrezeve të diellit. Por, ai qe vetëm treni që menjëherë u zhduk pas drurëve, me atë uturimën e tij të largët dhe atëherë mund ta dëgjoja orën time dhe trenin që po zhdukej, si të nxitonte nëpër një muaj tjetër ose nëpër një verë tjetër dikah, duke rendur larg e më larg nën pulëbardhën dhe çdo tjetër që ngutet. Pos Xheraldit. Edhe ai do të dukej madhështor po të lundronte fillikat vetëm që nga mesdita, nëpër shtegun e gjatë e të ndriçuar të ajrit si në apoteozë, duke u ngjitur në pasosmërinë dremitëse ku gjallojnë vetëm ai dhe pulëbardha, njeri që s'lëviz dot, ndërsa ajo në depërtimin e pareshtur e të matur si dhe në ngritjen e sërishme, ai pjesëmarrës i inercionit, teksa nën hijet e tyre në diell gjendej bota e vockël. Kedi lahper, Kedi lahper

Zërat e tyre vinin prej matanë kodrës, e pastaj i pashë të tri kallamet e brishta si tre penj të tendosur të zjarrit. Më vështruan kur u nisa, mirëpo nuk e ndalën hapin.

"Bah", thashë unë, "atë s'e shoh".

"S'u orvatëm ta zëmë", tha i pari. "Atë peshk s'është punë që e zë kush".

"Ja ora", tha i dyti duke ma treguar atë. "Do të shihni sa është ora kur të afroheni edhe pak".

"Po", thashë unë. "Në rregull". U ngrita. Të gjithë shkoni në qytet?"

"Po shkojmë te gjiri i Edit për të zënë bërcakë", tha i dyti.

"Mbase po shkoni te mulliri ku kalamajtë stërpiken me ujë dhe i trembin peshqit".

"Te gjiri nuk mund të zësh peshq".

"Nuk do të zëmë asnjë peshk nëse nuk nisemi", tha i treti.

"S'di pse dërdëlisni, për Gjirin e Edit", tha i dyti. "Atje s'mund të zësh peshq".

"S'je i shtrënguar të vish", tha i pari. "S'je i lidhur me mua".

"Vemi te përroi i mullirit për t'u larë", tha i treti.

"Shkova te Gjiri i Edit për të peshkuar", tha i pari. "E ju bëni ç'të doni".

"Dëgjo, kur ke dëgjuar se dikush ka zënë ndonjë peshk te Gjiri i Edit?" i tha i dyti të tretit.

"Shkojmë për t'u larë te përroi i mullirit", tha i treti. Kubja po kridhej dalngadalë pas pemëve, ndërsa sheshi i rrumbullakët i orës dukej atje larg. Po ecim ende nën hijen lara-lara. Arritëm te pemishtja e kuqërremtë dhe e bardhë. Në të kishte plot e përplot bletë. Po e dëgjonim zukatjen e tyre.

"Shkojmë për t'u larë te përroi i mullirit", tha i treti. Një shteg lakonte skaj pemishtes. Kalamani i tretë ngeci dhe u ndal. I pari vazhdoi të ecte, ndërsa luzmat e rrezeve të diellit po i shkëlitnin nëpër shpatulla dhe nëpër shpinë e nëpër këmishë, "Hajdeni", tha i treti. U ndal edhe kalamani i dytë. *Pse duhet të martohesh me dikë Kedi*

A dëshiron ta them a mendon nëse ta them se s'do të ketë më

"Shkojmë te mulliri", tha ai. "Hajde".

I pari u nis. Këmbët e tij të zbathura nuk zhapullonin po më të buta se gjethet shkilnin në pluhurin e imët. Në pemishte zukatnin bletët ashtu si shushurima e erës, ash një shushurimë disi mes kreshendos dhe zërit të përmbajtur si me ndonjë magji. Shtegu kalonte skaj murit i mbuluar nga degët e pemëve dhe nga behari, pastaj tretej në pemishte. Rrezet e diellit e pranin pjerrtazi, me rreze të rralla por të etshme. Fluturat e verdha po fluturonin në hije si njollat e diellit.

"Pse ke qejf të shkosh pikërisht te gjiri i Edit?" tha i dyti. "Mund të zësh peshq te përroi i mullirit në daç".

"Le të shkojë de, tha i treti. E shikuan të parin që tashmë ishte nisur. Drita e diellit me luzma rrezesh po shkëliste shpatullave të tij që lëviznin duke shndëritur në kallam si thnegla të verdha.

"Keni", tha i dyti. *Thuaji Babait a bën Unë do të them Unë jam Prind i babës tim Unë e kam shpikur atë e kam krijuar Unë jam Thuaji se s'do të jetë më ashtu nga e ai do të thotë se unë nuk jam e pastaj unë dhe ti ngase nuk mund ta duash dike që e ke farefis*

"Ç'pritni mor", tha kalamani. "Ata hynë në ujë". E vështruan sërish kalamanin e parë. "Ahu", thanë papritmazi, "hajt ik djali i nënës, lazdrani. Nëse lahet do t'i laget koka e pastaj ha dacka". Ata hynë shtegut dhe vazhduan të ecin. Fluturat e verdha në fluturim të pjerrët po silleshin rrotull tyre në hije.

Kjo ka ngjarë ngaqë s'ka asgjë tjetër unë mendoj se prapëseprapë ka diçka po ndoshta edhe s'ka e mandej unë Ti do të kuptosh se edhe padrejtësia mezi vlen aq sa pandeh se vlen Ai s'më kishte vënë re fare, ia pashë nofullën në profil, fytyrën e kishte pak të shtrembëruar nën kapelen e leckosur.

"E pse edhe ti nuk shkon të lahesh me ta?" thashë unë. *Kedi lahperi*

Ti deshe të rrahesh me të apo jo

Kedi është gënjeshtar dhe rezil atë e dëbuan nga klubi nqase bënte hile në lojën me letra s'donin të shoqërobeshin me të bile e zunë sesi po bënte me hile edhe në provimet semestrale dhe e dëbuan nga universiteti

Aniçka unë s'kam ndërmend të loz letra me të "E do më shumë peshkimin apo notin?" thashë unë. Zukama e bletëve u fashit, mirëpo ajo dëgjohej ende, dhe në vend të kridhej në heshtje, ajo vinte duke e përforcuar heshtjen në mësin tonë, si uji gjatë baticës. Shtegu lakonte përsëri dhe shndërrohej në rrugë mes livadheve me hije me shtëpi të bardha. *Ai Kedi lahperi mund të mendosh për Benxhin dhe Babain e të veprosh ashtu s'e kam për vete*

Për ç'gjë tjetër mund të mendoj unë për se tjetër kam menduar Kalamani e ndërroi rrugën. E kaloi gardhin nga drurët pa u kthyer pas dhe i ra livadhit duke arritur te një lis ku e lë kallamin u kacavar në trungun e degëzuar të lisit dhe u ul aty me shpinë të kthyer kah rruga ndërsa dielli, lara-lara, dukej i palëvizshëm në këmishën e tij të bardhë. *Përse mendoja nuk mund të qaj dot unë kam vdekur vjet unë të kam pas thënë por atëherë nuk dija se ç'desha të them nuk dija se ç'flisja* Disa ditë në Gushtin e vonë në shtëpi janë tamam si kjo ditë sot, ajri i thatë dhe i etshëm si ky sot, me diçka të trishtueshme, të përmallshme e të njohur. Njeriu është rezultat i përvojës klimatike, tha Babai. Njeriu është rezultat i asaj që ka. Njeriu me veset e tij është problem që zvarritet ngadalë e me mërzi deri te Asgjëja e pandërrueshme: shah mati i bërllokut dhe i epshit. *Mirëpo, tash di që kam vdekur ja ku të them*

Prandaj s'ke çare pa dëgjuar ne mund të shkojmë ti Benxhi dhe unë dikah ku s'na njeh askush ku Qejzen e tërhiqte allçi, me thundra trokthi i të cilave po jehonte topitshëm nëpër rërën e imët, rrotat me merimanga duke llokoçitur hollë po ngjiteshin përpjetë nën Shallin e zhubravitur të gjetheve. Vidhi. Jo: Vithit. Vithi.

Me se paratë e tua për studime paratë që i morën për shitjen e livadhit në mënyrë që U të shkosh në Harvard a nuk sheh se lipset ta kryesh tash nëse nuk e kryen ai nuk do të ketë kurrgjë

E kanë shitur livadhin

Babai do të vdesë pas një viti nëse s'e le pijen por ai s'e lë alkoolin nuk mund ta lërë që kur unë nga vera pastaj do ta dërgoj Benxhin në Xhekson unë nuk mund të çoj asnjë minutë ajo rrinte te praku i derës në minutën tjetër ai e ngrente për fustan dhe uluronte zëri i tij jehonte mes mureve si valët ajo bëhej kruspull për muri duke u zvogëluar përherë e më tepër me fytyrën e saj të bardhë sytë e saj si të ishin të gropuara me gishtërinj derisa i qiti nga dhoma zëri i tij ushtonte si ta shfrenonte fuqia e tij dhe si të mos kishte vend për të në atë qetësi ai uluronte.

Kur u hap dera, zilja cingërroi, po vetëm një herë, cingërroi fort dhe qartazi në errësirën e plotë mbi derë mu si të ishte konstruktuar dhe kurdisur për ta lëshuar atë cingërrimë të vetme të qartë po të hollë, si të ishte paraparë që zilja të mos prishej e të kurseheshin të hollat për heshtjen e gjatë të saj, për riparimin e saj e në atë çast dera u hap dhe brenda hyri era e ngrohtë e bukës së pjekur, vura re një vogëlushe të ndyer me sy të arushës-lodër dhe me dy gërsheta si nga lëkura e regjur.

"Tungjatjeta, motër". Fytyra e saj ishte si tasi i qumështit i përzier me kafe në atë zbrazëti të këndshme. "Ka kush këtu?"

Mirëpo, ajo më vështronte derisa u hap dera dhe ia behu zonja. Mbi banakun me samuna të pjekur pas qelqit u duk si e ngrehur me ndonjë tel fytyra e saj e pastër e përhime, flokët e saj të fortë e të rrallë në kafkën e pastër e të përhime, syzet me korniza të pastra e të përhime, si ndonjë bibliotekare. Ishte si diçka mes rafteve të pluhurosura, si siguritë e radhitura të ndara kaherë nga realiteti, duke u terur në rehati, si dihama e atij ajri që e shihte padrejtësinë e bërë

"Ju lutem, zonjë, dy nga këto".

Futi dorën nën banak dhe nga aty nxori një copë gazetë

katërqipëshe e vuri në tavolinë dhe i nxori dy simite. Vogëlushja i vështronte me gjakftohtësi me ata sy të saj të qetë që u gjasonin dy kokrrave të kafesë që notojnë në filxhanin e kafesë së hollë. Vendi i hebexhinjve atdheu i makaronaxhinjve. I vështronte simitet, duart e pastra e të përhimta, unazën e gjerë të artë në gishtin e majtë tregues që e mbante kopsa blu.

"Vetë e piqni bukën, zonjë?"

"Zotëri?" tha ajo". Tamam kështu. Zotëri? Si në shfaqje, Zotëri? "Pesë sencë, dëshironi gjëkafshë tjetër?"

"Jo, zonjë. Unë s'dua asgjë tjetër. Kjo zonjushë dëshiron diçka. "Ajo s'ish aq e gjatë, prandaj nuk e kishte diktuar, ndaj vajti në skaj të banakut dhe e shikoi vogëlushen.

"Ju e sollët këtu?"

"Jo, zonjë. Këtu e gjeta".

"Moj çapkëne", tha ajo. Iu afrua por s'e çiku, "Mos fute gjë në xhep?"

"S'ka fare xhepa", thashë unë. "S'bënte asgjë. Qëndronte këtu, ju priste".

"Pse s'ra zilja?" Ajo më shikoi ngutazi. I mungonte numëratorja dhe dërrasa e zezë pas saj me numrat 2x2-5. "Ajo mund të ketë fshehur diçka nën fustan dhe askush s'do ta ketë diktuar. Moj çapkëne. Po si hyre këtu?"

Vogëlushja s'bënte zë. Ajo e shikoi zonjën, mua më lëshoi një shikim të rrufeshëm pastaj sërish ia qepi sytë zonjës. "Epo këta të huajt", tha zonja. "Si hyri pa rënë zilja?"

"Hyri si e hapa derën", thashë unë. "Zilja cingërroi një herë për ne të dytë. S'do të mund të prekte asgjë këtu. Edhe sikur të mund të merrte diçka, ajo s'do ta prekte gjënë e huaj. Apo jo, motër?" Vogëlushja më vështroi disi me enigmë, e kridhur në mendime. "Ç'deshe ti? Bukë?"

Ajo e zgjati dorën. E hapi grushtin. Në të gjendej një monedhë pesë sencash, e lagët dhe e papastër, ndytësia e lagët si t'iu kishte ngjitur për mish. Monedha ishte e lagët dhe e ngrohtë. I vinte era e metalit.

"Keni një samun pesë sencash, zonjë?"

E futi dorën nën banak dhe nxori një copë gazete katërqipëshe, e vuri në banak dhe me të e mbështolli bukën. Unë vura në banak monedhën e saj dhe një monedhë tjetër. "Edhe një simite, zonjë, ju lutem".

Nga vitrina nxori edhe një simite tjetër. "Ma jepni atë", tha

ajo. Ia dhashë. Ajo e çmbështolli bukën time, e futi simiten e tretë aty dhe i mbështolli përsëri. Pastaj, i mori paratë në përparëse gjeti dy monedha bakri që m'i dha si kusur. Unë ia dhashë vogëlushes. Gishtërinjtë e saj i shtrënguan ato, i kishte të lagta e të ngrohta si skërranjat.

"Ia jepni këtë simite?" tha zonja.

"Po", thashë unë. "Shpresoj se simitja juaj do t'i pëlqejë ashtu si më pëlqen mua".

E mora bukën dhe simitet e mbështjella, simiten ia dhashë vogëlushes, ndërsa ajo gruaja si të ishte nga hekuri i përhimtë pas banakut na vështronte me një siguri të acartë. "Pritni një çast", tha ajo. Shkoi në një kthinë pas furrës. Dera u hap dhe u mbyll përsëri. Vogëlushja më shikonte ngultazi duke e shtrënguar simiten për fustanin e saj të papastër.

"Si quhesh?" thashë unë. Ajo e ktheu shikimin ndonëse nuk lëvizi. Si të mos merrte frymë. Ajo gruaja u kthye. Në dorë kishte diçka të çuditshme. Mbante diçka që dukej si ndonjë mi i zbutur dhe i ngordhur.

"Merre", tha ajo. Vogëlushja e vështroi. "Merre", tha gruaja duke ia lëshuar në dorë. "Duket si për hukubet. Mirëpo, kur ta hani s'do të dalloni asgjë. Na, merre, s'kam nge të rri këtu gjithë ditën e lume". Vogëlushja e mori, pa i ndarë sytë nga ajo. Gruaja i fshiu duart për përparëse. "S'kam çare pa e riparuar zilen", tha ajo. U nis kah dera, e hapi derën me rrëmbim. Zilja cingërroi, njëherë mezi, qartë dhe padukshëm. Ne u nisëm kah dera ndërsa dyqanxhesha po na përcillte me shikimin e saj.

"Ju falem nderit për pastën", thashë.

"Eh, këta të huajt", tha ajo duke e vështruar errësirën ku cingërronte zilja. "Dëgjomani këshillën, shporruni nga të huajt, çuno".

"Mirë zonjë", thashë unë. "Hajde motër". Dolëm "Falemnderit, zonjë".

E mbylli derën, pastaj e hapi me rrëmbim përsëri në mënyrë që të cingërronte zilja me cingrimën e saj çjerrëse. "Eh, këta të huajt", bëri ajo duke e vështruar zilen.

Ne ecëm edhe një copë herë. "Ani", thashë unë. "A do një akullore?" Ajo e hante pastën e grimcuar. "Ta ka ënda akulloren?" Ajo përtypte pa pushim dhe më hodhi një vështrim të zymtë e të qetë. "Shkojmë pra".

Arritëm te tregtiza dhe porositëm akullore. Ajo s'e lëshonte

bukën nga dora. "Pse *s'e* lë diku atë? Do të mund të hash më mirë", i thashë dhe desha t'ia merrja bukën. Ndërkaq, ajo e shtrëngonte për vete duke e përtypur akulloren si të ishte bonbone. Pasta e grimcuar gjendej në tavolinë. Si e hëngri akulloren e mori pastën dhe vazhdoi ta hante duke vështruar rreth e rrotull vitrinës. Unë e hëngra akulloren time dhe ne dolëm.

"Ku banon moj?" thashë unë.

Llandoni, ai me kalë. Vetëm doktor Pibodi ishte trashallëk. I ka nja njëqind e pesëdhjetë kilogramë. Lipset të ulesh në anën tjetër kah ana e kodrës dhe të mbahesh fort kur udhëton me të. Fëmijët. Më lehtë e ke të ecësh këmbë sesa të vozitesh ashtu në përpjetëze. *Ishe te mjeku a shkove te ai Kedi*

Tash s'jam e detyruar të shkoj nuk mund ta pyes tash më vonë do të jetë puna në rregull

Ngase gratë janë aq të brishta dhe aq misterioze, tha Babai. Drejtpeshimi sensibil i ndytësisë periodike mes dy hënave në ekuilibër. Hënës, tha ai, të plota e të verdha si hënat e të korrave janë ijet e saj. Por ngaherë jashtë jashtë tyre. Të verdha. Si tabanët e zbehta nga ecja. Pastaj merr vesh se na qenka ndonjë mashkull të cilin e kanë fshehur këto krijesa misterioze, Gjithë ato organe të brendshme e formojnë hijeshinë e tyre të jashtme që mezi e pret të çikurit. Lëngu i kalbur si ca gjëra të mbytura si goma e zbehtë e mbushur dosido e cila e ka marrë erën e gjakut të dhisë dhe gjithë këto ishin të përziera

"E tash, e mira e së mirës është që bukën ta shpiesh në shtëpi, apo jo, motër?"

Ajo më lëshoi një vështrim. Përtypte ende dhe s'ishte hutuar fare. Herë pas here nëpër gërmazin e saj rrëshqiste një bymim i vogël. I çmbështolla simitet dhe ia dhashë një. "Mirupafshim", i thashë. E vazhdova rrugën. Pastaj, u ktheva. Ajo gjendej pas meje. "Në këtë drejtim banon ti?" Ajo s'u përgjigj. Ecte përkrah meje, thuajse nën sqetullën time, duke ngrënë. Po ecnim. Çdo gjë dukej e qetë, mezi hetohej kush aty pari *kishte marrë erën e gjakut të dhisë dhe gjithë këto ishin përzier Duhej të më thoshte dhe nuk është dashur të m'ë lejonte të ulesha atje te shkallët që të dëgjoja sesi po ia shkundte derën muzgu e të dëgjoja sesi Benxhi po qante akoma Edhe darka lipsej të zbriste me erën e gjakut të dhisë Gjithçka ishte përzier me të* Arritëm deri te këndi i rrugës.

"Epo mirë, tash unë shkova këtej", thashë unë, "Mirupafshim". U ndal edhe ajo. E gëlltiti copën e fundit të pastës, pastaj zuri ta hante simiten gjithë duke më vështruar. "Mirupafshim", i thashë. U nisa asaj rruge dhe vazhdova të ec, mirëpo, përsëri u ndala në këndin tjetër.

"Ama ku banon ti moj?" thashë unë. "Këtej?" Bëra me gisht kah rruga. Ajo ende më vështronte. "Andej banon ti? Me siguri banon afër stacionit hekurudhor ku ka trena. Apo jo?" Ajo më vështronte e qetë, enigmatike duke përtypur. Rruga ishte e shkretë, nga të dy anët kishte oborre të qeta dhe shtëpi të pastra mes drurëve, mirëpo, askush s'shihej aty pos atje pas. U kthyem dhe zumë të ecim. Dy veta ishin ulur në karrige para një dyqani.

"Mos e njihni këtë vogëlushe? M'u lye pas, si të them, por s'di se ku banon".

Ata ia qepën sytë asaj.

"Mbase është nga ato familje ardhacake italiane", tha njeri. Kishte xhaketë të vjetër. "E kam parë edhe më parë. Si të thonë moj çupëz?" Ajo i vështroi e ngrysur një copë here, ndërsa fulqitë s'i pushonin. Ajo gëlltiti një hafshore por vazhdoi të përtypte.

"Ndoshta s'di të flasë anglisht", tha tjetri.

"E kishin dërguar të merrte bukën", thashë unë. "Duhet të dijë anglishten ngapak".

"Si të quhet babai?" tha i pari. "Pit? Xho? Ndoshta quhet Xhon?" Ajo e kafshoi simiten përsëri.

"Si t'ia bëj me të?" thashë unë. "Ajo më qepet pas. Duhet të kthehem në Boston".

"Po ju, nga kolexhi jeni?"

"Po, zotëri. Duhet të kthehem në kolexh".

"Vazhdoni kësaj rruge e çojeni tek Ansei. Mbase e gjeni te stalla. Është sherif".

"Më duket se ndryshe s'kam si t'ia bëj", thashë unë. "S'kam çare pa i ndihmuar. Ju falemnderit. Hajde moj motër".

Zumë të ecnim rrugës, në anën e saj me hije, ku hija e fasadës së prishur po binte në rrugën tonë. Iu afruam plevicës. Rojë nuk kishte. Aty ndodhej një njeri i ulur në një karrige me derë të gjerë e të ulët, ndërsa frynte një erë e ftohtë amoniaku nga stalla, sakaq, ai më tha të shihja në kishte arritur ndonjë letër. As ai s'e njihte vogëlushen.

"Jabanxhinjtë. Të gjithë, njësoj janë. Është mirë ta çoni matanë hekurudhës atje ku banojnë, ndoshta *e* kërkon dikush".

U nisëm në postë. Ishte pas rrugës. Ai njeriu me xhaketë po shfletonte një gazetë.

"Ansi sapo iku nga qyteti", tha ai. "Më mirë shkoni në stacion duke kaluar afër atyre shtëpive buzë lumit. Dikush mbase e njeh atje".

"Unë s'kam çare pa shkuar", thashë unë. "Hajde, motër". E futi në gojë kafshatën e mbrame të simites dhe e gëlltiti. "Do një tjetër?" I thashë. Ajo më lëshoi një vështrim, duke përtypur, me sytë e saj të zez, të qetë dhe miqësorë. I nxora edhe dy simite dhe një ia dhashë, tjetrën e kafshova vetë. E pyeta një njeri se ku gjendej stacioni dhe ai më tregoi. "Hajde, motër".

Arritëm në stacion, e kaluam hekurudhën, aty ku gjendej lumi. Një urë kapërcente mbi lumë, ndërsa rruga plot e përplot me shtëpiza nga druri të mpleksura disi, gjendej buzë lumit, kurse nga pas shtëpitë ishin të kthyera kah lumi. Ajo ishte një rrugë e shkretë, por disi e gjallë. Mes një djerrine, të rrethuar nga gardhi i drunjtë me një varg plasaritjesh dhe hunjsh të thyer, ndodhej një çejze e vjetër dhe një këlcare, e zymtë nga dritarja e epërme e të cilës ishte lëvarur një cohë e kuqërremtë.

"Mos i përngjan kjo shtëpisë tënde? e pyeta. Ajo më shikoi mbi simiten. "Si kjo?" i thashë duke ia treguar këlcarenë. Ajo mbllaçiste pa pushim, mirëpo, m'u duk si t'i pohonte fjalët e mia edhe pse në një mënyrë të vagulluar. "Si kjo?" thashë unë. "Hajde pra". Hyra nëpër një derë të shpartalluar. U ktheva ta shoh vogëlushen. "A duket kjo si shtëpia jote?"

Më bëri me kokë për të ponisur, gjithë duke më shikuar dhe duke e ngrënë simiten në formë te gjysmëhënës. Vazhduam të ecnim. Shtegu nga pllaka të thyera të gurit mes të cilave kishin qitur krye tufëza bari, çonte në një tëbanë të shembur. Në atë shtëpi, s'pipëtinte askush, ndërsa atë cohë të kuqe të lëvarur nga dritarja, nuk e trazonte era. Zilja kishte një litar të gjatë me dorëz porcelani. E tërhoqa litarin dhe trokita në derë. Vogëlushja ende po e mbllaçiste simiten.

Një grua e hapi derën. Më hodhi një shikim, mandej i tha diçka italisht vogëlushes me zërin e ngjirur, e pastaj, për një copë here, pllakosi heshtja. Përsëri i foli italisht, ndërsa vogëlushja e vështronte mbi skajin e kojes së simites duke e futur në gojë me dorë të ndyer.

"Thotë se këtu banon", tha ajo. "E gjeta atje në qytet. Bukë juaja është kjo?"

"Sën me folë", tha gruaja. Përsëri i tha diçka vogëlushes. Ajo e shikonte vazhdimisht.

"Këtu, banoni, jo a?" thashë unë. Tregova me gisht vogëlushen, pastaj atë, mandej derën. Gruaja bëri me kokë. Ia kishte lëshuar frerin çakallës. Ajo erdhi deri në verandë dhe duke llomotitur na tregoi tatëpjetë rrugës.

Edhe unë pohova me kokë: "Ju vini, tregoni?" thashë unë. E kapa për dore, ndërsa me dorën tjetër e tregoja tatëpjetë rrugës. Ajo s'pushonte së foluri duke treguar rrugën "Ju, vini, tregoni", thashë unë duke u munduar të zbres shkallët me të.

"Si, si", tha ajo, duke refuzuar të ecte, e duke më treguar diçka. Unë përsëri pohova me kokë.

"Falemnderit. Falemnderit. Falemnderit". Zbrita shkallëve dhe u nisa kah dera, jo me vrap, po goxha shpejt. Iu qasa derës, u ndala dhe e shikova vogëlushen. Tashmë s'e kishte kojen e simites, kurse ajo më shikonte me vështrimin e saj të ngrysur po miqësor. Ajo gruaja ishte ndalë në krye të shkallëve dhe na vështronte.

"Hajde moj, eja", i thashë. "E gjejmë shtëpinë herët a vonë".

Ecte pranë meje tamam nën bërrylin tim. Vazhdonim të ecnim. Të gjitha shtëpitë më bëhej se ishin të zbrazta. Si të mos kishte frymë njeriu. Epo, megjithatë, s'është e mundshme të jenë boshe. Gjithë ato dhoma të ndryshme, sikur të zhdukeshin muret sa hap e mbyll sytë, zonjë, ja bija juaj, ju kam rixhanë. Jo. Zonjë, në dini perëndinë, ja bija juaj. Ecte pa ndarë nën bërrylin tim, me bishtalecat e saj të shkëlqyeshëm e të dendur, e sakaq u zhduk edhe shtëpia e fundit dhe rruga e ndërronte kahjen dhe zhdukej pas një muri, buzë lumit. Nga një derë e thyer, ia behu një grua me një shallë mbi kokë të lidhur nën mjekër. Rruga merrte kthesë tjetër, por, ishte e shkretë. Gjeta një monedhë dhe ia fala vogëlushes. Një çerek dollari. "Lamtumirë, motër", i thashë dhe u vura për të lehtë.

Isha vu në pikë të vrapit dhe s'shikoja pas. Para se të kaloja nëpër bërrylin e rrugës, ktheva kokën për të shikuar pas. Ajo ishte ndalur në rrugë, kolopuçja e ngratë, e kishte mbështetur bukën për petkat e papastra, me sytë e saj të qetë, të zez, të ngrysur. Unë vazhdova të vrapoja.

Një rrugicë ndahej nga rruga. Rashë nëpër të dhe pas një

copë here e ndala vrapin dhe fillova të ecja me hapa të shpejtë. Rrugica kalonte pas shtëpive të ngjyrosura të stolisura me një sërë teshash të varura në spangot për varjen e teshave, aty gjendej edhe një plevicë gjysmë e shembur, mes pemishtes së heshtur, me barojë dhe çaravalle të kuqe dhe të bardha, plym me gumëzhimën e bletëve dhe të rrezeve të diellit. U ktheva të shikoja. Në krye të rrugicës s'dukej askush. E ndala hapin edhe një grimë, ndërsa hija ime më përcillte këmba-këmbës duke e shtirë kokën deri te baroja që e fshihte gardhin.

Shtegu shkonte kah porta e mbyllur, tretej në bar, shndërrohej në një monopat të zakonshëm, i mbuluar nga bari i njomë. Iu ngjita portës, e kapërceva dhe iu afrova murit tjetër përbri të cilit po ecja, ndërsa hija s'më ndahej dot. Kishte hardhi dhe lule mustaku tamam si kemi ne në shtëpi lulen dorëzonjë. Derisa i afrohesha, moti ishte shumë i lig, me shi, në mugëtirë, sidomos kur përhapej edhe era e dorëzonjës, si të mos e kishim pisk edhe pa të, *Pse i lejova të të puthë, të puthë*

Nuk i lejova, po e shtrëngova të më shikonte derisa isha e xhindosur Ç'thua pra? Shenja e kuqe e dorës sime shkëliste nëpër fytyrën e saj si të ishte ndonjë elektrikë e dorës nën dorë ndërsa sytë i shndrisnin

S'ta lidha shpullën për shkak të putbjes. Bërrylat e vajzave pesëmbëdhjetëvjeçare tha Babai i gëlltit si ta kishte në gërmaz ashtin e peshkut ç'keni ti me Kedin mataně tavolinës që s'më shikoni. Ta lidha shpullë ngase ia lejove atij qyrramani të mallkuar të qytetit të të puthë ti do të ti do të thuash tash se dorëzohem. Dora ime e kuqe u shqit nga fytyra e saj. Ç'thua t'ia fërkoj kokën në Bari të therr ta pickon mishin dhe ia gudulis kokën asaj. Thuaj se dorëzohem thuaje

Unë s'e putha kurvën e çiftit të Natalisë. Muri hyri në hije, pastaj u bë hija ime, kështu që ia hodha përsëri. E kisha harruar se lumi lakonte aty. Iu ngjita murit. Dhe aty, ajo më vuri re se si kërceva, duke e mbajtur bukën të mbështetur për fustanin e vet.

U ndala më barojë. E shikuam njëri-tjetrin një copë herë.

"Pse s'më the se banoje këtej, moj motër? "Buka dalngadalë dhe si me zor po dilte nga letra. I duhej letra e re". "Epo, më trego se ku banon", *jo një kurvë të çiftes së Natalisë. Po binte shi mund të dëgjonim në pullaz sesi dihaste nëpër zbrazëtirën e gjatë dhe të ëmbël të plevicës.*

Andej? duke e prekur

Jo andej

Andej? nuk binte shi i madh ndonëse nuk mund të dëgjonim asgjë pos pullazit dhe si të ishte gjaku im në të sajin

Më shtyri teposhtë shkallëve dhe ua mbathi dhe më la Kedi ma bëri këtë

Aty të erdhi rëndë kur krisi dhe iku Kedi, atëherë të erdhi keq

Oh Po ecte tamam nën bërrylin tim, tepja e kokës së saj me lëkurë të përlyer, buka po dilte nga letra përherë e më tepër.

"Nëse s'arrin së shpejti në shtëpi, do të të prishet buka. Ç'do të thotë mama atëherë?" *Vë bast se mund të të çoj*

S'mundesh jam mjaft e rëndë

A iku Kedi a shkoi në Shtëpi s'ke si ta shohësh plevicën nga shtëpia jonë a je rrekur ta shohësh plevicën nga

Ajo kishte faj ajo më shtyri ajo iku me vrap

Mund të të çoj pa shiko

Oh gjaku i saj apo gjaku im Oh Po ecnim ende nëpër pluhurin e imët, hapat i kishim të prajshëm si goma në pluhurin e imët ku lapsat e diellit po binin pjerrtazi për drurë. Përsëri e ndjeva ujin sesi rridhte me rrëmbim qetë-qetë në hijen misterioze.

"Larg banon ti, apo. Duhet të jesh shumë e mençur kur guxon të shkosh filli vetëm deri larg në qytet". *Është tamam si kur vallëzojnë të ulur, ke vallëzuar e ulur? E dëgjonim shiun, miun në grazhd, ahurin e zbrazët pa kuaj. Si e pushton partnerin për të vallëzuar kështu e mban*

Oh

Zakonisht e pushtoja kështu kujton se s'isha edhe aq e fortë apo jo

Oh oh oh oh

E mbaj kështu të ngjitur për vete desha të them dëgjove se ç'thashë thashë

Oh oh oh oh

Rruga po vazhdonte, e qetë e shkretë, ndërsa dielli sa vinte po përcëllonte. Gërshetat e saj të forta e të vogla ishin të lidhura në skaj me copëza të një stofi të kuq të mbyllët. Qipi i letrës me të cilën e kishte mbështjellë, bukën po lëkundej derisa ecte ajo kurse maja e bukës ishte lakuriqësuar. U ndala.

"Dëgjo moj. Mos banon përskaj rruge? Ka një milje që s'hasëm në asnjë shtëpi".

Më vështronte e mvrejtur misterioze dhe miqësisht.

"Ku banon, moj motër? Mos banon ndoshta atje, pas qytetit?"

Cërcërima e një zogu u dëgjua në pyll, matanë rrezeve të rralla e të pjerrta të diellit.

"Do të brengoset yt atë. Mos e di ti se do të hash dacka që s'u ktheve menjëherë në shtëpi me bukën?"

Ai zogu cërcëroi përsëri, i padukshëm, me një cërcërimë të pakuptimtë, të thellë, monotone dhe sakaq pushoi si ta kishe prerë me thikë, e pastaj, sërish si ajo ndjenjë që të kaplon kur e çik ujin e rrëmbyeshëm po edhe të qetë mbi disa korie të fshehta, ndjenjë e përjetuar po jo edhe e parë apo e dëgjuar.

"Oh, djall o punë, moj motër". Më se gjysma e letrës me të cilën e kishte mbështjellë bukën, i lëvarej nën sqetull. "Epo kjo letër më s'të hyn në punë". Ia rrëmbeva dhe e flaka skaj rrugës. "Hajde. Të kthehemi në qytet. Kthehemi bregut të lumit".

E lëmë rrugën. Mes myshkut kishin shpërthyer disa lule të zbehta, m'u bë se përsëri e pata atë ndjenjë të ujit të qetë e të paparë. *E mbaja kështu të shtrënguar desha të them se e përqafoja kështu duke e mbajtur Ajo qëndronte te pragu i derës duke na shikuar me duar në ije*

Ti më shtyre ti pate faj më dhimbti

Ne vallëzonim të ulur vë bast se Kedi s'di të vallëzojë ashtu

Mjaft më mjaft

Desha vetëm t'ia heq pluhurin nga ana e pasme e fustanit tënd

Hiqmu sysh me ata duar të ndyta prej matufi ti ke faj ti më shtyre jam e zemëruar me ty

Aq më bën ajo na kundronte po hidhërohet më kot iku zumë të dëgjojmë disa britma dhe disa zhabaritje në ujë; befas diktova një kufomë të nxirë.

Hidhërohu de. Këmisha dhe leshrat e mi ishin lagur. Përtej çatisë e dëgjoja tash çatinë që zhurmëronte e vura re Natalinë e cila ecte nëpër kopsht nën shi. Lagu, bëhu qull në daç shpresoj se merr të kallurit e mushkërive kthehu moj në shtëpi moj fytyrëlopë. Kërceva me tërë fuqinë në pellgun e derrave dhe në baltovinën që kundërmonte dhe u bëra i verdhë nga balta deri në bel u krodha derisa radhë e mandej m'u tek të bërlykem në lluc" "Dëgjon se si lahen moj motër? Edhe unë do të lahesha tash". Po të kisha kohë. Kur të kem kohë. E dëgjoja tiktakun e orës sime. *balta ishte më e ngrohtë se shiu kundërmonte sa s'bën më keq. Ma kishte kthyer shpinën unë i kalova pas shpine dhe i dola përpara. Di se ç'bëra? Ajo ma kishte kthyer shpinën kurse unë i shkova nga pas dhe i dola përpara ndërsa shiu shkëliste nëpër baltë dhe e lagte jelekun e saj kundërmonte një erë shumë e keqe. E shtrëngova për vete ja se ç'i bëra. Ajo ma ktheu kurrizin kurse unë i dola përpara. E shtrëngova, ja ku ju them,*

Punë e madhe se ç'i ke bërë

S'je ngushtë, s'qenke ngushtë të detyroj unë të shtrëngoj që të jesh ngushtë që ç'ke me të. Ajo m'i shtyri krahët unë e bëra me baltë me dorën tjetër nuk e ndjeva shpullën e lagët të dorës së saj e i pastrova këmbët nga balta dhe e leva me baltë shtatin e saj të lagët, të fortë të spërdredhur i ndieja gishtërinjtë e saj sesi po nguleshin në fytyrën time por s'ia dola ta ndieja atë as atëherë kur shiu zuri të shkëliste si i ëmbël buzëve të mia

Ata në ujë i vunë re më parë kokat pastaj shpatullat tona. Po çirreshin ndërkaq njeri syresh që ishte galiç brofi mes tyre. Dukeshin si kastorët, këlthitnin, ndërsa uji ua përkëdhelte mjekrrt.

"Largoje atë vogëlushe! Ç'ke ore, vogëlushe na sjell këtu? Hiqu saj!"

"Ajo s'ju bën asgjë. Kemi merak t'ju shikojmë".

Ishin ulur galiç në ujë. Kokat si t'i kishin bashkuar tok. Na kundronin. Ndërkaq, u shpërndanë dhe na u sulën duke na stërpikur me ujë. Ne u larguam.

"Dëgjoni, djema; s'ju bën gjë, s'ju qet telashe".

"Hup, mor Harvard!" Këto ishin fjalët e çunit tjetër, të atij i cili ëndërronte për kalin dhe qerren te ura. "Lagini, shokë!"

"Të dalim nga uji dhe t'i hedhim në ujë", tha tjetri. "Unë s'ia kam frikën asnjë vogëlusheje".

"T'i lagim! T'i hedhim në ujë!" Na u turrën duke na stërpikur me ujë. Ne zumë të ikim. "Hupni!" - britnin. "Qërohuni!"

Ne u larguam. U grumbulluan rrëzë bregut, kokat u dekeshin të lëmueta e të radhitura mbi ujin e shkëlqyeshëm. Vazhduam rrugën. "S'është ky vend për ne, apo jo". Dielli atykëtu po e prekte myshkun, por tash më rrafsh e jo ashtu pjerrtas si më parë. "Moj e shkretë. Po ti qenke kolopuçe, e vockël". Lulet që gjendeshin në myshk ishin të vogla, më të vogla kurrë s'kam parë: "Ama qenke e mitur. E ngrata". Një monopatë lakadredhonte buzë lumit. Pastaj lumi u bë i qetë përsëri, i mvrejtur i qetë i shpejtë. "Qenke e vockël. Moj motërzë e shkretë". *Ishim shtirë në barin e lagët duke u dridhur shiu si kokrra të ftohta të saçmës më binte në shpinë. Po tash thua përsëri se aq të bën se s'je ngushtë apo jo apo jo*

O zot i mcdh se ç'bela na gjeti çobu. Aty ku shiu ma çikte ballin filloi të më dhimbte dora m'u skuq vijat e kuqe i shpëlau shiu. Të dhemb

Ta merr mendja ç'kujtove

Sesi më m'u duk se gati t'i shkula sytë o i lumi zot ne na vjen erë e keqe më së miri të lahemi e të pastrohemi te përroska "Ja qyteti përsëri, motër. Tash, të shkosh në shtëpi. Unë s'kam çare pa u kthyer në shkollë. Shiko se sa vonë shkoi. Tash ik në shtëpi, apo jo?" Mirëpo, ajo s'e shqiste nga unë atë vështrimin e saj të mrrolët, misterioz e miqësor, ndërsa bukën gjysmë të lakuriqësuar e shtrëngonte për kraharor. "U bëmë qull. Mendoja se u kthyem me kohë". E nxora shaminë dhe u orvata ta fshij bukën, mirëpo, koja e saj gati ra, ndaj pushova së fshiri. "Le të teret vetë. Mbaje ashtu vetëm ashtu". Ajo e mbanite ashtu. Si ta kishin gicur minjtë, *ndërsa uji sa vinte rritej në shpinën e ulur teksa koja e përçarë e baltës kundërmonte në siprinë duke e zhubravitur me disa njolla si të vajit në stufën e skuqur. Të thashë se do të të deturoj*

Aq më bën se ç'bën ti s'jam ngushtë

Në atë çast i dëgjuam hapat e dikujt që vraponte. U ndalëm dhe u kthyem të shikojmë dhe pamë se si na ofrohej me turr shtegut, ndërsa hijet e rrafshta po i këcenin në këmbë.

"I ngutet atij. Ne..." pastaj vura re edhe një tjetër njeri, më të moçëm, i cili mezi vraponte me bastun në dorë, ndërsa pastaj

diktova sesi vraponte edhe një vogëlush, gjysmë i zhveshur, duke i mbajtur pantallonat me duar.

"Ja Gjulio", tha vogëlushja e në atë çast vura re fytyrën e tij italiane dhe sytë e tij kur më sulmoi. U rrëzuam për toke. Duart e tij donin të ma prishnin fytyrën, fliste disa fjalë dhe donte të më kafshonte, më duket atëherë e ngritën duke e mbajtur fort, ndërsa ai kundërshtonte, përdridhej e hidhej rreth e rrotull duke bërtitur. Ngaqë ia mbanin duart fort, ai mundohej të më mëshonte me shkelm derisa s'e larguan. Vogëlushja po qante duke e mbajtur bukën me të dyja duart. Ai vogëlushi gjysmëlakuriq hidhej e përdridhej herë andej herë këtej duke i mbajtur pantallonat. Dikush më ngriti me kohë që të diktoja edhe dikë tjetër cipricullak se si po dredhonte te laku i shtegut, por papritur e papandehur e ndërroi drejtimin dhe u struk pas disa drizave, ndonëse në kurriz kishte dy petka disi të drejta si dërrasa. Gjulio nuk ishte fashitur ende. Ai që më ngriti, më tha: "Hej, të zumë. Na re ne dorë". Kishte veshur jelek, po xhaketë s'kishte. Në jelek kishte një pllakë metali. Në dorën tjetër kishte një shkop me nyja.

"Ju jeni Ansi, apo jo?" i thashë. "Ju kërkoja. Ç'ndodhi?"

"Ju vë në dijeni se çfarëdo që të thoni mund të përdoret kundër jush", më tha ai". "Ju jeni të arrestuar".

"O lermëni ta grij bre", thoshte Gjulio. Ai ende mundohej t'u ikte atyre që e mbanin. Atë e kishin mbërthyer dy veta. S'e lëshonin. Vogëlushja çirrej pa pushim duke mos e lëshuar bukën nga dora. "Ti motrën po ma grabit", thoshte Gjulio. "O më lëshoni bre zotërinj"...

"T'ia grabis motrën, unë?" thashë unë. "Paj, unë..."

"Mbyll gojën", tha Ansi. "Këtë do ta vërtetosh para gjykatësit".

"Unë t'ia grabis motrën?" thashë unë. Gjulio u iku atyre dyve e t'm'u turr përsëri, por rojtari ia ndali hovin; ata u përfytën, kurse ata dy të tjerë ia mbërthyen krahët për së dyti. Ansi e lëshoi, i dihatur.

"Jabanxhi i mallkuar", tha: "Do të të rras në birucë me gjithë qejf nëse e ke ngucur". Përsëri m'u kthye. "A ecën vetë përpara apo të lidha me pranga?"

"Eci vetë", thashë unë. "Mirë de, bëj si thua... Ama ta sulmoj dikë? ... Unë t'ia ... T'ia grabis..." thosha me vete. "Motrën e tij..."

"Të thashë me kohë, të kesh kujdes", më tha Ansi, "se ai ka

ndërmend të të akuzojë se ti me qëllim ia grabite motrën. Hej, mbylljani gojën asaj vogëlusheje".

"Oh", thashë unë. Mandej, ia plasa gazit. Edhe dy vocërrakë me flokë të lagët e me sy topolakë dolën nga drizat duke i përthekuar këmishat që iu ishin lagur në supe dhe duar. Unë po përpiqesha ta përmbaja gazin, ndonëse s'ia dilja dot.

"Ki kujdes, ruhu Ans, më duket se është i rrokatur".

"Tash pu-pushoj", thashë unë, "Ja sa... orë-saora. Njëherë ah-ah-ah", thashë unë duke qeshur. "Të ulem pak". U ula ndërsa ata të gjithë m'i kishin qepur sytë, edhe vogëlushja me fytyrë të përbaltur dhe me atë bukë si të kafshuar, edhe uji i shpejtë dhe i qetë nën shteg. Pas një copë here gazi u fashit. Mirëpo, fyti im ende donte të qeshte, shi ashtu kur të villet ndonëse lukthin e ke të zbrazët.

"Hej, pusho mor", më thoshte Ansi, "mblidh veten".

"Po", thashë unë, duke e shtrënguar gërmazin. Ia behu fluturimthi një flutur tjetër, si të ishte shqitur njëra ndër ato njolla të diellit. Pas një copë here, s'më qeshej më. U çova, "Gati më ke. Kah më çoni?"

Ecnim shtegut, ndërsa ata dy të tjerë e ruanin Gjulion dhe vogëlushen ndër vocërrakët kishin mbetur pas. Shtegu kalonte buzë lumit dhe pastaj kalonte edhe nëpër urë. Ne e kaluam urën, pastaj i kaluam edhe binarët, ndërsa gjindja dilnin në dyer për të na kundruar, ia behën edhe disa fëmijë të tjerë prej s'di nga, kështu që kur ndodheshim në rrugën kryesore, ishte bërë një shpurë e tërë. Para dyqanit të bakallit gjendej një automobil i madh, kurse unë s'dija se kush ishte aty derisa zonja Bland s'më bëri zë,

"Pa shih, Kuentini! Kuentin Kompsoni! "Pastaj e diktova Xheraldin dhe Spoudin në ulëset e pasme, me qafë të mbështetur për mbështetëse. Aty ishte edhe Shrui. Ato dy vazhëzat që ishin me të nuk i njihja.

"Kuentin Kompsoni!" tha zonja Bland.

"Mirëdita, zonjë", i thashë duke e ngritur kapelen. "Jam i arrestuar. Më vjen keq që s'e mora lajmin tuaj. Shrui ju njohtoi?"

"Arrestuar?" tha Shrui. "Më falni", tha ai. U drejtua kaloi mes tyre dhe doli. Kishte pantallonat e mia të flanelës, që i rrinin për bukuri. S'më kujtohej se i kisha harruar. S'më kujtohej as sa gusha i kishte zonja Bland. Më e bukura vashëz ishte me Xheraldin, përpara. Vashëzat më shikonin nga vela e tyre, me

njëfarë tmerri të butë. "Kush është i arrestuar?" tha Shrui. Ç'është kjo, zotëri?"

"Xherald", bëri zonja Bland, "Largoji këta gjind. Futu në automobil, Kuentin".

Xheraldi doli jashtë. Spoudi s'kish luajtur nga vendi.

"Ç'faj bëri, o kapidan?" tha ai. "Mos vodhi gjë në furrik të pulave?"

"Ju tërheq vërejtjen", tha Ansi. "E njihni të arrestuarin?"

"A e njoh", tha Shrui. "Dëgjoni —"

"Atëherë mund të vini me ne te gjykatësi. Kështu vetëm më pengoni në punë. Shkojmë". Ai ma shkundi dorën.

"E pra ditën e mirë", thashë unë. "Më vjen mirë që ju pashë të gjithëve. Më falni nëse s'vij me ju".

"Mor Xherald", tha zonja Bland.

"Dëgjoni, xhandar", tha Xheraldi.

"Ju vura në dijeni se po i pengoni në detyrë një zbatuesi të ligjit", tha Ansi. "Në paça gjë për të thënë, mund të vini te gjykatësi dhe si dëshmitarë të deklaroni se e njihni të arrestuarin". Ne vazhduam të ecim. Tashmë ishte bërë një procesion i vërtetë në ballë të të cilit ndodheshim unë dhe Ansi. Dëgjova sesi u thoshin se ç'kishte ngjarë, sesi Spoudi pyeste gjepura, e pastaj Gjulio këputi një sharje të pakripë në italishte. Unë u ktheva dhe vura re atë vogëlushe duke qëndruar rrëzë trotuarit duke më shikuar ashtu miqësisht dhe në mënyrë enigmatike.

"Kthehu në shtëpi", i briti Gjulio, "Se t'i theva brinjtë".

Po ecnim rrugës. Pastaj hymë në një rrugicë që disi gjendej pas rrugës dhe ku gjendej një bina njëkatëshe nga tullat e lyera me ngjyrë të bardhë. Ecëm shtegut të shtruar me gurë deri te dera, ku Ainsi i ndali të gjithë pos nesh dhe u tha të prisnin jashtë. Hymë në dhomën pa orendi ku kundërmonte era e duhanit. Mes një si podiumi të kuq katërqipësh të mbushur me rërë gjendej stufa nga hekuri, ndërsa në mur gjendej një hartë e zbehtë dhe një vizatim gri i qytetit. Pas tavolinës së gërvishur dhe plym me do shkresurina të çuditshme na e kishte ngulur shikimin nëpër ca syze me korniza çeliku një mjeri me leshra të shpupurishura ngjyrë të çelikut dhe të përhime.

"Ho Ans, të ra në lak, apo jo?" tha ai.

"Po, i nderuar".

Ai hapi një alamet libri të pluhrosur, e afroi për vete, e futi

pendën e papastër në shishen e myreqepit të mbushur si me njëfarë pluhuri të thëngjillit.

"Dëgjoni, zotëri", tha Shrui.

"Si quhet i arrestuari", tha gjykatësi. Unë i thashë si quhesha. Ai e shkroi ngadalë, ndërsa penda i gërvishej dhe të lodhte.

"Dëgjoni, zotëri", tha Shrui. "Ne e njohim këtë djalë. Ne-"

"Qetësi në sallë", tha Ansi.

"Rrudhe gojën, jaran", tha Spoudi. "Le ta kryejë punën e vet. S'ke ç'i bën".

"Mosha", tha gjykatësi. I thashë. Ai i shkruante këto duke i lexuar shkronjat që i shkruante. "Profesioni". I thashë. "Student i Harvardit, qy qy...!" E çoi kokën për të më parë përmbi syzet. Sytë i kishte të kthjellët dhe të ftohtë, si të sqapit. "Epo ç'ju shkrepi të vini këtu për t'i grabitur fëmijët?"

"Kanë luajtur mendësh, o gjykatës", tha Shrui. "Ai që thotë se ky djalosh i grabit fëmijët -"

Gjulio kërceu. "I luajtur mendësh?" tha ai. "A s'i kapa vetë? A s'i pashë me këta sy —"

"Ti rren", tha Shrui. "Ti askurrë —"

"Qeteëi, qetësi", bëri Ansi me zë të ngritur.

"Ju djema, kyçeni gojën", tha gjykatësi. "Nëse s'rrinë urtë, qiti jashtë, Ans". Gjykatësi e shikoi Shruin, pastaj Spoudin e mandej edhe Xheraldin. "E njihni këtë çun?" i tha Spoudit.

"Po, i nderuar", tha Spoudi. "Është çun nga fshati nga një shkollë jo fort larg. S'është djalë i keq. Besoj se edhe Xhandari do të dëshmojë se është fjala për një mosmarrëveshje. Babanë e ka famullitar".

"Hëm", bëri gjykatësi. "Ç'dreqin bëje ti?" Unë i kallëzova derisa ai më shikonte me sytë e tij të ftohtë e të zbehtë. "Ç'thua ti, o Ans?"

"Bën vaki", tha Ansi. "Çka s'bën vaki me këta jabanxhinj të mallkuar!"

"Unë, amerikan", kërceu e tha Gjulio. "Me dokumente".

"Ku është vogëlushja?"

"E ktheu në shtëpi", tha Ansi.

"Mos ishte frikësuar? Mos e kishte gjetur gjë?"

"Jo, s'pat gjë derisa Gjulio s'iu turr të arrestuarit. Ata ecnin shtegut buzë lumit që çon kah qyteti. Disa fëmijë që laheshin na treguan se kah shkonin".

"Është bërë një mosmarrëveshje, me siguri, gjykatës i nderuar", tha Spoudi. "Fëmijët dhe qentë e duan, i lyhen pas ngaherë. Ç'e do".

"Hëm", bëri gjykatësi. Ai hodhi vështrimin jashtë dritares. Ne e vështronim Gjykatësi na shikoi përsëri.

"Jeni i bindur se vogëlushja s'është lënduar, ju atje?"

"Jo, e paprekur është", tha Gjulio.

"E latë punën për ta kërkuar atë?"

"Po de. Ngajta. Sa mujta. Këqyr andej, këqyr këndej. Mandej një njeri më tha që e ka pa qi ai ia ka dhanë me hangër, e ajo i lyhet mbas".

"Hëm", bëri gjykatësi. "E biro, më bëhet se duhet t'i jepni diçka Gjulios, ngaqë atij iu desh ta linte punën".

"Po, imzot, sa?"

"Epo, mjafton një dollar".

Ia dhashë Gjulios një dollar.

"E pra", tha Spoudi, "nëse s'ka gjë tjetër, unë mendoj, gjykatës i nderuar se tash ky është i lirë".

Gjykatësi as që e denjoi ta vështronte. "Sa vrapove pas tij, Ans?"

"Të paktën dy milje. Mezi e zura pas gjysmë ore".

"Hëm", bëri gjykatësi. Mendoi për një copë here. E shikonim, atë xhufkë të tij, ato syze të tij të lëshuara në hundë. Hija e verdhë e dritares po rritej në dysheme, po i afrohej murit dhe së shpejti do të ngjitej nëpër të. Pluhuri po vërtitej në ajër. "Gjashtë dollarë".

"Gjashtë dollarë", tha Shrui. "E pse?"

"Gjashtë dollarë", tha gjykatësi. Ai i hodhi një vështrim Shruit, pastaj edhe mua.

"Dëgjoni", tha Shrui.

"Mbylle çakallën", tha Spoudi. "Jepni, dashamir, mos prit dhe të ikim. Zonjushat na presin. I ke gjashtë dollarë?"

"Po", thashë unë. Ia dhashë gjashtë dollarë.

"Gjykimi mbaroi", tha ai.

"Merre vërtetimin", tha Shrui. "Merre vërtetimin e nënshkruar për paratë e paguara".

Gjykatësi e shikoi Shruin me butësi. "Rasti mori fund", tha ai pa e ngritur zërin.

"Mallkuar qofsha —" tha Shrui.

"Shkojmë," tha Spoudi duke e rrokur për dore. "Ditën e

mirë, i nderuar. Ju falemnderit". Ndërsa dilnim nëpër derë u dëgjua përsëri zëri qortues i Gjulios, pastaj u fashit. Spoudi më vështronte me sytë e tij gri, kërshërplotë e të ftohtë "E mor lum miku, paskëtaj unë mendoj se do të përmallohesh për ato çupat e Bostonit".

"Mor i krisur", tha Shrui. "Ku dreqin i bie këtejza dhe shoqërohesh me këta delenxhinj?"

"Hajde", tha Spoudi. Ato do të kenë humbur durimin".

Zonja Blland u çuçullaste diçka zonjushave Holms dhe Deinxherfild. Për një copë herë ato s'ia varën veshin dhe zunë të më shikonin përsëri me atë llahtar të matur po kurioz, me vela mbi hundë të bardhë, ndërsa sytë e tyre nën to shikonin me afsh dhe misteriozisht.

"Kuentin Kompson", zuri të qortojë zonja Blland, "ç'do të thoshte nëna juaj po ta dëgjonte këtë reng? Djali i ri, u mor vesh, fare lehtë mund të bjerë në bela, por ta zërë ashtu me të xhandari i provincës, kjo s'ka bërë vaki. Ç'kujtuan se kishte bërë, Xherald?"

"Kurrgjë", tha Xheraldi.

"Marri. Ç'ndodhi, Spoud?"

"Deshi ta grabiste atë vogëlushe qyrramane, por e zunë me kohë", tha Spoudi.

"Marri", tha zonja Blland, por zëri iu shua, kështu që më vështroi ngultazi për një copë herë, ndërsa vashat mezi po dihatnin. "Gjepura", tha zonja Blland me rreptësi. "Këto janë trillimet e atyre jankive të pagdhendur. Hyr, Kuentin".

Shrui dhe unë u ulëm në dy ulësen montuese. Xheraldi e ndezi motorin me kurbë, hyri brenda dhe u nisëm.

"E pra, Kuentin, tash më thuaj përnjëmend se ç'marri ishte ajo", tha zonja Blland. U tregova, ndërsa Shrui i përkulur dhe i mllefosur ishte ulur në ulësen montuese, kurse Spoudi sërish ishte ulur afër zonjushës Deinxherfild me qafë të mbështetur për mbështetëse.

"Ç'është më e keqja Kuentini na mashtroi tërë kohën", tha Spoudi. "Ne gjithmonë mendonim se ai është djalosh i pashoq dhe se secili mund t'ia besojë bijën derisa policia s'ia çori maskën dhe e zuri me kërpesh në dorë".

"Pusho, Spoud", tha zonja Blland. Po voziteshim tatëpjetë rrugës, e kaluam urën dhe kaluam afër shtëpisë në dritaren e të cilës ishin varur do petka të kuqe. "Kjo ju ka ngjarë ngaqë

s'e keni lexuar pusullën time. Pse nuk erdhët për ta marrë? Zotëri Mëkenzi thotë se ju ka njoftuar se gjendej atje".

"Po, zonjë, ashtu është. Kisha ndër mend të vijoj, mirëpo, harrova të kthehesha në dhomë".

"Ju do të na linit të prisnim atje ku ta di sa kohë po të mos ishte zotëri Mëkenzi. Kur ai na lajmëroi që nuk ishit kthyer, ne na mbet një vend i lirë, ndaj e lutëm atë që të vinte me ne. Fundja, ne jemi shumë të kënaqur që ju jeni me ne, zotëri Mëkenzi. "Shrui nuk bëzante. I kishte kryqëzuar duart dhe shikonte përpara kah kapelja e Xheraldit. Kapele të tilla mbajnë shoferët në Angli. Kështu, të paktën tha zonja Blland. Kaluam para asaj shtëpie dhe para tri shtëpiave të tjera si dhe para një oborri tjetër ku ajo vogëlushe po qëndronte para derës së oborrit. Tash s'e kishte bukën në dorë, mirëpo fytyrën e kishte si të lyer me qymyr. Ia bëra me dorë, por ajo s'më përshëndeti po e ktheu vetëm kokën ngadalë derisa kalonte automobili dhe na përcolli me shikimin e saj. Në atë çast ne po nxitonim pranë murit, ndërsa njëkohësisht edhe hijet tona po rendnin rrëzë murit. Pas një hopi, kaluam një copë të një gazete të grisur që gjendej aty, në rrugë ndërsa unë zura të qesh përsëri. Ndieja se më qeshej edhe në fyt dhe vështroja pa ndarë drurët ku pehatej pasditja pjerrtazi, mendoja për pasditen dhe për atë zogun si dhe për ata çuna që i kisha parë duke u larë. Megjithatë, nuk mund ta përmbaja gazin dhe e dija se në qoftë se do të rrekem të buzëqesh me zor, do t'ia shkrep vajit. Mendoja për atë që kisha menduar edhe më parë se nuk mund të mbetesha i virgjër, i papërvojë ku pranë gjithë atyre gocave që baresin nën hije dhe pështpërisin me zërat e tyre të ëmbël, ndalen nëpër skuta dhe vende nën hije, ndërsa unë i dëgjoj fjalët e tyre, i nuhas parfumet e tyre dhe i ndiej sytë e tyre, por nuk i shoh. Në qoftë kjo punë e lehtë, atëherë s'qenka gjë ajo punë dhe, në mos qoftë asgjë, atëherë çfarë qenkam unë. Në atë çast foli zonja Blland: "Kuentin? Mos është i sëmurë, zotëri Mëkenzi?" Në atë çast dora e majme e Shruit e çiku gjurin tim, kurse Spoudi zuri të fliste kurse unë s'pata si ta ndërprisja.

"Nëse ajo shportë i pengon, zotëri Mëkenzi, ngrejeni pak pranë jush. Unë mora një shportë me shishe të verës, ngaqë mendoj se zotërinjtë e rinj duhet të pinë verë, ndonëse babai im, gjyshi i Xheraldit *"ke bërë ndonjëherë atë punë A ke bërë*

ndonjëherë aso pune Në errësirën e përbime shndritnin duart e saj të kryqëzuara

"E pinë sa herë që ta shtien në dorë", tha Spouidi. Apo jo, Shru?" *gjunjët fytyra e saj e kthyer kah qielli era e lulemustakut në fytyrën dhe në qafën e saj*

"Edhe birrën e pinë", tha Shrui. Dora e tij e çiku përsëri gjurin tim. E largova gjurin përsëri. *si ngjyra e hollë e jargavanit fliste për të e solli*

"Ti s'je kurrfarë zotërie", tha Spoudi. *atë në mesin tonë derisa e humbi formën po pa ndikimin e errësirës*

"Jo, unë jam kanadez", tha Shrui. *duke folur për të rremat i bënte ajo me sy kur bëri të nisej, i bëri me sy Kapela e cila ishte bërë e shëmbëllyeshme si kapelat e shoferëve në Angli gjithnjë duke rënë poshtë kurse për njëri-tjetrin ai kishte qenë në ushtri dhe kishte vrarë njerëz*

"Unë e adhuroj Kanadanë", tha zonjusha Dainxherfild. "Për mua është një vend magjik",

"Ke provuar ta pish parfumin?" tha Spoudi. *me një dorë mund ta çonte në shpatull dhe kështu të rente të rente Të rente me të*

"Jo, s'kam provuar", tha Shrui. *Ai e trembte kafshën me dy shpina kurse ajo në vrap e sipër ishte shndërruar në rrema që i bënin me sy i trembte derrat e Euboleit mitik që në vrapim e sipër shumëzoheshin me gjithë ata Kedi*

"As unë s'kam provuar", tha Spoudi. *Unë s'i njoh edhe aq kishte diçka të mnershme në mua Atë unë kam bërë A ke bërë ndonjëherë Jo s'kemi bërë vallë a kemi bërë*

"edhe i ati i Xheraldit ngaherë i mblidhte mendrat para mëngjesit derisa ato ishin ende të kapluara me vesë. As Uilkit plak s'i lejonte t'i prekë. A mban mend mor Xherald? Vetë i mblidhte dhe pastaj e përgatiste pijen e Xhulepit. Ishte mjeshtër i vërtetë për përgatitjen e asaj pije të tij si ndonjë vajzë në moshë duke matur çdo gjë në saje të një recete që e kishte në kokë, Vetëm një njeriu ia dha recetën; e pra *ne e kemi bërë ashtu çfarë ti s'ke haber vetëm ki durim unë t'i them të gjitha se si qe puna krimi u bë ne kemi bërë një krim të mynxyrshëm s'mund të fshihet ti pandeh se po mundet por prit se do të shohësh Kuentin i shkretë ti s'ke bërë kurrë një gjë të atillë apo jo kurse unë ja ku të them se çka ngjarë e pastoj do t'i them kështu duhet të jetë puna ngaqë ti e do Atin mandej do të*

tregojnë me gisht drejt nesh dhe do të na pllakosë mynxyra do të na kaplojë flaka e pastër unë do të të shtrëngoj të pranosh se ne e kemi bërë krimin unë jam më i fortë se ti unë do të të shpjegoj se ne kemi gisht aty ti ke pandehur se ata e kishin fajin por unë e bëra atë dëgjo unë tërë kohën të bëja budallaqe unë po ndërsa ti kujtoje se unë ndodhesha në shtëpi ku lulemustakja e mallkuar duke u munduar të mos mendoj rrjeta e shrregullës qendra trazimi i instinkteve të fshehta fryma e ndalur pija frymëmarrja e vrullshme po Po Po po "ai kurrë s'e kërkoi verën, ndonëse thoshte se shporta e verës, keni lexuar në ndonjë libër për të aty ku përshkruhen petkat e rremimit të Xheraldit, është pjesë përbërëse e piknikut të një xhentëlmeni në natyrë" *a i ke dashur Kedi i ke dashur Kur më prekën si të kisha vdekur*

për një minutë ajo qëndroi aty po fill pastaj ai zuri të çirrej dhe ta ngre për fustan dolën në korridor mandej te shkallët këlthiste në kupë të qiellit duke e shtyrë atë përpjetë shkallëve deri te dera e banjos sakaq aty u ndal ajo me kurriz të kthyer kah dera dhe me dorë në fytyrë, ndërsa ai bërtiste dhe mundohej ta fuste në banjo kur ia behu në darkë T. P. — i e ushqente atë përsëri ia dha vigmës po më parë para se ta çikte pastaj ia nguli sytë si ndonjë mi i zënë në qark paskëtaj unë zura të vrapoja në errësirën gri i vinte era e shiut dhe ▪ erërave të përhime të luleve të përhapura nga ajri i lagët dhe i ngrohtë e gjinkallat çurlikonin atë këngën e tyre të shpërndara në bar duke më shëtitur dalngadalë me ishullin e vogël shtegtar të heshtjes Fensi më kundronte matanë gardhit e bërë me njolla si ndonjë mbulojse e varur për telin e nderë të teshave mendova ai zezak i dreqit përsëri kishte harruar ta ushqente. u lëshova me vrap tatëpjetë shpatit drejt atij vakuumi të gjinkallave dhe si ndonjë dihamë që e bezdis pasqyrën ajo ishte shtrirë në ujë me kokë të mbështetur për llucë uji ia çikte dhe ia guduliste ijet në ujë kishte pak më tepër dritë fundi i saj i lagur deri në gjysmë i valëzonte në vithe sipas ritmit të ujit që rridhte pa ndonjë qëllim me valëzat e rrëmbyeshme kurse rrathët e ujit, përtriheshin sërish në saje të vrullit të lëvizjes së tyre unë qëndroja në breg dhe e kundërmoja erën e lulemustakes në atë përroskë ajri si të ishte mbushur me erën e lulemustakes dhe me çurlikamën e gjinkallave dhe kjo çurlikamë e tyre si të ishte ndonjë substamcë që e ndieje në mish

ende qan Benxhi

e po s'di ku ta di
i shkreti Benxhi
u ula në breg bari ishte pak i lagët atëherë e pata të qartë se këpucët i kisha të lagta
del nga uji moj a je në vete
mirëpo ajo s'ma vuri veshin fytyrën e kishte si njollë të bardhë e cila vetëm për hir të leshrave të saj spikatej nga njolla e rërës
ama a po del a ç'thua
u ul pastaj u ngrit fundi i saj nga pikonte uji e shkundi mandej iu ngjit bregut ndërsa petkat i ngjiteshin për shtat ajo u ul
pse nuk e shtrydh fundin për ta terë mos deshe të ftohesh po
uji thithte dhe gërgëllonte nëpër shtresën e llucës së rërës dhe rridhte kah errësira mes shelgjeve duke bërë cektina uji bëhej palë palë e valë valë si ndonjë petk duke ruajtur dritën edhe pak ashtu si e ka zakom. uji
i ka kaluar të gjitha oqeanit kryq e tërthor botës i ka rënë
mandej më rrëfeu për të duke u kapur me duar për gjunjët e saj të lagësht fytyrën e ngriti kah drita ngjyrë gri era e lulemustakut drita ndodhej në dhomën e nënës dhe në atë të Benxhit ku T. P. — i e shtrinte në shtrat
e do
e zgjati dorën unë s'luajta nga vendi ajo duke më çikur me dorë e mori dorën time dhe e vuri atë në gjoksin e vet zemra i rëktinte me rrëmbim
jo jo
të shtrëngoi e pra të paska detyruar me zor që të të kapë ai ka qenë më i fortë se ti nesër e vras po pasha zotin e vras baba s'duhet të dijë për këtë po më vonë merr vesh e mandej ti dhe unë këtë s'duhet ta dijë askush kurrën e kurrës i marrim të hollat e mia për shkollim unë çregjistrohem nga universiteti Kedi ti e urren apo jo apo jo
e mbante dorën time aty pranë fytit aty ku i rëktonte zemra si çekani
Kuentin i gjorë
fytyrën e kishte të kthyer kah dielli që ishte i ulët aq i ulët saqë të gjitha erërat dhe zërat e natës të mbledhur nën të si nën ndonjë çadër të patendosur veçanërisht era e lule mustakut që

ishte përcjellë në dihatjen time gjendej sipër fytyrës dhe qafës së saj si ndonjë ngjyrë gjaku i saj e godiste dorën time u mbështeta për dorën tjetër ajo filloi ta ngrehte e të këcente kurse unë mezi merrja frymë në atë enë të dendur e gri të lulemustakut
po unë e urrej unë do të vdisja për të unë kam vdekur për të unë vazhdimisht vdes për të sa herë që ma bën atë punë
kur e çova dorën nga dheu akoma ndieja sesi më digjte shuplaka e dorës nga degët dhe bari për të cilat kisha qenë i mbështetur.
Kuentin i ngratë
u mbështet dhe i zuri gjunjët me duar
ti s'e ke bërë kurrë atë punë apo jo
çfarë s'kam bërë
atë që unë atë që bëra unë
po po e kam bërë atë punë shpeshherë me shumë vajza atëherë zura të qaj dora e saj më çiku përsëri ndërsa unë vajtoja i mbështetur për bluzën e saj pastaj ajo u shtri në kurriz dhe pranë kokës sime dhe filloi ta vështronte qiellin unë mund ta shihja shiritin e bardhë të iridës së saj e hapa thikën
të kujtohet dita kur vdiq gjyshja kur ti u fute në ujë me brekë
po
majën e thikës e mbaja në fytin e saj
Do të zgjasë vetëm një çast vetëm një hop e mandej njësoj do t'i bëjë vetes
E po mirë mund të provosh tek ti më parë
si jo tehun e ka mjaft të gjatë Benxhi tashmë është në krevat
po
do të zgjasë vetëm një copë herë sa çel e mbyll sytë ti as që do ta ndiesh
mirë
i mbyll sytë
jo sepse ashtu ta ngul më thellë
preke me dorë
mirëpo ajo s'luajti nga vendi sytë i kishte hapur dhe pranë kokës sime e shikonin qiellin
Kedi të kujtohet se si u zemërua Dilzi me ty ngaqë brekët i pate të fëlliqta
mos qaj

unë s'qaj Kedi
ngule thikën a do
dëshiron të ta ngul
po, ç'pret
ngule me dorën tënde
mos qaj mor Kuentin i mjerë
por s'ishte punë të pushoja së qari ajo e mbante kokën time në gjoksin e saj të lagësht e dëgjoja zemrën e saj që rëktonte njësoj dhe ngadalë tash s'i binte më si çekani uji po gurgullonte dhe po llokoçiste mes shelgjeve në errësirë dhe valët e aromës së lulemustakut po shpërndaheshin në ajër dora dhe krahu im u përkulën nga barra e trupit
ç'bën ti ashtu
muskujt iu mblodhën unë u ula
ja thika ime e lëshova
u ul edhe ajo
sa është ora
s'di
u ngrit ndërsa unë qëndroja në vend
shkova unë ti lëre aty ku është
ndieja se ajo ishte ulur atje i kundërmoja petkat e saj të lagta ndieja se ishte aty
këtu diku është ajo
lëre ku është e gjen nesër shkojmë tash
prit një hop se e gjej
ke frikë
ja ku është këtu paska qenë
tash shkojmë përnjëmend
u ngrita dhe u nisa pas saj iu ngjitëm bregut gjinkallat heshtën para nesh
çudi është ulet njeriu i bie diçka dhe atëherë ai duhet ta kërkojë rreth e rrotull
gri ishte gri nga vesa që ngjitej pjerrtazi në qiellin gri e mandej drurëve atje më tej
ajo erë e mallkuar e lulemustakut sikur të pushonte njëherë
e po ti gjithmonë e ka dashur
iu ngjitëm majës së kodrës vazhduam të ecim drejt drurëve ajo mu afrua mandej përsëri u largua pak hendeku ishte si vurata e zezë në barin e përhimë ajo mu afrua përsëri më shikoi u largua përsëri ne iu afruam fare afër hendekut

shkojmë këtej
pse
të shohim a mund t'i gjesh përsëri eshtrat e Nensit unë s'kam menduar t'i shoh kaherë po ti
aty kishte hardhi të egra të pleksura me driza të murrme
ja atje ishin tash nuk shihet se a janë aty apo nuk janë
mjaft Kuentin
hajde
hendeku ngushtohej dhe mbyllej ajo u kthye kah drurët
lëri këto Kuentin
Kedi
Unë i dola përpara
Kedi
mjaft
e ndala
jam më i fortë se ti
ajo nuk lëvizi por nuk epej dhe ishte e qetë
nuk dua të përleshem mos më nguc
Kedi mos Kedi
s'është mirë kështu e di edhe vetë lëshomë
era e lulemustakut s'më linte vendin vend i dëgjoja gjinkallat që na vështronin aty ajo u zmbraps dhe u vërtit rreth meje pastaj u nis kah drurët
ti kthehu në shtëpi s'është nevoja të vijsh
unë vazhdoja të ecja
pse nuk kthehesh në shtëpi
erë e mallkuar e lulemustakut
iu afruam gardhit ajo e kaloi me zvarritje edhe unë kalova duke u zvarritur dhe kur unë u drejtova vura re se ai po dilte nga pylli i përhimë dhe ecte drejt nesh ecte drejt nesh shtatlartë dhe i ngjeshur dhe megjithatë edhe kur ecte si të ishte i palëvizshëm ajo iu afrua
ky është Kuentini unë u laga u bëra qull s'je i detyruar nëse s'do
hijet e tyre një hije koka e saj u ngrit ishte mbi kokën e tij në qiell dukeshin më të larta të dy kokat e tyre
nëse s'ke qejf nuk je i detyruar
pastaj s'kishte më dy koka errësirës i vinte era e shiut e barit e gjetheve të lagta drita gri rigonte si shiu era e lulemustakut avullonte në valë të pareshtura unë e pikasja fytyrën e saj si

ndonjë njollë të paqartë të mbështetur për shpatullat e tij ai e mbante atë në një krab si të ishte ajo ndonjë fëmijë ai e shtriu dorën

gëzohem që u njohëm

ne i qokëm duart pastaj qëndruam aty hija e saj ishte e lartë e mbështetur për të tijën një hije

si ia bën ti Kuentin

do të shëtis pak do të shkoj në pyll mugës e do të kthehem nëpër qytet

u nisa të shkoj

natën e mirë

Kuentin

u ndala

ç'dëshiron

në pyll gargaliçet e nuhasnin shiun në ajrin e lagësht dhe lëshonin disa tinguj si ato kutia të vogla të muzikës me të cilat lozin fëmija por të cilat është zor t'i përdorësh dhe era e lulemustakut

eja këtu

ç'do

eja këtu Kuentin

unë u ktheva ajo e preku shpatullën time duke e përkulur hijen e saj njollën e fytyrës së saj duke u përkulur nga hija e tij e lartë unë u zmbrapsa

ki kujdes

ti shko në shtëpi

s'më flihet po shkoj të shëtis

më prit te përroska

shkova të shëtis

vij menjëherë pritëm atje

jo po shkoj të shëtis *në* pyll

nuk u ktheva të shikoj pas gargaliçet nuk më vinin re drita gri si myshku në drurë po rigonte ndonëse ende nuk binte shi pas një copë herë unë u ktheva rrëzë pyllit dhe sapo arrita atje përsëri fillova ta kundërmoja erën e lulemustakut mund t'i pikasja dritat në orën e godinës së gjyqit si dhe shkëlqimin e qytetit dhe të sheshit në qiell dhe shelgjet e murme përgjatë përroskës dhe dritën në dritaret e nënës dritën që ishte e ndezur ende në dhomën e Benxhit mandej u përkula për ta kaluar gardhin dhe dola në kullotë me vrap vrapoja nëpër barin

gri mes gjinkallave era e lulemustakut bëhej gjithnjë e më e fortë si dhe era e ujit atëherë vura re sesi uji kishte ngjyrën gri të lulemustakut u shtriva në breg të përroskës me fytyrë për toke kështu që nuk mund ta kundëmoja më erën e lulemustakut nuk mund t'ia merrja erën në atë çast isha shtrirë dhe ndieja dheun sesi i çikte edhe petkat e mia dëgjoja ujin dhe pas një copë herë nuk merrja frymë me vështirësi po isha i shtrirë aty duke menduar se nëse nuk e lëviz fytyrën atëherë marr frymë fare lehtë dhe ia marr erën dheut e mandej nuk mendoja më për asgjë ajo erdhi në breg dhe u ndal unë nuk lëviza fare

shkoj vonë të shkojmë në shtëpi

çfarë

shko në shtëpi se u bë vonë

e po mirë

petkat e saj shushuritën unë nuk lëviza mandej nuk shushuritën më

a po shkon si të thash apo jo

unë nuk dëgjoja asgjë

Kedi

po shkoj nëse do ti shkoj

unë u ngrita ajo ishte ulur për toke me duar i kishte zënë gjunjët

shko në shtëpi si të thashë

po bëj ç'të duash ti bëj si të dëshirosh ti

ajo as që më shikoi unë e kapa për shpatulle dhe e shkunda me forcë

mos ashtu

unë e shkundja

mos pusho mjaft

po

ajo e ngriti fytyrën dhe në atë çast unë pashë se ajo as që më shikonte dhe unë e vura re të bardhët e syrit të saj

çohu

unë e tërhoqa kurse ajo ishte e mefshtë

hajde tash

a qante Benxhi kur e braktisët

vemi

e kaluam përroskën atje larg e pikasa pullazin pastaj dritaren e epërme

ai flet tash
mua m'u desh të ndalem ta mbyll derën ajo hyri në dritën gri dhe në erën e shiut edhe pse ende nuk binte shi ndërsa era e lulemustakut po vinte nga gardhi i kopshtit ajo ishte strukur në hije në atë çast unë i dëgjoja hapat e saj
Kedi
u ndala te shkallët nuk i dëgjoja më hapat e saj
Kedi
i dëgjova zhapullimat e hapave të saj mandej dora ime e preku atë ajo nuk ishte as e ngrohtë as e ftohtë por vetëm e qetë petkat i kishte pak të lagta
a e do tash atë
ajo nuk merrte frymë po si të kishte një dihatje të largët
Kedi a e dashuron tash atë
s'di
jashtë dritës gri hijet e gjërave dukeshin si sende të vdekura në ujin amull
si s'vdiqe
a po vjen tash
a i ke mendtë ende te ai
s'di
thuajmë se ç'mendon pa më thuaj
mos mjaft Kuentin
rrudhe gojën mbylle atë gojë a më dëgjon kyçe gojën a e mbyll gojën apo jo.
mirë mirë ja nuk flas do të bëjmë zhurmë të madhe
të vras a më dëgjon
shkojmë më mirë atje te shrregulla se këtu të dëgjojnë
unë s'po qaj pse thua ti se po qaj
mjaft më pusho do ta zgjojmë Benxhin
hajt shko në shtëpi shko tash në shtëpi
shkova mos qaj unë s'jam aq e keqe ç'të bësh
ne jemi të mallkuar s'është faji ynë s'kemi ne faj
pusho të them hajde shko tash të flesh
s'mund të më detyrosh me zor s'bën na zë mallkimi
më në fund e pashë atë në çastin që po hynte te berberi ai shikoi rreth e rrotull unë u ndala dhe e prita
ka dy apo tri ditë që po ju kërkoj
më paskeni kërkuar
pata një fjalë me ju

ai e nxori cigaren dhe e shtrydhi vrikshëm me një apo dy lëvizje mandej me gishtin e dorës e ndezi shkrepsën
këtu s'bën të bisedojmë më mirë të shihemi diku tjetër
vij në dhomën tuaj a jeni në hotel
jo s'është mirë kështu më mirë e dini atë urë atje te lumi i vogël atje pas
e po mirë dakord
në orën një
po
u nisa
ju falemnderit
dëgjoni
u ndala dhe u ktheva
a është shëndosh e mirë ajo
ai dukej si të ishte nga bronzi me atë këmishën e tij prej pambuku ngjyrë kafe
a mos i duhem gjë asaj
atje ju pres në orën një
ajo më dëgjoi kur i thashë T. P. që ta shalojë kalin Princ kah ora një ajo m'i çepi sytë sepse unë nuk haja aq tepër dhe m'u ngjit pas
ç'ke ndërmend të bësh
asgjë a s'bën të dal e të shëtis me kalë nëse më teket
ti po bluan diçka ke ndërmend të bësh diçka çfarë
s'është punë për ty lavire lavire
T. P. e kishte qitur Princin te dera e skajshme
s'më duhet kali dola të shëtis
zura të ecë shtegut pastaj dola nga dera u ktheva një rrugice dhe u vura në pikë të vrapit derisa arrita tek ura ku e pashë atë të përkulur për parmakun e urës ndërsa kalin e kishte lidhur diku afër në pyll u kthye të më shikonte pastaj e ktheu kurrizin dhe nuk më shikoi derisa arrita te ura dhe u ndala ai kishte marrë një kore të një lisi në duar dhe e grimconte atë kurse grimcat i hidhte nga parmaku i urës në ujë
erdha t'ju them që të largoheni nga qyteti
ai këputi një copë të kores dhe e hodhi me kujdes në ujë duke e vështruar sesi e rrëmbeu uji
ju thashë që të largoheni nga qyteti
ai më shikoi
a të dërgoi ajo te unë

unë ju them që të ikni ku sytë këmbët as im atë dhe askush tjetër nuk ma ka thënë këtë unë po ta them

dëgjo e paçim lënë këtë për më vonë tash dua të di se a është ajo shëndosh e mirë a mos i kanë rënë në qafë atje

s'është kjo punë për ju mos ia bani ju dertin

pastaj e dëgjova veten sesi i thashë se i jepja afat deri në perëndimin e diellit që të largohej nga qyteti

ai shkëputi edhe një copë të kores dhe e hodhi në ujë pastaj e la koren në parmak nxori një cigare tjetër e shtrydhi pak me ato lëvizje të shpejta të gishtërinjve dhe e ndezi çibritin për parmak

si ia bën nëse nuk e braktis qytetin

të vras mos kujto se s'të vras edhe pse të dukem si fëmijë

tymi i cigares po ngjitej në ajër nga flegrat e hundës së tij dhe nëpër fytyrën e tij si dy fjolla

sa vjeç je

duart filluan të më dridheshin aty në parmak dhe kujtova se në qoftë se i fsheh ai do ta dijë arsyen

afatin e ke deri sonte

dëgjo djalosh si quhesh ti Benxhi ishte ai idioti apo jo po ty si të thonë

Kuentin

goja ime foli, jo unë

ke afat deri në perëndimin e diellit

ai e hodhi shpuzën e cigares mbi parmak dalngadalë dhe me marifet si të ishte duke e mprehur ndonjë laps sakaq duart e mia nuk dridheshin më

dëgjo mos u hidhëro edhe aq ti nuk ke faj je çilimi mos të isha unë e kishte kapur ndonjë jaran tjetër

a ke pasur ti motër fol a ke pasur

jo ama ato të gjitha janë kurva

e godita me shuplakë të dorës desha t'ia këpusja edhe një grusht turinjve por dora e tij qe më e shpejtë se imja cigareja e tij fluturoi matanë parmakut unë u përpoqa ta godisja edhe me dorën tjetër por ai ima zuri edhe atë para se ta godisja dhe para se të kishte rënë në ujë cigarja e tij ai m'i kishte bërë zap të dy duart me një dorë kurse dorën tjetër e fut pas nën xhaketë aty në atë çast dielli vezulloi dhe një zog cërcëronte diku matanë diellit oe shikonim njëri-tjetrin ndërsa zogu nuk pushonte së cërcërituri ai m'i lëshoi duart

dëgjo

ai e mori përsëri atë koren nga parmaku dhe e flaku në ujë korja po vallëzonte sipër ujit dhe po notonte gjithnjë më tutje ndërsa dora e tij po mbante alltinë ne prisnim

s'mund të qëllosh tash

jo

ajo korja po notonte sipër ujit ndërsa në pyll kishte pllakosur heshtja megjithatë unë e dëgjoja ende atë zog dhe gurgullimën e ujit alltia u duk përsëri qëlloi ai nuk kishte marrë në shenjë fare mirëpo korja sipër ujit u zhduk pastaj copëzat e saj filluan të notonin sipër ujit ai shtiu edhe dy herë në copëzat e kores që nuk ishin më të mëdha se dollari i argjendtë

mjaft më

ai e hapi mullirin dhe i fryu në tytë alltisë prej saj doli një tym i dendur që u zhdavarit menjëherë ai përsëri i mbushi të tri vrimat me fishekë e ktheu mullirin në vendin e vet dhe ma zgjati alltinë me dorëzën kah unë

ç'më duhet nuk dua të matem me ty në qitje

do të të duhet si të mora vesh unë po ta jap këtë sepse ti pe me sytë e tu se ç'mund të bëj

ta marrtë lumi këtë allti

unë e godita përsëri gjithnjë përpiqesha ta godisja edhe pas atij momenti që m'i kishte shtrënguar duart mirëpo unë përpiqesha edhe më vonë ta godisja pastaj m'u duk se po e shikoja nëpër një copë xhami të ngjyrosur dhe e ndieja gjakun tim pastaj e pikasa qiellin përsëri dhe degët në të dhe diellin që po përvidhej mes degëve dhe atë që më mbante të mos rrëzohem.

a mos më qëllove

unë nuk dëgjoja

çka

po si ndihesh

mirë lëshomë

ai më lëshoi mirëpo unë u mbështeta për parmakun e urës

mos të ndodhi gjë

lermë të qetë se s'kam gjë

a mund të shkosh vetë në shtëpi mos të gjeti gjë

shporru lermë të qetë

mos shko këmbë merre më mirë kalin tim

hajt hiqmu sysh

lëshoja lirisht frerët lëre kalin se ai vetë të kthehet në stallë
lermë të qetë dhe hiqmu sysh lermë të qetë

u përkula prej parmakëve zura ta shikoj ujin dëgjova kur e zgjidhi kalin i hipi kalit dhe u nis e pas një copë herë unë nuk dëgjoja tjetër pos gurgullimës së ujit pastaj e dëgjova përsëri cërcërimën e atij zogut u nisa nga ura dhe u ndala afër një druri u mbështeta për të e ula kokën i mbylla sytë një rreze dielli m'i guduliste sytë prandaj bëra edhe disa hapa rreth drurit e dëgjova zogun përsëri dhe gurgullimën e ujit mandej gjithçka si të rrokullisej kështu që nuk ndieja më asgjë por ndieja si të isha mirë dhe si të më ktheheshin të gjitha ato ditë dhe net me erën e lulemustakut diku prej errësirës në dhomën time ku përpiqesha të flija edhe atëherë kur pas një copë here unë e dija se nuk më kishte qëlluar dhe se kishte gënjyer për hir të saj kurse unë isha trumhasur si ndonjë vajzë por as kjo nuk kishte rëndësi tash ndërsa isha i mbështetur për atë dru dhe ndërsa pikat e vogla të rrezeve të diellit ma gudulisnin fytyrën si gjethet e verdha në degë e dëgjoja gurgullimën e ujit dhe nuk mendoja për asgjë edhe atëherë kur dëgjova sesi po vinte një kalë me nxitim isha ulur aty me sy të mbyllur dhe dëgjoja si thundrat e tij po shkelnin me shushurimë nëpër rërë këmbët po i iknin me nxitim dhe duart po i iknin po kështu me nxitim

budalla budalla a mos u lëndove
i hapa sytë ajo ma prekte fytyrën

s'dija se ç'kish ngjarë derisa e dëgjova alltinë s'di se ku nuk mendoja se ai dhe ti do t'i hynit belasë unë nuk mendoja se ai do të

ajo e mbante fytyrën time mes duarve dhe e përplaste kokën time për dru

mos mos ashtu
e kapa për duarsh
mos pusho
e dija se s'do të bënte kështu e dija

ajo po rrekej ta përplaste kokën time për trungun e drurit

i thashë që të mos më flasë më kurrë që të mos flasë me mua

ajo rropatej t'i lironte duart
më lësho
mos unë jam më i fortë se ti më lësho

më lësho duhet ta zë atë dhe ta pyes më lësho Kuentin të lutem lëshomë

pa pritur e papandehur duart e saj u molisën

Po do t'i them unë do ta bind atë do ta detyroj

Kedi

ajo nuk e kishte lidhur Princin kurse ky mund të nisej në shtëpi kur t'i tekej

s'ka çare pa më besuar
a e do atë Kedi
çfarë

ajo më shikonte dhe në atë çast gjithçka u zbraz nga sytë e saj dhe ata dukeshin si sytë e zbrazët, të verbër dhe të kthjellët të një shtatoreje

prekma fytin

ajo ma rrëmbeu dorën dhe e mbështeti për fytin e saj

thuaj si quhej
Dalton Eims

ndjeva nën lëkurë vrushkullin e gjakut që po nxixonte me ritme të rrëmbyeshme

thuaj përsëri emrin e tij

fytyra e saj i shikonte drurët ku dielli po arrinte me rrezet e tij dhe ku zogu

thuaj përsëri
Dalton Eims

gjaku në fyt i nxitonte me ritëm kurse ritmi përplasej për dorën time

Gjaku i saj qarkulloi kështu për një kohë të gjatë, mirëpo, fytyra ime u ftoh dhe si të kishte vdekur, kurse syri im dhe ajo plaga në gisht si të më dhimbnin përsëri. Dëgjoja si Shrui merrte ujë te truma, pas një hopi u kthye me lavamanin dhe me një topth të muzgut që pehatej në një tis të verdhë si balloni që pëlcet pastaj pasqyrimi im. Përpiqesha ta shihja fytyrën time në të.

"A iu ndal gjaku?" tha Shrui. "Ma jep atë leckë" ai u mundua ta merrte nga dora ime.

"Ki kujdes", thashë unë, "Lërma mua. Po, tash i ndalet gjaku". Unë e laga leckën me ujë përsëri, duke e shpërthyer balonën. Lecka e ngjyrosi ujin. "Sikur të kisha një leckë të pastër".

"Të duhet një copë mishi gjedhe për këtë sy", tha Shrui...

"Nesër do të kesh syrin e nxirë e marrtë dreqi. Qen bir qeni", tha ai.

"Po unë, a e rraha ndopak?" E nxora shaminë e shpalosa dhe u përpoqa ta fshijë gjakun nga jeleku im.

"Nuk e fshin gjakun ashtu", tha Shrui. "Duhet ta dërgosh në pastrim kimik. Mbaje në sy këtë, ose nuk e mban".

"Pastroje disi", thashë unë. Mirëpo kot e kisha. "Si e kam jakën?"

"S'di", tha Shrui. "Mbaje kështu në sy. Ashtu".

"Shiko", thashë unë. "Lerma mua. A e qëllova edhe unë?"

"Ndoshta e ke qëlluar. Mund të shihja mirë ose ndoshta edhe i kapsallitja sytë më duket. E po të paska prishur. Të paska zhdëpur. Pse u rroke me të me grushta? Mor i krisur. Si i ke hallet tash?"

"Jam shumë mirë", thashë unë. "S'di si mund ta pastroj këtë jelek".

"Oh, lëri tash teshat. A mos të dhemb syri?"

"E po s'kam gjë", thashë unë. Çdo gjë më dukej ngjyrë vjollce dhe e qetë, qielli i gjelbër dhe i zbehur matanë kulmit merrte një ngjyrë të arit, kurse një fjollë e tymit po ngritej nga oxhaku pa u trazuar nga era. Përsëri e dëgjova trumën e ujit. Dikush po mbushte një kovë me ujë dhe po na shikonte nga truma. Një grua kaloi para derës, mirëpo nuk na diktoi. Unë dëgjova një lopë që po pëlliste diku.

"Hajde", tha Shrui, "hiqu tash teshave po mbaje atë leckë në sy. Nesër herët në mëngjes t'i çoj teshat në pastrim kimik".

"E po mirë. Më vjen keq që s'ia paskam thyer turinjtë".

"Qen bir qeni", tha Shrui. Spoudi doli nga shtëpia dhe u ndal të bisedonte me një grua më duket pastaj kaloi nëpër oborr. Ai më shikonte me ata sytë e tij të ftohtë dhe përqeshës.

"Ani jaran", tha ai duke më shikuar, "të marrtë dreqi të marrtë, gjithnjë e lyp belanë. Më parë grabit një vogëlushe pastaj shkon e rrahesh, po gjatë pushimeve verore ç'bën a thua? A mos i djeg shtëpitë?"

"S'kam gjë, jo", thashë unë. "Çfarë tha zonja Blland?"

"Ajo është zënë me Xheraldin dhe nuk i la gjë pa i thënë për shkak se të rrahu ty. Do të të qortojë edhe ty ngaqë i lejove të të fshijë përpara. Ajo nuk është kundër përleshjes, mirëpo gjakun nuk mund ta shohë me sy. Ja ku të them se ke humbur

namin para syve të saj ngase je përgjakur. E po tash si i ke punët?"

"Mirë", tha Shrui, "Në qoftë se s'mund të jesh i familjes Blland, atëherë e mira e së mirës është që të bësh ndonjë pisllëk, të dehesh ose të rrahesh me dikë ashtu si bëre ti".

"Ashtu është", tha Spoudi. "Mirëpo unë nuk dija se Kuentini kishte qenë i dehur".

"Jo s'ka qenë i dehur", tha Shrui. "A mos duhet të jesh i dehur që të kesh dëshirë për ta goditur atë qen bir qeni?"

"Paj, për të bërë një gjë të këtillë duhet të bëhem tapë sidomos pasi e pashë se çka e kishte gjetur Kuentinin. Ku mësoi të boksojë a thua?"

"Shkonte te Majku gati përditë atje në qytet", thashë unë.

"Me të vërtetë?" tha Spoudi. "A e dije ti këtë kur e qëllove?"

"S'di", thashë unë. "Po më duket. Po".

"Lage përsëri atë leckë", tha Shrui. "Mos deshe pak ujë të freskët?"

"Mirë e kam këtë", thashë unë. E futa leckën përsëri në ujë pastaj e vura në syrin tim. "Sikur të kisha diçka për ta pastruar jelekun". Spoudi më shikonte ende.

"Hej", tha ai, "Pse e godite? Çka të tha ai?"

"S'di. S'di pse e qëllova".

"Më kujtohet kur të pashë si i kërceve papritmas duke i thënë, "A ke ti motër? A ke?" Dhe kur ai të tha jo, ti e prite grusht. Pashë si e shikoje pa ndarë, mirëpo s'ia vare veshin askujt po i kërceve dhe e pyete se a kishte motra".

"Ah, shiste mend si zakonisht", tha Shrui, "llomotiste për femra. E dimë: se si ai, para vajzave të tij, para dashnoreve, s'di si t'ia bëjë ngaqë ato nuk e marrin vesh. Ato pallavrat e tij dhe gënjeshtrat e këtilla që s'kanë kurrfarë kuptimi. Na kallëzonte për njëfarë hallajke me të cilën kishte caktuar një takim në sallën e ballos në Atlantik Siti sesi e kishte mashtruar atë dhe kishte shkuar me të në hotel pastaj ishin shtrirë në shtrat mirëpo atij i kishte ardhur keq për të e kishte lënë vetëm që ajo ta priste në molo, kurse ai nuk kishte shkuar për t'i dhënë ato që kërkonte ajo. Na fliste për bukurinë e shtatit dhe gjeja se i ardhka keq për fundin e keq të tyre, na fliste për atë se sa shumë ua ka ënda femrave atë punë duke na thënë se ato gënjejnë gjithmonë. Ai na ishte si në mitologji Leda pas drizave, duke cfilitur dhe duke psherëtitur për mjellmën. Ai qen bir

qeni. Do ta fshija edhe unë me grushta. Veçse unë do ta qëlloja me shportën e verës mu në turi".

"Oh", tha Spoudi, "mbrojtësi i damave. Dashamir, ti ndjell jo vetëm admirim por edhe tmerr". Ai më shikoi me sytë e tij të ftohtë dhe përqeshës. "Zoti të shëroftë", tha ai.

"Më vjen keq që e qëllova", thashë unë. "A mos dukem se jam bërë për ibret a duhet të kthehem e të flas me të?"

"T'i kërkosh ndjesë, e marrtë lumi", tha Shrui, "Le t'i marrë dreqi. Ne po shkojmë në qytet".

"Ky duhet të kthehet në mënyrë që tërë bota le ta dijë se rrahet si burrë", tha Spoudi. "Le të hajë dajak si tash".

"Si tash?" tha Shrui, "Me petka të përgjakura?"

"E po, ç'e do", tha Spoudi. "E di edhe vetë këtë"

"Nuk mund të vijë me ne me fanellë", tha Shrui, "Nuk është ende absolvent. Hajde, të shkojmë në qytet".

"Mos eja me ne", thashë unë. "Shko më mirë në piknik".

"Le t'i marrë dreqi", tha Shrui. "Eja këtu".

"Ç'tu them atyre?" tha Spoudi. "Tu them se ti e Kuentini u rrahët?"

"Mos u thuaj asgjë", tha Shrui. "Thuaji asaj se afati i zgjedhjes së mysafirëve nga ana e saj kalon me perëndimin e diellit. Hajde, Kuentin. Ta pyes atë grua ku është stacioni më i afërt i tramvajit."

"Jo", thashë unë, "Unë nuk do të kthehem në qytet".

Shrui u ndal duke më shikuar. Duke u kthyer, syzet e tij dukeshin si hëna të vogla e të verdha.

"E po si po ia bën".

"Unë nuk do të kthehem në qytet. Ti shko në piknik. Thuaju se unë nuk vij ngaqë rrobat i kam të papastra".

"Dëgjo", tha ai, "Ç'ke ndërmend të bësh?"

"Kurrgjë. S'kam asgjë. Ti dhe Spoudi kthehuni. Shihemi nesër". U nisa kah oborri pastaj dola në rrugë.

"A e di ti se ku është stacioni?" tha Shrui.

"E gjej. Shihemi nesër. Thuaji zonjës Blland se më vjen keq që s'mam pjesë në ndejën e saj". Ata më vështronin. Unë u vërtita rreth shtëpisë. Një shteg i shtruar me gurë ngjitej me rrugën. Nga të dy anët e shtegut kishte trëndafila. Dola nga dera dhe iu ngjita rrugës. Ajo shkonte tatëpjetë kodrës.

Kish dritë elektrike në tramvaj; kështu që derisa kalonim mes drurëve unë mund ta shihja vetëm fytyrën time dhe një

grua kundruall me një kapelë në majë të kokës, me një pupël të thyer në të, sakaq si i kaluam drurët përsëri mund ta pikasja muzgun, atë lloj drite kur të duket se koha me të vërtetë është ndalur për një copë herë, me diellin e lëvarur nën horizont, paskëtaj kaluam edhe strehën ku ai plaku hante diçka nga një qese, ndërsa rruga të çonte më tutje nën muzg në muzg, ndërsa matanë e ndieje ujin e qetë po edhe të rrëmbyeshëm. Tramvaji nxitonte edhe më tutje, kurse nga dera e hapur turrej një korrent ajri që e mbushi tërë tramvajin me erën e verës, dhe të errësirës, pos jo të lulemustakut. Unë mendoj se era e lulemustakut është era më e pikëlluar se çdo erë tjetër. Më kujtohen shumë erëra. Fjala vjen e luleviles. Kur mamës iu desh të mbetej e shtrirë në krevat, Dilzi na i vishte petkat e vjetra dhe na linte të bridhnim në shi ngaqë si thoshte ajo shiu s'u bënte asnjë të keqe fëmijëve. Mirëpo, nëse ngrihej Mama ne loznim në verandë derisa s'na qortonte dhe s'na thoshte të mos bënim zhurmë, me ç'rast ne dilnim dhe loznim nën tendën e luleviles.

Atëherë atë mëngjes aty unë e pashë lumin për herë të fundit. Mund ta ndieja, ta kundërmoja ujin nga muzgu. Kur në pranverë çelnin lulet dhe kur çapuriste shiu, aroma e lules përhapej kudo, ndonëse këtë s'e vije re në kohët e tjera ama kur binte shiu, aroma sa vinte futej në shtëpi buzë muzgut ose në muzg fillonte të binte shi si rrëke apo atëherë kishte diçka te drita, mirëpo atëherë gjithmonë aroma gjithsesi ishte më e fortë, kështu që unë i dehur me aromë shtrihesha në krevat dhe e vrisja mendjen se kur do të pushonte shiu. Korrentit të ajrit te dera i vinte era e ujit, ishte ajo një zallahi e lagësht. Ngandonjëherë më zinte gjumi duke e përsëritur atë pa pushim derisa s'më bezdiste era e lulemustakut e cila bëhej për mua simboli i natës dhe i shqetësimit, ndërsa mua më dukej se rrija i shtrirë as në ëndërr as në zhgjëndërr duke vështruar tatëpjetë një korridori të gjatë me dritë gjysmë të errësuar ku çdo gjë e sigurt ç'bëhej dhe shndërrohej në një gjë paradoksale e të hijesuar, gjithë ç'kisha bërë, bëhej hije, të gjitha ndjenjat dhe vuajtjet e mia merrnin trajtë të dukshme antike dhe përbuzjeje perverze pa atë rëndësinë e tyre karakteristike, nuk e kishin atë domethënien të cilën lypsej ta kishin, ndaj unë pandehja se unë isha ai që nuk isha i cili nuk isha nuk isha.

Ua merrja erën leqeve të lumit matanë muzgut dhe i pikasja rrezet e mbrame të dritës të cilat të plogështa e të qeta,

pushonin në rërën e grumbulluar nën ujë si ndonjë copë e pasqyrës së thyer, kurse përtej ishin ndezur dritat në ajrin e pastër e të venitur që dridhëtonte si ndonjë flutur e cila në dehjen galduese flutturon atje tej. Benxhamin, mor djalë. Sa me qejf rrinte para asaj pasqyre. E kishte përherë skutën e fundit ku zbutej çdo konflikt i tij, ku shutitej dhe harrohej çdo brengë e tij. Benxhamin, fëmijë e pleqërisë sime, i mbetur si peng në Egjipt. O Benxhamin. Dilzi thotë se kjo ka ngjarë meqë Nëna mburrej së tepërmi me të. Ata hyjnë në jetën e të bardhëve me pikëla të vrullshme të mprehta dhe të zeza që i izolojnë faktet e bardha për një hop, i nxjerrin të vërtetat e pamohueshme si nën ndonjë mikroskop; herave të tjera, janë këto zëra që qeshen kur s'ka asgjë për të qeshur dhe lotët derdhen atëherë kur s'ka arsye për të derdhur lot. Ata do të vënë bast për atë se a ka numër tek apo çift të përcjellësve në funeral. Në një shtëpi publike në Memfis të gjitha prostitutat zezake i kishte kapluar një fanatizëm fetar, kështu që kishin dalë vrapimthi në rrugë të zhveshura cipricullak. Vetëm njërën mezi e kishin bërë zap tre policë. Po o Jezu O ti njeri zemërbardhë Jezu O ti njeri i mirë.

Tramvaji u ndal. Unë dola, ndërsa të gjithë e shikonin syrin tim. Kur erdhi tramvaji tjetër, ai ishte plym. Unë ndodhesha në platformën e pasme.

"Ka vende të lira përpara", tha konduktori. Shikova rreth e rrotull. Në anën e majtë nuk kishte ndenjëse të lira.

"S'po shkoj larg", i thashë. "Më parë do të qëndroja këtu".

E kaluam lumin. Ura, ngrihej ngadalë po edhe lart në hapësirë, mes heshtjes dhe hiçit ku dritat — të verdha, të kuqe dhe të gjelbra — po dridheshin në ajrin e pastër pareshtur.

"Më mirë shkoni përpara dhe uluni", më tha konduktori.

"Së shpejti zbres", thashë unë. "Pas disa blloqeve të ndërtesave".

Zbrita para se të arrinim në postë. Mbase të gjithë ata janë ulur bashkë tash diku, në atë çast e dëgjova orën time dhe zura t'ia përgjoj tiktakun ndërsa nën pallto e preka letrën e Shruit teksa hijet e plasaritura të vidheve po vallëzonin në dorën time. Dhe kur u nisa në oborrin e shkollës, në kambanare me të vërtetë filloi të binte ora, ndërsa unë vazhdova të ecë, kurse tingujt arrinin si rrathët e valëve të ujit në gjol, kalonin vrik pranë meje duke thënë Pa një çerek? Shumë mirë. Pa një çerek.

Dritaret tona ishin të errëta. Hyrja ishte e zbrazët. Po ecja

afër murit të majtë dhe si hyra, pashë se ishte e zbrazët: vetëm shkallët spërdridheshin në errësirë në hije, ndërsa nëpër to jehonin hapat e brezave të pikëlluar si pluhuri i imët i rënë në hije që e shpupurisnin hapat e mi, si pluhuri që fill pastaj qetësohet përsëri.

E pashë letrën para se ta ndizja dritën, ishte e mbështetur për një libër në tavolinë me qëllim që ta pikasja menjëherë. Ata e quanin burri im. Atëherë Spoudi tha se po shkonin dikah dhe se nuk do të kthehej deri vonë, kurse zonjës Blland do t'i duhet kavalier i ri. Mirëpo, unë duhej të shihesha me të, ndërsa ai për një orë nuk do të ketë tramvaj tjetër, ngaqë ora gjashtë kishte kaluar. E nxora orën time dhe fillova ta dëgjoj tiktakun e saj duke mos ditur se s'do të mund të gënjente. Pastaj e lashë në tavolinë me xhamin e kthyer përpjetë, pastaj e mora letrën e zonjës Blland dhe e bëra copë e çikë, copëzat i hodha në shportën e letrave, mandej i zhvesha pallton, jelekun, jakën. kravatën dhe këmishën. Edhe kravatën e kisha të ndrangosur, por, me ato njolla të posaçme, me njolla të tilla gjaku çfarë pat edhe Krishti. Në dhomën e Shruit gjeta benzinë, ndaj e shtriva jelekun dhe e hapa shishen e benzinës.

automobili i parë në qytet vajza Vajza Xhesoni nuk mund ta duronte erën e benzinës iu morën mendtë mandej u xhindos sa s'ka më keq ngase vajza Vajza nuk kishte motra pos Benxhaminit Benxhaminit djalit të pikëllimit tim po të kisha nënë atëherë do të mund të thosha Nëno Nëno M'u desh të përdor shumë benzinë kështu që pastaj nuk dija në ishte ende aty njolla apo ndoshta jeleku ishte bërë vetëm me benzinë. Plaga filloi të më dhimbte përsëri dhe kur u nisa t'i shpëlaja duart e vara jelekun për karrige dhe e ula llambën elektrike duke shpresuar se ajo do ta thante njollën. I lava duart dhe fytyrën, mirëpo ëra i vinte gjithnjë, ndonëse sapuni më digjte pak dhe m'i shtrëngonte flegrat e hundës. Atëherë e hapa valixhen dhe nxora nga ajo një këmishë të pastër, jakën dhe kravatën, kurse brenda i palosa rrobat e përgjakura, e mbylla valixhen dhe u vesha. Teksa po krihesha, ra gjysmë ore. Mirëpo, kishte kohë deri në tre çerekë, pos nëse rastësisht *vura re në errësirën e dendur vetëm fytyrën e tij nuk kishte pupla të thyera pos nja dy puplave por as ato dyja nuk ishin si ato të Bostonit atë mbrëmje atëherë fytyra ime fytyra e tij sa çel e mbyll sytë me krismën e papritur kur nga errësira dy dritare me dritë*

me rrëmbim u përplasën fytyra e tij ■ zhduk u zhduk edhe fytyra ime shi tash shoh pashë a kam parë pa u ndarë nën atë strehë asnjeri s'ba më rruga e shkretë në errësirën e qetë ura i ka ngritur harqet në heshtje errësirë gjumë uji i qetë i rrëmbyeshëm s'ka lamtumirë

E fika dritën dhe hyra në dhomën e fjetjes, larg nga era e benzinës, ndonëse ende kundërmonte era e saj. Qëndroja te dritarja perdet lëvizën ngadalë nga errësira duke e prekur fytyrën time si të prek dikush me dihamën e tij në gjumë duke e lënë në mua erën e dihamës së tij. *Si shkuan ata në katin e sipërm, Nëna mbeti e mbështetur në karekllën e saj, ndërsa në gojë e kishte shaminë e lyer me komfor. Baba akoma s'kishte lëvizur nga vendi ai ishte ende i ulur pranë saj duke ia mbajtur duart ulurima po tretej si të mos kishte më vend për të në qetësi.* Kur qeshë i mitur, në një libër tonin ishte një vizatim, njëfarë vendi i errët ku një rreze e dobët e dritës binte pjerrtazi në dy fytyra që ishin ngritur nga hija. *E di ti se Ç'do të bëja po të isha mbret?* Ajo s'kishte qenë kurrë as mbretëreshë as zanë, ajo gjithmonë kishte qenë mbret ose div ose gjeneral. *Unë do t'i shembja muret e këtij burgu, do t'i qitja jashte ata dhe do t'ua bëja shpinën më të butë se barkun* Kështu burgu shembej, bëhej hi e shpuzë. Më vinte mirë. Ngase, përndryshe do të duhej ta shikoja pa ndarë të atillë, derisa burgu të mos shndërrohej në Nënën time, ajo me Babain — atje lart nën dritën e zbehtë duke u mbajtur për dore, kurse me nën ta pa asnjë rreze drite. Në atë çast ia behu era e lulemustakut. Me ta shuajtur dritën dhe u orvata të flija era zuri të depërtonte në dhomë gjithnjë e më me hov valë-valë të cilat sa vinin e po rriteshin kështu që unë fillova të dridhesha e të mundohesha të merrja frymë, ndaj edhe çohesha dfoe bëja ecejake nëpër dhomë ashtu si atëherë kur isha çilimi *duart mund të shohin edhe shpirtin mund të bëjnë trajta dera e padukshme Dera tash duart s'janë në gjendje të shohin asgjë prej gjëje.* Hunda ime shihte benzinën, jelekun në tavolinë, derën. Korridori akoma ishte i boshatisur nuk ishin më gjithë ata hapa të brezave të pikëlluar që kërkonin ujë *megjithatë sytë që nuk shohin ishin stisur si dhëmbë s'është se janë të pabesë po për më tepër të dytë në mungesë të dhemb nyja gjuri i gjatë rrjedhë e padukshme e kangjellave të shkallëve ku merr në thua në errësirën plym me gjumë Nëna Babai Kedi Xhezon Mori kishin rënë në gjumë aq të thellë unë do ta zija*

veshin do të flija që ç'ke me të kur unë dera Dera dera Të zbrazta ishin edhe gypat, porcelani, muret e papastra, të ngurta, froni i vëzhgimit. Gotën e kisha harruar por mund të *duart mund të shohin gishtërinjtë e ftohur nga qafa e mjellmës së padukshme ku s'të hyn më në punë bastuni i Moisiut — ta kërkosh gotën duke kërkuar me gishtërinj të kesh kujdes sesi i rrekton damari në qafën e ftohtë e të zhdërvjellët flladi i metalit gota e mbushur e stërmbushur ftohja e gotës gishtërinjtë e trembin ëndrrën dhe lënë shijen e gjumit me zagushi në heshtjen e gjatë të gërmazit.* U ktheva korridorit duke i zgjuar në ecje e sipër hapat e tretur të batalionave që çuçurisnin në heshtje, përsëri ia "behu kundërmima e benzinës, kurse ora në tavolinën e errët e rrëfente gënjeshtrën e saj të lemerítshme. Në atë çast perdet që dihatnin nga errësira në fytyrën time, e linin frymën e tyre në fytyrën time. Edhe një çerek ore. Paskëtaj, s'do të jem më. Ato fjalë më të qeta. *Fjalët më të prajshme.* Njëherë diku i pata dëgjuar kambanat. Më Misisipi apo në Masaçusets. Qeshë. S'jam më. Në Masaçusets apo në Misisipi. Shrui ka një shishe në valixhe. *A s'do ta hapësh më atë* Zoti Xhezon Riçmond Kompson me zonjën bashkëshorte shpallin *Tri herë. Ditët. S'do ta hapësh atë virane* se bija ■ tyre Kendasë lidh kurorë *ajo pije* e fortë të bën t'i ngatërrosh mjetet *me qëllimin.* Po, jam. Pi. Nuk qeshë. Ta shesim livadhin e Benxhit në mënyrë që Kuentini të regjistrohet në Universitetin e Harvardit, kurse unë të mund të trokas me eshtrat e mi të gjalloj disi. Do të vdes një ditë. Më duket se Kedi tha brenda një viti. Shrui ka një shishe në valixhe. Zotëri mua s'do të më nevojitet shishja e Shruit unë e kam shitur livadhin e Benxhit dhe ka të ngjarë të vdes në Harvard Kedi tha në shpellat dhe zgërbonjat e detit duke u përkundur qetë-qetë sipas ritmit të baticës dhe zbaticës nga që emri i Harvardit kumbon për bukuri dyzet

nuk është çmim i lartë për një emër aq kumbues. Fjalë kumbuese morte do ta këmbejmë livadhin e Benxhit për një fjalë kumbuese morte. Do t'i mbetet për një kohë të gjatë ngaqë ai s'është në gjendje ta dëgjojë pos nëse ia merr erën *me të hyrë ajo nga dera ai ia plasi vajit* Unë pandehja se ai ishte një ndër spitullaqët e qytetit që ia përmendte Babai duke e qesëndisur derisa. Në të nuk shija tjetër pos një pramatar të zakonshëm ose diçka të tillë unë mendoja se ai merrej me shitjen e këmishave ushtarake derisa papritur e papandehur s'e pata të qartë se ai

as që më pandeh për shkaktarin eventual të belave, po mendtë i kishte te ajo ndërsa më shikonte më shikonte përmes saj si nëpër një copë qelqi të ngjyrosur *pse i fut hundët në punët e mia po a s'di ti se s'ia sheh hairin kësaj pune unë pandehja se ti do të heqësh dorë nga ajo për hir të Nënës dhe Xhezonit*

mos i tha Nëna Xhezonit që të të përgjojë unë s'do ta bëja këtë

Gratë i përdorin vetëm kanunet e huaja të nderit ajo vepron asisoj ngaqë e do Xhezonin duke mbetur atje poshtë edhe kur nuk ndihej mirë vetëm e vetëm që Babai të mos mund ta gërgasë Xha Morin para Xhezonit Babai tha se Xha Mori ishte një klasik aq i dobët saqë s'do t'ia mbante të matej me atë djalë të verbër po të pavdekshëm ai do të duhej do të lypsej ta zgjedhë Xhezonin ngaqë Xhezoni do t'i bënte gabimet e njëjta Xha Mori kurrë nuk do të bënte të tilla gabime dhe as që do ta kishte syrin e nxirë për gabimin e bërë Patersoni i vogël ishte më i vogël se Xhezoni ata dy i shitnin xhitat e letrës për pesë senca një copë derisa s'ndodhën ato telashe financiare atëherë Xhezoni zuri një jaran të ri më të vogël se Patersoni sido që të jetë ishte tepër i vockël ngaqë T. P. tha se Xhezoni qenka ende arkatar mirëpo Babai tha pse të punojë Xha Mori kur vetë Babai mund të mbante pesë gjashtë zezakë të cilët s'punojnë fare po vetëm ulen dhe i ngrohin këmbët afër stufës s'do mend në mënyrë që pastaj, hera-herës, t'i japë banesë dhe ta ushqejë Xha Morin dhe t'i japë disa para hua atij i cili pa ndarë me atë afsh fisnik e ysht besimin e Babait të tij në prejardhjen hyjnore të fisit dhe të brezit të tij në raste të tilla Nëna ngaherë qante dhe thoshte se si Babai pandeh se familja e tij është më e mirë se e saja ndaj e përqeshte Xha Morin dhe se kjo na lë të kuptojmë edhe neve si është puna kurse ajo nuk mund të kuptojë sepse Babai ynë na edukon ngaqë thotë ajo të gjithë meshkujt janë grumbuj kukullash të mbushura me blozhurinë të mbledhur me fshesë nga bërlloku ku ishin flakur të gjitha kukullat e mëparshme me atë blozhurinë e cila kishte dalë nga ndonjë plagë në ndonjë ije që s'e kishte parë vdekjen për mua nuk kishte parë. Dikur vdekjen e përfytyroja si njeriun disi si gjyshin tim si të qe ai miku i tij miku i tij i ngushtë shi ashtu si e përfytyronim edhe tavolinën e gjyshit nuk na mbante ta çiknim me dorë bile as që flisnim me zë të artë në odën ku gjendej ajo tavolinë unë gjithmonë i parafytyroja kurdoherë ata

dy se tërë kohën ndodhen diku bashkë dhe se e presin kolonelin plak Sartoris që të zbriste dhe të ulej me ta e prisnim në kodrën pas kodrës Koloneli Sartoris ndodhej në një vend edhe më të lartë në breg dhe shikonte diçka atje larg ndërsa ata e presnin derisa të merrte lodhej së shikuari dhe të vinte tek ata Gjyshi e mbante uniformën e vet dhe mund të dëgjohej nënëritjen e zërave të tyre andej pas kedrave gjithnjë po bisedonin për diçka ndërsa Gjyshi ngaherë kishte të drejtë.

Zuri të binte ora tri të katërtat. Rënia e parë jehoi me përmbajtje dhe me kumbim me një vendosmëri të freskët duke e zbrazur qetësinë e ngadalshme për trokitjen tjetër të orës dhe duket se njerëzit mund ta zëvendësojnë njeri-tjetrin përherë në këtë mënyrë, për t'u zhdukur si flaka që shpërthen me vërtik dhe me rrëmbim që të shuhet tërësisht në errësirën eterne dhe të ftohtë, në vend që të rrinë aty dhe të rreken ta harrojnë Shrregullën derisa të gjithë kedrat të përhapin atë erë të rëndë mortore të cilën Benxhi nuk e honepste dot. Kur në imagjinatën time e përfytyroj zabelin më bëhet se po e dëgjoj përshpëritjen e epshit të fshehtë si t'ia ndieja erën e hovit të gjakut të nxehtë nën mishin e çakërdisur po jo të fshehtë si të vështroja pas kapakëve të kuq sesi derrat në çifte i sulen detit duke u ndërsyer lypset mbetur zgjuar dhe duhet parë sesi ndodh e keqja vetëm pak nuk ndodh kjo gjithmonë unë për një njeri që ia mban nuk i duhet një kohë e gjatë ai këtë ti e quan guxim unë po gjithsesi pse ti nuk e quan guxim këtë ai secili është gjykatës i virtyteve të veta në konsiderohet ndonjë akt akt i guximshëm apo jo është më me rëndësi se vetë akti se çdo lloj akti tjetër pa të s'ka seriozitet unë ti s'beson se unë e kam me gjithë mend ai unë jam i mendimit se ti mendon tepër seriozisht ndaj s'më jep arsye për bezdisje përndryshe nuk do të ndieje nevojën që të matesh në dinakëri dhe të më tregosh sesi ke bërë incest unë nuk kam gënjyer nuk kam gënjyer ai ti ke dashur që një marri të zakonshme njerëzore të ngresh deri në ndonjë lemeri e pastaj t'i shmangesh me të vërtetën unë këtë e bëra me qëllim që ta ndaj nga bota buçitëse kështu që bota të na evitojë patjetër ndërsa jehona e saj do të ishte sikur të mos kishte ngjarë asgjë ai a je përpjekur ta kandisësh që të veprojë ashtu unë kisha frikë kisha frikë se do të pajtohej kurse nga ajo s'do të kishte kurrfarë dobie ndërsa unë mendoja se kur të them ty se ne të dy kemi bërë incest kjo do të jetë punë e sigurt

kështu të tjerët do të besojnë e pastaj gjindja do të shpërndahen duke britur dhe duke u çirrur ai sa për të tjerët ti nuk gënjen as tash po ti je ende i verbër ndaj asaj që ke ti ndaj asaj pjese të së vërtetës së përgjithshme ndaj rrjedhës së ngjarjeve të natyrshme dhe të shkaqeve të tyre ndërsa një gjë e tillë ia errëson ballin secilit madje edhe Benxhit ti nuk mendon në fundin ti pret ndonjë apoteozë në të cilën gjëllimi i kufizuar kohor i njeriut do të ngritet simetrikisht mbi mishin me ç'rast ti nuk do të flakesh tërësisht përkundrazi nuk do të jesh as krejtësisht i vdekur unë do të jem i përkufizuar me kohë ai ti nuk mund ta marrësh me mend se një ditë nuk do të vuash më ashtu si vuan tash arritëm te e vërteta duket se ti atë fazë e heq vetëm si një përjetim të zakonshëm të zakonshëm si një ngjarje për shkak të së cilës do të të thihen flokët për një natë ndërsa pamja jote e jashtme thuaja s'do të ndërrojë fare ti s'do t'i bësh këlto në kushte të tilla ajo do të jetë një lojë fati njëfarë hazardi është çudi sesi njeriu i cili rastësisht zë fill dhe për të cilin çdo dihamë është një hedhje e re e zareve që qysh më parë është hedhur kundër tij nuk ka vullnet të ballafaqohet me hedhjen e fundit për të cilën di që më parë se do të duhet të konfrontohet me të para se të provojë marifetilëqe të ndryshme qoftë dhunën qoftë llomotitjet e tjerrjet e gjata me fjalë që nuk mund të mashtrojnë as fëmijën e marrë derisa një ditë prej ditësh i mbushur me neveri të verbër mos të mbështetet vetëm në një letër dhe asnjeri nuk e bën këtë në turrin e parë të tërbuar të dëshpërimit të brejtjes së ndërgjegjes apo të pikëllimit për shkak të humbjes ai e bën këtë vetëm atëherë kur e ka të qartë se as ai dëshpërim as ajo brejtje e ndërgjegjes as ai pikëllim nuk janë shumë me rëndësi për bixhozxhiun e zymtë unë i kufizuar kohësisht vështirë është të besosh se dashuria ose dhimbja janë vetëm kambiale që blehen pa ndonjë plan dhe që ia behin deshe ti apo s'deshe dhe nga të cilat mund të heqesh dorë pa ndonjë paralajmërim paraprak që të zëvendësohen me lloj-lloj letrash që i lëshojnë perënditë rastësisht dhe në atë çast në qarkullim në treg jo ti s'do ta bësh këtë derisa të mos e kesh të qartë se as ajo nuk ka merituar gjithë atë vuajtje ndoshta unë unë s'do të bëja kurrë diçka të tillë asnjeri s'di atë që di unë ai unë mendoj se e mira e së mirës është që ti të shkosh menjëherë atje në Kembrixh ndoshta mirë do të qe të shkosh për një muaj edhe në maine ti mund të shkosh vetëm nëse je

kursimtar ndoshta kjo do të qe një ide e mrekullueshme vigjilenca e parave ka shëruar më shumë plagë se Jezui unë ç'ndodh nëse unë e parashikoj atë që ti mendon se do të parashikoj atje javën tjetër apo muajin tjetër ai atëherë do të të kujtohet sesi që nga lindja jote nëna të ka ëndërruar se ti do të shkosh në Harvard ndërsa asnjë Kompson nuk ka zhgënjyer deri tash ndonjë damë unë përkohësisht do të jetë më mirë për mua për të gjithë ne ai secili është gjykatës i virtyteve të veta por asnjeri të mos ia mvesh tjetrit mirëvajtjen e vet unë provizorisht ai kjo është fjala më trishtuese nga të gjitha përndryshe asgjë nuk ka në botë nuk ka dëshpërim deri në kohë nuk ka as kohë derisa të mos mund të thuash se ka pasur kohë

U dëgjua edhe trokitja e fundit e orës. Më në fund jehona pushoi ndërsa errësira përsëri u bë memece. Hyra në sallonin tonë dhe e ndeza dritën. E vesha jelekun. Tash benzinës nuk i vinte aq era, mezi që i vinte era, ndërsa në pasqyrë nuk dukej më njolla e përgjakshme. Sidoqoftë, jo aq sa syri im. E vesha pallton. Letra e Shruit po fëshfëriste në pallto prandaj nxora ia shikova adresën mirëfilli dhe e futa në xhepin përanash. Pastaj e çova orën në dhomën e Shruit dhe e futa në çekmexhen e tij dhe shkova në dhomën time mora një peshqir të pastër iu afrova derës dhe e preka çelësin e llambës. Atëherë m'u kujtua se nuk i kisha larë dhëmbët ndaj m'u desh ta hap përsëri valixhen time. E gjeta brushën e dhëmbëve e mora pak pastën e dhëmbëve të Shruit dola dhe i lava dhëmbët. E tera brushën duke e shtrënguar me tërë fuqinë e lashë përsëri në valixhe e mbylla dhe u nisa sërish kah dera. Para se ta shuaja dritën u ktheva të shoh në kishte gjë tjetër dhe vura re se përsëri e kisha harruar kapelen. Do të duhet të kaloj pranë postës dhe me siguri do të takohem me ndonjërin ndër ta kurse ata do të pandehin pastaj se unë jam një ndër ata studentë tipikë të Harvardit i cili pozon e shtiret si të ishte student i vitit të katërt. Harrova ta pastroj kapelen, mirëpo, meqë Shrui kishte një furçë, s'ishte nevoja ta hapja valixhen edhe njëherë.

6 prill, 1928

Si bëhet kurvë femra, mbetet kurvë përgjithmonë, ja ku ju them. Unë them po ashtu se do të jesh i lumtur nëse ajo të brengos vetëm për arsye se ikën nga shkolla. Unë jam i mendimit se ajo duhet të vijë këtu në kuzhinë menjëherë, në vend që të mbyllet në dhomën e saj, duke u lyer me pomadë dhe duke pritur që të vijnë të gjashtë zezakët të cilët as që luajnë nga vendi nëse nuk e rrasin barkun me bukë dhe me mish, që t'ia përgatisin asaj mëngjesin. Ndërkaq nëna thotë,

"Po të mendojë drejtoria e shkollës se unë nuk mund ta kontrolloj atë, se unë nuk mund të —"

"Paj", them unë, "Ti s'mund ta kontrollosh, apo jo? Ti nuk je orvatur kurrë të interesohesh për të", them unë, "Çka kujton ti, si mund të ndikosh në të kaq vonë kur ajo tashmë i mbushi të shtatëmbëdhjetat?"

Ajo mendoi për një copë kohë.

"Por, merre me mend nëse mendojnë se... Unë nuk dija fare se kishte dëftesë shkollore. Ajo më tha vjeshtën e shkuar se sivjet nuk kishte dëftesa. E tash profesor Xhankini më thërret me telefon dhe më thotë se po qe se mungon edhe një herë, ajo do të jetë e detyruar të mos vijë më në shkollë. Si guxon të sillet kështu? Kah ia mban athua? Ti rri në qytet gjithë ditën e lume; duhet të kujdesesh e të shikosh se mos bredh nëpër rrugë".

"Po", them unë, "Nëse bredh nëpër rrugë. S'ma merr mendja se ikën nga shkolla për të bërë diçka që do të mund të bënte publikisht", them unë.

"Ç'do të thuash me këto fjalë?" thotë ajo.

"Kurrgjë", them unë. "T'u përgjigjem në pyetje". Në atë çast ajo ia plasi vajit dhe filloi të fliste se si i kishte rënë mallkimi nga vetë gjaku i saj, fëmija e saj

"Ti më pyete vetë", them unë.

"Unë nuk e pata me ty", thotë ajo. "Ti je i vetmi prej tyre që s'më qet telashe".

"Sigurisht", them unë, nuk kam kohë për të hapur telashe. Kurrë s'kam pasur kohë që të shkoj në Universitetin e Harvardit si Kuentini ose të pij e të bëhem tapë si Babai. Mua m'u desh të punoja. Mirëpo, nëse ti dëshiron që unë t'i bie pas e të shoh se ç'bën, unë mund ta lë dyqanin dhe mund të punoj diku natën. Atëherë mund t'i bie pas ditën, kurse natën ti i thua Benit që ta përcjellë".

"Unë e di se jam barrë për ju, jam hall për ju", thotë ajo duke vajtuar me kokën mbi jastëk.

"Unë dua ta di këtë", them unë. "Ka 30 vjet që më flet kështu. Edhe Beni duhet ta dijë këtë tash. A do që t'i them diçka asaj për këtë?"

"A mendon se do të përmirësohet?" thotë ajo.

"Nuk përmirësohet nëse ti vjen këtu përsëri dhe përzihesh pikërisht atëherë kur ia nis muhabetit me të", them unë. "Në qoftë se ti dëshiron që unë ta kontrolloj atë, vetëm thuaj dhe mos u ngatërro më në këtë. Sa herë që unë përpiqem ta kandis atë, ia beh ti pa pritur e pa kujtuar dhe ngatërrohesh në bisedë kështu që ajo na bën budallenj të dyve".

"Mos harro se jeni të një nëne e të një babai", thotë ajo.

"Pa dyshim", them unë, "edhe unë mendoja si ti, jemi të një mishi. Kemi edhe pak gjak të përbashkët, si më thotë mua mendja. Kur njerëzit veprojnë si zezakë, pa marrë parasysh se kush janë, atëherë me ta duhet sjellë si me zezakë".

"Droj se do të hidhërohesh me të", thotë ajo.

"Paj", them unë, "Ti nuk pate fat të madh me sistemin tënd të edukimit. A dëshiron që t'i ndihmoj, apo jo? Pol, ç'mendon; unë duhet t'i hyj punës".

"E di se u mbytët duke punuar për ne", thotë ajo.

"E di ti, se po të kisha mundësi ti do ta kishe tash zyrën tënde dhe orarin e punës ashtu si i ka hije një Baskombi. Sepse ti je Baskomb, edhe pse e ke atë emër. E di se po të kishte qenë në gjendje yt atë t'i parashikonte —"

"E po", them unë, "Mendoj se edhe ai ka të drejtë të gabojë

ndonjëherë, si të gjithë të tjerët, si Smithi apo Xhonsi". Ajo përsëri filloi të qante.

"Si guxon të flasësh kështu për babain tënd të ndjerë", thotë ajo.

"Mirë pra", them unë, "Ani mirë. Ti mendon të duash. Por, meqë unë nuk kam zyrë, unë duhet t'ia bëj si di vetë. A dëshiron që t'i flasë asaj?"

"Po kam frikë se do të mllefosesh duke biseduar me të", thotë ajo.

"Në rregull", them unë, "Nuk do t'i them pra asgjë".

"Por diçka duhet ndërmarrë", thotë ajo. "Nuk bën që bota të kujtojë se unë po i lejoj që të ikin nga shkolla e të sorollatet rrugëve, ose të kujtoj se s'kam si ta pengoj... Xhezon, Xhezon", thotë ajo, "Si të bëri zemra të më lësh kështu. Si të bëri zemra që t'më lësh gjithë këtë sekëlldi".

"Lëre tash, lëre", them unë, "Do të sëmuresh. Pse ti nuk e mbyll atë gjithë ditën, ose nuk më lë mua që ta fshij përpara e ti mos të mërzitesh më për të?"

"E kam të mishit e të gjakut tim", thotë ajo duke vajtuar. Kurse unë i them,

"Mirë de. Unë do të përkujdesem për të. Madje hajde tash mos qaj".

"Mos u hidhëro fort me të", thotë ajo. "Ajo është ende fëmijë, mos harro këtë".

"Jo", them unë, "nuk do të harroj". Unë dola jashtë dhe e mbylla derën pas vetes.

"Xhezon", thotë ajo. Unë nuk iu përgjigja. Vazhdova të ecë në odajashte." "Xhezon", u dëgjua zëri i saj pas derës. Zbrita shkallëve. Në dhomën e ngrënies nuk kishte asnjeri, pastaj e dëgjova zërin e saj në kuzhinë. Ajo përpiqej ta kandiste Dilzin që t'i bënte edhe një kafe. Unë hyra brenda.

"Më duket se i paske petkat e shkollës, apo jo?" them unë. "Ose i ke petkat e festës së sotme?".

"Dilzi, vetëm gjysmë filxhani", thotë ajo. "Të lutem".

"Jo", i thotë Dilzi, "Kafenë s'ta bëj. Nuk të duhet edhe një filxhan tjetër, ti je vajzë 17-vjeçare, kështu thotë zonjusha Karolinë. Shko dhe veshu për shkollë që të mund të shkosh në qytet me Xhezonin. Këqyr se mos po vonohesh përsëri".

"Jo, nuk vonohem", them unë. "Tash e rregullojmë këtë punë". Ajo më shikoi, me filxhan në dorë. I largoi tufat e flokut

nga fytyra, ndërsa kimonoja i rrëshqiti nga supi. "Lëre poshtë atë kafe dhe eja me mua një minutë, pata një fjalë me ty", them unë.

"Pse?", thotë ajo.

"Hajde", them unë. "Lëre atë filxhan te lavamani dhe eja këtu".

"Çka të gjeti, Xhezon?" Dilzi thotë.

"Ti kujton se mund të më bësh budalla edhe mua ashtu si e bën budallë gjyshen dhe të gjithë të tjerët", them unë, "Tash do të shohësh se kush jam unë. Të jap dhjetë sekonda kohë që ta lësh atë filxhan aty ku të thashë unë".

Tash ajo nuk më shikonte më. Ia kishte qepur sytë Dilzit. "Sa është ora Dilzi?" thotë ajo. "Si të bëhen dhjetë sekonda, fishkëllo. Vetëm gjysmë filxhani. Dilzi, të —"

E rroka për krahu. I ra filxhani. U thye për dysheme kurse ajo u zmbraps me rrëmbim duke më shikuar edhe pse unë nuk ia lëshoja krahun. Dilzi u ngrit nga karrigia e saj.

"Mos, Xhezon", thotë ajo.

"Lëshomë", thotë Kuentina, se përndryshe ta lidha shpullë".

"Shapullë, apo jo?" them unë, "dashke shpullë të më lidhësh?" Ajo ma këputi një shpullë. Unë ia kapa edhe atë dorë dhe e shtrëngova si macen e egër. "Hajt provo, a do?" i them. "A kujton se mundesh?"

"Hej, Xhezon!" thotë Dilzi. Unë e tërhoqa në dhomën e ngrënies. Kimonoja ju hap; e pashë një pjesë lakuriqe të saj. Pas na vinte Dilzi duke u kolovitur. U ktheva dhe e mbylla derën me rrapamë para saj.

"Ti mos u përziej në këtë", i them.

Kuenitina ishte përkulur kah tavolina dhe po e përthekonte kimonon e saj. Unë po e shikoja.

"Tash", i them, "Dua *të* di unë se ç'do të thotë kjo që bën ti duke ikur nga shkolla dhe duke e gënjyer gjyshen duke falsifikuar emrin e saj në raportet e tua dhe duke e sëmurë atë. Ç'lojëra janë këto?"

Ajo nuk i tha asnjë gjysmë fjale. Po e përthekonte kimonon e saj edhe nën mjekër, duke e shtrënguar atë dhe duke mos i shqitur sytë nga unë. Ende nuk ishte lyer e pudrosur kështu që fytyra i dukej e lëmuar si me një leckë të pushkës. Iu afrova dhe e kapa për "beli. "Maskarallëqe janë këto?" them unë.

"Kjo s'të hyn në punë", thotë ajo. "Më lësho".

Dilzi ia behu te dera. "Mos, Xhezon", thotë ajo.

"Ti mos i fut hundët këtu, të thashë njëherë", them unë pa u kthyer për ta parë. "Dua të di se ku shkon ti kur ia dredh e ikën nga shkolla", them unë. "Në rrugë nuk del sepse të kisha diktuar. Me kë luan ti? A po fshehesh në zabel me ndonjërin prej atyre kopukëve të pispillosur? Atje shkon ti?"

"Mor — mor të marrtë dreqi!" thotë ajo. U mundua të largohet, por unë nuk e lëshova. "Mallkuar qofsh!" thotë ajo.

"Ta tregoj qejfin", them unë. "Ti mund ta frikësosh plakën, por unë të tregoj ty se nga sa shkon tërshëra". E mbaja me një dorë, kështu që ajo nuk mundohej më të ikte, por më vështronte pa ndarë ndërsa sytë i zgjeroheshin dhe i nxiheshin.

"Ç'ke ndërmend të bësh?" thotë ajo.

"Prit sa ta nxjerr rripin e ta tregoj qejfin", them unë duke e nxjerrë rripin tim. Në atë çast Dilzi më kapi për dore.

"Xhezon", thotë ajo, "Mos, Xhezon, allahile! A s'të vjen turp".

"Dilzi", thotë Kuentina, "Dilzi".

"Unë nuk e lë që të të prekë", thotë Dilzi, "Mos ki frikë, loçkë". Ajo më kishte zënë për dore. Por, atëherë e nxora rripin dhe e shtyva atë. Ajo gati ra në tavolinë. Ishte matufosur dhe mezi lëvizte. Por, nuk e gjeti gjë. Ne na duhet dikush në kuzhinë që t'i hajë mbeturinat e ushqimit të të rinjve. Ajo hyri mes nesh duke u kalamendur, duke u orvatur të më mbante përsëri. "E po, qëllomë mua atëherë", thotë ajo, "Nëse kujton se të bën mirë kjo gjë. Më godet mua", thotë ajo.

"A mendon se s'të qëlloj a?" them unë.

"Unë e di se je i zoti edhe për punë të këqija", thotë ajo. Në atë çast dëgjova hapat e Nënës te shkallët. Duhet ta dija se asaj nuk do t'i rrihej pa u ngatërruar edhe kësaj radhe. E lëshova atë. Ajo u mbështet për mur duke e mbajtur kimonon e mbyllur.

"Mirë, mirë", them unë, "e paçim lënë këtë muhabet përnjëherë. Por, mos kujto se më mashtron. Unë nuk jam grua matufe, as zezak ngordhalaq Moj zuskë e mbrapshtë", i them.

"Dilzi", thotë ajo, "Dilzi ... thirrma nënën".

Dilzi iu afrua. "Hajde, hajde", thotë ajo, ai s'do të të prekë me dorë derisa t'më kesh mua këtu". Nëna zbriti nga shkallët.

"Xhezon", thotë ajo, "Dilzi".

"Jo, jo", thotë Dilzi, "Para meje s'të ka prekur". Ajo e preku Kuentinën me dorë. Kuentina e largoi dorën.

"Moj zezake e mallkuar", thotë ajo. Krisi dhe iku kah dera.

"Dilzi", thotë Nëna nga shkallët. Kuentina iu ngjit shkallëve me vrap, duke kaluar pranë Nënës. "Kuentina", thotë Nëna, mos, Kuentinë". Kuentina po ikte. Dëgjoja hapat e saj kur arriti në atë kat dhe në odajashtë. Pastaj e përplasi derën me rropamë.

Nëna ishte ndalur. Pastaj u afrua. "Dilzi", tho të ajo.

"Në rregull", thotë Dilzi, "Erdha. Ti shko dhe merre atë automobil të vjetër dhe prite atë", thotë ajo, "e mandej e çon në shkollë".

"Mos ki merak", them unë. "E çoj unë në shkollë dhe do të bëj çmos që mos t'ia mbath nga shkolla. Unë i hyra kësaj pune dhe s'kam çare pa dalë faqebardhë".

"Xhezon", thotë Nëna nga shkallët.

"Hajde tash", thotë Dilzi, duke shkuar kah dera. "Mos deshe që t'ia nis edhe ajo shamatës? Unë erdha zonjusha Karolinë".

Dola. Edhe te shkallët dëgjoja sesi po bisedonin. "Ti kthehu në krevat", thoshte Dilzi, "a nuk e di ti se nuk je mirë me shëndet për t'u çuar nga krevati? Hajt tash kthehu atje. Lerma mua këtë unë do të kujdesem që të arrijë në shkollë me kohë".

Dola jashtë dhe u nisa për ta nxjerrë automobilin nga garazhi, por m'u desh të bie rreth e rrotull para se t'i gjeja ata.

"Më duket se të thashë ta vësh këtë gomë në rrotën e pasme të automobilit", them unë.

"S'pata kohë", thotë Lasteri. S'ka kush ta ruajë atë para se të zbresë Nëna në kuzhinë".

"Po", them unë, "Unë e ushqej një kuzhinë përplot me zezakë të cilët duhet të kujdesen për të, mirëpo nëse më duhet ta ndërroj rrotën, duhet vetë ta bëj këtë punë".

"S'pata me kë ta lë atë", thotë ai. Në atë çast ai filloi të rrënkonte dhe të përqurravej.

"Çoje pas shtëpisë", them unë. "Pse e mbani atë këtu ku mund ta shohin njerëzit?" U thashë të shkojnë para se të fillonte të rënkonte përsëri. Është mjaft keq që në ditën e diel, kur fusha mbushet plym me njerëz të cilët nuk mund të shkojnë të shohin cirkun me ata gjashtë zezakë që duhet ushqyer, që të lozin me atë farë topi të mallkuar të leckave atypari. Ai do të bëjë ecejake

rrëzë gardhit duke rënkuar orë e çast sa herë që t'i diktojë ata, kurse ata do të kërkojnë nga unë që të luaj golf, kurse nëna dhe Dilzi do të detyrohen të mos i marrin ato molla porcelani nga dera ata shkopinj dhe t'ia nisin lojës dhe ndërsa unë mos t'ia filloj të luaj me fanarin. E pastaj ndoshta të gjithëve si lojtarë të mirë na dërgojnë në Xhekson. Dhe, kushedi ndoshta atje njerëzit do të bëjnë ndonjë ceremoni si të na shohin.

U ktheva në garazh. Atje ishte goma e veturës e mbështetur për mur por tybe në paça pasur dëshirë ta ndërroj. Veturën e nxora duke u nisur pas e pastaj e ktheva nën anën tjetër. Kuentina ishte në skaj të rrugës.

"Unë e di se ti s'ke më libra", i thashë. "Desha vetëm të të pyes se ç'ke bërë me to, në qoftë kjo punë imja. U mor vesh, unë s'kam kurrfarë të drejte të të pyes për këtë, por të të përkujtoj se shtatorin e shkuar dhashë për ty 11 dollarë dhe 65 sencë".

"Nëna m'i blen librat", ma priti ajo. "Ju nuk shpenzoni asnjë sencë për mua. Më panë do të vdisja nga uria sesa të merrja gjë nga ju".

"Ashtu?" i thashë. "Thuaj këto gjyshes e do të shohësh se ç'do të thotë. Ti nuk del e nuk bredh lakuriqe", thashë "ndonëse podra e pomada në fytyrën tënde fshehin edhe atë grimë hijeshi që ke".

"Mos kujtoni ndoshta se për petkat e mia u harxhua ndonjë senc juaji, apo i gjyshes?" më tha ajo.

"Pyete gjyshen", i thashë: "Pyete se ç'ka ngjarë me ata kambialë. Me sa më kujtohet edhe ti ke parë se si u dogj një kambial".

Ajo as që më dëgjonte, por më maste me ata sy të saj gjakftohët si të ndonjë zagari, që i vezullonin në fytyrën e lyer e të pudrosur të saj.

"A dini se ç'do të bëja sikur të dija se këta janë blerë me një senc tuajin apo të gjyshes?" tha ajo duke e prekur fustanin.

"Po mirë, ç'do të bëje?" i thashë. "Pale, a do të ecje nëpër kacë?"

"Do ta grisja menjëherë dhe do ta hidhja në rrugë", tha ajo. "Nuk më besoni?"

"Të besoj, posi, ti ke përvojë në proçka të tilla".

"A mendoni se s'ma mban a", u mbush me mllef ajo dhe e rroku me të dy duart qafzën e fustanit si të donte ta griste.

"Grise, veç grise fustanin", i thashë unë me kërcënim, "e do të të rrah asisoj saqë do ta mbash mend tërë jetën".

"A po kujtoni se s'ma mban a?" po përsëriste ajo.

Në atë çast vura re se ajo me të vërtetë po mundohej ta griste dhe ta zhveshte fustanin. E ndala automobilin, ia mbërtheva duart, por, sakaq ia behën nja dhjetë badihavxhinj, kureshtarë. Një gjë e tillë më tërboi aq shumë saqë unë nuk shihja asgjë rreth e rrotull.

"Bëje edhe një herë një marrëzi të tillë do të pendohesh që ke ardhur në këtë botë", i thashë.

"Qysh tash u pendova", më tha me keqardhje. Iu shporr skenave kështu që sytë e saj morën një shprehje të çuditshme. Unë, thashë me vete: nëse ia nis të përloshesh këtu në veturë në rrugë, do të të rrah kamxhik, do të ta bëj shpinën më të butë se barkun". Fati që nuk qajti kështu që ia çlirova duart dhe vazhdova të vozis. Për fat të mirë gjendeshim afër një rruge skajore ku mund të ktheja në atë rrugën e veçuar duke iu shmangur sheshit. Në livadhin e Berdit po ngritnin tendën. Ërlli më kishte dhënë dy bileta falas, ngase në vitrinën tonë e kishim ngjitur pllakatën. Kuentina po rrinte me kokë të kthyer dhe po i kafshonte buzët. "Ja tash më vjen keq", tha ajo edhe njëherë. "S'di pse u linda".

"E njoh unë edhe dikë tjetër që s'e ka të qartë këtë", i thashë. E ndala veturën para shkollës. Ra zilja. Nxënësit e fundit po nxitonin të hynin në shkollë. "Të paktën një herë arrite me kohë", i thashë. "A ke ndërmend të shkosh në godinën e shkollës dhe të rrish aty apo duhet të vij unë me ty e të detyroj të rrish?" Ajo doli duke e përplasur derën e veturës. "Mos harro se ç'po të them", vazhdova unë, "e kam me gjithë mend. Veç të dëgjoj edhe një herë sesi po endesh qosheve me ndonjërin prej atyre lahperëve.

Me t'i dëgjuar këto fjalë, u kthye. "Unë nuk endem në kurrfarë qoshesh. Sa për mua të gjithë e dinë se ç'bëj".

"Po, të gjithë e dinë, mos ki merak. Secili në këtë qytet e di se çfarë je dhe kush je ti. Por, unë s'do ta duroj më këtë, ta dish. Sa për mua personalisht, s'jam ngushtë unë për sjelljen tënde, mirëpo, këtu unë kam njëfarë pozite prandaj s'do të lejoj që asnjë anëtar i familjes sime të bredhë rreth e rrotull si ndonjë lavire zezake. Më dëgjove?"

"Punë e madhe", ma ktheu ajo. "Jam e ligë, në skëterrë do

të shkoj, aq më bën. Më me qejf do të shkoja në skëterrë se sa të rri me ju".

"Në dëgjofsha edhe njëherë se ke munguar, do të pendohesh, ja ku të them". U kthye dhe i ra vrap oborrit. "Mbaj mend e mos harro se ç'të thashë, veç në mungofsh edhe një herë", i përsërita. Ajo as që u kthye më.

Shkova deri në postë, i mora letrat, arrita para dyqanit dhe e parkova automobilin. Ërlli më hodhi një shikim sapo hyra. I dhashë shkas që të më qortonte për vonesë, por ai vetëm më tha:

"Kanë arritur kultivatorët prashitës, ndihmojini xha Xhobit t'i montojë".

Shkova pas dyqanit ku Xhobi plak po i hapte arkat ku gjendeshin pjesët e kultivatorit. Ai i montonte aq ngadalë saqë për tri vidha i lypsej përafërsisht një orë.

"Ti do të duhej të punoje tek unë", i thashë. "Gjysma e zezakëve dembelë në këtë vend ushqehen në kuzhinën time".

"Unë punoj me kërkesën e atij njerin që më paguan të shtunën mbrëma", m'u përgjigj. "Pas kësaj pune s'kam kohë t'ua bëj qejfin të tjerëve". Ai zhvidhosi një vidhë. "Sa i përket punës në këtë vend asnjeri s'mbaroi nga puna e madhe përveç atyre kandrave që i rrasin feçkat në kapsollet e pambukut".

"Ji i lumtur që nuk je kandër e tillë dhe që s'punon në makinat e mia. Do të fikeshe së punuari".

"Mirë e keni, qe besa", më tha Xhobi. "S'e ka lehtë kandra. S'ka çare pa punuar përditë nëpër vapë, shi apo në motin e mirë. Nuk ka veranda para shtëpisë që të ulet në të dhe të bëjë kokrrën e sefasë, t'i bëjë sehir bostanet sesi rriten. S'ka pushim as të shtunën".

"As ti s'do të kishe të shtunë të lirë", i thashë unë "sikur të paguaja unë për çdo javë. Hajt, nxirri më ato sende dhe çoji në dyqan luaji duart!"

E hapa më parë letrën e nënës së Kuentinës dhe nxora kambialin. Grua tipike. Gjashtë ditë vonesë. Këtej përpiqet kinse t'i bindë meshkujt sesi ato janë të afta t'i kryejnë punët. Sa herë mashkulli do të duronte që të mos bankrotojë sikur të parin e muajit ta zëvendësonte me gjashtëshin! Kur ia dërgojnë nga banka kopjen e kontos, mbase s'do të më pyetë se për ç'arsye unë nuk e deponoj rrogën time kurrë para datës

gjashtë të muajit. Të tilla gjëra kurrë s'i bien në mend një femre.

Në letër shkruante: "Ende s'kam marrë përgjigje për letrën e dërguar lidhur me fustanin e Pashkëve të Kuentinës. A arriti në rregull? Nuk mora përgjigje as për të dy letrat e fundit që ia dërgova, ndonëse çeku në letrën e dytë u pagua me çekun tjetër. Mos është e sëmurë? Më njofto menjëherë, ose vij unë vetë atje për të marrë vesh si janë punët. Më ke premtuar gjithashtu se do të më lajmërosh nëse asaj i duhet gjë. Nga ti pres ndonjë lajm para dhjetësisht. Apo jo, më mirë më dërgo një telegraf menjëherë. Ti ia hap asaj letrat e mia. E di këtë me siguri, si ta shihja me sytë e ballit. E mira e së mirës është të më telegrafosh në këtë adresë".

Pothuaj në të njëjtën kohë Ërlli zuri t'i çirrej Xhobit, prandaj m'u desh ta lë letrën dhe të shkoj te ai që t'i jepja pak zemër zezakut. Këtij vendi i lipset fuqia punuese e bardhë. Do të duhej t'i linim këta dembelë të mallkuar zezakë që nja dy vjet të vuajnë nga uria, atëherë do të mernin vesh se ç'janë përtacia dhe ngathtësia.

Kah ora dhjetë shkova para dyqanit. Një udhëtar tregtar arriti aty. Ora ishte dhjetë pa disa minuta, kështu që e ftova në bufe matanë rrugës për të pirë nga një kokakolë. Kishim një muhabet rreth rëndimenteve.

"Kurrgjë s'është ajo punë", i thashë unë. "Pambuku është kulturë vetëm e spekulantëve. Spekulantët ua mbushin mendjen fermerëve me lloj-lloj gënjeshtrash e shtrëngojnë që të prodhojë së tepërmi, kurse ata pastaj bëjnë lloj-lloj dallaveresh dhe allishverishesh duke i mashtruar tarallakët e rinj dhe mendjelehtë. Ç'kujtoni, ç'dobi ka nga këto fermeri? Kurrfarë. Pos qafës së kuqe dhe gungës në shpinë. A mendoni se ai që e mbjell pambukun me djersën e ballit fiton ndonjë sencë më tepër se sa i duhet për bukën e gojës? Nëse ka bereqet, s'do të ketë leverdi ta vjelë, nëse s'do të ketë bereqet, s'do të ketë se ç'të shesë. Përse? Sepse të gjitha ia rrëmbejnë ata çifutët e mallkuar nga Lindja. S'mendova në njerëzit që e kanë fenë çifute, ruana zot, jo! Kam njohur unë çifutë të cilët ishin qytetarë të ndershëm. Mos jeni ju njeri ndër ta?"

"Jo, s'jam", tha ai. "Unë jam amerikan".

"S'desha t'ju fyej", vazhdova unë. "Unë secilit ia pranoj meritën pa marrë parasysh se çfarë feje ka ose kush është. Unë

s'kam gjë kundra çifutëve individualë. E kam fjalën për racën. Më falni, ata nuk prodhojnë asgjë. U qepen pas pionierëve në vendin e ri dhe u shesin petka".

"Ju me siguri mendoni në armenët", bëri ai, "apo jo? Çka i duhen një banori të ri, një pionieri rrobat e reja?"

"Mos u fyeni", i thashë unë. "Unë s'kam gjë kundra asnjë feje".

"U mor vesh", tha ai. "Unë jam amerikan. Familja ime ka gjak francez, prandaj kam hundë të këtillë. Me çdo tjetër unë jam amerikan".

"Edhe unë. S'kanë mbetur shumë amerikanë. Por, t'i kthehemi temës: Kur them çifutë të mbrapshtë mendoj në ata dallaveraxhinj që në Nju-Jork janë ulur në karreklla të buta dhe i nxisin axhaminjtë e papërvojë që t'u hyjnë dallavereve".

"Ashtu është", u pajtua ai. "I varfri s'ka si të bëjë spekullime. Këtë do të duhej ndaluar me ligj".

"A s'mendoni se kam të drejtë?" e pyeta.

"Po, keni plotësisht të drejtë", tha ai. "Bujku i ngratë e ha gjithmonë! Atij ia hedhin!"

"Unë ■ di se kam të drejtë", i thashë unë. "Kjo është një lojë lotarie për budallenjtë, nëse njeriu nuk merr lajme të fshehta nga ndonjëri i cili di me saktësi se ç'ndodh. Unë rastësisht kam lidhje me disa veta të cilët kanë disa lidhje me atë lloj tregtie. Këshilltar i tyre është njëri ndër spekulantët më të mëdhenj të Nju-Jorkut. Unë, përnjëherësh nuk i hyj rrezikut të madh, ky është parimi im. Spekulantët ua punojnë atyre leshkove të cilët mendojnë se i dinë të gjitha dhe me tre dollarë orvaten të fitojnë pasuri të tëra. Me të tillët, ata bëjnë spekulime të mëdha".

Në atë çast ra ora dhjetë. Shkova në zyrën e telegrafit, Kurset e parë në bursë ishin ngritur pak, pikërisht ashtu si paralajmëruan. Shkova në një këmd e nxora përsëri telegramin për t'u bindur. Teksa unë shikoja, ishin shpallur kurse të reja. Për dy poena më të mëdha. Blenin të gjithë. Këtë e kuptova nga fjalët e tyre. Të gjithë u turrën. Si të mos dinin se kurset mund të lëvizin në drejtime të ndryshme. Si të ekzistonte ligji ose dispozita sipas të cilës të gjitha duhej të bliheshin. Fundja, duhet të gjallojnë disi edhe çifutët e Lindjes. Por, më marrtë dreqi nëse kjo s'ka marrë hov të madh kështu që çdo i huaj i zgjebosur i cili nuk është i zoti të fitojë në vendin e vet, mund

të vijë këtu dhe mund t'ua grabisë amerikanëve të vërtetë paratë nga xhepi. Kursi përsëri ishte rritur për dy poena. Katër poena. Epo, hamadreq, ata janë në burim të ngjarjeve, dinë se ç'po ndodh. Dhe, nëse s'kisha ndërmend t'ua shihja hairin këshillave të tyre përse atëbotë të paguaj nga dhjetë dollarë në muaj për lajmet e tyre. Dola, pastaj më ra në mend diçka, u ktheva dhe dërgova një telegram. "Çdo gjë është në rregull. Q sot shkruan".

"Q?" pyeti telegrafisti.

"Po", ia ktheu ai, "Q. Nuk e keni këtë shkronjë *në* regjistër?"

"Pyeta vetëm për t'u siguruar", tha ai.

"Ju vetëm dërgojeni ashtu si kam shkruar, prandaj ju garantoj se do të jeni të sigurt", thashë unë. "Llogarinë e paguan marrësi".

"Ç'dërgoni, Xhezon?" pyeti doktor Rajti duke më shikuar mbi shpatulla. "Mos është ndonjë porosi e shifruar?"

"Punë për mua", u përgjigja. "Ju veproni sipas tekeve tuaja. Ju dini më shumë se ata atje në Nju-Jork".

"Patjetër", tha doktori. "Unë do të kurseja të holla sivjet sikur të merrja të paktën dy senca për një funtë".

Ishin shpallur kurset e reja. Tash ishin për një poen më pak.

"Xhezoni po shet", tha Hopkinsi. "Shikojani fytyrën".

"Unë veproj ashtu si kujtoj se është me mend", i thashë. "Kurse ju veproni si t'ju marrë mendja. Edhe ata çifutë të pasur të Nju-Jorkut duhet të jetojnë si tërë bota".

U ktheva në dyqan. Ërlli ishte i zënë me punë në pjesën e përparme të dyqanit. Unë kalova në pjesën e pasme të dyqanit te tavolina e shkrimit dhe e lexova letrën e Lorenës. "Bata i dashur sa e lumtur do të isha po të qëlloje këtu. Nuk ka argëtim pa babain tim. Më ka marrë malli për babushin tim të dashur". Edhe unë mendoj ashtu. Herën e fundit ia dhashë dyzet dollarë. Me të vërtetë ia dhashë, ia fala. Unë s'i premtoj kurrë asgjë asnjë femre, as që e lajmëroj se ç'do t'i fal. Kështu mund ta frenosh femrën. Lipset mbajtur ngaherë në pasiguri, le të mbetet ndërdyzash. Nëse s'ke si ta befasosh ndryshe, atëherë këputja një grusht turinjve.

E grisa letrën dhe e dogja mbi pështymoren. E kam si parim që mos të ruaj asnjë copë letre të shkruar nga dora e femrës dhe as t'u shkruaj femrave. Lorena vazhdimisht kërkon që unë të shkruaj, mirëpo unë i them: të gjithë ato që kisha harruar të

them gjatë takimit të fundit, mund të presë derisa të kthehem përsëri në Memfis, por s'do të më vijë keq nëse ti më shkruan ndonjë letër kohë pas kohe në pliko të zakonshme; mirëpo, nëse do të mopatesh të më thërrasësh me telefon, mos më prit në Memfis, ja ku të them. Ja, merri, i them dhe ja jap dyzet dollarë. Nëse dehesh diku dhe të shkrep të më thërrasësh me telefon, mos harro se ç'të kam thënë dhe numëro deri në dhjetë para se t'i hysh belasë.

"E kur?" tha ajo.

"Çfarë kur?"

"E kur do të vish përsëri?"

"Të lajmëroj", i thashë unë. Në atë çast deshi të porosiste birrë, por unë s'e lashë. "Kurseji të hollat. Blije një fustan", i thashë. Edhe shërbëtores ia dhashë pesë dollarë. Në fund të fundit, unë gjithmonë them: paraja nuk ka kurrfarë vlere, varet se për çka i shpenzon njeriu. Të hollat s'i përkasin askujt. Pse t'i fitosh dhe t'i zhvatësh pra? U takojnë vetëm atyre të cilët dinë t'i fitojnë dhe t'i ruajnë. Pikërisht këtu në Xheferson një njeri fitoi shumë para duke u shitur zezakëve mallra të pavlershme dhe të prishura, ndonëse banonte në një odë të vogël mbi dyqan që s'ishte më e madhe se tharku i derrave ku edhe ushqehej. Para katër pesë vjetësh, ai u sëmur. Atëherë, atë e kaploi një frikë e madhe dhe si e mblodhi veten biri i botës, u bë anëtar i një kishe ku i paguante një farë misionari kinez pesë mijë dollarë në vit. Shpeshherë mendoj se sa do të xhindosej ai njeri sikur të vdiste dhe të shihte se nuk kishte as qiell as parajsë e pastaj t'i kujtohen ato pesë mijë dollarë në vit. Unë them, e mira e së mirës për të është të vdesë ashtu të paktën do t'i kursente të hollat e veta.

Kur letra u dogj thuaja e tëra, letrat tjera desha t'i fusja në xhepin e pallto, kur papritmas diçka më tha ta hapja atë letrën dërguar Kuentinës, para se të shkoja në shtëpi. Mirëpo, pikërisht atëherë më bëri zë Ërlli i cili më thirri në pjesën e përparme të dyqanit. Kështu, i lashë letrat dhe shkova vetëm e vetëm për të humbur më se pesëmbëdhjetë minuta duke pritur nëse ndonjëri nga ata lypsa të mallkuar do të vendoste të blinte një rrip prej njëzet sencësh apo prej tridhjetë e pesë sencësh.

"Më mirë ta merrni këtë të mirin", i thashë unë. "Si mund të pritni ju se do të përparoni kur keni qitur cekën të punoni me pajime të lira?" i thashë.

"Nëse s'vlen pse e shitni?" pyeti ai.

"Unë nuk thashë se nuk është i mirë", ia ktheva unë, "por thashë se nuk është aq i mirë si ai i pari".

"E ku e dini ju se nuk është i mirë", pyeti ai. "Mos e keni përdorur ndonjërin prej tyre?"

"Ky tjetri nuk kushton tridhjetë e pesë sencë, ja se ku e di se nuk është aq i mirë".

E mbante atë prej njëzet sencësh në dorë dhe e përshkonte nëpër gishtërinj. "Mendoj se do ta marr këtë", më tha. Desha t'ia mbështjell rripin, mirëpo ai e paloi disi dhe e futi në xhepin e rrobave të punës. Mandej e nxori qesen e duhanit, e zgjidhi dhe nxori nga ajo disa monedha. M'i dha njëzet sencë. "Me këta pesëmbëdhjetë sencë blej diçka për drekë", më tha.

"Ani mirë", i thashë, "ju vendosni, punë për ju. Por, mos eni pas një viti për t'u ankuar nga pajimet e dobëta".

"Larg i keni të korrat e vitit tjetër", tha ai.

Tekefundit, iu shporra atij myshteriu. Mirëpo, sa herë që merrja atë letër në dorë, ia behte ndonjë dreq. Në qytet po degdiseshin gjindja për t'i parë shfaqjet e cirkut ambulant kështu që hynin nëpër dyqane tufa-tufa vetëm për të shpenzuar para për çkadoqoftë, por kësaj qyteti s'ia shihte hairin, pos atyre korrupsionistëve të zyrës së shefit të cilët i ndanin paratë e fituara mes vete. Ndërkaq, Ërlli im bënte varivinga, si pula në furrik, dhe pa një pa dy, thoshte: "Po, zonjë, do t'ju shërbejë zotëri Kompsoni. Xhezon, tregoji zonjës bastunet apo ato gremça nga dhjetë sencë".

Po, posi, Xhezoni e do punën. Unë nuk i kam përparësitë e edukatës universitare, mirëpo, ta zëmë, në Harvard mësojnë vetëm se si duhet notuar natën, pa ditur not, teksa në Universitetin e Svenit nuk mësojnë as atë se ç'është uji. Unë them: mund të më dërgoni në universitetin shtetëror; ndoshta do të mësoj si ndalet ora e murit me stërpikësin e hundës, pastaj Benin mund ta dërgoni në marinë, apo ndoshta në kavaleri ku i përdorin kuajt e tredhur. Atëherë kur ma dërgoi Kuentinën në shtëpi që ta ushqej, thashë: besa, sa bukur, në vend se unë të shkoj atje te ata në veri për të punuar, ata më dërgojnë pimë me telashe, atëherë Nëna ia plasi vajit, kurse unë i thashë se unë s'kam gjë kundra që beben e kishin dërguar këtu, nëse të bëhet qejfi, i thashë atëherë, umë e lë punën time dhe e rris fëmijën, teksa ty dhe

Dilzit ju lë përkujdesjen e ushqimit. Ose Benit. Më mirë është t'ia japin cirkut le ta rrisin nën tendë; do të ketë edhe njerëz të mëshirshëm që do të japin nga dhjetë sencë që të mund ta shikojnë: atëherë ajo filloi të qante edhe më me dënesë duke përsëritur: i ngrati fëmija im i sëmurë, kurse unë i thashë: po, atë do ta kesh mbështetje e krah kur të rritet, mirëpo tash është njëherë e gjysmë më i madh se unë, kurse ajo thotë se së shpejti do të vdesë dhe atëherë të gjithë do të jemi rehat, unë i them: mirë de, mirë, si të duash ti, Nëno; e ke mbesë atë tekefundit, ti mund ta konstatosh këtë më me siguri se shumica e gjysheve të tjera. Mirëpo, i them unë, kjo është vetëm çështje kohe. Nëse mendon se ajo do ta bëjë atë që thotë dhe se nuk do të orvatet që ta shohë kurrë më fëmijën e vet, atëherë ti gabon me thes; kjo ndodhi atëherë kur Nëna zuri të përsërisë pareshtur: lavdi zotit që ti s'je Kompson pos me emër, ti je tash gjithçka që më ka mbetur në botë, ti me Morin, kurse unë i them: sa për mua unë bëj edhe pa Xha Morin, nuk më bëhet qejfi qeder. Pastaj ia përpjetën ata dhe thanë se ishin gati për t'u nisur. Atëherë Nëna pushoi së qari. E lëshoi vellon dhe zbritëm në dhomat e poshtme. Xha Mori vinte nga dhoma e ngrënies me shami në gojë. Bëmë një farë rendi, kështu që dolëm te dera pikërisht në çastin kur mund ta shihnim Dilzin se si Benin dhe T. P.-në po i përcillte nga shtëpia. Zbritëm shkallëve teposhtë dhe hymë në çejze. Xha Mori fliste pandarë: motër e ngratë, e shkreta motër, duke vërtitur gjuhën rreth diçkafes në gojë dhe duke ia përkëdhelur dorën Nënës. Kushedi se rreth çkafit e sillte gjuhën ashtu.

"A e vure florin e zi?" tha Nëna. "Pse nuk nisem para se të dalë Benxhamini dhe me gjëmimin e vet shkakton shamatë? Djalë i gjorë, Ai s'di gjë. Ai as që ka haber se ç'bën".

"Pale, lëre", e ngushëllonte xha Mori duke ia përkëdhelur dorën dhe duke e vërtitur gjuhën rreth diçkafit. "Ashtu he të paça. Ç'duhet ditur për humbjen e babait, në qoftë e mundshme".

"Gratë e tjera i ngushllojnë fëmijët e tyre në raste të këtilla fatkeqe", tha Nëna.

"Edhe ti e ke Xhezonin dhe mua", i tha Xhaxhai.

"Për mua kjo është goditje e tmerrshme", tha Nëna. "Të humbasësh dy veta brenda më pak se dy vjetëve".

"Mos ki merak, mos u mërzit", e ngushëllonte gjithnjë ai. Për pak xhaxhai e futi dorën në gojë dhe deshi ta hedhte gojën jashtë; nga dritarja. Atëherë unë mora vesh se çkafit i vinte era tërë kohën. Ishin karanfilë. Mua më duket se sipas mendimit të xhaxhait s'ka pasur kuptim të vepronte ashtu në varrimin e Babait tim, apo ndoshta kujtonte se Babai ishte nga bufeja, meqë atë bufe e preku me këmbë në kalim e sipër. Unë them ngaherë se nëse Babait i duhej të shiste diçka për ta dërguar Kuentinin në Harvard, atëherë shumë më mirë do të bënte po ta shiste atë bufe dhe me një pjesë të parave të blinte për vete një këmishë të çmendurish me një mëngë. Sipas të gjitha gjasave, e tërë prona e Kompsonëve ishte zhdukur para se ta trashëgoja unë, si thotë Nëna, ngase Babai im i kishte shitur dhe të hollat i kishte bërë rrush e kumbulla duke u dehur. Sidoqoftë, kurrë s'kam dëgjuar që Babai im të ofronte diçka për shitje që të më dërgonte në Harvard.

Kështu Xhaxhai përkëdhelte të voglën pa ndarë dhe thoshte "e shkreta motër". Ia përkëdhelte dorën me njërën ndër ato dorëza të zeza për të cilat morëm llogarinë pas katër ditësh. Kjo ngjau më njëzetegjashtëshin. Në të njëjtën datë para një muaji Babai ishte ngjitur lart, e kishte marrë fëmijën dhe kishte sjellë në shtëpi dhe asgjë s'kishte dashur të thoshte se ku ndodhet ajo apo ndonjë lajm tjetër, teksa Nëna qante dhe thoshte: "A nuk e pe atë fare? A s'u përpoqe ta shtrëngosh që ta mbajë fëmijën?" Kurse Babai ia ktheu: "Jo, ajo s'guxon të prekë asnjë senc të të hollave të tij", mirëpo Nëna po ngulmonte. "Mund ta shtrëngosh me ligj. Ai s'mund të vërtetojë kurrgjë, pos... Xhezon Kompson, sikur të mos ishe budalla e sikur të mos thoshe..."

"Qetësohu, Kerollajn", po e ngushëllonte Babai, teksa po në atë çast mua më dërgoi që t'i ndihmoj Dilzit që të ma sjellë atë djep të vjetër nga tavani. Ndërkaq, unë flisja me vete:

"Ja, sonte më sollën disa punë në shtëpi", ngaqë tërë kohën kishim shpresë se çdo gjë do të rregullohej dhe se fëmija do të gjallojë te ne dhe ngaqë Nëna vazhdimisht pohonte se ajo të paktën do të ketë mjaft konsiderata ndaj familjes dhe nuk do ta cenojë ardhmëninë time meqë ardhmënia e saj dhe e Kuentinës ishin të siguruara.

"Epo ku ta ketë vendin gjetkë?" pyeti Dilzi. "Kush do të mund ta rriste pos meje? A nuk ju kam rritur unë të gjithëve?"

"Keni bërë punë të mrekullueshme, po, s'ka fjalë", thashë unë. "Por, Nëna tash e tutje do të ketë shkas të zemërohet dhe të shqetësohet".

Kështu e sollëm djepin, kurse Dilzi zuri ta përgatiste atë në dhomën e saj të vjetër. Afër mendsh, Nëna ia nisi avazit të saj.

"Më ngadalë, zonjusha Kalilajn", i thoshte Dilzi, "se po e zgjoni vogëlushen".

"Këtu do të banojë foshnja?" bëri Nëna. "Të sëmuret me këtë atmosferë? A nuk i mjafton barra e trashëguar në gjak?"

"Qetësohu. Mos u bëj budallaqe", e qortoi Babai.

"E pse mos të flejë këtu?" e pyeti Dilzi. "Në të njëjtën dhomë ku e shtrija në krevat të ëmën e saj përnatë derisa u rrit dhe filloi të flinte vetëm?"

"Ti s'e kupton këtë", po thoshte Nëna. "Bijën time ta braktis burri! Foshnja e shkretë, e pafajshme!" i thoshte me ëmbëlsi duke e shikuar Kuentinën. "Askurrë s'do të dish se çfarë vuajtjesh ke shkaktuar".

"Mos u shqetëso, Kerollajnë", i thoshte Babai.

"Pse të bësh skandal duke llomotitur para Xhezanit?" tha Dilzi.

"U mundova ta mbroj", bëri Nëna. "Gjithmonë ç'nuk kam bërë për ta mbrojtur prej këso telashesh. Çmos do të bëj për ta mbrojtur edhe këtë".

"A thua ç'mund ta dëmtojë foshnjën nëse fle në këtë odë?" pyeti Dilzi.

"Epo s'kam ç'të bëj", u justifikua Nëna. "Unë e di se jam grua plakë, e mërzitshme. Por, e di edhe se gjindja nuk mund t'i përqeshin ligjet e zotit pa u ndëshkuar e kastiguar".

"Budallallëk", tha Babai. "Lëreni djepin Dilzi në dhomën e zonjushës Kerollajnë".

"Quaje ti marrëzi", po mbrohej Nëna. "Por, foshnja s'guxon kurrë ta marrë vesh të vërtetën. Kurrë s'duhet ta dëgjojë atë emër. Dilzi, të ndaloj që në praninë e kësaj foshnje ta zësh me gojë atë emër. Nëse rritet pa marrë vesh gjë për të ëmën, duke besuar se *s'e* ka pasur, do të jem e miradishme ndaj zotit".

"Mos çaj kopalla", tha Babai.

"Kurrë s'jam përzier në metodat e tua të edukimit", ia ktheu Nëna me vendosmëri, mirëpo, tashmë s'duroj dot. E bora durimin. Për këtë duhet vendosur që sonte. Ose s'do të përmendet emri i nënës së saj në praninë e saj, ose fëmijën

duhet dëbuar nga shtëpia ose unë vetë dal nga shtëpia. E po, zgjidh tashti".

"Mos u zemëro", i tha Babai. "Ti je shqetësuar. Lëre djepin këtu, Dilzi".

"Edhe ju jeni sëmurë, zotëri", tha Dilzi. "Jeni "bo" si lugat, ruana zot! Hajde të shtriheni, unë ju qes atë pijen që e doni, todin, e ju do të flini rehat. Prejse keni udhëtuar s'keni "bo", si duket asnjë sy gjumë!

"Mos ashtu", tha Nëna me qortim. "A s'di ti se ç'thotë mjeku? Pse e nxit të pijë. Pijes po ia sheh sherrin e tash po duket sa s'bën më keq. Më shikoni, edhe unë po vuaj, por nuk jam aq e dobët që ta mbys veten me uiski".

"Dokrra", tha Babai. "E çka dinë mjekët? E fitojnë kafshatën e gojës tërë jetën duke i këshilluar njerëzit që të mos e bëjnë atë që bëjnë dhe kaq dinë ata për majmunin e degjeneruar. Mos po e thërret famullitarin që të më kapë për dore".

Atëherë Nëna u zhgreh në vaj, kurse Babai doli. Ai zbriti. Në atë çast e dëgjova tringëllimën në bufe. U zgjova dhe e dëgjova si po zbriste përsëri. Nënën tashmë e kishte zënë gjumi apo ashtu më dukej, meqë më në fund në shtëpi kishte pllakosur qetësia. Edhe ai përpiqej të mos çonte poterë; ngase nuk e dëgjoja më. Shihej vetëm skaji i këmishës së tij dhe këmbët e tij të zbathura nën bufe.

Dilzi po e përgatiste djepin, e zhveshi foshnjen dhe e shtriu atë në djep. Foshnja ende nuk ishte zgjuar që kur e kishin sjellë në shtëpi.

"U rrit goxha shumë, mezi e "nxe" djepi", tha Dilzi. "Po vallahi. Unë do ta shtrij dyshekun në skaj të korridorit kështu që ju s'duhet të zgjoheni natën".

"Unë s'do të fle", tha Nëna. "Shko në shtëpi. Mua s'më prish punë. Do të jem e lumtur nëse pjesën e jetës që më ka mbetur do t'ia kushtoj asaj, vetëm që të pengoj —"

"Boll ma", tha Dilzi. "Na e lë neve fëmijën. E ti shko e fli", më tha. "Nesër ke mësim".

Unë dola, mirëpo Nëna më thirri të kthehem dhe qau mbi mua tërë natën.

"Ti je shpresa ime e fundit", më tha. "Për çdo natë e lus zotin që të kam ty".

Derisa prisnim për t'u nisur, ajo fliste: nëse njëri më mbet gjytrym, lavdi zotit që mbete ti, e jo Kuentini. Lavdi zotit që t'i

s'je Kompson, ngaqë tash më keni mbetur vetëm ti dhe Mori. Kurse unë thashë: Sa për mua, unë do të mund të jem edhe pa Morin. Kështu, ia përkëdhelte dorën pareshtur me dorëzën e vet të zezë duke ngatërruar diçka afër saj. I hoqi dorëzat kur i erdh radha për ta marrë lopatën. Iu afrua të parëve që i mbanin çadrat mbi veten dhe aty këtu rrapëllonin me këmbë duke u munduar t'i shporren baltës nga astari, por ishte ngjitur edhe për lopata, prandaj duhej ta shkundin baltën. Kur binte në arkivol, lëshonte një tingull të topitur. Mbasi që u ktheva në karrocë nga ana tjetër, e pashë pas një varrmihësi si po pinte përsëri nga shishja. Mendoja se kurrë s'do të pushonte. Meqë, kisha veshur rroba të reja. Mirëpo, në rrota fare rastësisht nuk kishte shumë baltë. Nëna, megjithatë, e diktoi dhe tha: s'di se kur do të kesh përsëri rroba të reja, teksa xha Mori e ngushëllonte duke i thënë: "Hajde, hajde, mos u trazo. Më ke mua, mund të mbështetesh gjithnjë në mua".

Me të vërtetë mund të mbështeteshim. Letra e katërt ishte prej tij. S'ishte nevoja ta hapja. Unë do *të* mund ta shkruaja vetë ose t'ia diktoja Nënës përmendsh duke shtuar dhjetë dollarë për çdo rast. Mirëpo, kisha një parandjenjë të ligë duke pasur parasysh atë letrën tjetër. Pikërisht atëherë parandjeva sesi kishte ardhur koha që ajo të provonte përsëri një ndër truket e saj. Pas asaj here të parë ajo ishte mësuar mjaft mirë. E kuptoi shpejt se unë s'jam i krijuar si Babai. Kur filluan ta vënë në karrocën e përmortshme, Nëna filloi gjithsesi të qante dhe atëherë xha Mori hyri me të në karrocë dhe u nisën. Mua më tha: ti mund të shkosh me këdoqoftë, do të të marrë secili, me gjithë qejf, unë duhet ta përcjell nënën tënde. Desha t'i them: është dashur të marrësh dy shishe në vend të njërës, por, atëherë m'u kujtua se ku ndodhesha, prandaj e lashë të mbetej si ishte. S'jepnin pesë para që isha lagur, bile më mirë që ishte bërë ashtu, meqë Nëna do të vuante për së tepërmi po të merrja të kallurit e mushkërive.

M'u kujtuam të gjitha këto, ndërsa i vështroja varrmihësit sesi hedhnin dheun në varr dhe si i binin dheut rrafshtas me lopata, si të bënin horasam apo diçka të tillë ose si të ngrenin ndonjë gardh. Të gjitha këto më dukeshin qesharake, pra ndaj vendosa të shëtisja. Me vete mendoja: nëse nisem kah qyteti, do të më arrijë dhe do të më kandisë që të bredh me çejze. Prandaj, u ktheva në varrezat e zezakëve. U strehova nën

kedrat ku shiu nuk mund të binte gjithaq po ku rigonte vetëm ngandonjëherë. Prej aty pashë kur e kryen punën dhe kur u nisën. Pas një copë here nuk ishte kurrkush, prandaj, për një moment prita edhe pastaj u nisa.

Meqë duhej të ecja monopatit për ta evituar shkeljen e barit, atë s'e vura re derisa iu afrova pranë. Qëndronte me mantel të zi dhe po i vështronte lulet në varreza. E njoha menjëherë para se të më shikonte dhe ta çonte vellon e zezë.

"Tungjatjeta, Xhezon", më tha ajo duke zgjatur dorën. U tokëm.

"Ç'bën ti këtu?" i thashë. "Unë mendoja se ti i kishe dhënë fjalën Nënës se nuk do të kthehesh këtu kurrë më. Mendoja se ishe më e zgjuar".

"Ashtu?" bëri ajo. Përsëri i shikoi lulet. Me siguri vlenin nja pesëdhjetë dollarë. Dikush kishte lënë një tufë lulesh në varrin e Kuentinit. "Me të vërtetë ashtu kishe menduar".

"Prapëseprapë nuk çuditem me sjelljen tënde", thashë unë. "Ti je në gjendje të bësh gjithçka. Ti s'ia var torbën askujt. S'je ngushtë për asnjeri".

"Aha, mendon në atë punën tënde", iu kujtua asaj. Po shikonte varrin. "Më vjen keq për atë që ndodhi, Xhezon".

"Edhe unë mendoj se tash të vjen keq. Tash do të flasësh me të butë dhe me përulje si qengji. Por, përsëri s'është dashur të vije. Babai nuk ka lënë kurrfarë trashëgimi, mos ki dert. Nëse s'më beson, pyete xha Morin".

"Mua s'më duhet kurrgjë", u përgjigj. Po shikonte në varr. "E pse nuk më kanë njoftuar për vdekjen? Rastësisht lexova në gazetë. Në faqen e fundit. Fare rastësisht".

Nuk i dhashë kurrfarë përgjigje. Të dytë qëndronim vetëm dhe po e vështironim varrin, dhe atëherë më shkoi nga mendja në fëmijërinë tonë, pastaj më ra në mend jo kjo jo ajo dhe përsëri e ndieja veten qesharak si të isha i tërbuar për diçka, kur më ra në mend se tash tërë kohën duhet ta kemi në shtëpi xha Morin dhe se ai sipas stilit çdo gjë do të rregullojë ashtu si më kishte lënë mua parës, që të shkojë vetëm nëpër shi. Atëherë i thashë motrës:

"Ti qenke me të vërtetë e pafytyrë kur u përvodhe deri këtu fill pas vdekjes së tij. Mirëpo, s'ke kurrfarë leverdie. Mos kujto se do të nxjerrësh ndonjë dobi se u përvodhe këtu. Nëse s'mund të mbahesh më në kalin tënd të lartë, atëherë do të mësohesh të

ecësh këmbë. Në shtëpinë tonë nuk ta dimë as emrin. A s'e di ti? S'njohim më as ty, as atë, as Kuentinën. E di ti këtë?"

"E di", tha ajo. "Xhezon", tha ajo duke e shikuar varrin panda, "nëse më mundëson që ta shoh time bijë vetëm për një minutë, do të të jap pesëdhjetë dollarë".

"Ti s'i ke fare pesëdhjetë dollarë", i thashë.

"A pajtohesh?" më pyeti pa më shikuar.

"Pale t'i shoh të hollat një herë", thashë unë. "S'besoj të kesh aq të holla".

Vura re se si kërkoi me duar diçka nën mantel, pastaj e zgjati dorën. Pasha zotin grushtin e kishte plot me para. Pashë edhe nja dy-tri verdhushka.

"Ende të dërgon të holla? Sa t'i dërgon?"

"T'i jap njëqind dollarë. Dakord?" tha ajo.

"Vetëm një minutë" përsërita. "Do të bësh ashtu si të them unë. As për një mijë dollarë s'do të lejoja që ta marrë vesh këtë Nëna".

"Ani mirë", tha ajo. "Do të punoj ashtu si thua ti. Ta shoh vetëm një minutë. Tash s'do ta lus më dhe as që do të hap telashe. Fill pastaj do të udhëtoj".

"M'i jep të hollat", thashë unë.

"A s'më beson?" e pyeta.

"Jo", ma priti. "Të njoh fort mirë. Jam ritur me ty".

"Edhe ti ke fytyrë të flasësh për besimin që duhet patur ndaj njerëzve", bëra unë. "Mirë, s'kam çare pa u strehuar nga shiu. Lamtumirë". U shtira kinse u nisa.

"Xhezon", më tha ajo. U ndala.

"Ani? Ngutu. Unë u bëra qull", i thashë.

"Po mirë", tha. "Ja të hollat". S'na kishte diktuar askush. U ktheva t'i marr të hollat. Ende i mbante në grusht. "A do ta mbash fjalën?" më tha duke më shikuar nën vello. "Ma jep fjalën?"

"Hajde, m'i jep", i thashë. "Mos deshe të dalë dikush e të na shohë këtu?"

I dha të hollat. I futa në xhep. "A do ta mbash fjalën, Xhezon?" më pyeti. "Nuk do të lusja sikur të kishte shtegdalje tjetër.

"Ke tërësisht të drejtë se s'ka shtegdalje tjetër", i thashë me përbuzje. "U mor vesh, do ta mbaj fjalën. A s'ta dhashë fjalën e nderit? Por, do të veprosh ashtu si do të të them unë".

"Mirë, mirë", bëri ajo.

Atëherë i thashë se ku do të shiheshim dhe shkova te pronari i çejzes. Nxitova dhe arrita në çastin që po i zgjidhnin kuajt. Pyeta se a kishin paguar për çejze, kurse karrocieri më tha se s'ia kishin paguar pastaj unë thashë se zonja Kompson kishte harruar diçka dhe se i duhet çejza përsëri, kështu që e mora çejzen përsëri. Minku voziste. Ia bleva një cigare dhe ashtu zumë të shëtisim me të rrugëve të paralagjeve derisa ra terri. Paskëtaj, Minku tha se duhet t'i kthente kuajt në stallë kurse unë i premtova t'ia blejë edhe një cigare dhe kështu arritëm në rrugën tonë dhe unë hyra në oborrin e shtëpisë sonë e pastaj u ndala para shtëpisë. U ndala në hajat derisa i dëgjova Nënën dhe xha Morin më katin e parë, pastaj vazhdova nëpër derën e pasme të kuzhinës. Ajo dhe Beni ndodheshin me Dilzin në kuzhinë. Thashë se Nëna dëshironte ta shihte foshnjën, prandaj e mora dhe e çova në shtëpi. Në paradhomë gjeta mantelin e Xha Morit, ■ mbështolla me të, ■ mora në prehër u ktheva në rruginë dhe hyra me fëmijën në çejze. I thashë Minkut të më çonte në stacionin hekurudhor. Kisha frikë të kaloja afër stallës, prandaj i ramë rrotull. E vura re si po priste në këmbë nën lampion, prandaj i thashë Minkut t'i afrohej trotuarit dhe kur t'i thosha unë "përpara" le t'u binte kamxhik kuajve. Në atë çast e çmbështolla foshnjën dhe e mbajta në dritaren e pajtonit, kurse Kedi e diktoi dhe m'u duk se kërceu përpara.

"Bjeri, Mink", i urdhërova dhe Minku kërciti me kamxhik kështu që kaluam pranë saj vetimthi si pompa zjarrfikëse. "E tash ngjitu në atë tren ashtu si ma dhe fjalën", i brita unë. Shikoja nga dritarja e pasme sesi vraponte pas nesh. "Bjeri përsëri", i dhashë urdhër Minkut, "tash shkojmë në shtëpi!" Kur kthyem në këmbë ajo ende vraponte pas nesh.

Kështu atë mbrëmje përsëri i njeh të hollat dhe i lashë përanash dhe nuk ndihesha keq. Me vete, thashë: këtë do ta kesh mësim të mirë, motër. Unë mendoj se tash e tutje do të kesh të qartë se nuk mund t'ia prishësh dikujt punën aq lehtë dhe të skapullosh pa pasoja. As që më shkonte nga mendja se ajo nuk do ta mbante fjalën dhe se nuk do të niset me atë tren. Mirëpo, asokohe, ende nuk i njihja femrat. Isha aq tarallak saqë u besoja fjalëve të tyre. Dhe ja, dreqi më rroftë nëse të nesërmen në mëngjes s'ia behu tek unë në dyqan. Mirëpo, u

tregua e kujdesshme kështu që erdhi me vello dhe nuk këmbeu asnjë fjalë me askënd. Ishte e shtunë paradite meqë unë atëherë isha në dyqan kurse ajo, me hapa të shpejtë nxitoi tek unë para tavolinës së shkrimit.

"Gënjeshtar, gënjeshtar i dreqit!" ma priti.

"Mos u rrokate?" i thashë me zemërim. "Si guxon të hysh këtu në këtë mënyrë?" Zuri të më shprazë një breshëri fjalësh, mirëpo unë ia mbylla gojën menjëherë. I thashë: "Për shkak tëndin, unë humba një punë: mos deshe ta humbas edhe këtë? Nëse ke për të më thënë gjë, do të shihemi diku si të errësohet. Ç'ke për të biseduar me mua? A s'kam bërë unë të gjithë ato që i premtova? A s'të thashë se do ta shohësh vetëm një minutë? Po mirë, a nuk e pe? "Ajo qëndronte aty dhe më vështronte duke u dridhur si ta kishte sulmin e malaries. Grushtat i kishte shtrënguar si të kishte krizë nervore. "Unë e mbajta fjalën", i thashë. "Ti je gënjeshtare. Ti më pate premtuar se do të udhëtoje me atë tren. A s'ma dhe fjalën? A s'më premtove? Nëse tash i kërkon që të t'i kthej të hollat, atëherë gabon. Vetëm provo! Po të më jepje edhe një mijë dollarë, ti do të më mbeteshe borxh meqë unë i hyra një rreziku të madh për hatrin tënd.

E nëse të shoh ose nëse dëgjoj se ende je në qytet pasi të ikën treni nr. 17, atëherë do t'u tregoj Nënës dhe xha Morit. Kështu, do të presësh një kohë të gjatë para se ta shohësh fëmijën". Ajo qëndronte dhe më maste me shikim teksa duart i lakonte njërën me tjetrën.

"Dreqi të marrtë", tha ajo. "Të marrtë dreqi!"

"Mirë, mirë", ia ktheva unë. "Pajtohem edhe me këtë që thua. Por, ki kujdes se ç'thua tash. Nëse mbetesh pasi të largohet treni nr. 17, unë do t'u kallëzoj sesi është puna".

Si shkoi ajo, e ndieja veten më mirë. Me vete thosha: unë mendoj se do të mendosh mirëfilli më parë para se të më lësh edhe një herë pa atë vendin e premtuar të punës. Atëherë unë isha kalama axhami dhe budalla. U besoja njerëzve kur premtonin se do të bënin diçka për mua. Që atëherë, u bëra më i mençur. Fundja, si them gjithmonë, mua s'më duhet ndihma e askujt për të përparuar në rrugën e jetës. Unë mund të qëndroj në këmbë ashtu si kam qëndruar ngaherë. Në atë çast më vajtën në mendje Dilzi dhe xha Mori. Më tha mendja se ajo do të mund ta kandiste Dilzin, kurse xha Mori ç'nuk do

të bënte për dhjetë dollarë. Kurse unë jam këtu, nuk mund ta lë as dyqanin për ta mbrojtur Nënën. Ai më thotë pa ndarë: nëse qenka thënë që njerin ta kem të paralizuar, lavdi zotit që të kam ty, sepse mund të mbështetem në ty. Kurse unë ia kthej: unë mendoj se sipas gjasave kurrë nuk do të mund të jem aq larg dyqanit që të mos mund të arrish tek unë. Dikush të paktën duhet ta ruajë atë që na ka mbetur, mendoj unë.

Me të arritur në shtëpi, fola me Dilzin. I thashë se Kedi e kishte leprozën, ndaj, e mora Biblën dhe ia lexova fragmentin ku flitej për atë sesi ishte kalbur mishi i të sëmurit nga leproza, i thashë gjithashtu se në qoftë se ajo apo Beni, ose edhe Kuentina e vështrojnë vetëm një herë Kedin se edhe ata do të sëmuren nga leproza. Kështu mendoja se ua kisha treguar qejfin të gjithëve deri në ditën kur arrita në shtëpi dhe e gjeta Benin duke rënkuar. Çirrej si t'ia rripnin lëkurën dhe askush s'mund ta qetësonte. Nëna më tha: jepi atë pandofle. Dilzi shtirej kinse nuk kishte dëgjuar as gjysmë fjale. Nëna e përsëriti urdhrin, kurse unë thashë: Unë ika, s'mund ta duroj më këtë këlthitje të mallkuar. Epo, thashë unë, unë mund të duroj shumë gjëra, unë s'pres shumë nga njerëzit, mirëpo nese duhet të punoj gjithë ditën e lume në atë tregtizë të mallkuar, atëherë, pasha zotin, meritoj pak qetësi gjatë ngrënies. Si thashë se do të ikja, Dilzi tha: "Xhezon!"

Po në atë çast e pata të qartë se ç'kish ngjarë, po megjithatë që të jem sa më i sigurt, shkova ta marr pandoflen dhe e solla në dhomë dhe, pikërisht ashtu si parandjeva; si e vuri re Beni pandoflen, atij ju bë se do ta vrisnim. Atëherë, unë e detyrova Dilzin që të pranonte se ç'kish ngjarë, e pastaj i kallëzova edhe Nënës. Afër mendsh, na u desh ta çonim lart në krevat menjëherë, e meqë atmosfera u pashit një grimë, unë ia futa frikën në palcë Dilzit. Aq sa mund t'ia kallësh frikën një zezaku. Ngaqë, është hall me shërbyesit zezakë nëse punojnë një kohë të gjatë në një familje të njëjtë. Bëhen aq të krekosur saqë s'vlejnë për pesë para. Mendojnë se ata janë padronë dhe se mund ta tiranizojnë tërë familjen.

"Unë s'di se pse mos t'ia lejojmë asaj të shkretës që të mos

e shohë fëmijën e vet", vërejti Dilzi. "Po të qe gjallë zotëri Xhezoni, puna do të ishte ndryshe".

"Mirëpo, ç'e do zotëri Xhezoni nuk është gjallë", ia ktheva unë. "Unë e di se ju s'ua varni torbën urdhrave të mi, mirëpo, e di po ashtu se ju do t'i zbatoni porositë e Nënës. Ju e trazoni dhe e sëkëlldisni pareshtur derisa ta futni edhe atë nën dhe, e pastaj mund ta mbushni shtëpinë me llojlloj hajvanash dhe bërllokësh. Kush dreqi ju nxiti që t'i lejoni atij idioti që ta shohë atë?"

"Xhezon, ti je njeri zemërgur, s'di a je ti njeri apo çfarë je", më qortoi Dilzi. "Lavdi zotit që zemrën e kam më bujare se ti, qoftë ajo edhe zemër e zezë".

"Kryesorja është që unë ta mbush hambarin", ia ktheva unë. "Nëse e përsëritni edhe një herë një fjalë të tillë, as ju nuk do të ushqeheni nga ai hambar".

Kur e pashë Kedin për herë të dytë, i thashë se nëse provon edhe një herë ta mashtrojë Dilzin, atëherë Nëna do ta dëbojë e do ta pushojë nga puna Dilzin, Benin do ta mbyllë në çmendinë në Xhekson dhe do ta marrë Kuentinën e do të ikë me të. Ajo më vështroi për një copë here. Nuk kishte llambë në shtyllat e rrugës atypari, kështu që s'vura re fytyrën e saj. Mirëpo, ndieja se ma kishte qepur shikimin. Kur qemë të vegjël e kur Kedi hidhërohej dhe nuk mund ta bënte atë që i tekej, asaj fillonte t'i dridhej buza e epërme. Sa më shpesh që i dridhej, aq më tepër i shiheshin dhëmbët. Tërë kohën qëndronte si huri i gardhit, nuk i lëvizte asnjë muskul, por buza e epërme i dridhej gjithnjë e më tepër dhe ia zbulonte dhëmbët. Ndërkaq, ajo nuk tha asnjë fjalë. Veçse u pajtua me fatin me fjalët:

"Në rregull. Sa?"

"Epo mirë, nëse një shikim inë dritarëzen e pajtonit vlente njëqind dollarë, atëherë mund të llogaritësh".

Paskëtaj, sjellja e saj ishte mjaft e mirë, vetëm një herë deshi ta shihte gjendjen e kontos së bankës.

"Unë e di se pas kambialit është nënshkrimi i Nënës", sqaronte ajo, "mirëpo, dua ta shoh me sytë e mi atë konto. Dua ta di se ku sosen kambialet".

"Kjo është punë për Nënën", i thashë unë. "Nëse ty ta merr mendja se ke të drejtë t'i fusësh hundët në punët e saj private, atëherë do t'i them se ti mendon se ato kambiale falsifikohen

dhe se kërkon të bësh kontrollimin zyrtar të llogarive, sepse Nënës nuk i beson".

Ajo as që bëri gëk me gojë dhe as që lëvizi, e dëgjova vetëm duke nënëritur: qoftë mallkuar, ah, qoftë mallkuar dhëntë zoti!

"Ti veç fol", i thashë unë. "Unë mendoj se nuk është kurrfarë sekreti se ç'mendojmë *ne* të dy për shoqishoin. Mos deshe të t'i kthejnë paratë?"

"Dëgjo, Xhezon", më luti ajo, "mos më gënje tash, të paktën. E kam fjalën për fëmijën. Unë nuk kërkoj kurrfarë llogarie. Nëse deri tash nuk mjaftonte ajo që jepja, atëherë çdo muaj, do të dërgoj më shumë. Vetëm se ma jep fjalën se ajo... Se ajo... Ti mund ta bësh këtë. Disa gjëra për të. Sillu mirë me të. Ato cikërrima që unë s'mundem... që s'm'i lejojnë... Por, jo, ti s'e bën këtë. Ti s'ke pasur pikë gjaku të nxehtë në vete. Dëgjo, nëse e kandis Nënën aë të ma kthejë fëmijën, do të t'i jap një mijë dollarë".

"Paj ti s'i ke një mijë dollarë", iu përgjigja. "Kësaj here e di se më gënjen me siguri".

"I kam. Do t'i kem. Mund t'i gjej"

"E di unë si do t'i fitosh", e qesëndisa. "Tamam ashtu si fëmijën. E kur të të rritet edhe fëmija..."

Në e parë kujtova se do të ma lidhte shpullë. Pastaj, s'dija se ç'bluante. Për një hop u soll si ndonjë lodër që është kurdisur së tepërmi dhe që duket se do të prishet e do të bëhet copë e grimë.

"Oh, unë kam luajtur mendsh", më tha ajo. "Unë s'jam në vete. Unë s'kam si ta marr atë. Mbaje ti. Si s'më shkoi kjo nga mendja. Xhezon, vazhdoi ajo duke më rrokur për dore teksa duart i kishte të nxehta si t'i kishte ethet, "ma jep fjalën se do të kujdesesh për të. E ke kushërirë. Të një gjaku. Premtomë, Xhezon. Ti, megjithatë, emrin e Babait e mban. A kujton se do të duhej ta lusja dy herë atë? Apo veç një herë?"

"Ashtu na qenka puna", ia ktheva unë, "ai më paska lënë diçka trashëgim. Ç'do nga unë? Ta blej përparësen dhe ta ngas karrocën e fëmijëve? Unë s'të kam detyruar t'u hysh telasheve. Tekefundit, unë rrezikoj më shumë se ti, ngaqë ti s'rrezikon hiç kurrgjë. Prandaj, nëse kujton se..."

"Jo", tha ajo dhe po në atë çast zuri herë të qeshte dhe herë të mos qeshte. "Jo, unë me të vërtetë s'rrezikoj kurrgjë", fliste

ajo pa pushuar duke qeshur dhe duke e mbajtur gojën me dorë. "Kurrë... Kurrë... Kurrgjë", nënëroi ajo.

"Po, mjaft më", i thashë

"Po mundohem të mos qesh", m'u përgjigj duke e mbyllur gojën me dorë, "Ah, zot, oh, zot."

"Unë ika prej këtu", i thashë. "S'është mirë të më shohin këtu. E ti, të qërohesh sa më parë nga qyteti. More vesh?"

"Prit një grimë", më tha ajo duke më zënë për dore. "Më kaloi lemza. S'do ta kem më lemzën. A ma jep fjalën, Xhezon?" më pyeti ajo kurse mua m'u duk se sytë e saj ma çiknin fytyrën. "A më premtoin? Nëna... Ato të holla... Nëse i duhet gjë vogëlushes... Nëse të dërgoj kambiale të tjera, pos atyre të rregullt, mujorë, a i jep ti ata që i duhen? A s'i thua askujt? Do të përkujdesesh që t'i ketë të gjitha, çdo gjë si edhe vogëlushet e tjera?"

"U mor vesh", iu gjegja, "por, vetëm derisa të sillesh urtë e butë, si të ka hije dhe të veprosh ashtu si të them unë".

Kur Ërlli erdhi para tregtizës, me kapelë në kokë, më tha: "Po shkoj me nxitim te Roxhersi për të ngrënë pak bukë. Më duket se sot s'do të kemi nge që të shkojmë për drekë në shtëpi".

"E pse mos të kemi nge?" e pyeta unë.

"Kur jepet ajo shfaqje në qytet ose diçka lidhur me të", më thotë ai. "Do të japin shfaqje edhe pas dite, prandaj deri atëherë të gjithë kanë dëshirë t'i kenë blerë gjërat e duhura, në mënyrë që të arrijnë me kohë. Atëherë, e mira e së mirës është që të shkojmë fët e fët te Roxhersi".

"Në rregull", pohova unë. "Tekefundit, ti ha për vete, e ke lukthin tënd. Nëse dëshiron të bëhesh rob i punës, mua s'më prish punë".

"Më duket se ti s'do të bëhesh rob i asnjë lloj pune", ma ktheu.

"Jo, s'bëhem në mos qoftë puna e Xhezon Kompsonit", ia prita edhe unë.

Kur shkova në pjesën e pasme të tregtizës dhe e hapa zarfin, u çudita kur brenda s'e gjeta çëkun po mandapostën. E po, kështu është puna, lum zotërie. Nuk i zihet besë asnjë femre. Ajo ma punon mua, edhe pse iu ekspozova rrezikut dhe ende jam në rrezik që të diktojë e të marrë vesh Nëna sesi ajo një apo dy herë në vit vjen këtu, kurse unë pastaj duhet

ta gënjej Nënën. Ja si të falëndron. Bile as që do të befasohesha sikur edhe ta ketë njoftuar postën që të mos ia japë paratë askujt në dorë, pos vogëlushes. Asaj qaramaneje, pesëdhjetë dollarë. Kah më kujtohet se si unë i kam parë të pesëdhjetë dollarët kur isha njëzetenjëvjeçar, ndërsa të gjithë shokët e mi pasditen e kishin të lirë, të lirë e kishin edhe tërë të shtunën, kurse unë punoja dhe robtohesha në dyqan. Unë ngaherë them: si mund të shpresosh se dikush do të jetë në gjendje ta frenojë atë çupulinë kur nëna e saj i jep para pas kurrizit tonë. Jeton në të njëjtën shtëpi ku ke jetuar edhe ti, edukohet në mënyrë të njëjtë si ti, them me vete. Unë mendoj se Nëna i di më mirë këto punë se ti, që nuk ke shtëpi e katandi të njëmendtë. "Në daç t'i dërgosh të holla", i them unë, "dërgoji përmes Nënës, por mos i jep asaj. Nëse unë i hyj rrezikut hove-hove gjatë disa muajve, atëherë edhe ti është e udhës të veprosh ashtu si të them unë, përndryshe e prishim ujdinë".

Pikërisht atëherë kisha ndërmend ta rregulloja këtë, meqë nëse Ërlli pandeh se unë do të shkoj turravrap rrugës dhe do të zhvat ngutazi ndonjë ushqim 25-sencësh dhe ashtu do ta prish lukthin, atëherë, pasha zotin, është mashtruar. Ndoshta s'kam fat të rri me këmbë mbi tavolinën e mahagonisë, mirëpo, mua më pagojnë për atë që punoj në këtë dyqan. Nëse unë jashtë dyqanit nuk mund të çoj një jetë të denjë për një njeri të civilizuar, atëbotë do të shkoj atje ku mund të jetoj më mirë. Unë jam i zoti që të bëhem i pavarur. Mua s'më lypset tavolina e askujt për t'u mbështetur! Pikërisht në momentin që po mendoja t'i hyj punës, m'u desh t'i lë të gjitha dhe të nxitoj t'i shes gozhda apo diçka të tillë një të pagdhenduri për dhjetë sencë, ndërsa Ërlli diku e zhvat sanduiçin e ndoshta ka të ngjarë se është duke u kthyer në dyqan. Papritmas, vura re se nuk kisha më kambiale-bjanko. M'u ikujtua se duhej t'i gjeja diku, mirëpo, tash ishte vonë. Atëherë e pashë Kuentinen. Ajo hyri nga dera e pasme. Dëgjova se si e pyeti Xhobin plak në isha në dyqan. Pata aq kohë sa ta fus letrën me mandapostë në syzë dhe ta mbyll atë.

Iu afrua tavolinës. E shikova orën.

"Ishe në drekë?" e pyeta. "Tash është ora dymbëdhjetë. Sapo dëgjova kur ra ora dymbëdhjetë. Me gjasë ti shkove fluturimthi në shtëpi dhe u ktheve vetimthi".

"Unë s'shkoj për drekë në shtëpi", u përgjigj ajo. "A arriti sot një letër për mua?"

"E prisje a? Mos ke ndonjë dashnor që të shkruan?"

"Nga Nëna, a mos më ka arritur ndonjë letër nga Nëna ime?" pyeti duke më shikuar.

"Gjyshja jote ka marrë një letër nga ajo", i them unë. "Unë s'e hapa. Prit sa ta hapë ajo. Ajo do të ta tregojë patjetër".

"Ju lutem, Xhezon", tha ajo pa i vënë re fjalët e mia, "a mos arriti ndonjë letër për mua?"

"Ama ç'ka ngjarë", e pyes. "Kurrë s'më thoshte mendja se ti ditke të jesh e kujdesshme me dikënd. Me gjasë, nga nëna pret para?"

"Më ka pas premtuar se... Ju lutem, Xhezon, a ka arritur gjë për mua?"

"Sot, bën vaki ishe në shkollë, ngaqë dikush të paska mësuar të thuash "ju lutem" prit një grimë derisa t'i shërbej atij myshteriu".

Shkova dhe i shërbeva. Kur u ktheva, ajo ishte zhdukur pas tavolinës. Vrapova. Vrapova rrotull tavolinës dhe e zura në momentin që e fuste dorën në syzë. Duke ia shtypur gishtërinjtë në tavolinë, e detyrova ta lëshonte letrën të cilën ■ mora.

"Ashtu vepron ti, apo?" e qortova.

"Ma jepni. E paskeni hapur. Ma jepni. Ju lutem, xhaxha Xheson. Aman. Është letra ime, e pashë emrin tim".

"Të jap unë ty dajak, dacka, ja se ç'të jap! Si guxon të hallakasësh në shkresat e mia?"

"A ka të holla në letër?" pyeti duke e zgjatur dorën për ta marrë. "Ajo më pat thënë se do të m'i dërgojë do të holla. Ma pat dhënë fjalën. Ma jepni".

"E, ç'të duhen paratë?" e pyes.

"Më pat thënë se do të m'i dërgojë. Ma jepni. Ju kam rixhanë, xha Xhezon. S'do t'ju lus më kurrë për asgjë, në m'i dhënçi tash".

"T'i jap, nëse më jep pak kohë", i thashë. E nxora letrën dhe mandapostën nga zarfi dhe ia dhashë letrën. Ajo deshi ta rrëmbejë mandapostën menjëherë, pa e vështruar fare letrën. "Më parë, nënshkruaje".

"Sa?" pyeti.

"Lexoje letrën. Me siguri në të shkruan".

Ajo e lexoi fët e fët letrën.

"Nuk thotë kurrgjë", tha ajo. E lëshoi letrën për tokë. "Sa?"

"Dhjetë dollarë", iu përgjigja.

"Dhjetë dollarë?" përsëriti e habitur duke m'i ngulur sytë.

"Ti do të duhej të ishe e stërlumtur që merr edhe kaq", i them unë. "Ende të qet buza tambël. E tash, pse të duhen paratë me aq nxitim?"

"Dhjetë dollarë?" fliste me zë të ulët, si në ëndërr. "Vetëm dhjetë dollarë?" Përsëri deshi ta rrëmbejë mandapostën. "Gënjeni!" klithi ajo. "Hajdut! Hajdut!"

"Si ke fytyrë moj?" i thashë duke iu shmangur.

"Ma jepni!" bërtiste ajo. "Janë të hollat e mia. Mua m'i ka dërguar Nënokja ime. Dua ta shoh mandapostën. Më lini ta shoh".

"Dëshiron ta shohësh?" i thashë duke e mbajtur fort atë. "E si do ta shohësh?"

"Vetëm ta shoh, xha Xhezon", tha ajo. "Ju lutem. S'do t'ju lus më kurrë për asgjë".

Ti mendon se po gënjej, apo jo?" e pyeta. "E po mu për këtë s'do ta shohësh mandapostën.

"Por, vetëm dhjetë dollarë", tha si e shastisur. "Kurse ajo më tha... Ajo më tha... Xha Xhezon, aman, ju lutem, ju kam rixhanë. Unë duhet të kem një shumë të caktuar parashë. Më nevojiten së tepërmi. Ma jepni, xha Xhezon. Atëherë do të bëj ç'të doni".

"Më thuaj pse je aq ngushtë për to".

"Më duhen", u përgjigj ajo. Më shikonte. Pastaj, e largoi shikimin nga unë pa bërë vërr me sy. E dija se po kurdis ndonjë gënjeshtër. "I kam borxh", tha ajo. "S'kam çare pa i kthyer. Duhet t'i kthej që sot".

"Kujt?" e pyeta. I shtrëngonte duart si të donte t'i thyente. E vështroja se si po përpiqej të trillonte ndonjë gënjeshtër. "Mos ke marrë me veresi përsëri diçka në ndonjë dyqan?" e pyeta përsëri. "Nuk mund të ma hedhësh me kopalla të tilla. Nëse e gjen ndokënd në këtë qytet që të jep veresi diçka pas asaj që u kam thënë, atëherë unë jam gomar".

"Një vajzë", kinse ju kujtua, "një vajze i kam borxh. Prej saj mora hua. Duhet t'ia kthej borxhin. Xha Xhezon, m'i jepni të hollat, ju lutem, Do të bëj ç'të doni. S'kam çare pa i pasur ato të holla. Do t'ju paguaj nëna ime. Unë do t'i shkruaj që t'ju

paguajë dhe kurrë më s'do t'ju lus për kurrgjë. Letrën time mund ta lexoni. Ju lutem. Xha Xhezon. M'i jepni ato para".

"Më thuaj pse të duhen paratë e atëherë do të shoh", i them. "Vetëm më thuaj". Ajo s'largohej nga vendi, duke e shtrydhur fustanin me duar. "Mirë pra", i them unë, "nëse s'të mjaftojnë dhjetë dollarë, unë i çoj në shtëpi te Nëna ime dhe atëherë do të dish se ç'do të ndodhë me to. Ta merr mendja, nëse ti je aq e pasur edhe s'të duhen ata dhjetë dollarë..."

Qëndronte aty, e shikonte dyshemenë dhe nënëronte ngadalë: "Ajo më tha se do t'i dërgojë paratë. Tha se ajo do t'i dërgojë të hollat këtu, ndërsa ju thoni se nuk i dërgon. Ajo tha se këtu kishte dërguar shumë të holla. Dhe thotë se ato të holla janë për mua, që edhe unë të marr diçka nga ato të holla. Kurse ju thoni se s'ka të holla".

"Ti di për atë sa unë", thashë unë. "Pashë se ç'bëhej me ato kambiale".

"Po", tha duke shikuar në dysheme. "Dhjetë dollarë, dhjetë dollarë".

"Lutju zotit që janë vetëm dhjetë dollarë. Ja, nënshkruaje", i thashë duke ia dhënë mandapostën me fytyrë kah tavolina duke e mbajtur dorën në të.

"A bën ta shoh? Dua vetëm të shoh. Sadoqoftë, unë nga ju do të kërkoj vetëm dhjetë dollarë. Kusurin mbajeni. Do të doja ta shoh mandapostën".

"Pas kësaj sjelljeje tënde, s'ta tregoj", iu përgjigja. "Vetëm diçka mos harro, kur të jap urdhër të bësh diçka, s'ke çare pa më dëgjuar. Tash, nënshkruaju këtu në këtë vijë".

E mori pendën, mirëpo, në vend që ta firmoste vetëm qëndronte aty kokulur, kurse penda i dridhej në dorë. Mu si nëna. "O zot, o zot", klithi ajo.

"Po, ashtu është. Atë duhet ta mësosh, edhe në mos mësofsh kurrgjë. Firmosu tash dhe qërohu".

E nënshkroi.

"Ku janë të hollat?" pyeti.

E mora mandapostën, e tera dhe e futa në xhep. Dhe pastaj ia dhashë dhjetë dollarë.

"E tash pasdite të shkosh në shkollë, më dëgjove", i thashë. Nuk më dha kurrfarë përgjigje. E bëri tutël bankënotën në dorë si të ishte ajo ndonjë rreckë apo diçka e tillë dhe doli nga dera e përparme në çastin që po hynte Ërlli. Me të ishte edhe një

myshteri dhe u ndalën pranë derës. Unë i përgatita gjërat e mia, e vura kapelen dhe u nisa kah dera.

"A pat shumë punë?" më pyeti Ërlli.

"Jo edhe aq", iu përgjigja. Shikonte kah dera.

"Makina juaj është ajo atje?" pyeti. "Më mirë sot të mos shkoni në shtëpi në drekë. Para shfaqjes së pasdites, me gjasë do t'ia beh edhe një valë e myshterinjve. Hani diçka te Roxhersi dhe vini një bon në kasë".

"Shumë ju falemnderit", unë i thashë, "por, unë ende di se si ta ushqej veten më duket".

Dhe pikërisht aty do të ngujohet ai, duke e vështruar derën si ndonjë skyfter derisa të kthehem unë. Besa, do të bëj rojë një copë here të mirë. Unë u nguta sa më erdhi ndoresh. Me vete thashë për herë të fundit këtë e ke bjanko kambial të fundit, mundohu t'i gjesh edhe disa të tjerë. Por, në atë rrëmujë s'të kujtohej asgjë prej gjëje. Dhe tash ajo shfaqja e mallkuar duhej të mbahej te ne pikërisht ditën kur unë i kërkoja ato çeqe, dhe pos detyrave të tjera që i kisha, bie fjala, barra e mbajtjes së familjes tash edhe Ërllit i duhej që të sogjonte te dera si ndonjë skyfter.

Shkova në tipografi dhe e luta atje një të njohurin tim se mos kishte gjë për mua, ngaqë dëshiroja të bëja shaka me një mik, mirëpo, ai nuk kishte kambiale-bjanko. Mirëpo, ai më tha që të pyesja në godinën e operës. Atje dikush kishte grumbulluar plot e përplot shkresurina dhe letra të vjetra nga Banka e vjetër Tregtare dhe Bujqësore kur kishte falimentuar ajo. Kësodore, unë u rashë edhe disa rrugicave që të mos më diktonte padroni Ërll dhe më në fund e gjeta Simonsin plak, i cili ma dha çelësin e bodrumit ku shkova dhe zura të kërkoj. Tekefundit, gjeta një bllok kambialesh të bankës së Sent-Luisit. Ajo, gjithsesi, kësaj radhe do të kërkojë që ta shohë kambialin nga afër. Ah, me siguri do të vlejë edhe ky. S'kisha kohë për të bjerrë.

U ktheva në dyqan. "Pata harruar do letra që Nëna më pati thënë t'i çoj në bankë", thashë me të arritur. Shkova pas, te skrivania dhe e rregullova kambialin. Në ngutje e sipër, me vete thosha: mirë është që Nëna s'po sheh mirë pranë asaj lavireje në shtëpi, e shkreta krishtere e durueshme. Unë i them: ti Nëno e di, si unë, se ç'mund të bëhet kjo qaramane, por, punë për ty, nëse dëshiron ta mbash dhe ta ritësh në shtëpinë tonë nga

dashuria për hir kujtimit të Babait. Në çaste të tilla ajo ia niste vajit dhe avazit duke thënë se atë vogëlushe e kishte të mishit dhe të gjakut të saj, ndërsa unë i thosha: dakord, bëj si të duash, mua s'më prish punë, unë e duroj, nëse e duron ti.

E futa përsëri letrën në zarf, e ngjita zarfin dhe dola.

"Mos u vononi më shumë se sa duhet", më tha Ërlli.

"Mirë", iu përgjigja.

Shkova në zyrën e telegrafit. Atje ishin të gjithë ata dallaveraxhinj që i njihja.

"Ore, djema, mos fitoi kush ndonjë milion?" pyeta.

"Ç' mund të fitosh në një treg të këtillë?" bëri Doktori.

"E po, si është puna?" pyeta. Hyra brenda dhe shikova. "Mbase s'do t'ju marrë në qafë një cikërrimë si është rënia e çmimit të pambukut, apo jo?" thashë unë. "Mendoja se jeni goxha të zgjuar për këso rastesh".

"E marrtë dreqi zgjuarësinë!" tha Doktori me mllef. "Në orën dymbëdhjetë kursi ra për dymbëdhjetë poena. Unë falimentova".

"Për dymbëdhjetë poena?" pyeta i habitur. "Pse s'më ka njoftuar asnjeri? Pse s'më keni thënë?" e pyeta telegrafistin.

"Unë e marr kursin ashtu si ma dërgojnë", u përgjigj ai. "Unë s'mbaj zyrë ilegale të spekulantëve".

"Sa më duket, jeni skile e madhe", ia ktheva unë. "Megjithatë, do të mund të më telefononit kur e dinit se sa shumë para harxhoj te ju. Apo ndoshta edhe qarqet tuaja të mallkuara u lidhën *në* dallaveret e përbashkëta me ata dallaveraxhinjtë e Lindjes".

Ai s'm'u përgjigj. U shtir kinse ishte i zënë.

"Disi ju rrinë të mëdha ato pantallona, po e teproni zullumin", i thashë unë. "Droj se së shpejti kafshatën e gojës do të duhet ta nxirrni me djersën tuaj".

"Pse bezdisesh?" ndërhyri Doktori. "Ke edhe tre poena plus".

"Po", i thashë unë, "sikur të shitsha rastësisht. Mirëpo, më duket se nuk zura ngoje diçka të tillë. Ore, çuna, a falimentuan të gjithë ata?"

"Më zunë dy herë", tha Doktori. "Mezi ua mbatha".

"E po mirë", u paraqit O. Snoupsi, "unë ju dhashë sinjale deri tash, edhe unë mendoj se ju duhet të më jepni ndonjë shenjë, të më paralajmëroni".

I lashë duke shitur dhe blerë poena pesë sencësh. Gjeta një zezak dhe e çova që të më sillte një automobil, ndërsa unë e prisja në kënd të rrugës. Nuk e vura re Ërllin duke zhbiruar rrugëve dhe duke e shikuar orën orë e çast, ngaqë nga ai vend s'mund ta pikasja derën e dyqanit. Pas një kohe të gjatë u kthye zezaku.

"E po ku mbete deri tash mor jezit?" e qortova. "Ndoshta u vërtite rreth e rrotull që t'u biesh në sy vajzave?"

"Erdha sa më shpejt që munda", filloi të kërkojë ndjesë ai. "I rashë sheshit ngaqë kishte plot e përplot automobila".

Ende s'e kam njohur zezakun i cili për çdo gjë që bën të mos ketë ndonjë arsyetim. Lere para timonit, kurse atij i teket të bëjë parada. Hyra në veturë dhe i rashë skajit të sheshit. E vura re shikimin e Ërllit nga pragu i derës së dyqanit matanë sheshit.

Shkova në kuzhinë dhe i thashë Dilzit që ta bënin më shpejt drekën.

"Kuentina ende s'u kthye", më tha ajo.

"Ani çka?" ia ktheva unë. "Herën tjetër do të thoni se Llasteri akoma s'është gati për të ngrënë Kuentina e di fort mirë se kur hamë drekën ne. Ngutuni!"

Nëna ishte në dhomën e saj. Ia dhashë letrën. E hapi, e nxori çekun dhe u ul duke e mbajtur në dorë, unë shkova dhe e solla lopatën nga këndi dhe ia dhashë shkrepësen.

"Epo, hajde, ndeze", i thashë. "Sa më parë aq më mirë. Se, përndryshe, tash do t'ia plasësh vajit".

E mori shkrepësen, por, s'e ndezi. Rrinte dhe e shikonte kambialin ngultazi. Pikërisht ashtu si kisha paramenduar.

"Zor e kam", tha ajo. "Kur e di se si barrën tënde të madhe po e ris me shpenzimet që bëj për Kuentinën"...

"Do t'ia bëjmë disi", iu përgjigja. "Hajde, ndeze!"

Mirëpo, ajo rrinte me kambial në dorë.

"Këtë e paska lëshuar ndonjë bankë tjetër", vërejti ajo. "Ato të mëparshmit ishin të bankës së Indianopolisit".

"Po", u përgjigja menjëherë. "Femrat kanë edhe këtë të drejtë".

"Çfarë të drejte?" pyeti.

"Të drejtën të mbajnë të holla në dy banka të ndryshme", thashë unë.

"Ashtu", tha si e lehtësuar nga një barrë duke e vështruar

kambialin për një hop "gëzohem kur e di se ajo është ashtu... Se ka aq... Zoti s'do të zemërohet me mua për këtë", tha ajo me frikë.

"Jo", i thashë. "Jepi fund. Shporrju shakasë".

"Shakasë, thua?" u zemërua ajo. "Kah mendoj se..."

"Unë mendoja se ti ua vije flakën të dyqind dollarëve për çdo muaj", i them unë. "E po, ç'pret. Ta ndez shkrepësen?"

"Do të mund të pajtohesha me fatin dhe t'i pranoj paratë", më tha ajo. "Për hir të fëmijëve. Unë s'jam mburravece".

"Kurrë s'do të kesh qetësi", e këshillova. "Ti edhe vetë e di këtë. Një herë pate vendosur, le të jetë ashtu. Do t'ia bëjmë disi".

"Unë të gjitha ty t'i lë snë dorë", tha e prekur. "Mirëpo, hove-hove kam frikë se të privoj nga të drejtat e tua. Ndoshta një ditë zoti do të më dënojë për këtë. Në daç ti, unë e fsheh edhe krenarinë time dhe do t'i marr paratë".

"A ka kuptim t'ia nisësh tash kështu, ndonëse i ke bërë rrush e kumbulla gjatë pesëmbëdhjetë vjetëve?" e pyeta. "Nëse i djeg edhe tash e tutje, atëherë s'do të humbasësh asgjë, mirëpo, nëse fillon t'i marrësh tash paratë, ke një humbje prej pesëdhjetë mijë dollarësh. Deri tash ia bënim disi. Çanim përpara, apo jo? Unë s'të kam parë në shtëpinë e pleqve".

"Ashtu është", pohoi ajo. "Baskombësve s'u duhet lëmosha e askujt. Kurse mëshira e grave të shthurura s'u duhet fare!"

E ndezi shkrepësen, ia vuri flakën kambialit dhe e hodhi në kaci, kurse mbi flakë e vuri zarfin pastaj zuri t'i vështronte si po digjeshin.

"Ti s'ke haber biro, si është puna", filloi të ankohej. "Lavdi zotit që ti s'do të kuptosh kurrë se ç'mund të ndiejë zemra e nënës".

"Ka shumë gra në botë të cilat s'janë më të mira se ajo", e ngushëllova unë.

"Po, por ato s'janë bijat e mia", po mbrohej ajo. "Prandaj, s'më interesojnë: Unë do ta merrja përsëri Kedin me të gjitha të këqijat që i ka, sepse ajo është mishi i mishit tim dhe gjaku i gjakut tim. Mirëpo, e kam për shkak të Kuentinës".

Ç'është e vërteta, në atë çast, do të qe më së miri t'i përgjigjesha e t'i thosha se s'ka të ngjarë që dikush ta prishë Kuentinën më tepër se sa është e prishur tash, por, u përmbajta më me qejf, duke menduar se edhe unë, fund i fundit, s'pres

shumë nga jeta, po e di se do të ha dhe do të flej rehat, kurse të dy plakat s'do të justifikohen dhe s'do të kukasin në shtëpi gjithë ditën e lume.

"Edhe sebepi yt", vazhdoi ajo. "Unë e di se ç'ndien ti ndaj saj".

"Sa për mua, lirisht thirre në shtëpi".

"Jo' s'dua. Kështu duhet të veproj për hir të kujtimit të babait tënd".

"E si ndodhi kjo? Babai tërë kohën rrekej të të mbushte mendjen që ta pranoje në shtëpi, pasi që Herberti e dëboi?" e kundërshtova unë.

"Ti s'i merr vesh këto punë", u përgjigj ajo. "Unë e di se ti s'ke për qëllim që të ma sjellësh shpirtin në fyt e të ma bësh edhe më zi. Qenka shkruar që unë kërcuna të heq të zitë e ullirit për fëmijët e mi. Unë e duroj fatin tim të lig".

"E mua më duket se ti duke vuajtur ashtu po i qet vetes telashe të tepërta", i thëm unë. Letra ishte djegur. E çova deri te grilat e kaminit dhe e hodha brenda. "Mua më duket se është turp të digjet; paradë e bukur", shtova unë.

"Dhëntë zoti që mos ta shoh kurrë atë ditë kur fëmijëve të mi do t'u teket ta marrin pagën për mëkat", tha Nëna me patetikë. "Më parë do të doja të të shoh ty në arkivol sesa të ndodhë ashtu".

"Si të duash, Nëno", i thashë. "A e hamë më atë drekë?" e pyeta. "Nëse jo, atëherë unë duhet të kthehem menjëherë. Sot kemi shumë punë". Ajo u ngrit. "Unë i fola njëherë", ia përkujtova Nënës. "Por, si duket, ajo e pret Kuentinën, Llasterin apo s'e di se kënd tjetër. Pa prit se unë e thërras". Mirëpo, ajo u ngjit në majë të shkallëve dhe u bëri zë.

"Kuentina ende nuk arriti", tha Dilzi.

"Atëherë unë ika", thashë. "Ha ndonjë sanduiç në qytet diku. Pse të ngatërrohem në përgatitjet e Dilzit?", shtova.

Nëna e pa të udhës t'i lëshonte edhe një zë, ndërsa Dilzi po nënëronte me vete.

"Mirë, mirë, ja po ngutem sa më parë".

"A sheh, mundohem t'ju bëj qejfin të gjithëve", tha Nëna. "Po përpiqem të ta lehtësoj barrën me sa po mundem".

"A mos po ankohem diçka, Nëno?" e pyeta, "Mos të thashë ndonjë fjalë pos se duhet të kthehem në punë?

"Unë e di", vazhdoi nëna me avazin e saj", unë e di se ti

s'ke pasur kushte dhe raste të volitshme si të tjerët, se fati nopran të ka lënë të gremisesh në këtë dyqan provincial. Unë dëshiroja që të përparosh. Unë e dija se yt atë kurrë s'do të kuptonte se ti je ai i cili, je i vetmi, që merr ere nga tregtia, bile edhe kur filloi teposhtëzja e jonë, unë besoja se kur të martohet ajo, Herberti... Si pat premtuar..."

"E pra edhe po duket se ka gënjyer", thëm unë. "Ndoshta s'ka pasur kurrfarë banke. E po të kishte unë prapëseprapë meindoj se ai s'do të shkonte as deri në Misisipi për të kërkuar pune për të".

Derisa po hanim, e dëgjoja Benin në kuzhinë ku e ushqente Llasteri. Unë thëm gjithmonë: nëse duhet të ushqejmë edhe një gojë më tepër, kurse ajo s'i merr paratë e veta, pse s'e dërgojmë Benin në Xhekson. Atje do të ndiehej më mirë me ata që janë njësoj si ai. Unë gjithnjë thëm: edhe vetë zoti e di se në familjen tonë nuk ka arsye për s'di çfarë krenarie, por njeriut nuk i lipset të jetë tepër krenar dhe t'i vijë inati të shikojë se si një tridhjetëvjeçar luan në oborr me fëmijën zezak, se si vrapon përpjetë gardhit, tatëpjetë gardhit *dhe* pëllet si lopa sa herë që të lozin golf matanë. Unë thëm: po ta dërgonim që në fillim në Xhekson, sot të gjithë do të ndiheshim më mirë. I thëm nënës: ti e bëre tënden për të: ke bërë çmos, bile edhe më shumë se të tjerët, e pse pra atëherë nuk e dërgon atje që t'ia shohësh hairin duke u liruar pak nga tatimi i madh që paguajmë. Kurse ajo, ma pret: "Unë *s'e* kam të gjatë, biro. Unë e di se jam barrë për ty". Ndërsa unë i përgjigjem: "Ka kohë që m'i përsërit këto fjalë, Nëno, saqë kam filluar të të besoj", veçse me vete thëm: e di unë vendin ku do ta çojnë edhe atë, e ai vend nuk quhet as Rruga e Qumështit dhe as Bulevardi i Mjaltit. Atëherë ajo zuri të qante, kurse unë i thashë: mirë, mirë, Nëno, edhe unë mburrem me farefisin tim, me gjakun tim shi si të tjerët, ndonëse unë, ç'është e vërteta, ende s'jam i sigurt se nga e kam atë krenari.

Hamë për një copë here, pastaj Nëna e çoi Dilzin te dera e shtëpisë që të shikonte se mos po vinte Kuentina.

"Epo unë sa herë të thashë se ajo s'do të vijë në drekë", i thëm.

"S'është e marrë që të guxojë të sillet ashtu", thotë Nëna. "Ajo e di shumë mirë se unë nuk e lë që të bredhë rrugëve dhe të mos vijë në shtëpi për drekë. A shikove mirë, Dilzi?"

"Atëherë, ndaloja", ia kthej unë.

"Ç'mund të bëj unë?" zuri të ankohej. "Ju të gjithë më keni përqeshur. Gjithmonë".

"Sikur të mos vije të më pengosh, unë do ta mbushja me mend atë", them unë. "Do të më mjaftonte vetëm një ditë që t'ia thyej rrashtën e kresë".

"Ti do të silleshe me vrazhdësi të madhe me të", më thotë ajo. "Ti ke tabijatin e njëjtë si xhaxhai yt, Mauri".

Si e përmendi atë emër, më ra në mend zarfi. E nxora nga xhepi dhe ia dhashë. "S'duhet ta hapësh fare", i them, "banka do të të informojë se sa ke kësaj here".

"Letra është në adresën tënde", vërejti Nëna.

"Ti vetëm hape", i them.

E hapi, e lexoi dhe ma dha.

"Nipi im i dashur", shkruante në të,

"Do të të vijë mirë të dëgjosh që unë jam në atë gjendje saqë mund të përfitoj nga një rast i atillë të cilin s'do ta përshkruaj për arsye se do të t'i shpjegoj këtu, po vetëm atëherë kur të ketë raste që të ta rrëfej më me siguri. Përvoja ime në punë më ka mësuar të jem syçelë, që çdo gjë të besueshme t'ia besoj dikujt gojarisht, ndërsa nga vigjilenca ime e madhe me këtë rast ti do ta kesh të qartë se ç'rëndësi ka ky aksion imi. As që është e udhës të ta përmend se si sapo u dhashë fund kërkimeve të hollësishme të aksionit a apo të ndërmarrjes në fjalë në të gjitha format dhe drejtimet dhe s'ngurroj aspak që të të them se ky është një rast i rrallë që mund të ketë njeriu vetëm një herë në jetë. Tash unë e kam të qartë atë qëllim të cilin e aspirova për një kohë të gjatë dhe paepur; id est, apo përforcimi final i punëve të mia financiare me ç'rast do t'ia kthej vendin që meriton asaj familjeje anëtar i fundit mashkull i të cilës kam nderin të jem vetë: asaj familjeje anëtare e së cilës e nënkuptoj edhe zonjën Nënën tënde dhe fëmijët e saj.

Sikurse ndodh, meqë nuk jam në gjendje t'i shfrytëzoj të gjitha përparësitë që m'i garanton një ndërmarrje e atillë dhe që të mos kërkoj ndihmë në të holla jashtë familjes, sot mora nga kontoja e bankës së Nënës tënde një shumë të vogël, e cila më duhet si plotësim i kapitalit tim të investuar në fillim. Këtu bashkangjitur e ke edhe kambialin e nënshkruar nga unë ku zotohem se do të paguaj për këtë shumë dhjetë për qind

kamatë në vit. As që duhet të të përmend se çfarë formaliteti i thjeshtë është ky, për sigurimin e Nënës tënde në rast të atij çasti të fatit lojë dhe zbavitje e të cilit është ngaherë njeriu. Unë, gjithsesi do ta përdor atë shumë si të ishte imja dhe në atë mënyrë do t'i jap mundësi Nënës tënde që të përfitojë nga ky rast, të cilin pas një kërkimi të hollësishëm, jam i mendimit — lejomë të përdor një krahasim banal — se është burim i fatit prej nga rrjedh uji më i kthjellët dhe i pastër dhe minierë e arit më të kulluar.

Të gjitha këto, do të kuptosh, t'i rrëfej në besim, si tregtari tregtarit. Të tjerëve, s'do t'u lëmë që të vjelin rrush nga vreshtat tona. Duke e njohur shëndetin e brishtë të Nënës tënde dhe atë drojë të cilën e ndiejnë si të natyrshme zonjat e jugut me edukatë delikate ndaj tregtisë e biznesit dhe duke pasur parasysh prirjen e tyre gjentile që, bile edhe kundër vullnetit të tyre, të zbulojnë gjëra të tilla në bisedë, unë do të të propozoja që asaj mos t'ia zësh ngoje këto fare. Kur mendoj më mirë, të këshilloj, bile, që mos t'ia çelësh këtë muhabet. Ndoshta e mira e së mirës e do që atë shumë ta paguaj të tërën në konton e saj në bankë me një rast, me ato shuma të tjera të vogla që i kam borxh, pa ia përmendur këto fare asaj. Është detyrë jona që ta mbrojmë nga kjo botë e vrazhdë materiale me sa na vjen ndoresh.

Të fala të përzemërta nga xhaxhai:

Mauri L. Baskomb"

"Ç'do të bësh me të?" e pyes duke ia flakur letrën mbi tavolinë.

"Unë e di se ty s'të vjen mirë që unë i jap atij atë shumë", më thotë ajo.

"Janë paratë tua. Nëse do, hedhjua edhe zogjve, punë për ty".

"E kam vëlla", zuri të arsyetohej Nëna. "Baskombi i fundit. Kur të mos jemi ne të dy, s'do të mbetet më askush nga rodi ynë".

"Ti kujton se ky lajm do ta pikëlloj ndokënd", e shpotita unë. "Por, ani, në rregull", vazhdova unë. "Janë paratë e tua. Bëj me to ç'të duash. A do ta njoftoj bankën që ta paguajë shumën?"

"Unë e di se ti ia ke zilinë" zuri të tjerrë Nëna. "Unë po kuptoj se çfarë barre ke ti. Kur të vdes unë, më mirë do ta kesh".

"Do të mund ta lehtësoja barrën menjëherë, tash", i them unë. "Por, ani, e paçim lëmë këtë. Në daç, këtu mund të bësh një çmendi".

"Benxhin e ke has vëlla, edhe pse ai është i sëmurë".

"Do ta marr librezën tënde të bankës", i them. "Sot do të marr kambialin tim".

"Të janë dashur të presësh gjashtë ditë për pagesë", ma priti Nëna e brengosur. "A je i sigurt se tregtia e tij është solide, pa hile? Çuditem sesi një ndërmarrje që punon me të holla, s'ka si t'u paguajë tregtarëve të vet".

"Ai është njeri i fortë, solid, mos u bëj merak. I sigurt si banka. Mirëpo, unë i them që të mos ma bajë dertin, derisa mos ta bëjmë bilancin mujor të kërkesave. Së këndejmi, unë heraherës ■ marr rrogën me vonesë".

"S'do të mund ta duroja, do të më vinte shumë keq sikur ti të humbisje atë mundin tim të vogël që kam investuar për ty", tha ajo. "Shpeshherë më ka shkuar nga mendja se Ërlli nuk është ndonjë farë tregtari. Unë e di se ai s'të beson aq sa do të duhej sipas kapitalit që ke investuar. Unë do të bisedoj me të një herë".

"Mos Nëno, lëre të qetë, le të kujdeset për punën e vet ashtu si di ai".

"Mirëpo, ti ke investuar një mijë dollarë në tregtinë e tij".

"Lëre mos e nga. E di unë se ç'bëhet aty. Tekembramja, unë e kam autorizimin tënd. Çdo gjë do të jetë në rregull".

"Ti s'ke haber se çfarë ngushëllimi je për mua", më tha Nëna. "Ngaherë ishe mburrja dhe gëzimi im, mirëpo erdhe ti vetë dhe me ngulmim kërkove që për çdo muaj të investosh në bankë rrogën tënde në emrin tim, unë e falënderova zotin që të paktën ti më kishe mbetur kur të tjerët m'i kishte rrëmbyer".

"As atyre Nëno, s'ke ç't'u zësh për të madhe", thashë unë. "Unë mendoj se ata kanë bërë atë që kanë ditur më së miri".

"Kur flet ashtu, unë e di se ti me dëshpërim mendon në babain tënd. Ndoshta edhe ke të drejtë. Por, zemra më bëhet copë e thërrime kah të dëgjoj".

U ngrita. "Nëse të qahet, qaj vetëm, sepse unë s'kam çare pa u kthyer në dyqan. Shkova ta marr librezën e bankës".

"Ta sjell unë", më tha ajo.

"Ulu ti. Unë e marr".

Shkova në katin e sipërm dhe nxora librezën e bankës nga skrivania e Nënës, pastaj u ktheva në qytet. Shkova në bankë dhe e deponova kambialin dhe mandapostën si dhe ata dhjetë dollarë, paskëtaj ktheva dhe u ndala pak në zyrën e telegrafit. Tash ishte gjendja një poen mbi kursin e hapjes. Unë tashmë kisha humbur trembëdhjetë poena, vetëm e vetëm pse ajo qaramane kishte ardhur në dymbëdhjetë në dyqan që të çirrej dhe të më mërziste për shkak të asaj letre.

"Kur arriti raporti i kurseve?" pyeta.

"Përafërsisht para një ore", u përgjigj telegrafisti.

"Para një ore? E pse ju paguajmë ne?" e qortova unë. "Për raportet javore nga burza? Ç'mendoni, si mund të arrish diçka në atë mënyrë? Tërë shitoren do të mund ta hedhësh në ajër, kurse ne s'dinim erë sandi!"

"Unë s'mendoj se do të fitoni gjë prej gjëje", ma priti ai. "Ata e kanë ndërruar ligjin për ata që spekulojnë në tregun ■ pambukut".

"Vërtet? Ende s'e kam dëgjuar këtë. Me gjasë, lajmet i paskan dërguar nëpërmjet Uestern Unionit".

U ktheva në tregtizë: Trembëdhjetë poena. Qofsha i mallkuar, nëse di kush diçka për atë lloj dallavereje pos atyre të cilët janë rrasur rehat në kolltukët e tyre më zyrat e Nju-Jorkut dhe presin të vijnë mistrecat e provincës për t'i lutur që t'ua marrin paratë. E para, nëse njeriu shkon atje dhe s'bën tjetër, ai dëshmon në atë mënyrë se s'ka besim në vetvete, kurse unë gjithnjë them: nëse s'ke ndërmend ta dëgjosh këshillën ç'të duhet t'i prishësh paratë për të. Përveç kësaj, ata atje janë më të këqijë: ata dinë se ç'ndodh. Më ra në mend se e kisha telegramin në xhep. Lipsej të vërtetoja se kompania telegrafike po përdoret për mashtrime. Se ajo, në të vërtetë, është një lloj burse spekulantësh. Besa, as që do të pritoja ta bëja këtë. E po, e marrtë dreqi e marrtë, kush do të thoshte se një kompani e madhe dhe e pasur si është "Uestern Unioni" nuk i merr me kohë lajmet nga bursa. Së paku me gjysmën e shpejtësisë me të cilën ta dërgojnë telegramin me anë të të cilit të bëjnë të ditur se konton e paske të bllokuar. Por, atyre aq u bën. Ata kanë allishverishe me ata rezilët e Nju-Jorkut. Kjo është më se e qartë.

Me të hyrë, Ërlli hodhi një vështrim orës së vet. Mirëpo, nuk më tha asgjë para se të largohej myshteriu. Pastaj, më pyeti:

"A ishit për drekë në shtëpi?"

"M'u desh të shkoja te dentisti", iu përgjigja, sepse tekefundit ç'i hyn në punë atij se ku ha bukë unë, ndonëse duhet të jemë me te në tregtizë tërë pasditen. Dhe, pos gjithë asaj që pësova tash t'ia dëgjoj edhe llomotitjet e tij pa ndarë. Unë ngaherë them: shikoje vetëm këtë tregtar të varfër të provincës, i cili i ka vetëm pesëqind dollarë në bankë, se si i rrit mendtë si t'i kishte pesëdhjetë mijë në bankë.

"Është dashur të më thoshit", më qortoi ai. "Unë prita të ktheheni menjëherë".

"Do ta këmbeja me ju këtë dhëmb dhe do t'ju jap edhe dhjetë dollarë yst kur të doni", ia ktheva unë. "I patëm lënë fjalët që gjatë kohës së drekës unë të kem një orë të lirë, por, nëse s'ju pëlqen mënyra se si punoj unë atëherë dini se ç'duhet bërë".

"E di unë kaherë këtë mesele", tha ai. "Po të mos qe hatri i nënës suaj, unë do t'i rregulloja kaherë do hesape. Ajo është një zonjë hijerëndë, ndaj të cilës ushqej simpati, Xhezon. Është për të ardhur keq që disa të njohur të mi, s'mund të thonë as kaq për vete".

"Atë simpati mund ta mbani për vete", them unë. "Nëse na duhet ndonjë lloj simpatie unë do t'ju njoftoj me kohë".

"Unë, për disa gjëra, ju kam mbrojtur për një kohë të gjatë, Xhezon", më tha.

"Ashtu?" thashë unë. E lashë ta zgjidhë çakallën dhe ta dëgjoj mirë e mirë para se t'ia mbyllja gojën.

"Unë e di më mirë se ajo sesi e morët atë automobil".

"Njëmend? Ashtu mendokeni ju?" ia bëra unë. "E kur do ta përhapni lajmin se e kam grabitur nga ime ëmë?"

"Unë s'thashë asgjë. Mirëpo, e di se e keni autorizimin e saj. E di edhe se ajo ende beson se ato një mijë dollarë janë investuar në këtë tregtizë". "E po mirë, meqë ditkeni aq shumë, do t'ju tregoj edhe diçka tjetër: shkoni në bankë dhe pyetni se në llogarinë rrjedhëse të kujt i deponoj unë njëqind e gjashtëdhjetë dollarë më datën një të çdo muaji qe më se dymbëdhjetë vjet".

"Unë s'flas asgjë. Mirëpo, ju lutem që në të ardhmen të keni më shumë kujdes".

Në fjalët të tilla nuk u përgjigja kurrë më. S'kam leverdi të flas. Përvoja më ka mësuar se nëse dikush është ngatërruar në diçka, e mira e së mirës është që ta lë që të zhgatërrohet vetë nga lëmshi. E kur dikujt i ngulitet në mendje se lipset të të thotë diçka për të mirën tënde, atëherë natën e mirë. Më vjen mirë që s'kam ndërgjegje të atillë të cilën duhet gjithnjë ta llastoj e ta përkëdhel si ndonjë qen të sëmurë. Sikur unë të mund të investoja diçka për një punë, si bën ai, vetëm e vetëm që ta mbajë në këmbë atë tregtizë të mjerë, ku mundohet aq shumë, nuk do të më sillte ajo vetëm tetë për qind profit! Ai, si duket, mendon se do ta hedhnin në gjyq për koprraci sikur të fitonte më shumë se tetë për qind. Çfarë dreq karriere mund të arrijë dikush i cili ka qitur cekën të ngujohet në një fshat dhe në një tregtizë të atillë. Pih, sikur unë ta merrja në duar atë tregtizë vetëm një vit, do ta siguroja ashtu sa që tërë jetën s'do t'i duhej të punonte më ai. Mirëpo, ai me atë rast, të gjitha të ardhurat do t'ua dhuronte kishës apo institucioneve të tilla. Askush s'më nevrikos aq shumë sa hipokriti i djallëzuar: ai që pandeh se çdo gjë që s'ia kap atij rradakja është e pandershme patjetër dhe me rastin e parë, do ta shohë të udhës që t'ia komunikojë personit të tretë të cilin s'e intereson fare ajo që i thotë. Unë ngaherë them: sikur të mendoja se dikush sa herë që të bëj diçka, të cilën unë s'e kuptoj me të vërtetë, ka bërë ndonjë hajni, mendoj se s'do ta kisha vështirë që në ata regjistra atje në kthinat e pasme të tregtizës të gjej diçka. Mirëpo, juve do t'ju dukej si gjë e poshtër dhe e padobishme që unë pastaj të nxitoj dhe t'ua kallëzoj të tjerëve, të cilët, sipas mendimit tim, do të duhej ta dinë. Kjo do të qe e padobishme veçanërisht atëherë nëse kam arsye të supozoj se ata dinë për atë më shumë se unë. Nëse s'dinë, atëherë mua s'më hyn në punë. Ndërkaq, padroni im gjithnjë me të veten: "Librat e regjistrimit tek unë janë në dispozicionin e çdokujt. Çdokush i cili ka të drejtë, apo mendon se ka të drejtë në këtë tregtizë, mund të niset pas dhe t'i kontrollojë regjistrat, mua mirë se më vjen gjithmonë".

"Natyrisht, ju s'flitni asgjë", ia prita unë, "ngaqë këtë s'mund ta harmonizoni me ndërgjegjen tuaj. Ju vetëm do ta shpini atje pas që të bindet vetë myshteriu. Ju s'do t'i thoni asnjë fjalë".

"Mua s'më interesojnë punët tuaja private", më tha ai: "Unë e di se ju në jetë jeni të privuar nga disa gjëra që i gëzonte Kuentini. Por, edhe nëna juaj s'ka pasur fat në jetë dhe po të

vinte këtu dhe të pyeste se pse e keni braktisur punën, unë do t'i thosha patjetër. S'është fjala për ata një mijë dollarë. Ju e dini. Por, njeriu kurrë nuk arrin asgjëkund, nëse gjendja reale nuk i pajtohet me regjistrat. Pos kësaj, desha të them, edhe këtë, unë s'e gënjej asnjëri, as për hir timin dhe as për hir të tjetërkujt".

"Në qoftë ashtu", i them unë, "sipas mendimit tim ndërgjegjja juaj është punonjës më i mirë se unë. Nuk është nevoja të shkoni për drekë tnë shtëpi. Por, kini kujdes që ndërgjegjja juaj të mos ma prish oreksin", i them unë. E po, si ta kryej detyrën time si duhet, e marrtë, lumi e marrtë, me këtë familje të mallkuar, kur Nëna s'përpiqet ta mbikëqyrë as vajzën, as të tjerët. Shembulli më i mirë i paaftësisë së Nënës doli më së miri inë shesh atëherë kur ajo e kishte parë Kedin duke u puthur me një çun. Të nesërmen, gjithë ditën e lume bënte ecejake nëpër shtëpi e veshur me një fustan të zi të pikëllimit dhe e mbuluar me vello, kështu që as Babai s'mund ta kandiste që të thoshte ndonjë fjalë. Vetëm qante dhe ankohej se si e bija i kishte vdekur. Asokohe Kedi sapo i kishte mbushur të pesëmbëdhjetat. Po të vazhdonte me atë tempo, pas tre vjetësh Nënës, sipas gjasash, do t'i duhej të mbante zi dhe të lyhej me hi. A kujtoni se unë mund të lejoj që ajo lahpere të bredhë rrugëve me çdo udhëtar të ri tregtar që vjen këtu, e pastaj ata ta përhapin lajmin nëpër rrugë e përgjatë rrugës se kur të vijnë në Xheferson do të gjejnë një "copë" e cila është si prushi. Unë s'jam tepër krenar, mirëpo, prapëseprapë, s'do të duhej të lejoj sidomos kur kuzhinën e kam plym me zezakë të cilët duhet t'i ushqej, që çmendinë shtetërore ta lë pa kandidatin e klasës së parë. Thonë se në familjen tonë rrjedh gjaku i guvernatorëve dhe i gjeneralëve. Sa të lumtur do të ishim sikur mes nesh të mos kishte as mbretër dhe as kryetarë! Përndryshe të gjithë ne këtu në Xhekson kaherë do të gjuanim flutura. Ja ku ju them se s'do të kishte kuptim sikur Kuentina të qe imja. Mirëpo, atëherë, të paktën do të isha i bindur në diçka: se është dobiç. Kurse tash as vetë zoti s'e di mirë se si është puna.

Pas një copë here, u dëgjua muzika dhe njerëzit zunë të iknin nga dyqani. Të gjithë u sulën drejt vendit ku do të mbahej shfaqja. Pak më parë bënin pazarllëk për tojza prej njëzet sencësh që të kursenin nga pesëmbëdhjetë sencë, në mënyrë që t'ia dhuronin shoqatës "Jenki" që kishte ardhur në vizitë te

ne, kurse bashkë t'i paguajnë ndoshta edhe nga dhjetë dollarë për licenca. Unë dola nga dera e pasme.

"Ki kujdes", i them Xhobit, "të mos rritet mishi i huaj që e ke në dorë. Se pastaj do të duhej ta merrje sëpatën dhe ta preje atë. Epo, ç'mendon ti, ç'do të hanë mizat e grurit nëse ti nuk i monton kombajnat për korrje? A mos kujton se do të ushqehem me sherbelë?"

"O zot, sa mirë u bikan borive ata atje!" m'u përgjigj ai. "Thonë se qenka një njeri në atë cirk, i cili ditka të lozë melodi në sharrë. E lozka aq mirë saqë të duket se i bie benxhos".

"Pa dëgjo", i them unë, "a di ti se sa para do të lënë ata në këtë vend? Afro dhjetë dollarë", iu përgjigja përnjëherësh. "Ata dhjetë dollarë tashmë i ka në xhep Bak Tarpini".

"E pse i japin dhjetë dollarë zotëri Bakut?" më pyeti.

"Për lejen që të mund të japin shfaqje këtu. Tash mund të llogaritësh se çfarë shpenzojnë ata këtu sipas mendimit tënd".

"Ju doni që ata të paguajnë dhjetë dollarë vetëm e vetëm që të mund të japin shfaqje këtu?" pyeti ai.

"Po, vetëm kaq. E ti, ç'mendon, sa..."

"O i lumi zot! Doni të më thoni se ata janë të detyruar të paguajnë për të dhënë shfaqje këtu? Unë do të jepja dhjetë dollarë, sikur t'i kisha, vetëm që të dëgjoj dhe ta shoh atë që lozën me sharrë. Mirëpo, sikur të paguaja atë çmim, atëherë të nesërmën në mëngjes do të kisha borxh edhe nëntë dollarë dhe shtatëdhjetë e pesë sencë".

E pastaj ata "Jenki" ta mbushin mendjen me disa mesele për atë se si zezakët po përparojnë shumë. Le të përparojnë ata them unë. Le të përparojnë aq sa të mos jemi në gjendje të gjejmë asnjë zezak në jug të Luisvillit, bile as me qenin e policisë. Ngase kur i thashë Xhobit se si ata të cirkut deri të shtunën mbrëma do të mbledhin të paktën një mijë dollarë nga qarku im dhe do t'ua mbathin me ato të holla, ai më tha:

"Unë s'ua kam lakminë. Unë mund të bëj një luks për vete dhe t'i bëj rrush e kumbulla rrum 25 sencë".

"T'i marrë djalli ata 25 sencë!" thashë unë. "Ky është fillimi. E ku janë ato dhjetë dhe pesëmbëdhjetë sencë që duhet t'i shpenzosh për një kuti të pshurrët bonbonesh, që zakonisht kushton dy sencë, apo diku kaq? E ç'thua për kohën që ja tash e bjerr duke e dëgjuar muzikën?"

"Vërtet, vërtet", më tha. "Mirëpo, nëse do të jem gjallë deri

sonte, ata do të marrin nga njëzet e pesë sencë më tepër prej këtu, ja ku ju them".

"Atëherë ti qenke me të vërtetë qyqar", i thashë.

"As këtë s'e mohoj," ma ktheu. "Po të qe krim kjo, atëherë të gjithë zezakët s'do të ishin zezakë".

E pra, disi pikërisht në atë kohë rastësisht i lëshova një vështrim rrugës dhe e diktova Kuentinën. Kur u zmbrapsa dhe e shikova orën, nuk vura re ndërkohë se kush ishte me të, sepse në atë çast e shikoja orën. Ora ishte dy e gjysmë, dyzet e pesë minuta para se askush tjetër pos meje do të mund të priste që ajo të qëllojë në rrugë. Kur shikova nga dera, më parë më ra në sy kravata e kuqe të cilën e mbante përcjellësi i saj, dhe me vete mendova, vallë ç'tip mund të jetë ai i cili mbaka kravatë të kuqe. Ajo përvidhej rrugës duke e shikuar derën e tregtizës, kështu që unë nuk mendoja asgjë për atë derisa s'kaluan pranë meje. Thashë me vete vallë a aq pak më respekton saqë jo vetëm që mungon në shkollë edhe pse ia kam ndaluar rreptësisht, po asgjë mangu të shëtisë para tregtizës për inat, duke qenë koshiente se mund ta diktoja. Mirëpo, ajo nuk mund të shikonte kah dera, ngaqë rrezet e diellit kishin rënë mbi ta kështu që ata do të shihnin aq sa mund të shohë dikush kur i ka të drejtuar reflektorët e automobilit. Kështu, qëndroja në prag dhe e vështroja se si po kalonte. Fytyrën e kishte të papastër si të ndonjë palaçoje të cirkut, flokët e ngjitura, të shkëlqyeshme dhe të kaçurrelta. Pustani ia mbulonte aq pak këmbët dhe prapanicën, saqë në rininë time një femër të veshur në atë mënyrë, do ta burgosnin menjëherë, qoftë edhe sikur të paraqitej edhe në lagjen ekskluzive Gajiso ose Bill Strit të Memfisit. Ja ku ju them se këto femrat tona nuk veshen në atë mënyrë si të donin ta provokonin secilin që kalon afër tyre rrugës që t'ua ngjesë për prapanice. Ndërsa unë mendoja se çfarë dreq mashkulli ishte ai biçim me kravatë të kuqe, papritur e pakujtuar, si të më thoshte ajo vetë, unë e pata të qartë se ai ishte një anëtar i cirkut. Me fjalë të tjera, unë e kam durimin e madh. Po të mos e kisha sabrin e madh, do të më gjendte ndonjë bela. E pra, si kthyen pas qoshkut, unë iu turra pas. Më përfytyroni pa kapele, në mesditë, rend poshtë e lart rrugëve të errëta, vetëm e vetëm për namin e mirë të Nënës sime. Unë them ngaherë: me një femër të tillë, s'ke ç'të bësh, nëse ajo e ka në gjak atë. Nëse e

ka në gjak, të kota do të jenë të gjitha përpjekjet. E vetmja shtegdalje: t'i shporresh një krijese të tillë, ta lësh të shkojë rrugës së vet dhe le të jetojë mes krijesave të sojit të vet.

Shkova deri te rruga kryesore, mirëpo, s'i pashë më asgjëkundi. Qëndroja aty, pa kapele, si të kisha lojtur nga mendja edhe unë. S'kish gjë më logjike sesa ndokush të përfundojë: njëri ndër ta është i rrokatur, tjetri ishte mbytur në ujë, të tretën burri e kishte dëbuar në rrugë, e pse të mos jenë të krisur edhe të tjerët. I shihja pa ndarë sesi më vështronin si skifterët duke pritur rastin e volitshëm për të thënë: e pra, unë nuk jam befasuar fare, unë e merrja me mend se tërë familja e sorollopi i tyre janë të çmendur. Merrni me mend: kanë shitur një rrisk toke që ta dërgojmë djalin e tyre në Harvard, paguajnë tatim për mbajtjen e universitetit shtetëror të cilin e kam parë vetëm dy herë në jetë, atëherë kur u lojtën dy ndeshje të bejsbollit në to, nuk lejojnë që emri i bijës të zihet me gojë në shtëpi, kështu që babai i tyre e qiti cekën të mos dalë kurrë më në qytet po ta kalojë kohën me shishen e alkoolit. E pashë skajin e mintanit të tij të natës dhe këmbët e tij të zbathur dhe dëgjova se si kërciti shishja derisa nuk erdhi T. P. dhe ia mbushi gotën, kurse ai thotë: Ti nuk ke kurrfarë respekti kundrejt kujtimit të Babait tënd kurse unë ia kthej Unë s'di pse mos ta respektoj atë ajo është mjaft e ruajtur dhe do të gjallojë vetëm nëse edhe unë rrokatem vetë një zot e di se ç'do të bëjë me të veçse unë sëmurem meta shikuar ujin dhe më me qejf do të pija një galon benzinë se një gotë uiski kurse Lorena u thotë Ai vërtet s'e pi por në mos besofshi se është taman mashkull unë do t'ju tregojë mënyrën se si të bindeni ajo thonë Në të zënça se më mashtron me ndonjërën nga ato lavire e di se ç'do të ta gjejë atë thotë ajo Do ta kap dhe do ta rrah e do ta zhdëp aq sa të mund ta mbaj në duar thotë ajo kurse unë them Nëse unë s'e pi është punë për mua por a më ke gjetur ndonjëherë pa të holla dhe a mos të kam lënë ngusht them unë Unë do të të blej aq shumë birra sa të mund të lahesh me birrë në daç sepse unë e respektoj thellë laviren e aftë dhe të zellshme. Duke pasur parasysh shëndetim e lig të Nënës si dhe pozitën që dua ta ruaj ajo në vend të respektit ndaj të gjithë asaj që imë rrekem të bëj për të vepron e sillet ashtu saqë emri i saj emri im dhe emri i Nënës sime është bërë gaz i botës në këtë qytet.

Ajo më iku s'di as vetë se si. Më ka vënë re dhe ka ikur në

ndonjë rrugicë tjetër e tash endet me atë palaço të mallkuar me kravatë të kuqe kështu që të gjithë që e shohin mendojnë çfarë dreq njeriu është ai me kravatë të kuqe. Djaloshi më fliste pareshtur, kështu që unë e kisha marrë telegramin pa vënë re se e kisha marrë. As që dija se ç'mbaja në dorë derisa u firmosa në të. E hapa pa i dhënë ndonjë rëndësi se ç'shkruante në të. Megjithatë, tërë kohën parandjeja se ç'mund të kishte në të. Ai ishte kulminacioni i çdo gjëje që do të mund të më ndodhte, pikërisht tash kur e kisha regjistruar kambialin në librezën e kursimit.

Unë s'e kam të qartë se si qyteti që nuk është më i madh se Nju-Jorku ka vend për të gjithë ata njerëz të cilët ia dalin ndanë të na i marrin paratë me mjeshtëri neve tarallakëve të papërvojë të provincës. Puno e këputu së punuari gjithë ditën e lume, dërgojua paratë atyre, e për këtë merr një pusullë ku shkruan: "Gjendja e llogarisë suaj është 20.62". Më parë të tërheqin, pastaj të bëjnë të mundshme që të fitosh pak dhe pastaj bum!" "Gjendja e llogarisë suaj është 20.62". Si të mos mjaftonte kjo. Paguaja edhe dhjetë dollarë një mistreci që të të thotë sesi do t'i humbasësh shpejt ato, ngaqë ose s'ka haber nga ato punë ose punon në marrëveshje me kompaninë e telegrafit. E po mirë, u mërzita më prej të tillëve. Kjo është hera e fundit që më zunë në rrjetën e tyre. Çdo budalla, pos atij të krisuri i cili s'ka mendtë e kresë dhe u beson fjalëve të fajdexhiut, e di se kursi nuk do të rritet pareshtur atje ku tërë diga e deltës së mallkuar sapo s'ka vërshuar, kurse pambuku do të zhduket nga dheu si vjet. Neve na dështon puna nga viti *në* vit, ndërsa ata atje në Uashington shpenzojnë peshëdhjetë mijë dollarë në ditë për mbajtjen e njëfarë ushtrie në Nikaragua apo një zot e di se ku. Përsëri do të këtë vërshimë kështu që një funtë e pambukut do të kushtojë tridhjetë sencë. Kisha dashur t'ia qëlloj të paktën një herë dhe t'i kthej paratë e mia. Unë s'dua kushedi se çfarë shume të madhe, premi, vetëm bixhozxhinjtë e qytezës lakmojnë diçka të tillë, unë dua vetëm t'i kthej paratë e mia nga ata jahudinj të mallkuar të cilët m'i kanë marrë me mashtrime të tyre të garantuara dhe ilegjitime. Pastaj, i le të qetë; mund të m'i puthin edhe këmbët por s'u jap se s'u jap asnjë sencë.

U ktheva në tregtizë. Ora ishte afro tre e gjysmë. Pak kohë kishte për ndonjë punë me nder, mirëpo, unë tashmë isha mësuar. S'më ishte dashur të shkoja në Harvard për ta mësuar këtë Orkestra i dha fund melodisë. Të gjithë kishin hyrë brenda, kështu që nuk do të lodhen më. Ërlli thotë,

"Ju gjeti, apo jo? Ishte këtu parës. Unë kujtoja se ishit në dyqan, atje pas".

"Po", i them unë, "E mora. Nuk mund të më linin pa të tërë pasditen. Qyteti është me të vërtetë i vogël. Duhet të hyj në shtëpi, për një moment", them unë. "Mund të më ndalni nga rroga në doni".

"Shkoni", thotë ai, "ia bëj disi tash. Ndoshta keni lajme të këqija, shpresoj".

"Lypset të shkoni në zyrën e telegrafit për ta marrë vesh këtë", i them. "Ata do të kenë kohë që t'ju thonë. Unë, s'kam nge".

"Unë vetëm pyeta", thotë ai. "Nëna juaj më beson".

"Ajo do të dijë ta çmojë këtë", i them. "S'do të rri më shumë se sa duhet".

"Mos u mërzitni", thotë ai. "Tash ia bëj disi. Urdhëroni, shkoni".

E mora automobilin dhe shkova në shtëpi. Një herë në paradite, dy herë në mesditë, dhe tash përsëri, me atë meselen rreth saj, ndjekjen e saj nëpër qytet dhe më në fund duhet t'i lus të tjerët që të më japin diçka për të ngrënë për ushqimin që e paguaj unë vetë. Hera-herës mendoj, a kanë kuptim të gjitha këto. Me përvojë të tillë nga e kaluara do të duhej të isha me të vërtetë i rrokatur për të vazhduar njësoj. Dhe tash sipas gjasash do të arrij në shtëpi me kohë që të vozitem për një kohë të gjatë për të gjetur tnjë shportë me domate apo gjëra të ngjashme, pastaj të kthehem në shtëpi, ndërsa era do të më kundërmojë si e ndonjë uzine të kamforit, vetëm e vetëm që të mos më pëlcasë koka mbi supe. Unë pa ndarë e bind se në aspirin nuk ka kurrgjë tjetër pos miellit dhe ujit për të sëmurët e shtirur. Unë të them se ti nuk ke haber se ç'është kokëdhimbja e vërtetë. Ta them edhe këtë: a mendon ti se unë do ta humbisja kohën duke vozitur me këtë automobil të mallkuar po të varej nga unë? Unë do të mund të bëja edhe pa të. Jam mësuar që në jetë të më mungojnë mjaft gjëra, mirëpo, nëse ti njëmend dëshiron ta rrezikosh jetën tënde duke u vozitur me atë karakatinë të vjetër e të riparuar, me atë vozitësin melez, ani, urdhëro. Unë vetëm them: zoti e shtrin

dorën mbrojtëse mbi krijesa të atilla si është Beni; zoti e di se s'ka çare që ta kompensojë disi atë fatkeqësi, mirëpo, nëse ti mendon se unë atë makinë delikate që bën një mijë dollarë, do t'i japë në dorë një zezaku axhami apo të parritur, e po gabohesh qe besa. Atëherë e mira e së mirës është që t'ia blesh vetë automobilin. Ti ke qejf të vozitesh me automobil, ti e di vetë se sa qejf ke.

Dilzi tha se Nëna ishte në shtëpi. Shkova në hajat, përgjova pak, mirëpo, nuk dëgjova asgjë. Shkova në katin e sipërm, dhe në çastin që po kaloja afër derës së saj, ajo më thirri.

"Desha vetëm të di se kush është", tha ajo. "Jam filli vetëm këtu e vetmuar dhe dëgjoj çdo shushurimë".

"Paj kush të detyron të jesh gjithnjë këtu?" i thashë unë. "Mund të shkosh në vizita si gratë e tjera, nëse do".

Iu afrua derës.

"Pandehja se mos ishe i sëmurë", tha ajo. "Se pse disi shpejt erdhe për drekë".

"Ndoshta herën tjetër do të kem fat më të mirë", i thashë. "Ç'dëshiron?"

"Mos ndodhi gjë?" tha ajo.

"Ç'mund të ketë ngjarë?" i them unë. "A s'mund të vij në shtëpi në mesditë pa e çuar peshë tërë shtëpinë?"

"A mos e ke parë Kuentinën?" më pyeti.

"Është në shkollë", i thashë unë.

"Ka kaluar ora tre", tha ajo. "Dëgjova kur ra ora para afro gjysmë ore. Tash duhet të jetë në shtëpi".

"Duhet a?" thashë unë. "Kur e ke parë ti atë këtu para errësirës?"

"Duhej të ishte në shtëpi", tha ajo. "Kur unë qeshë vajzë.."

"Ty të ka mësuar dikush sesi të sillesh", i

thashë unë. "Ajo s'e ka askënd".

"S'di si t'ia bëj me të", tha ajo. "Sa e sa herë jam munduar".

"Kurse mua, s'më lejon ta kandis njëherë, s'di se për ç'arsye", i thashë. "E pra, duhet të jesh e kënaqur". U nisa kah dhoma ime. Ia dhashë çelësit dhe prita derisa të kthehej dorëza e derës. Atëherë ajo tha,

"Xhezon"

"Ç'u bë", thashë unë.

"Mendova se kishte ngjarë diçka e keqe".

"Këtu s'ka ngjarë asgjë", i thashë. "Ke gabuar".

"S'desha të të mërzis", tha ajo.

"Më vjen mirë ta dëgjoj këtë", i thashë unë. "S'isha i bindur. Droja se mos isha hutuar. Mos deshe gjë?"

Pas një copë here ajo tha: "Jo. Kurrgjë". Pastaj, iku. Unë e nxora kutinë, i numërova të hollat dhe e ktheva kutinë në vendin e vet. E mbylla derën dhe dola. M'u kujtua era e kamforit, mirëpo, tash do të ishte vonë për të. Përveç kësaj, duhet të bëja edhe një xhiro me automobil. Ajo po priste te dera.

"A dëshiron të të sjell gjë nga qyteti?" e pyeta.

"Jo", tha ajo. "S'dua të përzihem në punët e tua. Por, s'di se ç'do të bëja sikur të të ndodhte gjë, Xhezon".

"Unë jam mirë, s'kam gjë", i thashë. "Më dhemb pak koka".

"Pse se more një aspirinë", tha ajo. "Unë e di se ti s'do të heqësh dorë nga automobili".

"Ç'lidhje ka automobili me të?" thashë unë. "Si mund të ta sjell kokëdhimbjen automobili?"

"Ti e di se benzina të sëmur gjithnjë", tha ajo. "Që nga fëmijëria. Më mirë të merrje një aspirinë".

"Ti dëshiro pa ndarë", i thashë unë. "Ty s'të prish punë".

Hyra në automobil dhe u nisa të kthehem në qytet. Sapo kisha hyrë në rrugën kryesore kur vura re se si një ford me shpejtësi të rrufeshme po ulej kah unë. Papritmas, frenoi. Dëgjova sesi nga frenimi kërcëlluan rrotët, automobili u nis pas, u kthye dhe iku rrëmbimthi. Pikërisht në çastin që po e vrisja mendjen se çka dreqin lypte, e vura re atë kravatën e kuqe. Atëherë e pikasa fytyrën e saj që shikonte nga dritarja e pasme. Ai ktheu me vrull në rrugicën e parë. E pashë edhe një herë kur e ktheu automobilin, mirëpo kur unë arrita në rrugicën e fundit, ai ishte zhdukur.

Çdo gjë më dukej e kuqe. Kur e pikasa atë kravatë të kuqe, përkundër të gjithë atyre që i kisha thënë, unë e kisha humbur pusullën. Nuk mendoja as për kokën time të shkretë derisa s'arrita në udhëkryqin e parë ku m'u desh të ndalem. Sa shumë të holla shpenzojmë për meremetinrin e rrugëve, i mallkuar qofsha nëse nuk vozitemi nëpër to si në ndonjë pllakë nga hekuri i ndryshkur me të cilën mbulohen çatitë. Do të doja ta di, si mund të shpresojnë se mund të shkojë përpara njeriu në një rrugë të tillë qoftë edhe me një karrocëz. Unë e çmoj shumë automobilin tim. Nuk do ta bëj copa-copa si të ishte ndonjë farë

fordi. Ata, bën vaki, e kanë vjedhur diku atë automobil, prandaj s'u kërcet. Ashtu si them unë: gjaku s'mund të fshehet, ai flet ngaherë. Me atë farë gjaku në dej njeriu është një gjendje të bëjë çkamos. Unë them me vete: çfarëdo që kërkonte ajo nga ti, tash më s't'i kërkon. Tash e tutje mund ta qortosh vetëm veten tënde, sepse të paktën tash e ke të qartë se ç'do të bënte në vendin tënd çdo njeri i mençur. Dhe, them: nëse gjysmën e kohës jam i shtrënguar ta kaloj si detektiv, atëherë do të shkoj të paktën atje ku mund të më paguajnë për këtë.

M'u desh pra të ndahem në rrugëkryq. Atëherë m'u kujtua se më dhimbte koka. Më bëhej se brenda saj ishte dikush me çekan dhe ma godiste papushuar. I them unë asaj koke time: u orvata t'i shporrem, që të të mos qiste telashe, por, tash, sa për mua, lere, le të shkojë në dreq të mallkuar nëse do, bile sa më parë aq më mirë për ty. Paj, ç'mund të presë tjetër ajo pos udhëtarëve tregtarë dhe palaçove bredharakë të cilët ia behin rastësisht në qytet, ngaqë tashmë i shmangen edhe spitullaqët e vendit. Ti as që ke haber se ç'ndodh, nuk i dëgjon llomotitjet që i dëgjoj unë, mirëpo, ji e sigurt se do t'ua vë kapakun. Unë u them: familja ime këtu ka mbajtur robër e robina kur ju mezi keni gjalluar, s'keni qenë kurrkushi, kurse tokë punuese keni pasur aq pak saqë asnjë zezak madje nuk ju vinte argat.

Nëse kanë punuar ndonjëherë atë zezakët. Fati që vet i lumi zot u kujdes për këtë tokë, ngaqë njerëzit e këtushëm, të cilët jetojnë në të, s'kanë luajtur as me gisht. Është e enjte pasdite. Pikërisht prej këtu shoh nja tre milje toke të papunuar e të paçarë, kurse çdo mashkull i aftë për punë rreth e përqark ndodhet tash në shfaqjen në qytet. Do të mund të isha edhe ndonjë i panjohur i cili vdes nga uria, por s'mund ta gjej dot as frymë njeri për të pyetur se si shkohet në qytet. Kurse ajo papra orvatet të më bind që të marr aspirinë. Unë them: kur e ha bukën, e ha më tavolinë, njëqind herë më përsërit se si ti ndan nga buka e gojës për hir tonin, ndërsa keshe mund të blesh dhjetë palë petka të reja në vit me ato të holla që i shpenzon për ato ilaçe të dreqit. Mua s'më duhen ilaçe për kokëdhimbje, mua më nevojitet pushimi dhe kushte të atilla që të mos më dhemb ajo, e jo që unë të punoj dhjetë orë në ditë për ta mbajtur kuzhinën plym me zezakë me atë stil të jetës me cilin janë mësuar ata, e bile t'i çoj edhe në shfaqje me të gjithë

zezakët rreth e rrotull. Vetëm ai u vonua. Kur ai arriti atje, shfaqja kishte mbaruar.

Pas një copë here automobilit iu afrua rojtari dhe kur i thashë se dëshiroja ta dija nëse dy veta me "Ford" kishin kaluar pranë tij, ai tha se po. Vozita edhe më tutje dhe kur arrita te kthesa ku niset një shteg arash, nga kalojnë qerret, vura re edhe gjurmët e gomave. Ab Rasëll ndodhej më arën e tij, mirëpo s'dija si ta pyesja. Ende e shikoja stallën e tij kur e diktova edhe "Fordin". Ishin përpjekur ta fshehin automobilin. Mirëpo, ajo ia kishte dalë këtij qëllimi si edhe çdo gjëje që donte të bënte. Unë përherë them: s'ia zë edhe aq për të madhe për atë akt që bën. Ajo ndoshta edhe s'ka si t'ia bëjë ndryshe. Mirëpo, halli është aty se ajo s'ka kurrfarë konsideratash ndaj familjes së vet. Tërë kohën kisha frikë se do të ndeshem me ta si në dy langonj që kapen midis rrugës apo nën qerren e mallrave në pazar.

E ndala automobilin dhe dola. Dhe pastaj m'u desh të kërkoj kryeqetërthor nëpër arën e lëruar, të vetmen arë të punuar që e pashë qëkur u largova mga qyteti dhe pas çdo hapi ndieja se si të më ndiqte dikush nga pas dhe më godiste me shtagë kokës. Ndërkohë, mendoja: si ta kaloj këtë arë, atëherë, të paktën do të ecën nëpër rrafshinë, e s'do të marr në thua në çdo hap. Mirëpo, me të hyrë më pyll, pashë se në të kishe shumë shkurre, e m'u desh të çaj nëpër to derisa arrita në një hendek plym me therra. Eca një kohë skaj atij hendeku, mirëpo gëmushat e kaçubat në të sa vinte bëheshin gjithnjë e më të dendura, ndërsa ndërkohë Ërlli me siguri i telefonon shtëpisë ku më kërkon, kurse Nëna me gjasë ka luajtur mendsh.

Kur u përvodha disi më në fund, kisha kaluar aq shumë kthesa e leqe saqë m'u desh të ndalem dhe të shoh se ku e kishin automobilin tash. E dija se s'mund të ishin aq larg prej aty, bën vaki nën kaçubën më të afërt. Prandaj, e ndërrova drejtimin dhe u drejtova kah xhadja. Meqë nuk dija se sa larg kisha shkuar, m'u desh të ndalem dhe të përgjoj, e meqë në atë moment këmbëve të mia nuk i duhej gjaku edhe aq, tërë gjaku më ishte sulur në kokë, kështu që më dukej se do të më pëlciste orë e çast. Edhe dielli në horizont ishte lëshuar aq shumë saqë m'i lëbyrte sytë, kurse në vesh më zukaste aq fort saqë nuk mund të dëgjoja kurrgjë. Po ecja pareshtur, e pastaj e dëgjova qenin apo diçka të tillë dhe e dija, se në më rëntë në

erë, do të më sulet duke lehur dhe tërë qëllimi im do të shkonte huç.

Rreth e rrotull meje kishte rrodhe, degë dhe të tilla sende kurse në rrobat, në këpucët, kudo ishin futur të gjitha këto. Në atë çast rastësisht shikova rreth e rrotull dhe vura re se dorën e kisha mbështetur në kaçubat e shkemëzës së helmuar. E vetmja gjë që s'kuptoja ishte se pse ishte shkemishte e helmuar e jo gjarpër apo diçka e tillë. Prandaj, as që e lëviza dorën. Vetëm prita aty derisa nuk u largua qeni. Pastaj, vazhdova të ecja.

S'kisha haber se ku gjendej tash automobili, Mendoja vetëm në kokën time. Dhe hohe-hove ndalesha aty këtu në vend dhe si të çuditesha në e kisha parë "Fordin", madje as që isha ngushtë ta shoh. Unë them: le të kapet me këndo që ka pantallona në këtë qytet ditë e natë, aq më bën. A mund të ndihem përgjegjës për dikë që s'ka as takt dhe as konsiderata, e cila është aq e poshtër saqë e lë "Fordin" në atë vend, duke më shtrënguar që ta humbas tërë pasditen, ndërsa Ërlli e shpie Nënën në kthinën e pasme të tregtizës dhe ia tregon regjistrat e mallrave, vetëm e vetëm pse është tepër i ndershëm për këtë botë. Ja ku them unë: ti do të mërzitesh shumë në qiell ku s'do të kesh rast t'i fusësh hundët në punët e huaja, veçse ruaju se mos të të shtij në dorë. Ja ku të them, do t'i mbyll sytë për hir të gjyshes tënde, por mos e dhëntë zoti që të të kap unë duke e bërë atë punë në shtëpinë ku jeton Nëna ime. E atyre zuzarëve të tu të pispillosur e mendjemëdhenj, të cilët mendojnë se janë dikushi, do t'ua kallëzoj unë qejfin, ja ku të them, e edhe ty bashkë me ta. Do ta bind unë atë kravatëkuqin tënd se ajo kravata e dreqit e kuqe e tij është shirit i lidhur për portën e ferrit në kujtoftë ai se mund të bredhë pa i hyrë ferrë në këmbë në pyll me mbesën time.

Me gjithë atë diell që m'i lëbyrte sytë, me gjakun që më gëlonte kokës, mendoja pa ndarë ja tash do të më pëlcasë koka dhe pastaj gjithçka do të marrë fund, me gjithë ato ferra dhe manaferra që m'ishin ngjitur, arrita më në fund deri te hendeku me rërë ku po zhgrryheshin ata dy, e pashë edhe drurin nën të cilin gjendej automobili. Dhe mu në çastin që dola nga hendeku dhe zura të vrapoj, dëgjova si u nis automobili. Fluturoi rrëmbimthi, duke i rënë klaksonit papushuar, si të më thoshin: ja, ja, jaaaaaa. Automobili ikte gjithnjë më tepër. Arrita në rrugë tamam me kohë për të parë se si u zhdukën.

Ndërsa unë arrita deri në vendin ku ndodhej automobili im, ata ishin zhdukur nga horizonti, vetëm klaksoni po dëgjohej ende. S'e vlente barra qiranë më të mendoja për këtë. Thashë me vete: vozit! Kthehu në qytet. Ngit në shtëpi dhe përpiqu ta bindësh Nënën se unë s'të kam parë kurrë në atë automobil. Mundohu që të besoj se unë nuk e di se kush ishte. Le të besojë se më duheshin edhe dhjetë hapa që të të kap në aktin flagrant në atë hendek. Orvatu ta bindësh se isha më këmbë si unë.

Ai ushtonte ende Jaaaaaa, Jaaaaaaa, por tash gjithnjë e më dobët. Atëherë ai pushoi, ndërsa në stallën e Rasëllit dëgjova se si po pëlliste lopa. Ende s'isha në gjendje të mendoj. Iu afrova derës së automobilit tim, ia hapa derën dhe e ngrita këmbën për të hyrë në të. M'u duk disi se automobili ishte pjerrë më tepër sesa duhej për shkak të pjerrësisë së rrugës, mirëpo nuk dita se ç'kish ngjarë para se të hyja dhe ta ndizja motorin.

Isha ulur aty. Dielli sa s'kish perënduar, kurse qyteti ishte afro pesë milje më tutje. S'ua ka mbajtur as që ta shpojnë gomën, që të bëjnë një vrimë në të. Ata vetëm e kishin shfryrë gomën. Për një copë herë mbeta aty duke menduar për kuzhinën përplot me zezakë, ndërsa asnjeri nuk kishte kohë që të çonte një rrotë rezervë dhe ta ngjiste me dy vidhosje. Ajo ishte me të vërtetë një situatë komike, ngaqë as ajo lahpere ▪ rafinuar me siguri nuk ka qenë aq largpamëse që ta marrë edhe pompën, pos në mos i pastë shkuar kjo nga mendja derisa ai e shfryente gomën nga ventili. Me gjasë dikush në shtëpi e ka marrë pompën nga automobili dhe ia ka dhënë Benit që të luajë me të si me revolen që stërpik me ujë. Bah, ata do të hallakatnin nëpër tërë automobilin, po të donte ai, e pastaj Dilzi do të thoshte: Asnjeri s'ta ka prekur veturën. Ç'punë kemi ne atje? Kurse unë atëherë do t'i thosha: Ti je zezake. A e di ti se ke fat që je zezake? Unë do të këmbëhesha më ty kur të duash, sepse vetëm një i bardhë i budallepsur mund të shqetësohet për shkak të asaj që bën një zuskë e vogël.

Shkova te Rasëlli. Ai, për fat, kishte pompë. Ndoshta këtë s'e kishin paraparë të ikurit. Mirëpo, unë ende nuk mund të besoja se ajo mund të ishte aq e pafytyrë. Kurrsesi s'më dilte mendsh. S'di si, por unë kurrsesi nuk u mësova të ngulis në mendje se një femër është në gjendje të bëjë gjithçka. Unë gjithnjë po shestoja kështu: Le të harrojmë për një çast se ç'ndjenja ushqej ndaj teje, dhe ç'ndien ti ndaj meje, mirëpo unë

kurrë s'do të isha në gjendje të bëj diçka të tillë. Sepse unë vazhdimisht pohoj: gjaku është gjak, gjakut s'ke si i ikën. Nuk ishte fjala për ndonjë marrëzi apo ndonjë shaka. Këtë do të mund ta bënte ndonjë kalama tetëvjeçar. Por, ja se ku është puna: ti ke lejuar që xhaxhain tënd ta përqeshë tipi me kravatë të kuqe. Ia behin ata horra të horrave në qytetin tonë dhe na quajnë grumbull provincialistësh dhe shtiren kinse ky vend është i vogël për njerëz aq të mëdhenj. Një budalla i tillë as që di se ka të drejtë. Se sa të drejtë ka ajo. Nëse edhe ajo mendon ashtu, më së miri është që të ikën, si për të ashtu edhe për ne do të jetë fat nëse ikim nga njëri-tjetri.

Ktheva te Rasëllët, ia ktheva pompën dhe u nisa me automobil kah qyteti. Shkova në një bufe, piva një kokakolë pastaj vazhdova për në zyrën e telegrafit. Kursi i fundit ishte ndalur te 12.21, dyzet poena më poshtë. Dyzet herë nga pesë dollarë. Blej diçka me ato të holla, po pate mundësi. E ajo do të vijë dhe do të thotë: Unë s'kam çare pa e pasur atë, unë patjetër duhet ta kem atë. Kurse unë i them: më vjen shumë keq, por do të jesh e detyruar t'i drejtohesh një adrese tjetër, ngase s'kam të holla, isha tepër i zënë për të fituar të holla.

Po e vështroja telegrafistin.

"Kam një lajm për ju", i thashë. "Do të çuditeni kur të merrni vesh se unë interesohem për kursin e pambukut. Kjo s'ju ka shkuar kurrë nga mendja, apo jo?"

"Unë bëra çmos që t'ju dorëzoj", ma priti ai. "Dy herë u orvata t'jua dërgoj në tregtizë bile edhe në shtëpi ju thirra me telefon, por ata s'dinin se ku ishit", u përgjigj ai duke kërkuar në syze.

"Çfarë të dorëzoni?" pyeta.

Ai ma dorëzoi telegramin.

"Kur arriti?"

"Kah ora tre e gjysmë", u përgjigj.

"Tash është pesë e dhjetë", thashë unë.

"U rropata t'jua dorëzoj. Mirëpo, asgjëkundi s'ju gjeta", kërkoi ndjesë ai.

"Ndoshta unë s'kam faj", thashë unë.

E hapa telegramin për të parë se me se do të ma hedhnin kësaj radhe. Mbase duhet ta kenë pisk teksa kanë ardhur deri në Misisipi për të vjedhur dhjetë dollarë në muaj. Shitni,

shkruante në telegram. Bursa e tregut nuk është stabile, ka tendenca të përgjithshme që të bjerë ende. Sipas raportit të qeverisë s'është nevoja për shqetësim.

"Sa kushton një telegram i tillë?" pyeta.

Më tha.

"Ata jua kanë paguar", tha ai.

"Atëherë unë u kam hua aq. E dija unë këtë. Dërgojeni këtë me shpenzimet e marrësit", thashë unë.

E mora formularin dhe shkrova: Bleni. Bursa e tregut sa nuk shpërtheu. Ka ndonjë ngurrim të përkohshëm, se mos bien në grep edhe disa tarallakë të provincës të cilët ende s'kanë haber se ç'është zyra e telegrafit. S'është nevoja të alarmoheni.

"Dërgojeni këtë me shpenzimet e marrësit", thashë unë.

E shikoi më parë mesazhin, pastaj orën.

"Bursa u mbyll para një ore", më tha.

"As për këtë s'kam faj unë", ia ktheva. "Unë s'e kam shpikur bursën. Unë vetëm kam blerë disa kambiale i bindur se kompania telegrafike do të më informojë vazhdimisht se ç'ndodh".

"Raportet shpallen me të arritur", tha ai.

"Po, në Memfis i shkruajnë në tabelëz *në* çdo dhjetë sekonda", i thashë unë. "Kurse unë një herë sot pasdite isha larg nga Memfisi as më pak dhe as më shumë se gjashtëdhjetë e shtatë milje".

E shikoi përsëri mesazhin dhe pyeti:

"A keni ndër mend me të vërtetë ta dërgoni?"

"Ende s'jam penduar", i thashë.

Shkrova një mesazh tjetër dhe i numërova të hollat.

"Dërgojeni edhe këtë nëse jeni të sigurt se mund ta transmetoni me korrektësi fjalën b-l-e-n-i".

U ktheva në tregtizë. Nga fundi i rrugës i dëgjova muzikantët. Prohibicioni është gjë e bukur. Dikur vinin në qytet të shtunave, tërë familja kishte vetëm nga një palë këpucë, ato i mbante ai, pastaj shkonin në repartin e pakove eksprese dhe e merrnin pakon e vet. Kurse tash të gjithë shkojnë këmbëzbathur në shfaqje, ndërsa nga pragjet e dyqaneve, si tigra apo si do bisha të tjera në kafaz, i vështrojnë tregtarët në kalim.

"Shpresoj se nuk ishte asgjë serioze", ma priti Ërlli.

"Çfarë?" pyeta unë:

E shikoi orën e vet, pastaj shkoi te pragu dhe shikoi kah gjyqi.

"Do të duhej ta blinit një orë për një dollar", i them unë. "Atëherë nuk do të kishit frikë se mos ju ngec gjithnjë".

"Çka?" pyeti ai.

"Kurrgjë", thashë unë. "Shpresoj se s'keni pasur kurrfarë kokëçarjesh në mungesën time".

"S'pat shumë punë. Të gjithë shkuan në shfaqje. Çdo gjë është në rregull".

"Nëse s'është gjithçka në rregull", them unë, "ju e dini se ç'mund të bëni".

"Unë thashë se çdo gjë është në rregull", u arsyetua ai.

"Këtë e dëgjova. Mirëpo, nëse rastësisht gjithçka nuk është në rregull, ju e dini se ç'mund të bëni".

"Mos doni të jepni dorëheqje?"

"Kjo s'është puna ime", u përgjigja. "Dëshirat e mia s'çojnë kandar. Por, mos kujtoni se ju jeni mbrojtësi im meqë më mbani në punë".

"Ju do të bëheshit tregtar i mirë, vetëm po të donit, Xhezon", më tha ai.

"Të paktën e kisha këqyrur punën time dhe s'do t'i fusja hundët në punët e hallkut".

"Unë s'di pse doni të më jepni shkas që t'ju pushoj nga puna. Ju e dini se mund të shkoni kur të doni e prapëseprapë do të mbetemi edhe më tutje miq si deri tash".

"Ndoshta unë pikërisht për këtë s'po shkoj", i thashë unë. "Teksa unë e bëj punën time, ju më paguani".

Shkova në kthinën e pasme, piva një gotë ujë dhe dola nga dera e pasme. Xhobi, më në fund e kishte montuar kombajnën. Në atë qetësi, së shpejti filluan të më kalojnë dhimbjet. Dëgjova sesi po këndonin, mirëpo atëherë edhe orkestra zuri të lozte. Le t'u japin të gjitha argjendarkat si nga një çerek dollarë ashtu edhe nga dhjetë sencë, sado paçin rreth e rrotull! Fundi i fundit, asnjeri s'më rjep mua. Unë bëra aq sa dita dhe sa munda. Njeriu në moshën time dhe me këtë përvojë, kur s'di të pushojë me kohë zakonisht është shul. Veçanërisht nëse s'është puna ime. Sikur ajo të ishte bija ime. ndryshe, krejt ndryshe do të qe puna, sepse ajo me atë rast s'do të kishte kohë të mendojë për gjëra të tilla. Ajo do të kishte pasur punë, meqë do të kishte qenë e detyruar të ushqejë disa invalidë, idiotë dhe zezakë,

ngaqë si do të kisha fytyrë që ta sjell dikënd në shtëpi papritur e pakujtuar. Unë i nderoj tepër të tjerët që të bëj diçka të tillë. Mirëpo, unë jam mashkull, unë mund ta duroj këtë, ajo është e mishit dhe e gjakut tim. Do të doja ta shoh ngjyrën e syve të atij njeriu i cili do të kishte guximin të flasë keq për cilëndo femër të cilën e kam mike. Gjëra të këtilla mund të flasin vetëm ato femra tepër të ndreshme. Do të doja të shoh ndonjë grua të ndershme fetare e cila është e ndershme dhe e urtë sa gjysma e Lorenës sime, qoftë ajo lavire ose jo. Unë gjithmonë them: po të më shkrepte të martohem, ti do të hidheshe në erë, si balona, ti e di këtë fort mirë, kurse ajo ma kthen: unë dëshiroj vetëm që të jesh i lumtur, ta kesh familjen tënde dhe të mos robtohesh për ne si rob tërë jetën. Mirëpo, unë së shpejti s'do të jem më, kështu që ti do të mund të martohesh, ndonëse kurrë s'do ta gjesh gruan e cila është e denjë për ty. Kurse unë, i them: ndoshta po. Nëno, ndoshta po. Mirëpo, me atë rast ti do të çoheshe nga varri: ti e di fort mirë se do të çoheshe. Por, jo, të falemnderit, i kam unë disa femra si barrë. Po të martohesha me ndonjërën, ka të ngjarë të del sheshit pastaj se është ose morfimiste ose diçka e tillë. Në familjen tonë edhe ajo na duhet.

Tash dielli kishte perënduar pas kishës metodiste, ndërsa pëllumbat vërtiteshin rreth e përqark kambanares. Kur pushoi muzika, unë i dëgjova duke guguruar. Ende s'kishin kaluar katër muaj nga Kërshëndellat, e numri i tyre ishte thuajse po aq sa edhe më parë. Ma merr mendja se i përndritshmi Uoltholl e rras tash barkun me to. Sipas predikimeve të tij dhe sipas faktit se me një rast ai ia rrëmbeu njërit pushkën nga duart kur kalonte tufa e pëllumbave, do të të bëhej se ne po vrasim gjithçka pa farë dallimi. Ai predikonte për paqen në botë dhe për vullnetin e mirë ndaj çdo krijese të gjallë, kështu që sipas fjalëve të tij, as trumcaku nuk guxon të bjerë për tokë. Sa për atë, aq i bën se sa shtohen kur ai s'ka kurrfarë pune të hairit. Ai s'paguan tatime, ai s'është i detyruar të shikojë sesi të hollat e tij për çdo vit shpenzohen për pastrimin e sahatit në gjyq. Një mjeshtri i paguan për atë pastrim rrum dyzet e pesë dollarë. Me atë rast numërova më se njëqind pëllumba me pupla të njoma e të reja në tokë. Ju do të thoni tash se është dashur të kishin mend dhe të iknin nga qyteti. Ja ku ju them se është fat i madh që as unë s'jam i lidhur për një vend si pëllumbi.

Orkestra lozte sërish njëfarë melodie të lartë dhe të

shpejtë si një farë lamtumire. Mbase tash publiku do të jetë i kënaqur. Ndoshta do të ketë mjaft muzikë që t'i zbavisë derisa voziten nëpër shtëpi nja katërmbëdhjetë apo pesëmbëdhjetë milje, derisa në errësirë i mbrehin kuajt, derisa e ushqejnë bagëtinë dhe i mjelin lopët. Tash vetëm do t'i vërshëllejnë melodité që i kanë dëgjuar, do t'u tregojnë mesele bagëtisë në ahur dhe do të llogarisin se sa të holla kanë kursyer që s'e kanë marrë edhe bagëtinë me vete në cirk. Mund të llogarisin: nëse dikush i ka pesë fëmijë dhe shtatë mushka, ka fituar rrafsh një çerek dollari meqë vetëm familjen e ka marrë në cirk. Vetëm kaq.

Ërlli erdhi me dy-tri pako.

"Ja disa që duhet dërguar", tha ai. "Ku është xha Xhobi?"

"Ndoshta ka shkuar në shfaqje", thashë unë. "Pos nëse e kemi ruajtur si rojtar".

"Ai s'guxon të ikë nga puna. Mund t'i besoj atij".

"Mos bëni aluzion në mua?"

Ai, pa u përgjigjur, shkoi te dera, shikoi jashtë dhe vështroi.

"Është orkestër e mirë", tha ai. "Por, më duket se është koha të shpërndahen".

"Vetëm në mos paçin vendosur të buajnë atje", thashë unë.

Dallëndyshet zunë të bredhin në ajër, trumcakët filluan të mblidhen plyma-plyma dhe të cërcërojnë në drurët para gjyqit. Holie-hove ia behte vrik ndonjë tufë mbi çatitë, e pastaj, zhdukej përsëri sa çel e mëshel sytë. Sipas mendimit tim edhe ata të fëlliqin me glasa si pëllumbat. Prej tyre as që mund të ndalesh nën drurët para gjyqit. Si të ulesh, plac mu mbi kapele. Por, duhet të jesh milioner dhe të shtiesh në ta kur dihet se çdo fishek të kushton pesë sencë. Po të hedhnin pak helm në treg, trumcakët do të zhdukeshin për një ditë. E nëse shitësi nuk mund ta pengojë tufën e vet që të mos ngarendë tregut, le të përpiqet të bëjë tregti me diçka tjetër e jo me zogj, me diçka që s'ha, si bie fjala me parmendë ose me qepë. Po kështu, nëse dikush nuk ia ban dertin ushqimit të qenve të vet, atëherë kjo do të thotë se nuk i do ose nuk e ka hak t'i mbajë qentë. Unë ngaherë them: nëse punët në qytet i bën si në fshat, atëherë nga qyteti bën fshat.

"Ç'dobi do të kishim edhe sikur ta ndërprisnin shfaqjen", i thashë. "Duhet të mbrehin kuajt menjëherë dhe të nisen që të arrijnë në shtëpi para mesnatës".

"Mosni, lërini të bëjmë zef e sefa. Le të shpenzojnë ndonjë metelik edhe për shfaqje ngandonjëherë. Malësorët punojnë shumë, ndonëse fort pak ia shohin hairin punës".

"S'ka ligje që do t'i shtrëngonte që ta punojnë tokën nëpër kodrina apo gjetkë", thashë unë.

"E ç'do të bëshit ju ose unë po të mos qenë fermerët?" më tha.

"Unë shi tash do të isha në shtëpi. Do të shtrihesha mirëfilli, me një grusht akulli mbi kokë".

"Diçka shpesh po ju dhemb koka. Pse s'i kontrolloni një herë dhëmbët? A ju kontrolloi sot paradite të gjithë dhëmbët?"

"Kush?" thashë unë.

"A nuk thatë sot paradite se shkonit te dentisti?"

"Mos më qortoni ndoshta ngase më dhemb koka gjatë orarit të punës? Këtë deshët ta thoshit? "Tash zunë të kalojnë rrugës, duke u kthyer nga shfaqja në cirk.

"Ja ku po vijnë", tha padroni. "Unë, më mirë të dal para dyqanit". Dhe doli. Dukuri e çuditshme: çfarëdo që t'ju mungojë në jetë, mashkulli do t'ju këshillojë t'i kontrolloni dhëmbët kurse femra, të martoheni. Dhe këshillat për atë se si duhet të kornni sukses në jetë, do t'ju japin pikërisht ata të cilët nuk kanë arritur asgjë të hairit në jetë. Ja, bie fjala, ata profesorët e universitetit të cilët as vetë nuk kanë një palë çorape të mira, do t'ju flasin me seriozitet se si mund të bëheni milioner brenda dhjetë vjetëve. Gjithë kështu, femra e cila nuk ka ditur se si ta gjuajë burrin për vete, do t'ju dërdëlisë e do t'ju shurdhojë se si lipset rritur dhe edukuar fëmijët.

Tekefundit ia përspjeti dhe plaku Xhob me qerren. Ju desh mjaft kohë që ta paloste kamxhikun.

"Ani", i thashë unë, "Si t'u duk shfaqja?"

"Unë ende nuk isha atje", ma priti ai. "Por, sonte mund të më mbyllin nën atë çadër".

"Qysh dreqin nuk ishe. Që nga ora tre s'je këtu. Pak më parë të kërkoi zotëri Ërlli".

"Isha diku me punë. Zotëri Ërlli e di se ku isha".

"Atij mund t'ia punosh, unë s'të shkel në besë", i thashë.

"Atëherë ai është i vetmi njeri të cilit do të orvatesha t'ia heq ndonjë rreng", tha ai. "A ka kuptim që ta humb kohën e t'ia punoj dikujt të cilin s'di se a do ta shoh të shtunën mbrëma apo jo? Kurse juve, as më shkon mendja t'jua bëj me hile. Jeni fort

i hollë për mua. Po qe besa", tha ai duke u shtirë kinse i zënë dhe duke ngarkuar nja pesë a gjashtë pako në qerre, "Ju jeni shumë mendjehollë për çiftin tim. Në këtë qytet tybe n'pastë njeri që mund të matet me ju në dinakëri. Shoqin s'e keni. Ju ia merrni mendtë dhe e mashtroni për hiçgjë edhe njeriun aq dinak saqë s'di si t'ia dalë në krye me veten e tij", fliste ai duke u ngjitur në qerre dhe duke i shlidhur frerët.

"E cili është ai njeri?" i thashë.

"Ai është zotëri Xhezon Kompson", tha ai. "Iho, Dan!"

Një ndër rrotët sa s'kish shqitur. E shikoja për seri se a do të dalë nga sokaku para se t'i shkëputet. Epo, ja, lejani zezakut ndonjë mjet vozitës. Ja ku ju them se karakatina e vjetër do të mbetet e tillë, ndoshta edhe nja njëqind vjet vetëm e vetëm që ai të mund të shkojë me të në varreza një herë në javë. Ja ku ju them se ai s'do të ishte i pari njeri i cili do të duhej të bënte diçka kundër qejfit të vet. Unë do ta detyroja të vozitet me automobil si njeri i civilizuar, ose le të rrijë në shtëpi. Ku e di ai se ku vozitet ose me çka vozitet, kurse ne jemi të shtrënguar ta mbajmë automobilin dhe kalin që ai të vozitet të dielën pasdite.

Se mos është ngushtë Xhobi se a do të shkëputet apo jo rrota, veç të mos ngasë larg pas saj. Si them unë i vetmi vend i mirë i punës për ta është ara, ku duhet të punojnë që nga lindja e deri në perëndim të diellit. Ata nuk mund të mësohen me rehati dhe me punë të mirë. Lëreni të jenë për disa kohë bashkë me të bardhët e s'do të vlejnë bile aq sa të harxhosh një plumb apo litarin për ta. Ata, sa i përket punës, do t'ju mashtrojnë para syve tuaj. Kështu Roskusi gaboi vetëm e vetëm pse një ditë nuk qe syçelur dhe vdiq. Me përtaci, sabotim, vjedhje dhe pafytyrësi gjithnjë më të madhe njeriu mërzitet aq shumë saqë s'i mbetet tjetër pos që një ditë prej ditësh t'i fshijë përpara me hu ose me diçka të ngjashme. Fundja, le të merakoset Ërlli për këtë. Mirëpo, mua s'do të më vinte mirë sikur punës sime do t'i bënte reklamë njëfarë plaku që kalamendet me një qerre e cila të duket se do të prishet e do të bëhet copë e grimë në çdo kthesë.

Dielli tashmë kishte shkuar larg pas horizontit, ndërsa në tregtizë dalngadalë po mërtiste mugëtira. Shkova në pjesën e përparme të tregtizës. Tregu ishte zbrazur. Ërlli po e mbyllte arkën. Zuri të binte ora.

"Ju do ta mbyllni derën e pasme", tha ai. Shkova atje, e mbylla dhe u ktheva. "Unë mendoj se sonte do të shkoni në shfaqje. Më duket se dje ju dhashë dy bileta falas".

"Po m'i dhatë. Mos doni t'jua kthej ndoshta?"

"Jo, fare. Vetëm se kam harruar se a jua kam dhënë apo jo. Dëm do të ishte të mos shfrytëzoheshin".

E mbylli derën, më uroi natën e mirë dhe shkoi. Trumcakët ende po cërcëronin në drurë. Tregu ishte zbrazur. Vetëm disa automobila kishin mbetur më të. Njëfarë "Fordi" ishte para vetëshërbimit, por unë s'e shikova mirë. E di unë se kur e teproj. Mua më vjen mirë që përpiqem t'i ndihmoj, mirëpo çdo gjë i ka caqet e veta. Unë do të mund t'ia mësoja Llasterit ta ngasë automobilin, kështu që ata mund ta ndjekin atë gjithë ditën në daçin, kurse unë do të mund të mbetesha në shtëpi dhe të luaja me Benin.

Hyra dhe bleva dy cigare. Pastaj më ra në mend se s'është keq nëse për çdo rast blej edhe një pluhur kundër kokëdhimbjes dhe kështu qëndroja aty dhe bisedoja.

"Epo", tha Meku, "mendoj se sivjet ke vënë bast për ekipin "Jenki" të bejsbollit".

"Për se?"

"Për flamurëz. Në ligë s'ka ekip që është në gjendje t'i mundë".

"Si jo", i thashë. "E pat puna e tyre. Mos kujtove se një ekip përherë mund të ketë fat?"

"Unë s'i them fat suksesit", tha Meku.

"Unë për nder s'do të mund të vija bast për asnjë ekip ku luan Ruthi", i thashë unë. "Bile edhe atëherë po të isha i bindur se do të fitojë".

"Vërtet?"

"A bën t'i përmend një dymbëdhjetë veta në çdo ligë që vlejnë më shumë se ai", i thashë unë.

"E ç'ke ti kundër Ruthit?" pyeti Meku.

"Kurrgjë", ia prita unë. "S'kam asgjë kundër tij. Mirëpo, s'ia shoh dot surratin, as në fotografi".

Dola. Po ndizeshin llambat, kurse njerëzia zjenin rrugëve. Ndonjëherë trumcakët nuk prajnë para se të errësohet nata. Atë natë që vunë poçe të reja dritash rrotull gjyqit, trumcakët u zgjuan nga drita, kështu që zunë të endeshin si të çmeritur rreth e rrotull duke u përplasur për llamba gjithë natën e gjatë.

Kështu duruan nja tri katër net, e pastaj, një mëngjes, u zhdukën. Mirëpo, pas dy muajve, u kthyen të gjithë.

Shkova në shtëpi. Në shtëpi dritat nuk ishin ndezur, mirëpo me siguri të gjithë shikonin nga dritaret, ndërsa Dilzi fërgëllente nga zemërimi në kuzhinë si të ishte ajo gjella e saj që duhej ta mbante të nxehtë derisa të kthehesha unë. Nëse e dëgjon atë, të bëhet se në tërë botën ka vetëm një darkë, dhe pikërisht ajo darkë të cilën duhet ta ruajë edhe disa minuta për shkak të vonesës sime. Por lavdi zotit, edhe unë më në fund mund të kthehem në shtëpi e të mos e gjej Benin dhe atë zezakun duke u kapur për traverset e portës, si ariu dhe majmuni në një kafaz të njëjtë gjithmonë kur dielli e ka çastin e perëndimit, ai i ngrati kalamendet disi deri te dera, taman si lopa kah ahuri, lëvaret për traversat e portës, zë ta shkundë kokën dhe të dënesë si të mendonte diçka të pikëllueshme. E po, ç'e do, kur dikujt i teket të ndëshkohet! Sikur të më ndodhte mua ajo që i ka ngjarë atij, ngaqë nga porta e hapur shkeli në dërrasa të kalbura dhe bëri marrëzi, kurrë s'do të më shkrepte të shikoja derë tjetër edhe një herë. Shpeshherë e pyesja veten athua përse mendon ai atje poshtë pas portës duke i kundruar vashëzat të cilat ktheheshin nga shkolla në shtëpi, duke u orvatur të dëshirojë diçka që nuk i kujtohej, që tashmë as që lakmon dhe as mund të dëshirojë. E ç'do të mendonte ai sikur ta zhveshnin dhe sikur ai rastësisht ta shikonte veten dhe t'ia kriste vajit si zakonisht. Por, si them ttnë, e di unë se ç'të duhet ty, ty të lipset ajo që ia bënë Benit dhe atëherë epshi yt do të pashitej, kurse ti do të silleshe si duhet. E nëse s'di *se* çka i kanë "bërë Benit, pyete Dilzin se të kallëzon ajo.

Në dhomën e Nënës kishte dritë. E lashë automobilin atje dhe shkova në kuzhinë. Brenda ishin Llasteri dhe Beni.

"Ku është Dilzi?" thashë unë. "Mos po e shtron darkën?"

"Është lart te zonjusha Kahilin", tha Llasteri. "Po grinden diçka keqas. Prejse zonjusha Kuentinë u kthye në shtëpi Mami u ngjit lart që t'i ndante të mos përlesheshin. A arriti cirku, zotëri Xhezon?"

"Po", thashë unë.

"Edhe mua më duket se kam dëgjuar muzikën", tha ai. "Sikur të mund të shkoja edhe unë atje. Do të shkoja, po të kisha një çerek dollari".

Ia behu Dilzi. "Erdhe, a?" tha ajo. "Ç'bëre deri kaq vonë? E di se sa punën e kam. Pse s'vjen me kohë?"

"Ndoshta isha në cirk", thashë unë. "A është gati darka?"

"Sikur të mund të shkoja edhe unë në cirk", ia bëri Llasteri. "Do të shkoja po të kisha një çerek dollari".

"Epo ç'të duhet ty cirku", tha Dilzi. "Rri në shtëpi e trus. E mos shko lart se përsëri pëlcet shamata".

"Ç'u bë", thashë unë.

"Parëz erdhi Kuentina dhe tha se ti i kishe rënë pas dhe e kishe ndjekur rreth e rrotull tërë pasditen, pastaj kërceu zonjusha Kahlin e s'i la gjë pa thënë. Pse s'e lë të qetë vogëlushen? A s'bën të banosh nën një kulm me mbesën e të mos grindeni?"

"Unë s'pata si të zihem me të për arsye se s'isha me të që nga mëngjesi. E ç'thotë? Ç'i paskam bërë? Mos e kam shtrënguar të shkojë në shkollë? Epo, ky është përnjëmend mëkat i madh", thashë unë.

"Ti këqyre punën tënde kurse atë lëre të qetë", tha Dilzi, "në më lejofshi ti me zonjushën Kahlinë, unë do të përkujdesem për të. Eja tash brenda dhe lermë të ta shtroj darkën".

"Eh, po të kisha një çerek dollari", tha Llasteri, "do të shkoja në atë farë shfaqjeje".

"Po të kishe krah, në qiell do të fuluturoje", ia priti Dilzi, "mos të dëgjoj më asnjë fjalë për atë farë cirku"!

"Seç më ra në mend", thashë unë, "i kam dy bileta". I nxora nga xhepi.

"Ju duhen allahile?" pyeti Llasteri.

"Mua jo", thashë unë. "S'do të shkoja atje po të më jepnin edhe dhjetë dollarë".

"Ma jepni njërën, zotëri Xhezon pash zotin", tha ai.

"Ta shes njërën", thashë unë. "Ç'thua, a?"

"E po s'kam para bre", tha ai.

"Sa keq, s'bën më keq", thashë unë. Bëra të nisesha.

"Ma falni njerën, ju bëj rixha, zotëri Xhezon", i tha ai. "S'ju duhen të dyjat bre!"

"Rrudhe çakallën", ia priti Dilzi. "A s'e di ti se ai s'ta jep as të zitë e thoit badihava?"

"Sa po ma mbani?" tha ai.

"Pesë sencë", thashë unë.

"S'i kam qaq", tha ai.

"Sa i ke?" thashë unë.

"S'kam hiç gjë!" tha ai.

"Ani mirë", thashë unë dhe u nisa.

"Zotëri Xhezom", tha ai.

"Pse s'e mbyll njëherë atë gojë amani të qoftë", i tha Dilzi. "A s'po sheh se ai po mahitet mej ty? Atij vetë i duhen biletat. Lere Xhezon, lëre të qetë".

"Mua s'më nevojiten biletat", thashë unë. Iu afrova kaftorit. "Erdha këtu për t'i djegur. Mirëpo, mos deshe të të shes një biletë për pesë sencë?" thashë unë duke e shikuar atë dhe duke ia hapur kapakun kaftorit.

"Paj s'kam aq para", tha ai.

"Epo mirë atëherë", thashë unë. Hodha një biletë në kaftor.

"E mor Xhezon", ma bëri Dilzi. "A s'të vjen turp?"

"Zotëri Xhezon", tha ai. "O, pashë zotin. Unë do t'jua fryj gomat për çdo ditë të muajit".

"Veç para në dorë", thashë unë. "Ta shes për pesë sencë".

"Kyçe më atë gojë, Llaster", tha Dilzi. E shtyu pas. "Hajde", tha ajo. "Hedhe. Hajde. Hedhe de më njëherë".

"Ta jap për pesë sencë", thashë unë.

"Hajde, ç'pret", tha Dilzi përsëri. "Ai s'ka pesë sencë. Hedhe më atë".

"E po mirë", thashë unë. E hodha biletën në kaftor kurse Dilzi ia mbylli kapakun.

"Edhe ti më je i rritur, të të vijë turp", tha ajo. "Shporru nga kuzhina ime. Hesht", i tha Llastërit. "Mos u bëhi sebep që t'ia nis Benxhi këlthitjes. Unë sonte ia marr Fronit një çerek dollari dhe nesër mbrëma ti do të shkosh në cirk. Tash, mbylle".

Shkova në dhomën e pritjes. Nga lart s'dëgjoja asgjë. E hapa gazetën. Pas një copë herë ia behën Beni dhe Llasteri. Beni iu afrua njollës së errët në mur ku dikur kishte qenë pasqyra dhe filloi ta fërkonte atë vend me duar, të përqyrret dhe të dënesë me ngulçim. Kurse Llasteri zuri ta shpupurishte zjarrin.

"Ç'bën?" pyeta. "Sonte më s'na duhet ziarri".

"Po orvatem ta qetësoj atë", tha ai. "Në kërshëndella gjithherë bën acar", tha ai.

"Po, por ende s'janë Kërshëndellat", thashë unë. "Lëre mos e prek".

E nxori mashën, mori një jastëk nga karreklla e Nënës dhe ia dha Benit, pastaj u ul para kaminit dhe u qetësua.

Unë e lexoja gazetën. Nga lant nuk dëgjohej asnjë zë kur hyri Dilzi brenda dhe Benin e Llastërin i dërgoi në kuzhinë, kurse mua më tha se më priste darka.

"Mirë", thashë unë. Ajo doli jashtë. Unë isha ulur, duke e lexuar gazetën. Pas një copë here, e dëgjova Dilzin e cila po shikonte nga dera.

"Pse s'vjen të hash bukë?" tha ajo.

"Po e pres darkën", thashë unë.

"Darkën e ke në tavolinë", tha ajo. "Të thashë".

"Vërtet?" thashë unë. "Më falni. S'dëgjova asnjeri të zbresë për të ngrënë darkë".

"Ato s'do të zbresin", tha ajo. "Hajde të hash bukë ti njëherë në mënyrë që t'iu çoj edhe atyre diçka atje lart".

"Mos janë të sëmura?" pyeta unë. "Çfarë tha mjeku? Mos e kanë lijën?"

"Hajde më, Xhezon", tha ajo. "Ta kryej edhe unë punën time".

"Po mirë", thashë unë, duke e marrë sërish gazetën. "Tash po e pres darkën".

Ndieja sesi më vështronte nga dera. Vazhdova ta lexoja gazetën.

"Pse ngatërron ashtu?" tha ajo. "Kur ti e di se sa telashet i kam".

"Nëse Nëna është më e sëmurë se sa para drekës, në rregull", thashë unë. "Mirëpo, përderisa unë paguaj për bukën e gojës së anëtarëve më të ri të familjes se unë, nëse duan të hanë, le të vijnë në tavolinë. Më thuaj kur ta shtrosh darkën në tavolinë", thashë unë dhe vazhdova ta lexoja gazetën.

E dëgjoja sesi u ngjitej shkallëve, sesi i zvarriste këmbët, si nëneriste dhe gulçonte, si të ishin të pjerrëta shkallët dhe si të kishte nga një metër distancë nga njëra te tjetra shkallë. Ia dëgjoja zhapullimat e hapave prej derës së Nënës, pastaj kur e thirri Kuentinën, si *të* ishte dera e mbyllur, pastaj kur u kthye në dhomën e Nënës dhe kur Nëna shkoi të bisedonte me Kuentinën. Mandej zbritën të trijat. Unë e lexoja gazetën.

Dilzi u duk te dera. "Hajde tash, mos prit", tha ajo, "se ndoshta qet prapë ndonjë kajde. Sonte, qe besa ia nxore fundin".

Shkova në dhomën e ngrënies. Kuentina ishte ulur dhe e kishte ulur edhe kokën. Përsëri ishte lyer. Hunda i dukej si ndonjë izolator porcelani.

"Më vjen mirë që ndihesh mirë dhe që zbrite", i thashë Nënës.

"Sa për të ardhur në tavolinë, s'më prish punë, s'është ndonjë mund i madh", u përgjigj Nëna. "S'është me rëndësi sesi ndihem. Unë e kuptoj njeriun kur i duhet të punojë gjithë ditën e lume dhe kur gëzohet nëse në darkë ndodhet me tërë familjen. Unë dua të ta bëj qejfin. Dëshiroj që të shkosh më mirë me Kuentinën e të mos keni zënka. Atëherë do ta ndieja veten më mirë".

"Ne pajtohemi shumë mirë", i thashë unë. "Unë s'jap pesë para nëse ajo mbyllet në dhomën e saj gjithë ditën e lume. Nëse i teket le të mbyllet. Mirëpo, nuk i duroj dot ngërdheshjet dhe çehret e tharta gjatë shujtës. E di se po lyp shumë prej saj, mirëpo, dëshiroj që kjo mos të ndodhë në shtëpinë time. Më fal, Nëno, desha të them, në shtëpinë tënde".

"Është shtëpia jote, biro", tha Nëna. "Ti je tash kreu i familjes".

Kuentina nuk na shikonte. Unë ia afrova pjatën me gjellë dhe ajo zuri të hante.

"A të ka rënë ndonjë copë e mirë e mishit", i thashë. "Nëse jo, ta gjej një copë më të mirë të mishit".

Ajo s'bëri gëk me gojë.

"Të thashë, a të ka rënë ndonjë copë e mirë e mishit?" i thashë.

"Çfarë?" tha ajo. "Po. Më ka rënë".

"A do edhe pak oriz?" i thashë.

"Jo", tha ajo.

"Lërmë më mirë të të jap edhe pak oriz", i thashë.

"Jo, s'dua", tha ajo.

"E po mirë atëherë", thashë unë. "Si të duash".

"Të kaloi kokëdhimbja?" pyeti Nëna.

"Kokëdhimbja?" bëra unë.

"M'u bë se të dhimbte koka", tha ajo. "Kur u ktheve sot pasdite".

"Oh", bëra unë. "Jo, s'më dhemb. Sot pasdite qemë aq të zënë me punë saqë e harrova".

"Prandaj u vonove?" pyeti Nëna. Vura re se Kuentina po na

dëgjonte. I hodha një vështrim. Ajo ende e përdorte thikën dhe pirunin, mirëpo, vura re se ajo po më vështronte, pastaj e shikoi përsëri pjatën e saj. Unë thashë,

"Jo. Ia dhashë një miku veturën time kah ora tre ndaj m'u desh ta prisja derisa u kthye". Pastaj hëngra edhe pak.

"Cili ishte ai?" tha Nëna.

"Një ndër ata palaçot", thashë unë. "Më duket se kunati i tij kishte dalë dikah me një vajzë nga qyteti ynë, kurse ai u kishte rënë pas".

Kuentina s'bënte zë, po vetëm po përtypte.

"S'është dashur t'ia japësh atij tipi makinën tënde", tha Nëna. "Ti je shumë bujar në punë të këtilla. Prandaj s'ta kërkoj kurrë nëse s'jam e detyruar".

"Edhe mua m'u duk disi se kisha gabuar", thashë unë. "Mirëpo, ai u kthye shëndosh e mirë. Më tha se kishte parë atë që duhej".

"Cila ishte ajo femra?" pyeti Nëna.

"Ta them më vonë", i thashë. "S'dëshiroj të flas për gjëra të tilla faqe Kuentinës".

Kuentina nuk hante më. Kohë pas kohe ajo çonte nga një gllënjkë ujë, pastaj shtirej kinse po kafshonte ndonjë piskotë, me fytyrë të përkulur kah pjata.

"Posi", tha Nëna. "Ma merr mendja se gratë që rrinë të mbyllura si unë s'kanë haber se ç'ndodh në këtë qytet".

"Jeta ime ishte ndryshe", tha Nëna. "Lavdi zotit që s'di për maskarallëqe të tilla. Bile as që më interesojnë gjithaq. Unë s'jam si shumë të tjera".

Unë s'thashë më asnjë gjysmë fjale. Kuentina e ulur vazhdonte të grimconte dhe të kafshonte piskota. E pastaj, papritmas pyeti: "Mund të shkoj tash?" pa e shikuar asnjërin.

"Çfarë?" thashë unë. "Po, si jo, mund të shkosh. Neve ma prisje?"

Ajo më lëshoi një vështrim. Ajo kishte copëtuar një piskotë të tërë, ndonëse ende i lëvizte duart si ta grimconte ende ndërsa sytë si mos të dinte ku t'i qepte, e sakaq, zuri t'i kafshonte buzët kështu që të bëhej se mënt u helmua nga tërë të skuqurit e buzëve të saj.

"Gjyshe", tha ajo. "Gjyshe —"

"Mos deshe diçka tjetër të hash?" e pyeta.

"Pse sillet me mua kështu, Gjyshe?" bëri ajo. "Unë kurrë s'e kam fyer".

"E vetmja dëshirë ime është që të pajtoheni me shoqi-shoqin", i tha Nëna. "Vetëm ju më keni mbetur, vetëm ju të dyve ju kam, prandaj dëshiroj shumë që të shkoni sa më mirë me njëri-tjetrin".

"Ky ka faj", tha ajo. "S'më lë të qetë, prandaj unë sillem ashtu. Nëse s'ka qejf të më shohë këtu pse s'më lë të kthehem më —"

"Mjaft më", thashë unë, "Asnjë fjalë s'dua ta dëgjoj më".

"E po atëherë, pse s'më lë të qetë?" tha ajo. "Ky — vetëm —"

"Këtë e ke si babain tënd", tha Nëna. "Ti dhe unë, bukën e tij po e hamë. Është e drejta e tij që të kërkojë mirësjellje nga ti".

"Ky ka faj", tha ajo. Pastaj, brofi. "Ai më shtrëngon të sillem ashtu. Sikur të —" ajo na shikoi me sytë e hutuar, kurse duart i kishte lëshuar përanash. Ato si t'i dridheshin.

"Çfarë sikur të —?" e pyeta.

"Çkado që të bëj, ju keni faj", më tha ajo. "Në qofsha e mbrapsht, e tillë duhet të jem. Ju më keni bërë të tillë. Do të isha fatlume sikur të vdisja. Sa fat do të qe sikur të vdisnim të gjithë". Pastaj, iku me vrap. Dëgjuam sesi po nxitonte përpjetë shkallëve. Pastaj, u dëgjua rrapëllima e derës.

"Kjo është fjala e parë e saj që e tha me mend", thashë unë.

"Sot nuk shkoi në shkollë", tha Nëna.

"Ku e di ti?" pyeta unë. "Mos ishe në qytet?"

"Ja, e di", tha ajo. "A mund të sillesh pak më mirë me të?"

"Me atë rast do të duhej ta shihja nga disa herë në ditë", thashë unë. "Thuaji që të vijë në tavolinë për çdo shujtë. Atëherë mund t'i jap çdoherë nga një copë të mirë të mishit".

"Janë do cikërrima që duhet t'ia bësh", tha ajo.

"Si bie fjala të mos vë vesh kur ti më lut që të kujdesem se a mungon në shkollë?" pyeta unë.

"Sot nuk shkoi në shkollë", tha ajo. "E di se s'ka shkuar. Më tha se kishte shkuar të shëtiste me automobil me një djalë sot pasdite, kurse ti i paske rënë pas".

"Si mund t'i bija pas", bëra unë, "kur automobilin tim ia kisha dhënë dikujt tërë pasditen? A ishte apo s'ishte *në* shkollë sot, kjo kaloi", thashë unë. "Nëse lipset t'ia mbash dertin,

atëherë prit deri të hënën tjetër".

"Unë kam merak që ti me të të kaloni sa më mirë", tha ajo. "Mirëpo, ajo ka trashëguar tërë atë kokëfortësi të prindërve. Edhe të Kuentinit. Ndaj, asokohe unë thashë me vete nëse i ka trashëguar cilësitë e prindërve, le ta mbajë edhe emrin e nënës. Hera-herës mendoj se Kedi dhe Kuentini si të kishin pasë dashur të më dënonin me Kuentinën".

"O zot i madh", thashë unë. "Ti je e zgjuar. S'është çudi sepse je gjithnjë e sëmurë".

"Çka?" tha ajo. "S'po të marr vesh".

"Shpresoj se jo", thashë unë. "Gruas së ndershme i shpëtojnë shumë gjëra që është më mirë mos t'i dijë".

"Të dytë kanë qenë të tillë", tha ajo, "sa herë mundohesha t'i qortoj, t'u bëja vërejtje, e përdornin ndikimin e tyre te babai dhe shpifnin kundër meje. Ngaherë më thoshte se nuk u duhet ndonjë mbikëqyrje se ata edhe vetë e dinin se ç'janë pastërtia dhe nderi, e vetëm këto, para së gjithash, kishin rëndësi. Tash, besoj se ai është i kënaqur".

"Mund të mbështetesh ende në Benin", thashë unë. "Çehre".

"Me qëllim m'u shmangën në jetë", tha ajo. "Veçanërisht ajo dhe Kuentini. Gjithnjë pështjellonin diçka kundër meje. Për ta, unë, ti dhe xha Mauri si të ishim jabanxhinj. Unë gjithnjë i thosha babait tënd se u lente liri të tepërt, se bukur shpesh rrinin bashkë e nuk ndaheshin. Kur Kuentini zuri të shkonte në shkollë, na u desh që një vit më parë ta dërgojmë edhe atë në shkollë që të jenë së bashku. Nuk mund të pajtohej që dikujt prej jush t'i lejohej diçka që s'ia lejonin asaj. Ajo vuante nga kotësia, kotësia dhe krenaria e rreme. Dhe kur mori rrugën e gabueshme dhe iu hapën telashe, unë e dija se Kuentini do ta ndiente si për detyrë që edhe ai të bënte diçka të tmerrshme. Mirëpo, nuk besoja se do të jetë aq egosit — as në ëndërr s'më shkonte mendja se —"

"Ndoshta parandiente se do të linte çupëz", thashë unë. "Dhe se ai nuk do të mund të duronte edhe një femër pranë vetes".

"Ai do të mund të kishte ndikim në të", tha ajo. "Si duket ai që i vetmi person ndaj të cilit ajo kishte konsiderata. Por, ndoshta edhe kjo është një pjesë e dënimit që më ka dhënë zoti".

"Po", thashë unë, "sa dëm që unë mbeta gjallë. Tash ti do ta ndieje veten shumë më mirë".

"Ti flet fjalë të tilla që të më pikëllosh", tha ajo. "Megjithatë, unë e kam merituar këtë. Kur filluan ta shesin tokën që ta dërgonin Kuentinin në Harvard, i thashë yt et se shumë të njëjtë lipset të siguronte edhe për ty. Kur Herberti premtoi të të merrte në bankë, unë thashë, ja pra edhe Xhezoni u sigurua një herë, e kur zunë të shtoheshin shpenzimet, kurse unë detyrohesha të shisja mobiliet tona dhe ato livadhe që kishin mbetur, i shkrova menjëherë, ngase m'u duk se ajo do ta kuptonte se ajo dhe Kuentini e kishin marrë hisen e tyre, madje edhe një hise të pronës së Xhezonit, dhe se nga ajo varet tash sesi do t'ia kompensojë atij hisen. Thashë me vete, mbase do të veprojë ashtu për hir të babait. Asokohe, kështu besoja. Mirëpo, unë jam një grua e gjorë, plakë. Mua më kanë edukuar me besimin se njerëzit janë në gjendje të sakrifikohen për mishin dhe gjakun e tyre. Faji im. Pate të drejtë që më qortove".

"Mos pandeh se më nevojitet ndihma e dikujt që të qëndrojë në këmbë?" i thashë. "Veçanërisht ndihma e gruas e cila s'e di se si quhet babai i fëmijës së saj?"

"Xhezon", tha ajo.

"Po mirë de", thashë unë. "S'desha ta them këtë. Fare".

"A mund të besoj në këtë, pas gjithë atyre vuajtjeve të mia?"

"S'është e vërtetë", thashë unë. "S'desha të flas ashtu"

"Shpresoj se do të më kursesh nga biseda të tilla", tha ajo.

"Sigurisht", thashë unë. "U gjason mjaft atyre të dyve, ndaj s'ke si të dyshosh".

"Unë s'do të mund të duroja diçka të tillë", tha ajo.

"E po atëherë mos mendo më në të", thashë unë. "A të ka trazuar përsëri për të dalë natën?"

"Jo. E kandisa dhe e binda se është për të mirën e saj të mos dalë dhe se një ditë do të më jetë mirënjohëse për këtë. Ajo i merr librat me vete edhe mëson pasi ta kem mbyllur derën me çelës. Ka net kur në dhomën e saj shoh dritë edhe kah ora njëmbëdhjetë e natës".

"Ku e di ti se po mëson", i thashë unë.

"Unë s'di se ç'do të mund të bënte tjetër në dhomë vetëm", tha ajo. "Kurrë s'e ka dashur leximin".

"Jo", thashë unë. "Ti as që do të mund të dije. Falju. Yllit tënd të lumtur që ashtu është", thashë unë. Por, ç'dobi sikur t'i

thosha këto me zë të lartë? Ajo do të zhgrehej në vaj përsëri para meje.

Dëgjova sesi po ngjitej shkallëve. Dikur i bëri zë Kuentinës, kurse Kuentina ia priti "Ç'është?" nga dera. "Natën e mirë", i tha Nëna. Pastaj, e dëgjova çelësin në biralore e Nëna u kthye në dhomën e saj.

Kur e piva cigaren dhe u ngjita lart, tek ajo drita ishte ende e ndezur. Mund ta shihja biraloren e zbrazët, por brenda s'dëgjohej kurrfarë zëri. Po mësonte pa bëzajtur. Ndoshta ashtu e kishin mësuar në shkollë. Ia urova Nënës natën e mirë, u ktheva në dhomën time, e nxora kutinë dhe sërish i numërova të hollat. E dëgjoja të Tredhurin e Madh Amerikan se si po kërhaste si sharra. Kam pas lexuar diku se meshkujt i kishin tredhur për të siguruar zëra femrash. Mirëpo, Beni, me gjasë as që ka ditur se çfarë i kanë bërë. Unë mendoj se ai as që ka qenë i vetëdijshëm se ç'përpiqej të bënte dhe pse zotëri Barxhis e kishte rrëzuar me hu përtokë. Po ta dërgonin në Xhekson ndërsa ende ndodhej nën ndikimin e etherit, ai as që do ta vërente dallimin. Mirëpo, një ide e tillë do të ishte tepër e thjeshtë për një Kompson. S'do të ishte gjithaq e ndërlikuar. Për të bërë diçka është, dashur të prisnin derisa të dilte dhe të mundohej ta dhunonte atë vajzë midis rrugës para syve të babait të saj. Bah, si them unë, vonë e filluan atë operacion të prerjes, e herët i dhanë fund. I njoh edhe dy veta të cilëve u duhet ai operacion. Njëri ndër ta s'banon as një milje më tutje. Por, më duket se as kjo s'do të duhej. Si thashë një herë, lavirja mbetet lavire. Po t'i kisha nja njëzet e katër orë pa këshillat e atyre jahudinjve të Nju-Jorkut të cilët më mësojnë se ç'do të ndodhë. S'jam ndër ata që pasurohen menjëherë; spekulantëve u shkon kjo ndoresh. Dua të gjej një rast të volitshëm, t'i kthej të hollat si t'ia dal kësaj, le ta sjellin këtu tërë Bil-Stritin me kurva, bile me dy sosh do të flija në krevat, kurse e treta le të ulej në vendin tim inë tavolinë.

8 prill, 1928

Agoi një ditë e zymtë dhe e ftohtë. Muri lëvizës i dritës së përhime nga verilindja në vend se të tretej dhe të shndërrohej në lagështi, dukej si të shkapërderdhej në grimca e thërrime helmuese dhe kur Dilzi e hapi derën e kasolles së vet dhe e qiti kokën, ato grimca si gjilpëra futeshin në mishin e saj dhe mblidheshin aty, por jo si lagështi po si diçka që i përngjan vajit të hollë të pangjizur. Në kokë kishte një kapele të fortë dhe të zezë kashte, të cilën e kishte rrasur mbi njëfarë çallme, kurse mbi fustanin prej mëndafshi të purpurtë kishte hedhur një pelerinë ngjyrë gështenje të vjetëruar. Tash qëndroi një copë herë te pragu, me fytyrë, në të cilën pikaseshin një mori rrudhash dhe vurratash, të kthyer kah qielli për të parë se ç'kohë do të mbante. Me dorën e saj thatiçe, shuplaka e butë dhe e ndritshme e të cilës dukej si barku i ndonjë peshku, e ngriti pak pelerinën për ta shikuar pjesën e përparme të fustanit.

Fustani madhështor ngjyre të mbyllur lëshohej nga supet nëpër gjoksin e saj të lëvarur, pastaj tendosej mbi barkun e fryrë, pastaj sërishmi lëshohej duke u fryrë pak mbi nënkëmishat e saj të cilat i zhveshte njerën pas tjetrës me ardhjen e ditëve më të ngrohta pranverore. Dikur ajo kishte qenë grua trupmadhe dhe shtathedhur, kurse tash i pikasej vetëm skeleti i mveshur disi me njëfarë lëkure të flashkët, e cila si fustani ishte tendosur nëpër barkun e saj gati-gati të sëmurë nga sëmundja e ujit, mu sikur muskulat dhe lëkura e saj të qenë guximi dhe trimëria të konsumuara nga gjithë ato ditë dhe vite, si t'i kishte mbetur vetëm skeleti i pamposhtur, i cili, si ndonjë gërmadhë apo megjetar qëndron mbi lukthin

e përgjumshëm dhe të paarritshëm, ndërsa mbi të, ajo fytyra e saj e dobësuar, dukej sikur në të edhe eshtrat të ishin jashtë mishit të saj, me një shprehje të rravijëzuar e të kapërthyer me fatalizëm si dhe me njëfarë zhgënjimi të shastisur fëmijënor. Sakaq, ajo u kthye, hyri në shtëpi dhe e mbylli derën pas vetes.

Dheu pranë derës ishte i djerrë. Sikur tabanët e zbathur të brezave me radhë të kishin lënë në atë dhe njëlloj shtrese dheu të ngjizur, si në sermin e vjetër apo nëpër muret e shtëpive meksikane të stolisura me dorë. Ndanë shtëpisë ndodheshin tre mana të cilët hedhnin hije në verë me gjethet si piskatore të cilat më vonë do të rriteshin dhe do të shndërroheshin në gjethe të gjëra dhe të qeta si shuplaka, kurse tash po eponin nga puhia. Dy grizhlemza ia bëhen s'di prej nga, u vërtitën nëpër erë si copat laramane të cohës apo të letrës, e, më në fund, u ndalën mbi manat, aty u lëkundën dhe u luhatën herë andej herë këtej duke këlthitur në erë që i përhapte klithjet ■ tyre ngado si grumbullin e letrave ose të cohës. Pastaj, iu bashkuan edhe tre grizhlemza të tjera, kështu që zunë të lëkundeshin, të pehateshin dhe të çirreshin nëpër degët ■ lakuara. Dera e kasolles, u hap sërishmi Dilzi u duk përsëdyti, kësaj radhe me kapele mashkulli dhe me mallotë ushtarake, nën kindet e të cilës fustani i saj nga pëlhura lara-lara dhe blu prej pambuku lëvarej hove-hove dhe eponte rreth saj, ndërsa po kalonte oborrit dhe po ngjitej shkallëve që shpienin kah dera e kuzhinës.

Pas një copë here u duk përsëri, kësaj radhe duke mbajtur para vetes çadrën e hapur për t'u mbrojtur nga era, shkoi deri te stiva e drurëve dhe ashtu të hapur e hodhi për toke. Fill pastaj e rroku përsëri çadrën dhe shikoi rreth e rrotull. E pastaj e mbylli çadrën, e lëshoi për tokë, mori një krah dru, i mbështeti për kraharor, e mori sërish çadrën të cilën mezi e hapi, u kthye te shkallët duke i mbajtur drurët në një drejtpeshim të pasigurt derisa disi e mbylli çadrën dhe e mbështeti në këndin pas derës. Drurët i hodhi në sandëkun pas kaftorit. Pastaj e zhveshi mallotën, e hoqi kapelen dhe mori nga muri përparësen e drangosur, e veshi dhe e ndezi kaftorin. Ndërkohë, duke e shpupurishur zjarrin me mashë dhe ndërsa i hapte kapakët që kërcitnin, asaj i bëri zë nga maja e shkallëve zonja Kompson.

Kishte veshur një fustan shtëpie nga sateni i zi të cilin me një dorë e mbante të mbyllur nën gushë, kurse në dorën tjetër e mbante termaforin nga goma e kuqe. Ndodhej në maje të shkallëve të shërbëtorëve duke bërtitur me një zë monoton "Dilzi" që po përsëritej e po përhapej pa ndarë nëpër shkallët e qeta që lëshoheshin në errësirën e dendur e dikur përsëri feksi drita e përhime nga dritarja. Ajo thërriste "Dilzi" pa e theksuar dhe pa e ndryshuar atë fjalë, pa farë nxitimi, sikur të mos priste përgjigje. "Dilzi".

Dilzi iu përgjigj dhe e la rrapllimën dhe bujën rreth kaftorit, mirëpo, para se të dilte nga kuzhina, sërishmi e thirri zonja Kompson dhe para se të kalonte nëpër dhomën e ngrënies dhe ta qitte kokën në njollën e përhime të dritares, e thirri edhe një herë.

"Mirë, mirë", tha Dilzi, "ja, erdha. Do ta mbush menjëherë sapo të kem ujë të ngrohtë". E ngriti fundin dhe u ngjit shkallëve duke u puthitur me dritën e përhime të dritares. "Lëreni termaforin dhe eni në shtrat".

"S'po marr vesh se çka ngjarë", tha zonja Kompson. "Kam një orë që jam e zgjuar dhe nuk dëgjoj asfarë zëri nga kuzhina".

"Ama lëreni dhe ejani në kuzhinë", tha Dilzi. E kolme dhe e mbushur frymë, ajo mezi u ngjitej shkallëve. "Për një minutë ndizet zjarri, për dy, nxehet uji".

"Kam një orë që jam e shtrirë", tha zonja Kompson. "Mendoja se mua më prisnit të zbrisja dhe ta ndizja zjarrin".

Dilzi doli në krye të shkallëve dhe e mori termaforin. "Veç një minutë", tha ajo. "Sot në mëngjes, Llasteri u zgjua, vonë, deri *në* mesnatë ishte ulur galiç në atë farë cirku. M'u desh ta ndez zjarrin. Ejani tash të flini, mos i zgjoni të tjerët derisa të mos jem gati".

"Në i lejofsh Llasterit të merret me gjepura që e largojnë nga puna vet do t'i heqësh pasojat", tha zonja Kompsan. "Xhezonit s'do t'i bëhet qejfi nëse e merr vesh këtë. Edhe vetë e di këtë shumë mirë".

"Ai nuk shkoi atje me të hollat e Xhezonit", tha Dilzi. "Kjo punë, dihet".

Dilzi u lëshua nëpër shkallë, kurse zonja Kompson u kthye në dhomën e saj. Derisa po shtrihej në shtrat, dëgjoi se si Dilzi akoma po zbriste shkallëve rrue një ngadalësi të dhimbshme dhe të tmerrshme nga e cila mund të lozje mendsh sikur mos

të pushonin dalngadalë zhapullimat e hapave nga kërcëllimet e rënda të derës së çarranikut.

Dilzi hyri në kuzhinë, e ndezi zjarrin dhe zuri ta përgatiste mëngjesin. Mu në vlugun e punës, i la të gjitha, iu afrua dritares dhe shikoi jashtë kah kasollja e vet, e pastaj shkoi te dera, e hapi dhe thirri në erë

"Llaster!" briste me veshë të curruar, duke e fshehur fytyrën nga era. "O, Llaster o!" Përgjoi për një çast. Dhe atëherë, mu atëherë kur u përgatit të bërtiste sërish, ia behu Llasteri pas këndit të kuzhinës.

"Ë?" bëri ai si me aq patëkeq saqë Dilzi e shikoi pa luajtur vendit me një befasi jo të rëndomtë.

"E, ku ishe ti?"

"Kurrkund! Veç "në bodrum".

"Çka dreqin bëje aty?" e pyeti ajo me rreptësi. "Mos rri aty në shi mor tarallak!"

"Tybe n'paça "bo" gjo".

Hipte shkallëve.

"Mos eja këtu pa një krah dru", ia bëri ajo. "Parëz është dashur të sillje dru dhe ta ndizje zjarrin. A s'të thashë mbrëmë mos dil pi' shtëpisë para se ta mbushësh me dru deri në maje këtë sandëk?"

"Paj, e mbusha, vallahi", tha Llasteri.

"Ani, ç'ndodhi atëherë?"

"S'di. Unë as që e preka"

"Epo tash s'ke çare pa e mbushur. Manej eja lart dhe ruaje Benxhin".

E mbylli derën. Llasteri u nis kah çarraniku. Pesë grizhlemza po fluturonin e po vërtiteshin mbi shtëpi duke kërrokatur e dikur përsëri u lëshuan në mana. Ai i bënte sehir. Mori një guralec dhe i gjuajti duke thënë: "Ish! Hupni! Qërohuni e kthehuni në ferr ku e keni vendin. Ende s'e keni ditën e kthimit në tokë".

Kishte marrë thuaja një kamare dru me vete. Nga drurët nuk mund të shihte fare, kështu që mori në thua deri te shkallët bile edhe duke u ngjitur shkallëve dhe duke u kalamendur u përplas me rrapllamë për derë duke rrëzuar disa copa drurë. Në atë çast, ia behu Dilzi dhe ia hapi derën kurse ai mori në thua në kuzhinë.

"Hej, Llaster, ki kujdes", i thirri ajo, mirëpo sakaq ai iu afrua

me nxitim sëndukut ku i hudhi drurët me rrapamë. "Ha!" mori frymë me lehtësi.

"A deshe ta çosh peshë tanë shtëpinë a?" i tha gjyshja dhe e goditi me dorë në zverk. "E tash, shko drejt atje dhe veshe Benxhin".

"Si urdhëroni", tha dhe u nis kah dera e oborrit.

"Ku shkon mor?" e pyeti ajo.

"Thashë mos "a ma" mirë që t'i bie rrotull shtëpisë dhe të hyj nga pas që të mos e zgjoj zonjushën Kahlinë dhe të tjerët.

"Zbrit shkallëve të shërbyesve si të thashë dhe veshe Benxhin", i tha Dilzi, me rreptësi. "Hajde, mos prit".

"Si urdhëro", tha Llastëri.

U kthye dhe doli nga dera e dhomës së ngrënies. Pas një copë here, dera nuk lëkundej më. Dilzi përgatiste brumin për piskota. Ndërsa po e lëkundte sitën mbi dërrasë, po këndonte me zë të ulët, në fillim me vete, diçka si nënëritje, pa melodi dhe fjalë, një melodi që përsëriste, një melodi trishtuese, vajtuese, festive. Tingujt e qetë të këngës po përhapeshin atypari, ndërsa mielli po binte dhe po zbardhëllente në dërrasë. Kaftori zuri ta ngrohte kuzhinën dhe ta mbushte me tinguj nënëritës të zjarrit e po në atë çast u këndell edhe kënga e Dilzit si ta ringjallte këngën dhe zërin vetë ngrohtësia, gjithnjë e më e madhe. Pastaj, zonja Kompsan, e thirri sërish nga shtëpia. Dilzi e ngriti fytyrën si të ishin në gjendje të depërtonin sytë e saj nëpër mur dhe tavan dhe ta shihnin atë plakë me fustan të gjerë shtëpiak duke qëndruar në krye të shkallëve dhe duke e thërritur si ndonjë automat emrin e saj.

"Oh, zot i madh!" thirri ajo.

E lëshoi sitën dhe i shkundi kindet e përparëses, pastaj i shkundi duart, e mori shishen nga karrigia e kapi me skajin e përparses mbajtësen e kusisë ku gargariste uji.

"Një minutë. Qe uji u "bo" gati".

Mirëpo, nuk ishte ajo shishja e termaforit nga goma të cilën e kërkonte zonja Kompson. Këtë shishe Dilzi e kishte rrokur për grykë si ndonjë pulë të ngordhur; ajo shkoi rrëzë shkallëve dhe shikoi lart.

"A s'tek "a" atje Llasteri me të?" tha Dilzi.

"Llasteri s'është në shtëpi që nga mëngjesi". Unë isha e shtrirë në krevat dhe e prisja që të vinte. E dija se do të

vonohej, mirëpo shpresoja se do të vinte me kohë dhe të mos e lërë Benxhaminin që ta trazojë Xhezonin të paktën në këtë ditë të vetme të javës kur i ngrati mund të flerë më tepër në mëngjes".

"Unë s'di se qysh mund të flejë dikush kur ju qëndroni atje te shkallët nga agimi dhe s'po u lini "gja" pa u thënë gjindëve rreth e rrotull, qe besa kaherë po i bani!" ia priti Dilzi. Filloi të ngjitej shkallëve si duke u zvaritur. "Paj ka gjysmë ore që e çova atje".

Atë po e vështronte zonja Kompsom e cila nën mjekër po e mbante fustanin. "Kah shkon ashtu?" e pyeti.

"Shkova ta vesh Benxhin dhe ta sjell në kuzhinë, se mos po ia prish gjumin Xhezonit dhe Kuentinës", u përgjigj Dilzi.

"Fillove ta përgatitësh mëngjesin?"

"E bëj edhe atë. Ju shkoni në krevat teksa Llasteri t'jua ndezë zjarrin. Sot a "acar" i madh".

"E di", bëri zonja Kompson. "Këmbët i kam si akulli. Ishin aq të ftohta saqë u zgjova". E vështronte Dilzin e cila po ngjitej shkallëve.

Ajo po ngjitej dalngadalë. "Ti e di se sa fort nevrikoset Xhezoni kur vonohet mëngjesi", tha zonja Kompson.

"Brenda një kohe mund të bëj veç një punë, njëqind "dur" s'i kam" tha Dilzi. "Allahile shkoni e shtrihuni se pasha zotin s'di si ia bëj".

"E po meqë ti i paske lënë të gjitha punët dhe je nisur për ta veshur Benxhaminin, atëherë e mira e së mirës është që unë të zbres në kuzhinë dhe ta përgatis mëngjesin. Ti e di si unë si zemërohet Xhezoni sa herë që vonohet buka".

"E kush e ha atë psheshin tuaj?" tha Dilzi. "Më thoni, ju lutem. Shkoni e shtrihuni në krevat", bëri ajo mezi duke iu ngjitur shkallëve. Zonja Kompson e vështronte ndërsa ngjitej shkallëve duke u mbështetur me një dorë për mur, kurse me tjetrën i mbante kindet e fundit.

"Po shkon ta zgjosh vetëm e vetëm që ta veshësh?" pyeti ajo.

Dilzi u ndal. Njërën këmbë e kishte vënë në shkallën tjetër. Me dorën tjetër ishte mbështetur për mur me njollën e përhimtë të dritares pas vetes dhe dukej e palëvizur dhe si e paformë.

"A s'u zgjua ende", tha ajo.

"Nuk ishte zgjuar kur shikova unë. Mirëpo, kishte kaluar

koha e gjumit të tij. Ai kurrë s'fle më shumë se shtatë orë e gjysmë. Ti e di këtë fort mirë".

Dilzi s'bëri zë. As që luajti nga vendi. Ndonëse zonja Kompson mund ta shihte vetëm siluetën e saj, ajo e dinte se Dilzi e kishte thartuar fytyrën dhe se po qëndronte te shkallët si lopa në shi duke mbajtur shishen e zbrazët të termaforit për gryke.

"S'është e thënë që ti të keshë kokëçarje me këto", i tha zonja Kompson. "Ti s'ke kurrfarë përgjegjësie. Ti mund të shkosh. Pse ti të heqësh të zitë e ullirit përditë. Ti s'u detyrohesh kurrgjë, as kujtimit të zotëri Xhezonit s'i detyrohesh asgjë. Unë e di se ti kurrë s'e ke pasur në qejf Xhezonin. Bile as që e ke fshehur këtë".

Dilzi s'i tha as gjysmë fjale. U kthye me ngadalë dhe zuri të zbriste shkallëve teposhtë duke u kolovitur mga shkalla në shkallë, taman si ndonjë fëmijë e duke u mbajtur për mur. "Shkoni dhe lëreni të qetë", tha përsëri zonja Kompson. "Mos hyni më te ai. Unë e çoj Llasterin, me ta parë. Mos u mërzitni për Benxhin".

Ajo u kthye në kuzhinë i lëshoi një vështrim kaftorit, e pastaj e zhveshi përparësen, e veshi mantelin, e hapi derën dhe shikoi kah oborri. Pikëlat e shiut, të vrikshme dhe të imta, po i përplaseshin për mish, ndonëse nuk mund të shihje as frymë njeriu. U lëshua teposhtë shkallëve me kujdes, si të donte t'i shmangej çdo shushurime dhe kaloi kah këndi i kuzhinës. Pikërisht në atë çast, papritur e papandehur, ia behu Llasteri te dera e qilarit.

Dilzi u ndal. "More dreq, çka po "bon" aty?" tha ajo.

"Kurrgja", tha Llastëri. "Zotëri Xhezani m'tha ta gjej "qat vend p'i kahit" po del ai uji".

"E kur ta tha këtë, mor haram? Ditën e vitit të ri të motmotit a?"

"Thash "t'kqyri i herë" sa janë tu, fjetë gjindja n' shpi".

Dilzi iu afrua derës së qilarit. U ndal pranë derës dhe filloi të shikonte andej kah errësira e cila kutërbonte si dheu, myku dhe goma.

"Ah", tha Dilzi. Përsëri e mati me sy Llasterin. Ai e shikoi me një shikim të padjallëzuar dhe të çiltër. "Unë s'di se çfare proçke po ban, po vallahi, me sa di, ti s'ke punë aty. Edhe ti po m'bie në qafë e po m'qet kajde si të tjerët sot paradite. E a more vesh, a?"

"Ani mirë", tha Llasteri dhe përnjëherësh u nis kah shkallët e kuzhinës

"Hej", ia bëri Dilzi. "Mbasi që t'kam këtu, "bima" edhe një krah dru".

"Ani mirë", tha ai.

Kaloi pranë saj dhe u nis kah çarraniku. Kur, pas një copë here mori në thua përsëri u ndesh për derë, sërishmi i padukshëm dhe si i verbër, Dilzi ia hapi derën dhe me dorë të fortë ia priu nëpër kuzhinë.

"Këqyr e qiti drutë n'atë sandëk", tha ajo, "Hapi sytë".

"S'kam çare", i tha Llasteri duke marrë frymë me bulqi. "Qysh t'i hedh ndryshe".

"Në qoftë ashtu atëherë prit edhe pak", i tha Dilzi. Filloi t'ia shkarkonte drurët një nga një. "Ç'të gjeti bre sot? Deri sot sa herë që t'kam "çu" për dru kurrë s'm'i ke pru më shumë se gjashtë copa, bën vaki se trembesh se mos po e merr herninë. E tash çka po m'pështjellon diçka? A e thyen qafën ata të cirkut?"

"Po, ikën".

E la edhe copën e fundit të drurit në sandëk. "E tash, mule e shko te Benxhi, mos harro. Nuk du që t'më piskat kurrkush "pi" majes s'shkallëve pa e thirrur unë vetë me zile. A more vesh, hej ti?"

"Poo ëëë", bëri Llasteri. Doli nga dera që sillej. Dilzi qiti edhe disa dru në kaftor dhe mandej filloi sërishmi ta shoshit miellin. Përsëri zuri të këndonte me zë të ulët.

Oda u nxe. Pas një copë kohe, lëkura e Dilzit u bëmë e njomë dhe më e shkëlqyeshme, në e krahasofshim me atë ngjyrën e zbehtë dhe të hirit që pikasej pak më parë në fytyrën e saj dhe të Llasterit, kurse Dilzi po vërtitej nëpër kuzhinë dhe i mblidhte artikujt e ushqimit për të përgatitur mëngjesin. Në murin mbi dollap, po binte ora e murit që dukej vetëm matën afër llambës, por edhe atëherë në njëfarë thellësie enigmatike, ngaqë kishte vetëm një tregues. Ora më parë zhurmëroi si të donte të kollitej e pastaj ra pesë herë.

"Ora tetë", tha Dilzi. U ndal, e ngriti kokën dhe zuri të përgjonte. Mirëpo, ajo mund ta dëgjonte vetëm tiktakun e orës dhe kërcitjen e zjarrit. E hapi furrën e kaftorit dhe e shikoi sahanin me piskota, pastaj ashtu e përkulur u ndal kur dikush po zbriste shkallëve. E dëgjoi rrapëllimën e hapave nga dhoma

e ngrënies, e po më atë çast befas u hap dera dhe Llasteri hyri në kuzhinë, kurse pas tij hyri edhe një njeri trupmadh, i cili si të ishte bërë nga diçka therrimet e të cilës nuk mund të njëzohen as me njëra-tjetrën dhe as me skeletin që e mbante. Lëkurën e kishte si të vdekurit dhe s'kish asnjë qime; ashtu i barkanjosur si ishte ai ecte duke u lëkundur si ndonjë ari i stërvitur. Leshrat i kishte të verdha dhe të mira. Në ballë i kishte krehur me elegancë tamam si fëmijët në fotografitë e vjetra. Sytë i shkëlqenin, ngjyra e tyre ishte e kaltër e mbyllur si kokoçeli, buzët e trasha i kishte të hapura dhe të jargëzuara një grimë.

"A po nerth ashtu?" tha Dilzi. I fshiu duart për përparëse dhe ia preku dorën Benxhit.

"Nashti ai spo nerth, po *unë* u ngrina", tha Llasteri. "Në Kërshëndella gjithmonë "a" acar i madh. Gjithherë njësoj sa di vetë. Zonjusha Kahlinë m'tha më mos e paçe gati atë farë termafori n'daç hiç mos ja ço".

"O i lumi zotyn", tha befas Dilzi. E shtyri karrigen deri në këndin mes sëndukut të drurëve dhe kaftorit. Ai njeriu u nis andej dhe u ul në karrige pa bëzajtur. "Llaster o, këqyr n'odë t'haes, se mos e kam harru atje shishen e termaforit", bëri Dilzi. Llasteri e solli shishen nga dhoma e ngrënies, kurse Dilzi e mbushi me ujë të ngrohtë dhe ia dha. "Tash ngutu e çoja. Këqyr kalimthi se mos u "zgju" Xhezoni. Thuj se kaftjalli "a" gati".

Llasteri doli. Beni ishte ulur afër kaftorit, i lëmekur dhe si i flashkët, i palëvizshëm, vetëm kokën e lëvizte me vrull herë andej, herë këtej derisa e shikonte me atë shikim të tij të butë dhe të pashibla Dilzin, e cila po vërtitej në kuzhinë. Llasteri u kthye.

"U zgju", tha ai. "Zonjusha Kahlinë tha t'shtrosh".

Llasteri iu afrua kaftorit dhe i zgjati shuplakat e duarve mbi të. "Ai bile u "bo" tym", tha Llasteri. "S'di as vetë pse. Si t'ish çu me "komb" të majtë".

"Çka dreqin e ke?" bëri Dilzi. "Hajde, qërohu. E çka mund "t'baj" unë kur ti m'rri aty si hu gardhi?"

"Po narth", tha Llasteri.

"A s'nirthshe në qilar a?" ia ktheu Dilzi. "Po Xhezonin, çka e gjet që u "idhnu" ashtu?"

"Ai po thotë se unë e Benxhi ia kemi thy atë "penxhere" n'odë".

"A u thy a?" tha Dilzi.

"Ai po thotë "qashtu". Bile po ma le fajin bigajri hak".

"E qysh ta thyesh ti kur odën e mban mshelë ditë e natë?"

"Thotë që e kam "thy" me guri", tha Llasteri.

"Po mirë, a ke thy?"

"Qy, qy, jo bre", bëri Llasteri.

"Mos m'rrej, mor jezit".

"O jo, s'e kam thy. Që "pvete" n'daç Benxhin. As që ia kam këqyrë penxheren".

"E kush mund ta ketë thy atëherë? Ndoshta e ka thy vetë "tu" dashtë ta zgjojë Kuentinën", tha Dilzi duke e nxjerrë nga kaftori sahanin me piskota.

"Bon vaki", tha Llasteri. "Njerëz tuafë.

Kam nafakë që s'jam asisojit".

"E cilët?" pyeti Dilzli. "Ngo "kho" se ç'po t'thom mor zezak lahper. Edhe ti i di tona dreqnit e Kompsonëve si vetë ata. E prapëseprapë, po thu se nuk e paske thy a?"

"E pse ta thej bre?"

"Pse a? Sepse i "bon" njiqind dreqni", ia ktheu Dilzi "E tash "ruje" Benxhin e çeli syltë se mos e djeg dorën "prapë" tekteri sa ta shtroj bukën".

Ajo shkoi në dhomën e ngrënies. Ata të dytë po dëgjonin se si po bënte ecejake. Mandej, u kthye dhe e vuri pjatën në tavolinën e kuzhinës. Pjatën e mbushi me ushqim. Beni po e vështronte duke u përjargur dhe duke lëshuar disa si klithma të prajtura, të përmbajtura.

"Ashtu, të paça", i thoshte ajo. "Qe ku e ke kaftjallin. Haje. Afroja karrikën, Llastar".

Llasteri ia ofroi karrikën, kurse Beni u ul duke sfilitur dhe duke u shkumbavitur. Dilzi ia lidhi një servijetë rreth qafes kurse me skajin e saj ia fshiu gojën.

"Këqyre, çili sytë se mos po i ndyn teshat përsëri", tha Dilzi duke ia dhënë lugën Llasterit.

Beni pushoi së sfilituri. E vështronte si i shushatur lugën sesi ngritej kah goja e tij. Të dukej se edhe grykësinë e kishte të paralizuar, ndërsa edhe vetë uria është enigmatike, ngase ai s'di se si është uria. Llasteri e ushqente me shkathtësi po edhe me indiferencë. Hove-hove shkathtësia e tij ishte e atillë saqë ai bënte sikur do t'ia afronte Benit lugën në gojë, kurse ky i shkreti e mbyllte më kot gojën e zbrazët, mirëpo, në momente

të tilla Llasterit me siguri i treteshin diku mendimet. Dorën tjetër e kishte te mbështetësja e karriges kështu që nëpër atë sipëfraqe të vdekur e lëvizte me kujdes dhe me butësi mu sikur nga ajo zbrazëti morte rrekej të nxirrte ndonjë melodi të padëgjuar, njëherë madje, derisa gishtërinjtë e tij po e përshkonin dhe po nxirrnin nga druri i heshtur arpegjon e pazëshëm dhe të ngatërruar, kishte harruar ta çikte Benin duke ia afruar gojës së tij lugën, mirëpo, Beni ia kishte përkujtuar këtë me sfilitjen e tij të sërishme.

Në dhomën e ngrënies, Dilzi po bënte varavinga duke punuar. Papritmas, ajo i ra zileS dhe në atë çast Llasteri i dëgjoi në kuzhinë zonjën Kompson dhe Xhezonin duke zbritur, madje edhe zërin e Xhezonit dhe kështu me t'i dëgjuar ai i kapsalliti sytë në atë mënyrë saqë i dukej vetëm të bardhët e syrit.

"Është e qartë, e di unë se ata nuk e kanë thyer", tha Xhezoni. "U mor vesh, e di. Ndoshta e ka thyer shtrëngata".

"Unë s'e kuptoj sesi ka mundur të ndodhte", tha zonja Kompson. "Dhomën e ke të mbyllur gjithë ditën e lume, askush s'ta prek —, të mbetet ashtu si e lë kur shkon në qytet. Askush nga ne nuk hyn në të pos të dielave për ta pastruar. S'dua që të mendosh se unë do të hyja aty ku s'më duan apo se do t'ia lejoja këtë dikujt tjetër".

"Mos thashë se ti e ke thyer?" tha Xhezoni.

"S'dëshiroj të hyj në dhomën tënde", vazhdoi zonja Kompson. "Unë e respektoj jetën private të çdo njeriu. S'do ta shkelja pragun e dhomës sate edhe po ta kisha çelësin".

"S'do mend", tha Xhezoni, "Unë e di se çelësat e tu s'e hapin bravën time. Prandaj, edhe ia ndërrova bravën. Unë dua ta di vetëm këtë: si ma thyen dritaren".

"Llasteri thotë se ai s'e paska thy", bëri Dilzi.

"Këtë e dija edhe pa e pyetur", tha Xhezoni. "E ku është Kuentina?"

"Aty ku "a" çdo të diele në mëngjes", iu përgjigj Dilzi, "Sikur ta dija çka dreqin e ke në këto javët e fundit".

"E po mirë, do ta ndryshojmë sistemin e deritashëm", tha Xhezoni. "Shkoni lart e kumtojuani se mëngjesi është shtruar".

"O Xhezon, lëre të qetë të ngratën", po e luste Dilzi. "Ajo zgjohet në çdo mëngjes të javës, vjen në mëngjes e Kahlina vetë i ka "dhonë" leje që të flejë më gjatë çdo të diele. Ti edhe vetë e di këtë".

"Unë s'mund ta mbaj kuzhinën plym me zezakët që t'ia bëjë asaj qejfin, bëri Xhezoni. "Shkoni lart dhe thuajini që të zbresë në kaftjall".

"Hiç kurrkush mos të lodhet për të", tha Dilzi. "Unë ja "lo" kaftjallin gati, të nxehtë e ajo..."

"A s'më dëgjuat se ç'ju thashë?" u hidhërua Xhezoni.

"Po të ndëgjoj bile fort mirë, mos ke dert", u gjegj Dilzi. "Kur ti je n'shpi'", asnjani" s'guxon "t'bajë cik me gojë. E qorton ose Kuentinën ose mamën ose Benxhin ose Llasterin. Qysh i lejoni t'lazdrohet, allahile, zonjusha Kahlinë?"

"E mira e së mirës është që ta dëgjosh atë që të thotë", bëri zonja Kompson. "Tash ai është i pari i shtëpisë. E drejta e tij është të kërkojë që t'i nderojmë dëshirat e tij. Unë po përpiqem ta dëgjoj e po munda unë, mundesh edhe ti".

"Budallaki e madhe "a" që Kuentina t'çohet "pi" krevetit pse ju ka tek atij", tha Dilzi. "Mos po ta ha mendja se ajo e ka "thy" dritaren?"

"Po t'i binte kjo në mend rastësisht ajo s'do të pritonte", tha Xhezoni. "Ju shkoni e kryeni detyrën që ju dhashë, hajde".

"Edhe po ta thonte as gjysmë fjale s'do t'i thosha", bëri Dilzi duke u nisur kah shkallët. "S'i le "gjo" pa i thanë, sa herë që je n'shpi".

"Rrudhe gojën, Dilzi", i tha zonja Kompson. "Nuk na ka hije as ty as mua se ç'duhet të bëjë ai. Hera-herës edhe unë mendoj se s'e ka mirë, e po unë përpiqem që ta dëgjoj për hir të gjithë juve. Nëse unë kam takat për të ardhur në tavolinë, atëherë mundet edhe Kuentina".

Dilzi doli. E dëgjonin se si po ngjitej shkallëve. E dëgjuan për një copë kohë të gjatë te shkallët.

"Paj shërbëtorët i ke për marak, nëno", bëri Xhezoni. Ia shtroi mëngjesin nënës, pastaj vetes. "A ke pasur ndonjëherë ndonjë të hairit? Ndoshta i ke pasur edhe do të mirë para se të rritesha unë, por mua s'më kujtohen".

"S'kam çare pa i marrë me të mirë", tha zonja Kompson. "Varem tërësisht prej tyre. Ndryshe do të ishte po të isha e fortë e me takat. Eh, sikur të isha e tillë. Sikur të isha e zonja t'i bëja punët e shtëpisë. Atëherë, të paktën do të ta lehtësoja barrën".

"Po, atëherë në thark derrash do të banonim", tha ai. "Ngutu moj Dilzi", briti.

"Unë e di se do të më qortosh, ngase sot ua lejoj që të shkojnë në kishë".

"Ku të shkojnë?" pyeti Xhezoni. "A nuk iku ende ai cirku i mallkuar?"

"Në kishë, biro", shpjegoi zonja Kompson. "Zezakët shkojnë në meshën e posaçme të Kërshëndellave. Para dy javësh ia dhashë fjalën Dilzit, i thashë se mund të shkojnë".

"Me fjalë të tjera për drekë do të kemi ndonjë gjellë të ftohtë nëse do të kemi gjë", bëri Xhezoni.

"Unë e di se aty kam gabuar", tha zonja Kompson. "E di se do të më qortosh".

"E pse të të qortoj? Mos e ke ringjallur ti Krishtin ndoshta? Apo ndoshta e ke ringjallur?"

Ende po dëgjoheshin hapat e Dilzit në shkallët e fundit dhe pastaj edhe ecja e saj e ngadalshme korridorit mbi ta.

"O Kuentinë", thirri Dilzi.

Kur thirri për herë të parë Xhezoni i la thikën dhe pirunin. Si ai ashtu e ëma, si të prisnin diçka nga njëri-tjetri, në poza të njëjta; ai i ftohtë dhe i rreptë, me flokë të zez dhe me kaçurrela të ndarë në dy tufa, një nga njëra anë, kurse tjetra nga ana tjetër tamam si ndonjë kamerier nga e përkohshmja humoristike me sy ngjyrë lajthie me bebëza të rrethakuara me ngjyrë të zezë si ndonjë ble, kurse ajo dukej e ftohtë dhe qaramane, me flokë të bardha, me sy të fryrë dhe të shushatur dhe aq të errët sa që të dukeshin si bebëza ose minza e syrit.

"Kuentinë", thirri Dilzi. "Zgjohu, zemër. Po të presin në kaftjall".

"Unë s'e kam të qartë sesi u thye ajo dritare", foli zonja Kompson. "A je i sigurt se dje e thyen? Në këtë mot të ngrohtë, mund të ketë ngjarë edhe më parë. Ai qelqi i epërm është i mbrojtur nga veranda".

"Ja ku po ta përsëris për herë të mbrame se qelqin e kanë thyer dje", tha Xhezoni. "A mendon ti se unë nuk e njoh dhomën time ku banoj? A mendon ti se kam mundur të banoj aty një javë, ndonëse aty ishte vrima nga e cila mund ta fusësh dorën?..." Zëri i tij, u ndërpre, ra dhe e la atë që ta shikonte të ëmën me një shikim pa shprehje. Si t'ia kishin ndalur frymën ata sy të tij, ajo po e vështronte me fytyrën e saj të lëmekur, qaramane, parashikuese, por topitëse.

Derisa po rrinin ashtu, Dilzi thirri përsëri:

"Kuentinë, moj zemër, mos u mahit me mu. Hajde, eja të hash mëngjes. Të presin".

"S'po e marr vesh", bëri zonja Kompson. "Si të ishte menduar dikush të futet me zor n'shpi..." Xhezoni brofi nga vendi. Karrigia iu rrëzua pas. "Ç'u bë — " briti zonja Kompson duke shikuar pas tij, ndërsa ai po nxitonte pranë saj dhe po u ngjitej shkallëve me vrundull ku u ndesh me Dilzin. Fytyra e tij tash ndodhej nën hije, kurse Dilzi tha: "I ka mbetur hatri. Nëna jote s'ia ka çelur derën —"

Mirëpo, Xhezoni ngarendi pranë saj dhe i ra korridorit e arriti para derës. As që bëri zë. Ia rroku dorëzën dhe u mundua ta hapte, pastaj mbet me dorëzën në dorë dhe me kokën e ulur mu si të dëgjonte diçka që dshte shumë më larg se dimensionet e dhomës pas asaj dere, diçka që tashmë ai kishte dëgjuar. Mbahej si dikush i cili kalonte nëpër të gjitha fazat e dëgjimit për ta mashtruar veten rreth asaj që kishte dëgjuar. Pas tij shkallëve u ngjitej zonja Kompson, duke e thirrur me emër. Pastaj e vuri re Dilzin, kështu që pushoi së thirruri Xhezonin po i bëri zë asaj.

"Të thashë se hala s'e kishte pa çelë derën", tha Dilzi.

Derisa po fliste ajo, ai u kthye dhe nxitoi kah ajo, por zërin e kishte të pashitur. "A e mban ajo çelësin me vete?" bëri ai. "Desha të them, a e ka me vete, tash, apo —"

"Dilzi moj", thirri zonja Kompson nga shkallët.

"Çkaaaa?" tha Dilzi. "Pse bre s'po e lë —"

"Çelësin", ia priti Xhezoni. Çelësin e kësaj dhome. A e mban ajo gjithnjë me vete? Nëna. "Në atë çast ajo e vuri re zonjën Kompson dhe u nis tatëpjetë shkallëve kah ajo. "Ma jep çelësin", tha ai. Zuri ta kërkonte nëpër xhepat e fustanit të saj të zi shtëpiak e të vjetër si ndonjë i lafitur. Ajo po i shmangej.

"Xhezon", bërtiste ajo, "Xhezon! Mos doni ti e Dilzi të më ktheni përsëri në krevat?" thoshte ajo duke e shtyrë atë. "A s'po më lini që të jem e qetë të paktën një javë?"

"Çelësin", ngulmonite ai. "Ma jep çelësin!" U kthye dhe shikoi kah dera përsëri si të pandehte se do të hapej aty për aty para se të arrinte te dera me çelësin që nuk e kishte gjetur.

"Moj Dilzi!" tha zonja Kompson duke e shtrënguar fustanin rrotull vetes.

"Ma jep çelësin, moj matufe!" briti Xhezoni papritmas dhe nga xhepi i saj nxori një tufë të madhe të çelësave të ndryshkur

në një hallkë hekuri si të ndonjë gardiani mesjetar dhe vrapoi me ta korridorit teksa dy gratë iu qepën pas.

"Mor Xhezon!" tha zonja Kompson. "Kurrë s'do ta gjejë çelësin që i nevojitet", tha ajo. "Dilzi, ti e di se unë s'ia kam dhënë kurrë askujt çelësat e mi", tha ajo. Po në atë çast zuri të qante.

"Mosni", ia bëri Dilzi. "S'ka çka t'i bajë. S'e la unë".

"Por, të dielën në mëngjes, në shtëpinë time", tha zonja Kompson. "Kurse unë bëra çmos që t'i edukoj sa më mirë si të krishterë. Ma jep se unë ta gjej çelësin e dhomës, Xhezon", tha ajo. E zuri për krahu dhe filloi të përleshej me të, mirëpo, ai e shtyri atë me bërryl dhe po në atë çast shikoi me zemërim, pastaj sërishmi iu kthye derës dhe u vu t'i kontrollonte çelësat e tufës.

"Boll bre!" tha Dilzi. "O Xhezon!"

"Ka ndodhur një hata", tha zonja Kompson duke ia nisur vajit përsëri. "Me siguri. Dëgjo, Xhezon", e luti përsëri duke e zënë për krahu. "Ja, s'më lejon që t'ia gjej as çelësin e dhomës në shtëpinë time".

"Qy, qy" tha Dilzi. "E çka kish "m'u" ba? Qe ku jam unë. S'e la unë që ta prekë me dorë. Kuentinë!" thirri me zë më të lartë, "mos u tremb, shpirti jem, këtu më ke".

Dera u çel hapekrah. U ndal për një moment në pragun e derës, duke e mbyllur hyrjen në dhomë, pastaj u mënjanua. "Hyni", tha me *zë* të vrazhdë dhe të larë. Hynë brenda. Ajo nuk ishte dhomë e një vajze. Ishte një dhomë thuaja pa identitet. Era e dobët e artikujve të dobët kozmetikë si dhe disa sende që i mbajnë femrat tok me disa dëshmi të tjera të përpjekjeve *të* pareshtura por të kota për ta bërë këtë dhomë dhomë femrash vetëm e vinin edhe më shumë në pah anonimitetin e saj duke ia shtuar atë atmosferë morte dhe stereotipe provizore të bujtinës. Çarçafët ishin të paprekur. Në dysheme ndodheshin ndërresat e ndyta të femrave nga mëndafshi i lirë që ishte tepër i kuq. Nga syza gjysmë e hapur e komos ishte varur një çorapë. Dritarja ishte e hapur. Pranë shtëpisë ndodhej një dardhë. Ajo kishte lulëzuar. Degët e saj i gërvishnin dhe i shponin muret, ndërsa ajri duke penetruar nëpër dritare, e përhapte në dhomë erën e harruar të beharit.

"A s'po shihni", tha Dilzi. "A s'ju thashë se s'u bo nami?"

"Qysh?" u habit zonja Kompson.

Dilzi hyni në dhomë pas saj dhe e preku pak me dorë.

"E tash flini dhe rehatohuni", tha Dilzi. "Unë e gjej atë për dhjetë dakika".

Zonja Kompson e shtyri. "Gjejeni pusullën", i tha. "Kur veproi kështu Kuentini, pat shkruar një pusullë".

"Ani mirë, hiç mos u mërzitni, e gjej", iu gjegj Dilzi "po veç ju kthehuni në dhomë".

"Në momentin që e pagëzuan me emrin e Kuentinës e dija se do të ndodhte diçka e tillë", tha zonja Kompson.

Shkoi te komoja dhe zuri të shpupuriste mes sendeve të shpërndara — shisheve të parfumit, kutisë së pudrës, lapsit të brejtur me dhëmbë, gërshërës me një teh të thyer në shallin e grisur, të pluhurosur nga pudra dhe të fëlliqur nga të kuqtë. "Gjeje atë pusullë", tha ajo.

"Qe menjëherë", tha Dilzi. "Shkoni ju. Unë e Xhezoni e gjejmë. Shkoni në dhomë, hiç mos u mërzitni".

"Xhezon", bëri zonja Kompson. "Ku është ai?" u nis kah dera. Dilzi i shkonte pas nëpër korridor kah dera tjetër e cila ishte e mbyllur. "Xhezon", thirri ajo nga dera. Asnjëri s'u përgjigj. U mundua ta sillte dorëzën e derës dhe thirri përsëdyti. Mirëpo, ende s'dëgjoi asnjë përgjigje, .ngase Xhezoni po i nxirrte rrobat këpucët dhe valixhen nga dollapi në mur dhe i hidhte pas vetes. Në atë çast nxori një copë dërrase të sharruar dhe të dhëmbëzuar dhe e vuri inë dysheme, pastaj sërish u kthye kah dollapi dhe u duk me një arkë metali. E la në shtrat dhe u ndal të shikonte në bravën e thyer, ndërsa nga xhepi po nxirrte një tufë çelësash dhe zgjodhi një ndër ta. Për një kohë të gjatë ndejti ashtu me çelësin e zgjedhur në dorë duke e shikuar bravën e thyer, e pastaj i ktheu çelësat në xhep dhe zbrazi me kujdes përmbajtjen e arkës në shtrat. Me po aq kujdes i kontrolloi dokumentet, një nga një duke i marrë dhe duke i shkundur. Pastaj e ktheu arkën dhe e shkundi edhe atë dhe përsëri i radhiti dokumentet dhe shkresat dhe u ngrit përsëri duke e shikuar bravën e thyer, duke e mbajtur arkën në dorë kurse kokën të përkulur. Para dritares dëgjoi disa grimzhela sesi po krrokatnin duke u vërtitur në ajër, po endeshin herë andej, herë këtej të rrahur nga era. Kaloi edhe një automobil, mirëpo, edhe uturima e tij pushoi. Nëna e thirri përsëri pas derës, mirëpo ai as që luajti nga vendi. Dëgjoi kur Dilzi e ktheu nënën në dhomë nëpër korridor dhe derën në

çastin që u mbyll. Paskëtaj, arkën e ktheu përsëri në dollapin e murit, i hodhi plaçkat në të dhe u nis tatëpjetë shkallëve kah telefoni. Derisa po qëndronte aty, me receptor të mbështetur për vesh, Dilzi zbriti nga shkallët. Ajo ia hodhi një shikim, veçse s'u ndal po u largua.

E mori lidhjen. "Këtu Xhezon Kompsoni", tha ai. Zërin e kishte aq të vrazhdë dhe aq të trashë saqë iu desh të përsëriste. "Xhezon Kompsoni", tha ai duke e përmirësuar zërin. "Përgatitni një automobil, në daçi çojeni zëvendëssherifin, në mos mundshi ju, le të jetë gati brenda dhjetë minutave. Unë do të vij atje — Çfarë? — Grabitje, në shtëpië time. E di se kush — grabitje, jua thashë. Le të jetë gati automobili — Çka? A s'ju paguan shteti që t'i zbatoni ligjet — Po, erdha për pesë minuta. Automobili le të jetë gati që të nisemi menjëherë. Nëse s'doni, do t'i ankohem guvernatorit".

E lëshoi receptorin me rrapamë, kaloi nëpër dhomën e ngrënies ku shujta thuaja e paprekur kishte mbetur e ftohtë në tavolinë dhe hyri në kuzhinë. Dilzi po e mbushte me ujë të ngrohtë shishen e termaforit. Beni rrinte urtë dhe shikonte në zbrazëtirë. Afër tij ishte Llasteri si ndonjë zagar rojtar, i shkathët, i zgjuar. Diçka po hante. Xhezoni kaloi nëpër kuzhinë.

"A s'po han kaftjall?" e pyeti Dilzi. Ai u shtir kinse s'e dëgjoi. "Hajde ha kaftjall", i tha Dilzi për së dyti. Pas tij u mbyll dera e jashtme. Llasteri u ngrit, iu afrua dritares dhe shikoi jashtë.

"Ahu", bëri Llasteri, "a thu çka u "bo" atje nalt? A ia theu brinjtë zonjushës Kuentinë?"

"Ti mbylle atë çakallë", i tha Dilzi. "Në ma trazofsh Benxhin, kuku për ty, a more vesh. Ruaje sa të kthehem". E mbylli shishen me kapak dhe doli. E dëgjuan sesi po ngjitej lart, pastaj e dëgjuan Xhezonin sesi po kalonte me automobil para shtëpisë. Në kuzhinë dëgjohej vetëm zukatja e kusisë dhe tiktaku i orës.

"A di përse po lidhem me kusht?" tha Llasteri. "Po lidhem me kusht se e ka "bo" kërsh. Ia ka "bo" kryet pshesh e tash po shkon te "daktori". Qe ku po lidhna me kusht". Tiktaku i orës vazhdonte të binte si solemnisht, i thellë. Ndoshta ato të rëna të prajtura ishin pulsi i asaj shtëpie në shkatërrim e sipër, pas një copë here, rrapiloi dhe ra gjashtë herë. Beni e shikoi atë, mandej e vuri re siluetën në formë plumbi të kokës së Llasterit

në dritare e pastaj përsëri zuri ta tundte kokën dhe të përjargej. Ia krisi sfilitjes.

"Boll bre budallë", bëri Llasteri, edhe pse s'u kthye fare. "Si po duket sot s'po shkojkemi në kishë". Mirëpo, Beni i ulur në karrige zuri të çirrej ngadalë ndërsa duart e tij të mëdha e të buta po i lëvizte mes gjunjëve. Papritmas, u zhgreh në vaj, në të vërtetë filloi të uluronte dalngadalë me disa ulurima të pareshtura dhe të paqarta. "Boll bre", i thoshte Llasteri. U kthye dhe e çoi dorën. "A do dajak?" Mirëpo, Beni vetëm e shikonte me butësi duke uluritur pas çdo dihame. Llasteri iu afrua dhe e shkundi. "Rrudhe gojën mor hej!" i briti ai. "Qashtu", i tha ai dhe e çoi nga karrigia, e çoi karrigen para kaftorit, ia hapi deriçkën kaftorit dhe e uli Benin në karrige. Dukeshin si ta tërhiqte rimorkioja një tanker të madh në dokun e ngushtë. Beni u ul para derës së kuqërremtë. Heshti. Pastaj, u dëgjua sërishmi rënia e orës dhe Dilzi e cila po zbriste shkallëve dalngadalë. Me të hyrë ajo, Beni ia nisi përsëri të përloshej. Fill pastaj zuri të uluronte.

"Çka i bane?" e pyeti Dilzi. "Pse s'e lë rehat të paktën sot në mëngjes?"

"Unë s'jam kah i "baj" kurrgjë", tha Llasteri. "Atë e trembi zotni Xhezoni, po vallahi. A mos e ka grirë zonjushën Kuentinë?"

"Mbylle "ma" atë çarapë, Benxhi", i tha Dilzi. Ai heshti. Dilzi iu afrua dritares dhe shikoi jashtë. "A mejti shiu?" tha ajo.

"Po, kaherë", iu gjegj Llasteri.

"Atëherë ju të dy, dilni pak", tha ajo. "Sa e qetësova zonjushën Kahlinë".

"A po shkojmë në kishë?" bëri Llasteri.

"Ta them kur të vijë koha. Rri me të njëherë larg shpisë derisa s'të thërras".

"A" bon" t'shkojmë atje n'livadh?"

"Mirë. Por, mbaje sa më larg "shpisë". Sot m'erdh shpirti n'fyt, u këputa".

"Ani mirë. Mami, e kah ia mbajti zotni Xhezoni?"

"Çka po t'hyn në punë?" pyeti Dilzi. Zuri ta pastronte tavolinën. "Mos ki gajle, Benxhi. Llasteri të nxjerr jashtë për lojë".

"As me dorë s'e ka prekur. Hajt, ju dy, hupni tash".

"Lidhem me kusht se ajo këtu "s'a", tha Llasteri.

Dilzi po e vështronte.

"E ku e di ti se s'tek a?" pyeti ajo.

"Unë e Benxhi e pamë "mbramë tu u kacavarë" kah dritarja. Fol, Benxhi, apo jo?"

"Njimen, a?" e pyeti Dilzi duke e shikuar.

"Na po e shohim çdo mbramje", tha Llasteri. "Po lëshohej nëpër atë dardhë".

"Qy, mos m'rrej mor zezak dejuz", ia bëri Dilzi.

"O tybe n'të rrejsha. Vete Benxhin n'daç".

"E pse mor haram nuk ma kallëzove këtë me kohë?"

"S'a puna jeme", u gjegj Llasteri. "Pse t'përzihna n'puntë e t'bardhëve. Hajde, Benxhi, po dalim pak".

Dolën. Dilzi u ndal një grimë para tavolinës, pastaj shkoi dhe e rregulloi dhomën e ngrënies, hëngri mëngjes dhe e rregulloi kuzhinën. Pastaj e hoqi përparësen, e vari dhe shkoi në fund të shkallëve dhe përgjoi për një moment. S'dëgjohej asgjë. E veshi pelerinën, e vuri kapelen, kaloi nëpër oborr e shkoi në kasolle.

Shiu pushoi. Ia behu një erë nga juglindja dhe i trazoi shtëllungat e murrme të reve. Mbi kreshtën e kodrinës, pas drurëve pullazeve dhe kambanareve të qytetit u duk një rreze dielli si copa e zbehur e leckës, e fill pastaj, u zhduk. Në ajër jehoi këmbimi i kambanave, e pastaj, si sipas një shenje të caktuar, jehuan edhe kambanat e tjera nëpër kodra.

Dera e kasolles u hap, Dilzi doli përsëri me atë mantelin e vet dhe me fustanin purpur. Mirëpo, tash i kishte edhe dorëzat e bardha e të lërosura deri në bërryla, ndonëse në kokë, kësaj here nuk e kishte shaminë. Hyri në oborr dhe i bëri zë Llasterit. Priti një copë here, pastaj, shkoi në shtëpi dhe i ra rrotull derës së qilarit dhe e shikoi derën. Beni ishte ulur te shkallët. Para tij, Llasteri ishte ulur galiç në dyshemenë e lagët. Në dorën e majtë e mbamte sharrën tehu i së cilës ishte shtrembëruar pak mën presionin e dorës së tij, kurse ai i binte tehut me një tëhollojsë të vjetër të drurit me të cilën për më se tridhjetë vjet, Dilzi e përgatiste brumin e piskotës. Nga sharra dilte një lloj zhangullime e keqe që të mërziste ngase i mungonte tingulli i gjallë, kështu që tehu mbetej si ndonjë hark i hollë dhe i qartë mes dorës së Llasterit dhe dyshemesë. Megjithatë, harku ishte fryrë në një mënyrë enigmatike.

"Kështu i binte sharrës ai "nin" n' cirkus", tha Llasteri. S'kam me çka t'i bie.

"Me këso punë po merresh a?" tha Dilzi. "Bima atë tëhollojsë".

"S'e prisha, "gjo" s'i bona", tha Llasteri.

"Bima këtu kur po t'them. Sharrën ktheje aty ku e ke marrë!"

Sharrën e ktheu në vend, kurse tëhollojsën ia dha asaj. Po në atë çast, Beni ia dha piskamës. Uluronte pareshtur. S'ishte gjë. Një lloj toni. Ndoshta ai ton gjithnjë ndodhej aty. Ndoshta padrejtësia e dhimbja për një çast nëpërmjet njëzimit të planeteve zunë të flisnin.

"A po e ngon?" tha Llasteri. "Qe kështu po m'shurdhon "pi se dolëm pi shpisë." S'di çka dreqin e ka sot".

"Bjere këtu", i tha Dilzi.

"Hajde, Benxhi", i tha Llasteri. U kthye tatëpjetë shkallëve dhe e rroku Benin për dore. Ky u nis i përunjur duke dënesur me atë gjëmën e tij të prajshme si të anijeve, gjëmë që pushon thuaja menjëherë.

"Nga e kërkoja kapuçin", i tha Dilzi. "Mos "bo" poterë se "të ndin" zonjusha Kahlhinë. Ngutu tash. Jemi vonu?"

"Ata ia ndijnë piskamën në mos ia mshelsh gojën", tha Llasteri.

"Sa t'dalim pi' shpisë, nuk pisket", tha Dilzi. "I ka ra n'erë se çka "boni vaki". Ky a sebepi qi ia dha vigmës".

"E çkafit i ra n'erë?" pyeti Llasteri.

"Bjerja kapuçin", i tha Dilzi.

Llasteri shkoi. Ata e pritnin duke qëndruar te dera e qilarit, Beni qëndronte një shkallë nën të. Tash qielli ishte copëtuar në lecka resh që e ndiqnin njëra-tjetrën nëpër qiell, kurse hijet e tyre të vrikshme i largonin nga kopshti i vetmuar matanë gardhit të shembur dhe oborrit të shkretë. Dilzi ia përkdhelte me ngadalë kokën dhe një tufë flokësh të Benxhit. Ai uluronte prajshëm dhe pa nxituar. "Boll' bre", i thoshte ajo. "Boll "ma", Benxhi. Tash po shkojmë. Rri urtë tash".

Kurse ai ia thoshte vigmës pa ndarë.

Llasteri u kthye, me një kapele të re filtre në kokë me gajtan laraman, kurse në dorë kishte një kapele nga stofi. Ajo kapelë si ta ndante kafkën e Llasterit në të gjitha pjesët e rrafshta dhe këndet pikërisht si drita e reflektorit. Forma e saj ishte aq e

rrallë dhe autentike saqë n'e parë dukej si të ishte në kokën e dikujt që ndodhej pas Llasterit. Dilzi e bënte sehir atë kapele.

"Pse s'e more kapelen e vjetër?" pyeti ajo.

"Sun e gjeta", tha Llasteri.

"Po de, "sun" e ke gjetë. Tybe mos e paçe fshehë mbramë diku me aq marifet sa sun po e gjen tash. T'u ka tekë ta prishish atë!"

"O mami, s'ka n'mend t'bie shiu", tha Llasteri.

"E ku e di ti? Gjeje atë të vjetrën e të renë ktheje aty ku e more".

"Mo! bre, mami".

"Hajt, merre çadrën".

"O mami".

"Ose kapelen e vjetër ose çadrën, të dyjat "s'bon". Për mu' njësoj".

Llasteri u kthye në kasolle. Beni po uluronte të vogël.

"Hajde, Ben", tha Dilzi. "Ata na mbërrijnë rrugës. T'shkojmë e t'i ngojmë sa bukur po këndojnë".

I ranë shtëpisë rreth e rrotull dhe ia mësynë kah dera e kopshtit. "Pssst", i thoshte Dilzi hera-herës ndërsa po ecnin rrugës së qerreve. Arritën te dera. Dilzi e hapi derën. Pas u vinte Llasteri me çadër. Me të ishte një grua. "Qe, po vijnë", tha Dilzi. Edhe ata dolën te dera. "Hajde, pra", tha Dilzi. Beni pushoi së uluruari. Llasteri dhe e ëma arritën. Froni kishte veshur një fustan mëndafshi ngjyre të kaltër të çiltër, kurse në kokë kishte një kapele të stolisur me lule. Ishte një grua thatiçe. Fytyrën e kishte pa ndonjë shprehje të posaçme, por simpatike.

"Paske veshur vleftën e gjashtë javëve të punës", tha Dilzi. "Si ia bon, n'raft shiu?"

"Lagna me siguri", tha Froni. "Shiun hala "sun" e nala".

"Mami sot pajada thotë se ka me ra shi", tha Llasteri.

"Në mos ju "bajsha" unë dertin të gjithëve, kush ju ban dertin", tha Dilzi. "Po shkojmë se jemi vonu".

"Sot predikon i përhirshmi Shegog", tha Froni.

"Po a? E kush a ai?" tha Dilzi.

"Pi' Sen Luisit ka ardhë", u përgjigj Froni. "Alamet predikuesi".

"Aha", bëri Dilzi, "na duhet një njeri që di ta shtijë frikën "pi" zoti mes këtyne lahperave të rinj zezakë".

"Sot predikon i përndershmi Shegog", ia nisi përsëri Froni. "Kështu thonë gjindja".

Rruga ziente. Përgjatë saj grupe besimtarësh të bardhë po shkonin kah kisha. Mbi ta, era po i përhapte tingujt e kambanave. Aty-këtu i prekte shkarazi dielli i trembur nga qielli. Era nga juglindja ishte e stuhishme, e ftohtë, e ashpër pas atyre ditëve të ngrohta.

"Hiç s'e kisha çu' në kishë këtë, mami", tha Froni. "Atëherë gjindja t'ia nisin shpërrallimeve".

"Çfarë gjindsh?" tha Dilzi.

"Unë po i ngoj", tha Froni.

"I njoh unë ata si paren e kuqe", tha Dilzi. "Janë ata edepsuza të bardhë. Qashtu folin ata. Ata kujtojnë se ky s'ka vend n'kishën e t'bardhëve e kisha e zezakëve s'a aq e mirë për të".

"Merre qysh t'dush, ata po çajnë kopalla", tha Froni.

"Paj, çoji ti te unë", tha Dilzi, "e thuju se i lumi zot s'këqyr se a a kush i bukur apo i mençëm. Kurrkush s'i këqyr këto veç atyne haramave t'bardhë".

Rruga merrte djathtas dhe duke zbritur shndërrohej në një rrugicë të papastër. Tash, nga të dy anët trualli po bëhej më i pjerrët; mes atyre pjerrësive shtrihej një rrafshinë e gjerë me plot e përplot kasolle çatijat e vjetra të të cilave ishin në nivelin e lartë me sipërfaqen e rrugës. Ato gjendeshin në lëndinën e pabarë të rrethakuara me gjëra të ndryshme të thyera, me tulla, dërrasa, poçe dhe vegsha, me gjëra që dikur ishin përdorur për diçka. Aty rritej vetëm baroja apo çaravallja, kurse nga drurët kishte mana, akacie dhe fiq, — të gjitha këto merrnin pjesë në atë përtharje që i rrethakonte ato kasolle apo këlcare; drurët, me ato që u kishte mbetur, të dukeshin si mbeturina të zymta dhe kokëforte të shtatorit të shkuar, sikur edhe pranvera të kishte kaluar, duke i lënë që të ushqeheshin me kutërbimën e fortë dhe të pashoqe të zezakëve mesin e të cilëve ishin rritur.

Nga dyert e tyre zezakët e përshëndesnin gjatë kalimit Dilzin, zakonisht kështu:

"Motër Gibson, qysh je?"

"Mirë. Po ti, a je, si je?"

"Nam. Shumë mirë, falemnderës". Dilnin nga këlcaret e tyre dhe u ngjiteshin shpateve të rrugës — meshkujt në moshë, të veshur seriozisht me rroba të përhime ose të zeza, me qostekë

ari, kurse disa kishin edhe bastunë; të rinjtë me rroba të lira ngjyrë çiltër ose me rroba lara-lara si dhe me kapele; femrat ngapak si të ngurosura me fustane fëshfëritëse, kurse kalamajtë me rroba të përdorura të blera nga të bardhët. Fëmijët e shikonin Benin me droje si kafshët e natës dhe thoshin:

"Hajt t'lidhem me kusht se s'ta mban ta prekësh".

"Qysh mendon, s'ma mban?"

"Vë bast se s'mundesh. Tutesh".

"Ai s'të prek. Është i fshimë, budallë!"

"E pse s'i sulmon njerëzit, pasi budallë?"

"Ky s'të bën gjë. Unë e preka i herë".

"Hajt, preke tash, nëse ta mban!"

"Po na sheh zonjusha Dilzi".

"Edhe po të mos na shihte, ty s'ta mban".

"O s'i nguc njerëzit. Është i luajtur mendsh".

Pleqtë vazhdimisht i drejtoheshin Dilzit, kurse ajo ia linte Fronit të përgjigjej, pos kur i afroheshin ata më të moçmit, ajo fliste.

"Mami s'a mirë diçka sot".

"Po m'vjen keq. E shnosh atë i përndriçmi Shegog, po qe besa. Ai e ngushëllon, ia gjen dermanin e mandej i hiqet sikleti".

Shtegu ngritej përsëri, kurse para besnikëve dilte një skenë që i përngjante sfondit ose prapaskenës së teatrit. Shtegu, me argjilë të kuq të plasaritur aty-këtu, i rrethuar me ahe, si të ndalej papritur e papandehur si ndonjë shirit i prerë solemn. Në skaj të shtegut, vinte një kishë e vjetër, si e pikturuar, me kubenë e vjetër dhe të dëmtuar, ndërsa tërë ai peizazh ishte aq i rrafshët dhe aq i paperspektivë, saqë dukej si ndonjë pikturë nga kartoni i lënë në zgripc të atij trualli të rrafshët në një hapësirë që zien nga era dhe dielli dhe agu i prillit që zukat nga kambanat. Kah kisha janë nisur besnikët, dalngadalë, për kremte. Gratë dhe fëmijët, hynë në kishë pa u ndalur, ndërsa meshkujt mbetën jashtë duke kuvenduar në grupe të vogla derisa s'pushuan kambanat. Pastaj, hynë edhe ata.

Kisha e stolisur me ato pak lule nga kopshtet dhe gardhet si dhe me shirita gjarpërorë dhe lara-lara të letrave të lidhura dhe të ngjitura. Mbi amvonë ishte varur një zile pak e ndryshkur e Kërshëndellave që ndërthurrej si harmonika. Në

amvonë nuk ndodhej asnjeri, mirëpo, anëtarët e korit tashmë ishin në vendet e tyre dhe freskoheshin me fryerka, ndonëse nuk bënte vapë.

Shumica dërrmuese e grarisë tuboheshin në një anë të kishës. Po çuçullatnin. Pastaj, zilja ra edhe një herë, kurse ato nxituan të uleshin në ndejëset e tyre. Pjesëtarët e famullisë pritën kështu në gjendje të nderë. Zilja ra përsëri. Anëtarët e korit u ngritën dhe zunë të këndojnë, kurse të gjithë besimtarët i kthyen kokat si një, ndërsa gjashtë fëmijë, — katër vogëlushe me gërsheta të dendura të lidhura me kordhele të vogla në formë të fluturave dhe dy vogëlushë të nënqethur — hymë brenda duke ecur rrugës së mesme të kishës, të lidhur me kordhele e shirita të bardhë e me lule, ndërsa pas tyre ecnin dy burra, njëri pas tjetrit. Ai tjetri ishte si ndonjë vigan. Ngjyrën e lëkurës e kishit si kafeja me qumësht, e me atë frak kremteje dhe me kravatë të bardhë dukej si alamet njeriu. Nga koka të linte të kuptosh se ka dinjitet dhe është i hollë nga mendja, kurse qafa mbi jakë kishte disa palë rrudhash. Atë e njihnin, ishte i tyre, ndaj kokat e banorëve të famullisë ende ishin të kthyera kah ai edhe atëherë kur kalonte ai. Vetëm atëherë kur kori e këndoi himnin, ata vunë re se predikuesi mysafir kishte hyrë brenda. Mirëpo, kur panë se ai njeri i cili ecte para famullitarit të tyre, iu ngjit amvonës para famullitarit të tyre, shpërtheu një mërmëritje, ofshamë dhe fërfërimë e madhe befasie dhe zhgënjimi.

Mysafiri nga trupi vinte i vogël, bile nën madhësinë normale dhe kishte veshur një pallto të vjetër nga allpaku. Fytyrën e zezë pis e kishte të zhubravitur si ndonjë majmun i vogël plak. Ndërsa kori po këndonte dhe teksa ata gjashtë fëmijë në këmbë ndërhynin me zërat e tyre të hollë, të drejtur dhe të pamelodi, besimtarët ndërkohë e vështronin me pabesi atë burralec se si, si ndonjë xhuxh dhe si i pagdhendur, po rrinte pranë figurës vigane të famullitarit të tyre. Me dyshim edhe më të madh e vështronin atë kur famullitari i tyre u ngrit dhe prezentoi të ftuarin me zë buçitës dhe të lartë, kështu shi kjo përzemërsi e famullitarit të tyre, e bëri për pesë para praninë e të huajit.

"E tektethi në Sen Luj janë shku për qat grimë mjeri", pëshpëriti Froni.

"Vakija e zotit. Çka s'kam pa unë nga i lumi zot, bile do

ndeshtrasha edhe "ma" të çuditshme", tha Dilzi. "Mos ki gajle", i tha Benit, "tash ia nisin kangës".

Kur i ftuari u ngrit të predikojë, zëri i tij kumbonte si zëri i ndonjë të bardhi. Ishte monoton dhe i ftohtë. Ishte shumë i fortë që të dilte prej tij, kështu që në fillim zunë ta dëgjonin nga kërshëria, ashtu si ta dëgjonin majmunin që flet. Paskëtaj, dalngadalë u vunë ta shikojnë ashtu si shikohet pelivani në litar. Bile e harruan pamjen e tij të pahijshme, kur zuri t'i magjepste ajo mjeshtëria e tij me anë të *së* cilës nëpër litarin e ftohtë e të palakuar të zërit të tij, po vraponte, po mbamte drejtpeshimin dhe po sulej. Kur, më në fund, si në ndonjë fluturim kryengulthi, ai aterroi pranë pupitrit për lexim, duke u mbështetur me një dorë për të, ndërsa shtati i tij prej majmuni u shtang si ndonji mumie apo si ndonjë enë e boshatisur e gjakut, besimtarët, morën frymë, si të ishin zgjuar nga gjumi kolektiv, ndaj u bë një si trazirë në radhët e ndenjëseve. Pas amvonës, anëtarët e korit po freskoheshin pareshtur me fryerka.

"Shsht, mos ba za", pëshpëriti Dilzi, "tash ia nisin kangës".

Në atë çast, u dëgjua një zë: "Vëllezër!"

Predikuesi as që kishte luajtur nga vendi. Dorën ende e mbante në pupitër; ai e mbajti këtë pozë teksa zëri po i pashitej nëpër jehonat mes mureve. Toni i tashëm dallohej si dita nga nata prej tonit të mëparshëm. Ky ton kishte një timbër pikëllues, diçka si tingulli i bririt. Ai zë depërtonte në zemrat e dëgjuesve dhe jehonte atje edhe pasi humbiste në morinë pashitëse të jehonave.

"Vëllezër dhe motra!" u dëgjua përsëri.

Predikuesi e hoq dorën nga pupitri dhe zuri të bënte ecejake para pupitrit, me duar pas shpine, ashtu shëndetlig dhe i shkretë, i mbyllur në veten e vet si ndonjë i burgosur i cili është i dënuar që të zhvillonte një luftë të rreptë kundër tokës së pamëshirshme.

"Unë e di se ç'është gjaku i Qengjit!"

Ashtu i kërrusur, me duar pas shpinës, ai shkonte herë përpara herë mbrapsej pas kurorave të letrave dhe ziles së Kërshëndellave. Ishte si ndonjë shkëmb i vogël dhe i dromcuar të cilin e dërrmojnë valët e zërit të tij. Dukej sikur me trupin e vet e ushqente atë zë, që, si ndonjë djallushë që shumëzohet me meshkuj, ia kishte ngulur dhëmbët atij. Dukej se besimtarët

me sytë e tyre po e vështronin ndërsa ai zë po e dërrmonte, derisa u bë një kurrgjë dhe derisa ata u bënë kurrgjë, kështu që nuk kishte më as zë, po në vend të tij flisnin zemrat e tyre njëratjetrës në ritme monotone kënge, ngase fjalët nuk hynin në punë me atë rast. Kështu, kur më në fund u kthye të çlodhej në pupitër, kur u ngrit fytyra e tij prej majmuni dhe kur qëndrimi i tij ishte si e të mbërthyerit të përmbajtur dhe të përvujtur, i cili ishte ngritur mbi të këqijat dhe mbi gjendjen e vet të përulët duke harruar vlerën e vet, papritmas, nga krahërori i të gjithë besimtarëve shpërtheu një rënkim i gjatë, e fill pastaj, zëri i një femre, zë sopranoje, këlthiti: "Po, o Jezu!"

Derisa drita e ditës po kalonte mbi ta, qelqet e shkreta të dritareve po shkëlqenin dhe po zbeheshin në reflekse fantastike. Atje jashtë, në rrugë kaloi një automobil, u zvarrit pak në truallin me rërë dhe u zhduk. Dilzi po rrinte e shtangur dhe pip drejt me dorë në gjurin e Benit. Dy lot u rrëkëllyem tatëpjetë mollëzave të saj, të dobësuara dhe u shpërndanë nëpër vurratat e tij të shumta dhe të shndritshme që ia kishin lënë flijimet, vetëmohimet dhe hallet ■ kohës dhe përsëri rrodhën prej tyre.

"Vëllezër", tha predikuesi me një pëshpëritje depërtuese, pa luajtur vendit.

"Po, o Jezu Krisht!" u dëgjua sërishmi zëri i asaj femre.

"Vëllezër dhe motra!" jehoi përsëri zëri i tij si kumbimi i bririt. E largoi dorën nga pupitri, u drejtua dhe i ngriti daurt. "Unë e di se ç'do të thotë gjaku i Qengjit!" As që vunë re sesi intonacioni dhe shqiptimi ishin bërë si të zezakëve. U lëkundën një grimë në ndenjëse derisa po i pushtonte zëri i tij.

"Kur të gjata, të ftohta — Oh, ja ku ju them vëllezër, kur... të gjata, të ftohta — Unë e shoh dritën e shoh edhe Fjalën, mëkatar i ngratë! U zhdukën në trojet e Egjiptit karrocat triumfale, u zhdukën breza të tana. Na ishte një njeri me kamë, një i pasur. E ku a tash, o vëllezër? Na ishte një skamnor, ku a tash o motra? Oh unë kam për t'ju thanë se çdo t'ju gjejë, në mos paçi tambël clhe shelbimin e vjetër kur vijnë vitet e gjata dhe të ftohta".

"Po, o Jezu!"

"Ja ku po ju them o vëllezër, qe ku po ju them o motra, do të vijë ajo ditë! Mëkatari i ngratë thotë: më lini të shtrihem në gjurin e të lumit zot, lërmëni ta shkarkoj barrën time. E

ç'do të thotë atëbotë Jezui, vëllezër e motra të mia? A e ke njohur ti gjakun e Qengjit? Sepse unë s'dua ta humb parajsën time!"

E kërkoi në pallto, e nxori shaminë dhe e fshiu fytyrën. Një nënëritje e matur shpërtheu nga goja e besimtarëve: "Mmmmmmm" Zëri i asaj femre, bëri: "O Jezu, o Jezu!"

"Vëllezër! Shikojini ato ferishte të ungjur atje! Dikur edhe Jezui qe aso doret. Nëna e tij i hoq një mijë të zeza po ajo e njohu edhe namin. Hove-hove ndoshta e ka mbajtë në prehën në muzgun e mbrëmjes ndërsa engjujt ia thoshin ninanenës. Ndoshta hera-herës e shikonte derën dhe shihte se si po kalonte policia romake". Ecte poshtë e lart dhe e fshinte djersën nga fytyra. "Dëgjoni, o vëllezër! Unë e shoh atë ditë. Shën Mërija rri te porta me Jezuin në prehën, me Jezuin e vogël. Me Jezuin e vogël, ashtu si janë ata fëmijë atje. I dëgjoj engjujt se si po ia thonë këngës së paqes dhe të famës. Po i shoh sytë se si po mbyllen. Po e shoh Marijen se si u trand menjëherë. Po i shoh fytyrat e ushtarëve se si flasin: ne do ta vrasim! Ne do ta grijmë! Ne do ta mbysim Jezuin ferishte! Po e dëgjoj vajin dhe dënesen e kërcunës nën pa shelbim e pa fjalën e të gjithëpushtetshmit zot!"

"Mmmmmmmmmmmm!" Jezui! Jezui i vogël!" e fill pastaj buçiti edhe një zë:

"Po të shoh o Jezu! Oh, Po të shoh!" pastaj ushtoi edhe një zë, pa fjalë, si fluskat e ujit:

"Po i shoh këto, o vëllezër. Po i shoh. Po e shoh skenën shkatërrimtare, verbuese! Po e shoh Kalvarin dhe drurët e saj të shenjtë, po e shoh hajdutin dhe cubin dhe të tretin mes tyre. Po i dëgjoj lavdërimet dhe përqeshjet: në qofsh Jezu, çoje kryqin tënd dhe shko. Po e dëgjoj kukamën e grave dhe brimën e mbrëmjes. Po e dëgjoj vajin dhe vigmën si dhe fytyrën e kthyer të zotit: e kanë vrarë Jezuin, e kanë vrarë tim bir!"

"Mmmmmmmmmm! Jezu! Unë po të shoh, o Jezu Krisht!"

"O, ju mëkatarë të verbër! Vëllezër, ja ku po ju them; motra, Unë po ju them: kur i madhi zot e ktheu fytyrën e vet të gjithëpushtetshme, ai deshi të thoshte se nuk do ta rëndojë qiellin e vet. Po e shoh zotin e trishtuar sesi po e mbyll portën e vet. Po shoh sesi po ngrihen valët e egra të përmbytjes. Po shoh sesi errësira dhe mordja po u kërcënohen gjithmonë brezave njerëzorë. E mandej, vëllezër! Po, o vëllezër! Ç'po më

shohin sytë? Çka po shoh, unë mëkatari? Po e shoh ringjalljen dhe dritën. Po e shoh Jezuin e urtë sesi flet: Ata më vranë që të mund të jetoni ju përsëri; unë vdiqa që ata që shohin dhe besojnë të mos vdesin askurrë. Vëllezër, o vëllezër! Po e shoh agimin e ditës së kiametit, po i dëgjoj boritë e arta sesi shpallin lavdinë e zotit dhe shoh si po ringjallen të vdekurit të cilët dinë për gjakun e Qengjit!"

Mes atyre zërave dhe duarve ishte ulur Beni i kapluar nga entuziazmi i shikimit të vet të butë e të kaltër. Dilzi ishte ulur afër tij e ngrirë dhe po qante ngadalë në flakën e gjakut të Qengjit të cilin ia sillnin ndërmend.

Derisa besnikët po ecnin nëpër dritën e shkëlqyeshme të pasdites nëpër shtegun me rërë të ndarë në grupe dhe duke biseduar me zë të ulët, Dilzi vazhdonte të qante pa i përfillur ato që flisnin të tjerët.

"Qaj tek "O" predikues, lum jarani! N'e parë s'dukej aso dore, por, mandej, pirolla i qoftë!"

"Ai e ka parë fuqinë dhe lavdinë e zotit!"

"Asha zotin, po, i ka parë. U ka dalë ballë për ballë. Dilzi s'bëri as gëk as mëk më gojë, çehreja s'i ndryshoi. ndërsa sytë rrëkëlleheshin vijave të tyre dredha-dredha, kurse ajo ecte kryelartë ndaj as që mundohej t'i fshinte lotët.

"Mos kaj, oj loke, pse po kan?" tha Froni. "Po të këqyrin gjindja. Tash shihemi me të bardhët".

"Unë e kam pa' fillin e fundin", tha Dilzi. "Mos ma maj ti dertin!"

"Fillin e "funin" e çkahit?" pyeti Froni.

"E çka po t'duket ty?" tha Dilzi. "E kam pa fillimin, tash po ia shoh mbarimin".

Ndërkaq, para se të arrinin deri në rrugë, ajo u ndal dhe e ngriti fustanin dhe i fshiu lotët me kindin e nënkëmishës. Paskëtaj, e vazhduan rrugën. Beni po ecte si pata përbri Dilzit dhe po e vështronte Llasterin i cili para tyre po ngërdheshej me çadër në dorë dhe me kapelen e re si ndonjë bandill në diell. E shikonte atë ashtu si e shikon ndonjë zagar i madh tarallak zagarin e vogël po të zgjuar. Arritën te dera e kopshtit dhe hynë brenda. Beni ia nisi të përloshej përsëri dhe po në atë çast të gjithë nga rruga e qerres e ngritën shikimin kah shtëpia katërkëndëshe dhe e pangjyrosur me portik të vjetër.

"Athu' çka u "bo" atje?" tha Froni. "Diçka ndodhi".

"Hiç kurrgja s'ka ndodhë", ia ktheu Dilzi. "Dëlire ti oborrin tand, leni t'bardhët ta dëlirin oborrin e vet".

"Diçka ka "bo" vaki", tha Froni përsëri. "Sot në mëngjes "e ngova" kah britke. Por, mirë e ke ti, çka po m'hyn n'punë".

"Unë e di se çka "ka bo" vaki", tha Llasteri.

"Ti po ditke ma shumë se "qi" t'duhet", ia bëri Dilzi. A s'ngove kur Froni tha se s'a puna "juj?" Çoje Benxhin mas shpie, ruje mirë sa "ta gatuj" drekën".

"Unë e di ku a zonjusha Kuentinë", tha Llasteri.

"Në "koftë" ashtu, mbaje për veti", tha Dilzi. "Në ju dashtë Kuentinës këshilla jote, unë ta them. E tash, ju dy, shkoni mbas shpisë e luni".

"Ti e di se "ç'bohet" në ia nisshin ata lojës me top", tha Llasteri.

"Hala s'ia nisin. "Manejna" vjen T. P. dhe e çon n'shëtitje. Bima atë kapelen e re".

Llasteri ia dha kapelen, kurse ai me Benin shkuan në oborr pas shtëpisë. Beni ende po përloshej, por jo si më parë, Dilzi me Fronin shkuan në kasolle. Pas një copë here, Dilzi u duk përsëri me fustanin e saj të zbehtë nga pambuku dhe shkoi në kuzhinë. Zjarri ishte fikur. Në shtëpi s'dëgjohej njeri i gjallë. Dilzi e veshi përparësen dhe shkoi në katin e epërm. Edhe atje kishte pllakosur heshtja. Dhoma e Kuentinës ishte ashtu si e kishin lënë. Dilzi hyri në të dhe i mbłodhi ato ndërresa të hedhura nëpër dysheme, kurse çorapën e cila kishte dalë nga syza e futi brenda në syzë dhe e mbylli syzën. Dera e dhomës së zonjës Kompson ishte e mbyllur. Dilzi u ndal për një grimë para derës dhe përgjoi. Paskëtaj, e hapi derën dhe hyri në dhomën ku kundërmonte era e kamforit. Perdet ishin lëshuar, dhoma ishte kredhur në gjysmëterr tok me shtratin, ndaj, me ta parë ajo pandehu se zonja Kompson kishte fjetur. Në çastin që deshi ta mbyllte derën, ia behu vetë zonja.

"Po mirë? Ç'ka ngjarë?"

"Unë jam", tha Dilzi. "Mos ju duhet gjë?"

Zonja Kompson s'u përgjigj. Mirëpo, pa luajtur kokën, pas një copë here, pyeti: "E ku është Xhezoni?"

"Hala s'u kthy'", u gjegj Dilzi. "E ç'po kërkoni? "

Zonja Kompson nuk tha as gjysmë fjale. Si shumica e atyre që kanë ndjenja të ftohta dhe fuqi të dobët shpirtërore kur më në fund u ballafaqua me katastrofën e pashmangshme, gjeti

diku në vete një lloj guximi dhe fuqie. Në rastin e saj ajo ishte një bindje e paluhatshme për ngjarjen ende të panjohur.

"Ani", bëri ajo përsëri, "a e gjete?"

"Çfarë a e gjeta? Përse e keni fjalën?"

"Pusullën. Duhet të ketë lënë ndonjë pusullë. Bile as Kuentini s'e pat harruar të linte një pusullë".

"Ku po e qitni?", tha Dilzi. "A s'e dini se Kuentinën s'e ka gjetë gja? "Asha zotin mos ta çeltë derën para territ, qe, këputma kryt!"

"Marrëzi", ia ktheu zonja Kompson. "E ka në gjak. Si xhaxhai e tillë edhe mbesa. Apo ndoshta i ngjan t'ëmës. S'di ç'është më zi. Fundja, aq më bën".

"E pse ju gjithnji me nji palë mend?" pyeti Dilzi. "E pse t'ketë "bo" ajo ashtu?"

"S'di. E pse bëri ai, Kuentini? Pashë zotin, çfarë arsye pati ai? S'e ka bërë veç që të më përqeshte e të më fyente. Cilidoqoftë zoti, një gjë të tillë, s'do ta lejonte. Unë jam zonjë ■ ndershme. Kam namuz. Ndoshta s'më beson për shkak të prejardhjes, por unë kam fytyrë".

"Veç pritni se do të shihni", tha Dilzi. "Qe ku po ju them se sonte, ajo do të jetë këtu, në krevetin e vet".

Zonja Kompson nuk tha asgjë. Lecka e lagur me kamfor ndodhej në ballin e saj. Fustanin e zi të shtëpisë e kishte hedhur në fund të krevatit. Dilzi po qëndronte duke mbajtur me dorë dorëzën e derës.

"Ani mirë", tha zonja Kompson, "si ia bën tash? A ke ndërmend t'u bësh gjë për drekë Xhezonit e Benxhaminit, apo jo?"

"Xhezoni hala s'u kthy'", tha Dilzi. "U përgatis diçka. Po juve, a mos ju duhem "gjo?" A e keni boll të nxehtë termaforin?"

"Do të mund të ma jepje Biblën".

"Jua dhashë në mëngjes para se të dilnit".

"E kishe lënë në skaj të krevatit. Ç'thua, sa do të mbetet aty?"

Dilzi iu afrua krevatit dhe duke prekur me gishtërinj në errësirë zuri ta kërkonte Biblën në skaj të krevatit. E gjeti të përmbysur. Zonja Kompson as që i hapi sytë. Flokët dhe jastëku i saj kishin ngjyrë të njëjtë. Nën petkat e lagura me kamforin mjekues dukej si ndonjë murgeshë plakë gjatë lutjes.

"Mos e lër Biblën atje përsëri", tha zonja Kompson pa i hapur sytë. "Aty e pate lënë më parë. Mos deshe të çohem nga krevati për ta marrë?"

Dilzi u përkul, e mori librin dhe e vuri në krevat ku kishte vend me bollëk.

"S'mund ta lexoni me këtë farë drite", tha Dilzi. "A ta çoj pak perden?"

"Mos. Mos e prek. Hajde, bëja drekën Xhezonit".

Dilzi doli. E mbylli derën pas vetes dhe u kthye në kuzhinë. Kaftori ishte thuaja i zbrazët. Derisa po qëndronte aty, ora mbi dollap ra dhjetë herë.

"Nja sahati", tha me vete ajo, "e Xhezoni hala s'u kthy? Po, unë e kam pa fillimm dhe mbarimin", vazhdoi të fliste duke e shikuar kaftorin e ftohtë. "E kam parë fillimin dhe mbarimin". E vuri ushqimin e ftohtë në tavolinë. Duke bërë varavinga nëpër kuzhinë po këndonte një këngë kishtare. Nga tërë melodia përsëriste vetëm dy vargje. E përgatiti shujtën, shkoi te dera dhe bëri zë Llasterit, e fill pastaj erdhën Llasteri dhe Beni. Beni po gjëmonte ngapak.

"Hiç s'ka pushu'", tha Llasteri.

"Ejani ju dy këtu e hani bukë", u tha Dilzi. Xhezoni sot s'vjen në drekë". U ulën dhe zunë të hanë. Beni mund ta hante edhe shujtën e ftohtë, ndonëse edhe me atë rast, Dilzi ia lidhi një peshqir rreth qafës. Ai dhe Llasteri zunë të hanë. Dilzi shëtiste nëpër kuzhinë dhe po i këndonte të dy vargjet e këngës kishtare që i kujtoheshin. "Ju veç hani, e ju baftë mirë", u thoshte ajo. "Xhezoni s'kthehet".

Në atë çast, Xhezoni ndodhej njëzet milje larg shtëpisë. Kur u largua nga shtëpia shkoi me nxitim me automobil në qytet që t'i arrinte grupet e ngadalshme të besnikëve të së dielës si dhe këmbimin e pareshtur të kambanave kishtare që i përhapte era në ajër. I ra sheshit të zbrazët dhe ktheu në një rruginë të ngushtë ku kishte rënë një qetësi edhe më e madhe, pastaj u ndal para një barake dhe u nis shtegut me lule përanash kah hajati i barakës.

Pas derës me perde po flisnin njerëzit. Kur e ngriti dorën për të trokitur, i dëgjoi disa hapa, ndaj s'e luajti dorën nga dera derisa atë e hapi një njeri trupmadh me pantallona nga stofi i rrallë dhe i zi dhe me këmishë të bardhë të ngushtuar në gjoks, pa jakë. Flokët i kishte të shprishur dhe ngjyrëpërhime, ndërsa

sytë e tij të përhimë ishin të rrumbullakët dhe të shkëlqyeshëm si të ndonjë fëmije. E rroku dorën e Xhezonit dhe duke ia shkundur e tërhoqi kah shtëpia.

"Hyni, urdhëroni". tha ai.

"Jeni gati për rrugë?" pyeti Xhezoni.

"Epo, urdhëroni, hyni", tha ai duke e shtyrë nga bërryli në dhomë ku tashmë rrinin të ulur një mashkull dhe një femër. "E njihni burrin e Mirtlajnes, apo jo? Ky është Xhezon Kompsoni, Vernoni".

"E njoh", tha Xhezoni pa e shikuar atë njeri.

Derisa sherifi po e tërhiqte karrigen, ai njeriu, tha:

"Ne po dalim pak derisa të bisedoni ju! Eja, Mirtëll".

"Jo, jo", tha Sherifi. "Uluni, mos shkoni! Unë mendoj, Xhezon se asgjë s'është aq serioze! Uluni, ju lutem".

"Ju kallëzoj gjatë rrugës", tha Xhezoni. "Merrini kapelen dhe pallton".

"Megjithatë, ne do të dalim", tha ai njeriu duke u ngritur.

"Vetëm uluni", tha sherifi. "Unë e Xhezoni dalim në verandë".

"Merreni kapelen dhe pallton", tha Xhezoni përsëri. "Edhe pse na kanë kaluar më se dymbëdhjetë orë".

Sherifi shkonte para tij në verandë. Një mashkull dhe një femër, i thanë diçka në kalim e sipër. Ai ua ktheu me një gjest entuziast dhe të përzemërt. Ende po jehonte tingulli i kambanave nga lagjja e quajtur "Lugina e zezakëve".

"Merreni kapelën, Sherif", i tha Xhezoni përsëri.

Në vend të kësaj Sherifi i tërhoqi edhe dy karrige.

"Urdhëroni uluni dhe më thoni se ç'ka ngjarë".

"Ju thashë me telefon", ia ktheu Xhezoni në këmbë. "Ju telefonova që të përfitoj nga koha. Mos jam i shtrënguar të shkoj në gjyq për t'ju detyruar që ta kryeni detyrën për të cilën jeni betuar si nëpunës?"

"Uluni dhe m'i tregoni të gjitha, fill e për pe", ngulte këmbë Sherifi. "E mandej, unë i hyj punës, ju ndihmoj, mos kini merak".

"Si jo", tha Xhezoni. "Ju ngurroni dhe e zvarritni punën, kësaj i thoni ndihmë?"

"Nëse e zvarrit kush punën, atëherë, ju jeni ai", ia ktheu Sherifi. "Uluni, qetësohuni dhe m'i tregoni të gjitha".

Xhezoni zuri t'i fliste, me ç'rast ndjenja e tij e padrejtësisë

dhe e paaftësisë po thyhej aq shumë nga tingulli i fjalëve të veta saqë gati e harroi edhe ngutjen e vet duke përmendur një mori arsyetimesh dhe fyerjesh të turpshme. Sherifi e vështronte pandarë me sytë e tij të ftohtë dhe të shkëlqyeshëm.

"Por, ju me siguri s'dini se ata kanë vjedhur", i thoshte ai. "Ju vetëm supozoni".

"Si s'di?" bëri Xhezoni. "Pasi i humba nja dy ditë të tëra duke u rënë pas nëpër rrugë, duke u munduar që ta largoj nga ai, i thashë se ç'do t'i bëja në e zënça me të, kurse ju më thoni tash se unë s'ditkam se ajo vogëlushe — ".

"Paj, dëgjoni", i tha sherifi. "Më ngadalë. Mjaft më". Sherifi po shikonte kah rruga me duar në xhepa.

"E kur vjen te ju, nëpunësi kompetent i ligjit", tha Xhezoni.

"Ai cirk kësaj jave ndodhet në Motson", tha Sherifi.

"Po", tha Xhezoni, "sikur të mund të gjeja ndonjë nëpunës të ligjit i cili të paktën një grimë do të kujdesej për t'i mbrojtur njerëzit të cilët e kanë zgjedhur në atë vend, edhe unë do të isha tash në Motson".

E përsëriti me pezëm tërë meselenë e vet, si të kënaqej edhe me tronditjen dhe në paaftësinë e vetë. Sherifi, si të mos ia varte torbën fare.

"Xhezon", e pyeti ai, "ç'keni bërë ju me ata tre mijë dollarë që i keni fshehur në shtëpi?"

"Çfarë?" tha Xhezoni. "Se ku i mbaj unë të hollat e mia, është" punë për mua! Puna juaj është që të më ndihmoni për t'i kthyer".

"A dinte nëna juaj se keni aq para në shtëpi?" "Dëgjoni", tha Xhezoni, "u plaçkit shtëpia ime. Di se cilët janë grabitqarët, e di se ku ndodhen. Vij te ju si te nëpunësi i autorizuar dhe kompetent i ligjit dhe ju pyes edhe një herë, a do të ndërmerni diçka që të më kthehet prona, apo jo?"

"Ç'keni ndërmend të bëni me atë vogëlushen nëse e zini?"

"Kurrgjë", tha Xhezoni, "hiç, asgjë. S'do ta prek fare! Asaj lavireje, për shkak të së cilës s'e zura vendin që më mundësonte karriera, asaj që e ka vrarë babain tim dhe përditë po ia shkurton jetën nënës sime, asaj që ma ka njollosur emrin saqë jam bërë gazi i hallkut në qytet, asaj, kurrgjë s'do t'i bëj. Hiç asgjë".

"Ju e keni detyruar atë që t'ia mbathë", tha Sherifi.

"Juve s'ju hyn në punë sesi e mbaj familjen time", tha

Xhezoni. "A keni ndërmend të më ndihmoni, a jo? Këtë po ju pyes unë!"

"Sipas të gjitha gjasave, ju e keni përzënë atë vogëlushe nga shtëpia", tha Sherifi. "Po dyshoj ngapak se të kujt janë ato të holla që i keni ruajtur në shtëpi ndonëse s'di se a do t'i bie në fije kësaj".

Xhezoni po qëndronte duke ndrydhur ngadalë strehën e kapeles në duar. Ai pyeti qetë-qetë: "E pra ju s'doni te ndërmerrni kurrgjë për t'i zënë ata?"

"S'është puna ime, Xhezon. Po të kishit prova të sigurta, atëherë unë do ta kryeja detyrën time. Por, pa prova, unë s'i hyj punës".

"Kjo është fjala juaj e mbrame?" bëri Xhezoni. "E po mirë, mendoni edhe njëherë".

"Po, kjo është përgjigjja ime", tha ai.

"Ani mirë", tha Xhezoni. E vuri kapelen në kokë. "Do të pendoheni. S'do të rri unë duarkryq. Këtu s'është Rusia ku nëse e ka dikush shenjën e metalit s'e prek ligji".

Zbriti shkallëve, hyri në automobil dhe e ndezi motorin. Sherifi po e kundronte se si u nis, ■ ktheu automobilin dhe kaloi me nxitim pranë shtëpizës duke u nisur kah brendia ■ qytetit.

Përsëri po jehonin kambanat, lart në rrezet e diellit, me vrushkuj tingujsh të përzier. U ndal te stacioni i benzinës në mënyrë që t'ia kontrollonin gomat deri të merrte benzinë.

"Pak n'teferiq a?" tha zezaku. Xhezoni s'iu përgjigj "M'duket se më në fund do të marrë mot i mirë", tha zezaku.

"Çfarë dreq moti", tha Xhezoni, "kah ora dymbëdhjetë do të bjerë shi me gjyma". Ai e shikoi qiellin, duke menduar në shiun, në rrugët e përbaltura dhe rrëshqitëse, e, mendoj edhe për veten sesi për shkak të njëfarë defekti, do të ndalej diku një milje larg qytetit. Mendonte për këto me njëlloj ndjenje ngadhënjimi, mendonte për faktin se sot s'do të hante drekë në shtëpi dhe se, nëse vihet për rrugë tash dhe e pushton meraku i tij i madh për shpejtësinë, aty nga mesdita do të jetë në largësinë më të madhe eventuale nga të dy qytetet. I dukej se rrethanat në këtë mes ishin kundër tij, meqë ia prishnin planet, prandaj i tha zezakut:

"Çka dreqin po pështjellon ti aty? Mos të ka paguar kush që ta mbash sa më tepër këtë automobil këtu?"

"Kjo gomë ishte e shfryrë", tha zezaku.

"Atëherë hiqmu sysh e ma jep atë pompë!", tha Xhezoni.

"Unë e fryra gomën", tha zezaku duke u ngritur. "Tash mund ta vozisni lirisht".

Xhezoni hyri në automobil, e ndezi motorin dhe u nis. E qiti motorin në marshin e dytë dhe motori zuri të shëmonte dhe të kërciste, pastaj u turr me shpejtësi të madhe duke dhënë gaz dhe duke e kontrolluar sustën e fshisave të dritareve. "Do të bjerë shi", thoshte me vete. "S'do të arrij as në gjysmën e rrugës kur do t'ia nisë shiu si me shtamba". E ngiste makinën sa më larg kambanës dhe qytetit duke menduar me vete se si do të shllapuritet nëpër baltë duke kërkuar ndonjë mushkë që ta ngrenin automobilin. "E në atë çast, ata horrat, me siguri do të jenë në kishë". E merrte me mend se më në fund do ta gjente edhe kishën dhe sesi ka gjetur dy mushka, sesi iu ka turrur pronari i tyre, sesi pastaj ai ia ka këputur një grusht dhe e ka plandosur atë për tokë, duke i thënë: "Unë jam Xhezon Kompsoni. Provo të më dalësh, nëse ta mban! Provo ta gjesh Sherifin i cili mund të më ndalë". Paskëtaj e përfytyronte veten sesi me një çetë ushtarësh hynte në gjyq dhe si e dëbonte sherifin me dhunë. "Ai mendon se mund të rrijë duarkryq dhe të shikojë sesi unë e humbas punën time. Unë do t'ia mësoj se ç'është puna". As që i shkonte mendja te e mbesa apo te vlera e atyre të hollave. Ka, në përgjithësi më se dhjetë vjet që as njëra dhe as tjetra nuk kanë qenë për të ndonjë gjë thelbore ose individuale. Vetëm të dyjat bashkë ishin simbol i punësimit në bankë të cilën e humbi para se ta gëzonte.

Ajri u kthjell, shtëllungait e nxituara të hijeve nuk e diktonin më atë, kështu që kthjellësia e ditës i dukej edhe si një goditje dinake e armikut, si beteja e re në të cilën hynte me plagë të vjetra. Herë pas here, kalonte pranë kishave, binave nga druri me kube të hekurta, ku rreth e përqark kishte kuaj dhe automobila, kështu që i dukej se çdo automobil ishte si ndonjë karakollë rojash prej nga rojat e Rastit po e kundronin pa ndarë. "Ah, i marrtë lumi edhe binat!" thoshte me vete. "Provoni të më ndalni, nëse mundeni" dhe pastaj mendonte në çetën e ushtarëve e cila me vete e përcillte atë sherif të lidhur me pranga dhe në qoftë nevoja, edhe të Plotëfuqishmin Zot e dëbonte nga froni i Tij. I vajti mendja në legjionet luftarake të

Parajsës dhe të Skëterrës mes të cilëve po përvidhej ai dhe, më në fund, e shtien në dorë edhe mbesën e arratisur.

Era po frynte nga juglindja. Era i përplasej pa ndarë për fytyrë. I dukej se korenti i ajrit apo shkuja, po i futej në kafkë dhe, papritmas, si t'ia kishte tërhequr vërejtjen një parandjenjë e vjetër, e shkeli frerin, u ndal dhe nuk luajti nga vendi. Mandej, e ngriti dorën në qafë dhe filloi të shante dhe vazhdoi të shante i ulur, duke pëshpëritur. Kur nisej në rrugë të gjatë me automobil, pajisej me një shami *të* lagur me kamfor. Si dilte nga qyteti, e lidhte shaminë rreth qafës dhe bështu ia thithte erën. Prandaj, u ngrit dhe e çoi jastëkun nga ulësja për të parë nëse rastësisht mos kishte haruar aty ndonjë shami të tillë. Kërkoi nën të dy uléset, u ndal sërish për një copë herë duke sharë e duke parë sesi e përqeshte vetë triumfi i tij. I mbylli sytë dhe u mbështet për derën e automobilit. Mund të kthehej për ta marrë kamforin e harruar ose mund ta vazhdonte rrugën. Sidoqoftë, atij do t'i dhimbte koka, por, në shtëpi, të paktën, do të gjente kamfor me siguri, qoftë edhe të dielën, por në e vazhdoftë rrugën s'do të jetë aq i sigurt se a do ta gjejë kund. Mirëpo, nëse kthehet, do të arrijë anë Motson një orë e gjysmë më vonë. "Ndoshta mund ta ngas automobilin më ngadalë", mendoi. "Ndoshta mund ta ngas më ngadalë duke menduar për diçka tjetër."

Hyri në autombil dhe u nis më tutje. "Do të mendoj për diçka tjetër", tha ai dhe filloi të mendonte për Lorenën. E përfytyroi veten në krevat me të, mirëpo, sapo ishte shtrirë pranë saj, kishte zënë ta përgjëronte që t'i ndihmonte. Pastaj, përsëri ranë në mend të hollat dhe rasti kur ia punoi ajo vogëlushja. Sikur të mund të besonte të paktën se e kishte plaçkitur ndonjë mashkull! E kur iu kujtua se ia kishin grabitur pikërisht ato nëpërmejt të cilave mendonte ta kompensonte punën e humbur, ato, të cilat i kishte fituar me aq mund dhe rrezik dhe se ato ia kishte rrëmbyer pikërisht vetë simboli i punës, pozitës së tij të humbur; më në fund, më së keqi i vinte se ato ia kishte grabitur një kurvë e zakonshme. Vazhdonte ta ngiste edhe më tutje automobilin, duke e mbrojtur fytyrën me jakën e ngritur të palltos.

Ai e pat të qartë sesi forcat kontradiktore të fatit dhe të vullnetit të tij tash të bashkuara, po ngarendnin drejt një nyje të pashmangshme; u bë syçelë. Tash s'guxoj të bëj marrëzira, tha

me vete. Ka vetëm një mundësi, pa shtegdalje tjetër: duhet përfituar nga ai rast. Ishte i bindur se ata të dy do ta diktonin dhe do ta njihnin me të parë, prandaj lypsej ta diktonte më parë atë, veç nëse ai palaçoja e mbante ende atë kravatë të kuqe. Fakti se duhej të mbështetej në kravatën e kuqe, i dukej si simbol i greminës që i kanosej. Këtë rrezik, ai, si të thuash, e nuhaste, e ndiente edhe pse kokën e kishte si daulle.

Arriti në maje të kodrës së fundit: mbi luginë kishte pllakosur tymi, por, atje pikaseshin pullazet dhe dy kambanare apo maje kishe mbi drurët. U lëshua tatëpjetë, kah qyteti, duke e ngadalësuar shpejtësinë dhe duke ia përkujtuar vetes se duhej t'i bënte sytë katër. Më parë duhej të gjente se ku ndodhej tenda. Tash shikimi i ishte mjegulluar; e dinte se kjo do ta merrte në qafë, ngaqë duhej të mendonte vazhdimisht mbi atë se s'kish çare pa shkuar diku për të gjetur diçka për zbutjen e dhimbjes së kokës. Në stacionin e benzinës i thanë se ende s'e kishin ngritur tendën e cirkut, mirëpo vagonat e cirkut, i thanë, ndodheshin në binarët periferikë të stacionit. U nis atje.

Dy vagona "pullmanë", të lyer me ngjyra të ndryshme të çiltëra, ndodheshin në binarë. I vuri re para se të dilte nga automobili. Orvatej të merrte frymë sa më i qetë që të mos i vërshonte gjaku në kokë. Doli nga automobili dhe u nis kah muri i stacionit me kujdes duke u ruajtur e gjithë duke i vështruar vagonët. Nga dritaret ishin varur do ndërresa, të zhubravitura dhe të shtrydhura, si t'i kishin larë pak më parë. Në tokë, rrëzë shkallës së një vagoni, gjendeshin tri karreklla nga kanvasi. Mirëpo, nuk kishte vënë re ende kurrfarë shenje të jetës derisa një njeri me përparëse të papastër nuk doli te dera dhe me një hov, e derdhi ujin e fëlliqtë nga kusia. Dielli vezulloi në pjesën e ngritur të kusisë, kurse ai njeri përsëri u kthye në vagon.

S'kam çare, mendonte ai, pa i befasuar para se t'u afrohem. As që i shkonte nga mendja se ata të dy ndoshta nuk ndodheshin në atë vagon. Sikur ata të mos jenë aty, sikur tërë suksesi s'do të varej nga ajo se a do ta shohin ata atë të parin apo ai do t'i diktonte i pari, kjo do të ishte në kundërshtim me të gjitha ligjet e natyrshme, do të ishte në kundërshtim me tërë ritmin e ngjarjeve. Bile për më tepër: ai duhet t'i diktojë i pari, pastaj do t'i marrë paratë e veta, e, ç'do të bëjnë ata më vonë,

aq i bën! Në mos qoftë ashtu, të gjithë do të marrin vesh se atë, Xhezon Kompsonin, e paska vjedhur Kuentina, e mbesa, lavirja.

E shikoi përsëri vagonin. Pastaj, iu afrua, iu ngjit shkallëve te dera. Kuzhina ishte e errët dhe i kutërbonte era e ushqimit të mëditshëm. Ai njeri dukej si një njollë e bardhë; tash këndonte një këngë me një zë që ndërpriste hove-hove, me një tenor që i dridhej. Qenka plak, mendoi Xhezoni, veç kësaj, s'është i fortë sa unë. Hyri në vagon, shi kur e vuri re plaku.

"Hej" bëri njeriu duke e ndërprerë këngën.

"Ku janë?" tha Xhezoni. "Përgjigju shpejt tash. Në vagonin e fjetjes?"

"Ku është kush?" pyeti ai.

"Mos më gënjeni!" tha Xhezoni. Mori në thua në errësirë.

"Ç'u bë?" pyeti ai tjetri. "Kë e quani gënjeshtar?" Por, kur Xhezoni e rroku për supi, ai briti: "Mos më nguc djalo!"

"Mos rrej", tha Xhezoni, "ku janë?"

"Mor i poshtër", i tha njeriu. Krahu i tij, Xhezonit iu duk i brishtë dhe i dobët. Ai u orvat ta lironte krahun, pastaj u kthye dhe ra mbi tavolinën e parregullt pas tij.

"Fol", tha Xhezoni. "Ku janë?"

"Tash ta them se ku janë", klithi njeriu. "Veç ta marr thikën e kasapit".

"Hej", bëri Xhezoni duke u munduar ta mbajë, "unë veç ju pyeta diçka".

"Mor pis", këlthiti tjetri dhe zuri të kërkonte nëpër tavolinë. Xhezoni u përpoq t'ia kapte të dyja duart për ta frenuar tërbimin e tij të dobët. Shtati i atij njeriu ishte aq i brishtë, aq i ligësht, por megjithatë aq me vrull po përqendrohej rreth një qëllimi, saqë Xhezoni për herë të parë e kuptoi fare mirë rrezikun që i kanosej.

"Mos e prek atë!" i tha Xhezoni, "hej! hej! Dola! Ika lermë të shkoj. Ika".

"Mua më quan gënjeshtar", çirrej tjetri. "Lëshomë, lermë veç një minutë se ta kallëzoj qejfin!"

Xhezoni shikonte i mllefosur rreth e rrotull duke e mbajtur tjetrin. Jashtë bënte mot i kthjellët dhe me diell, mot i gjallë, i ndriçuar, i zbrazët; ai mendonte për njerëzit të cilët së shpejti do të shkonin rehat në drekën e të dielës, në shtëpi, të veshur për të kremte, ndërsa ai mundohet ta mbërthente atë plakun

fatal dhe të tërbuar të cilin nuk guxonte ta lëshonte për t'ua mbathur këmbëve.

"A më lë të dal, të paktën?" tha ai. "A më lë të dal mor?" Mirëpo, ai tjetri mundohej t'i shqitej pa ndarë, kështu që në atë çast, Xhezoni e liroi njërën dorë dhe e goditi me grusht në kokë. Goditja e tij ishte e ngathët, e shpejtë dhe jo gjithaq e fortë, mirëpo, megjithatë, plakeci u kolovit dhe ra mes fëltereve dhe kovave në dysheme. Xhezoni qëndronte mbi të duke marrë frymë me rrëmbim dhe duke përgjuar. Pastaj, u kthye dhe doli me vrap nga vagoni. Te dera e vagonit, u ndal dhe zuri të zbriste shkallëve të vagonit dalngadalë. Përsëri u ndal për një hop. Dihaste duke bërë hah hah hah, pastaj u ndal aty dhe u mundua ta përmbante frymëmarrjen duke shikuar rreth e rrotull dhe, kur i dëgjoi rrapëllimat e hapave, u kthye me kohë dhe vuri re se si plakeci po ngarendte nga korridori i vagonit, duke mbajtur sopatën e ndryshkur.

Ai e rrëmbeu sopatën, pa ndier asgjë, ndonëse ishte koshient se po rrëzohej, duke pandehur: Ja, pra, mbarova, ai besonte se tash do të vdiste, kështu që kur diçka e goditi në zverk, ai mendoi, A thua si më qëlloi? Ndoshta ai më ka goditur shumë më parë, mendoi ai, kurse unë e ndiej tash, prandaj mendoi, ngutu. Nxito. Hajde më, e pastaj e pushtoi dëshira e tmerrshme që të mos vdiste, ndaj rezistonte duke i dëgjuar vigmat dhe sharjet me zë të dridhur të plakut.

Ende s'po dorëzohej kur e ngritën në këmbë, mirëpo kur e shtrënguan fort, ai pushoi së dridhuri.

"Mos po më shkon gjaku rrëke?" tha ai. "Zverku im. Mos po më rrjedh gjaku?" Ende pa e mbaruar fjalën, ndjeu sesi fët e fët po e shpienin dikah dhe e dëgjonte zërin çjerrës dhe të xhindosur të atij plaku si po vinte duke u tretur. "Kini kujdes për kokën time", tha ai, "pritni, unë."

"Çfarë djall pritjeje!" i tha ai që e mbante. "Ajo anza e vogël do t'ju mbysë. Hajdeni. S'jeni plagosur".

"Ai më goditi me sopate", tha Xhezoni. "A më rrjedh gjaku?"

"Ecni, tha tjetri. Ai e shpiente Xhezonin rrotull këndit të stacionit, e shpuri në një platformë të zbrazët ku ishte ndalur një kamion ekspres dhe ku ishte rritur bari me lule e ku gjendej një reklamë me drita elektrike:

Lëshoi një sy Motsonit, fjala sy ishte zëvendësuar me një sy prej një bebëze elektrike. Aty e lëshoi i panjohuri.

"E tash", i tha ai, "qërohuni dhe mos u dukni më kësajde. Ç'patët ndërmend? Të bënit vetëvrasje a?"

"I kërkoja dy veta", tha Xhezoni. "Vetëm e pyeta se ku ishin".

"E kë e kërkonit?"

"Një vashë", tha Xhezoni. "Dhe një mashkull. Ai dje, në Xhefterson kishte kravatë të kuqe. Ishte me atë cirk. Të dy më kanë plaçkitur".

"Oh", tha njeriu. "Ju qenkeni ai. E po, ata s'janë më këtu".

"Ashtu më duket", tha Xhezoni. U mbështet për muri, e preku zverkun me dorë dhe e shikoi shuplakën e dorës së vet. "Kujtova se isha përgjakur. Kujtova se ai më goditi me sopatë".

"I ratë binarit me kokë", i tha i panjohuri. "Tash, më mirë të ikni. Ata s'janë këtu".

"Po. Ai më tha se s'janë këtu. Pandehja se gënjente".

"Mos mendoni se edhe unë gënjej?" tha i panjohuri.

"Nuk po gënjeni. E di se s'janë këtu".

"I thashë të shkojnë në dreq të mallkuar, të dytë", tha i panjohuri. "Mua s'më duhen hora të tillë në cirk. Unë jam drejtor i një cirku të ndershëm, me trupë të ndershme".

"Po", tha Xhezoni. "A mos dini se kah shkuan?"

"Jo. As që dua ta di. Asnjë anëtar i cirkut tim s'bën palaçllëqe të tilla. A jeni — vëllai i saj?"

"Jo", tha Xhezoni. "S'prish punë. Desha t'i shoh. Jeni të sigurt se s'më qëlloi ai? Desha të them, gjaku s'më rrjedh?"

"Do të rridhte gjaku po të mos arrija me kohë pranë jush. Ikni prej këtu sa më parë. Ku sytë, këmbët. Ai lahperi i vogël do t'ju qëronte. A është ajo vetura juaj?"

"Po".

"Paj, hyni në të dhe kthehuni në Xheferson. Nëse i gjeni, s'do t'i gjeni mes trupës sime. Unë kam njerëz të ndershëm në cirkun tim. Ju thatë se ju kanë plaçkitur?"

"Jo", tha Xhezoni. "S'ka kurrfarë rëndësie". Shkoi në automobil dhe hyri në të. Si t'ia bëj tash? mendoi ai. Në atë çast iu kujtua. E ndezi motorin dhe filloi të ngiste rrugës dalngadalë derisa arriti në një vetëshërbim. Dera ishte e mbyilur. Qëndroi pak kohë me dorën në dorëz të derës dhe me kokë të ulur. Pastaj, u kthye dhe kur ia behu një njeri, e pyeti nëse ka ndonjë dyqan të hapur aty pari. Mirëpo, nuk kishte. Mandej e pyeti se kur niset ndonjë tren për në veri, kurse i panjohuri i tha se nisej

në orën dy e gjysmë. E kaloi kalldërmin, hyri në automobil dhe u ul. Pas një copë here para tij po kalonin dy zezakë të rinj. U bëri zë.

"A di ndonjëri prej jush ta ngasë automobilin?"

"Po, zotëri, dimë"

"Sa do të kërkonit për të më çuar deri në Xheferson menjëherë?"

Ata e vështruan njëri-tjetrin duke nënëritur diçka mes vete.

"Ju jap një dollar", tha Xhezoni.

Përsëri zunë të pëshpërisin. "Për një dollarë, s'bën", tha njeri.

"E pra sa do të shkojë?"

"A po e çon ti?" tha njeri.

"S'mundem", tha tjetri. "Pse s'po e vozit ti? S'ke punë të hairit!"

"Kam, qysh s'kam."

"E çfarë pune paske?"

Përsëri filluan të pëshpërisin, duke buzëqeshur.

"Ju jap dy dollarë", tha Xhezoni. "Cilitdo qoftë".

"As unë s'mund të shkoj", tha i pari.

"Në rregull", tha Xhezoni. "Vazhdoni. Mund të shkoni".

Priti aty ashtu i ulur për një copë herë. Dëgjoi se si diku një orë ra gjysmë ore, e fill pastaj filloi të gëlonte gjindja me petka të së dielës dhe të Kërshëndellave. Disa kalimtarë i lëshonin nga një vështrim një jabanxhiu i cili po rrinte i qetë para timonit të një veture të vogël, me jetën e tij të padukshme rreth e rrotull tij si ndonjë çorapë e leckosur. Pas një grime, ia behu një zezak me rroba punëtori.

"Mos je ti "qaj" që po do të shkojë në Xheferson?"

"Po", tha Xhezoni. "Sa po lyp?"

"Katër dollarë".

"T'i jap dy".

"Nën katër, s'bën". Njeriu në automobil po rrinte i qetë. As që e vështronte zezakun. Më në fund, zezaku e pyeti: "A po të duhem a jo, fol?"

"E po mirë", tha Xhezoni. "Hajde".

Ai i bëri vend në automobil, kurse zezaku u ul para timonit. Xhezoni i mbylli sytë. Në Xheferson do të gjej diçka për dhimbjen e kokës, thoshte me vete duke u rehatuar në automobil që të mos i pengonte korkolitja. Atje do të gjej diçka.

Po vozitnin rrugëve nëpër të cilat njerëzia ktheheshin nëpër shtëpi në drekën e Kërshëndellave. Pastaj dolën nga qyteti. Xhezoni mendonte për ata, por nuk i shkonte mendja në shtëpinë ku Beni e Llasteri hanin drekën e ftohtë në tavolinën e kuzhinës. Diçka — mungesa e katastrofës, kërcënimi, njëfarë rreziku eventual — sidoqoftë diçka i mundësonte që ta harronte Xhefersonin si çdo vend tjetër që kishte parë dikur, ta harronte si vendin ku duhet përsëri t'ia fillonte jetës së re.

Kur Beni dhe Llasteri hanë drekë, Dilzi i çoi jashtë.

"Ki kujdes se mos e shqetëson. Në katër vjen T.P.

"Mirë", tha Llasteri.

Dolën. Dilzi po hante drekë dhe po e pastronte kuzhinën. Pastaj, shkoi rrëzë shkallëve, përgjoi, mirëpo nuk dëgjoi asgjë. U kthye nëpër kuzhinë dhe doli nga dera e pasme dhe u ndal te shkallët. Benin dhe Llasterin nuk i diktoi, mirëpo derisa qëndronte aty dëgjoi përsëri rrapëllimën e derës së qilarit. Shkoi atje dhe kur shikoi në qilar, e gjeti skenën e njëjtë si në mëngjes.

"Kështu i binte ai", thoshte Llasteri, duke e shikuar sharrën me një farë pikëllimi plot shpresë. "Veçse unë s'kam me çka t'i bie", tha ai.

"E s'po e gjen atje poshtë", ia bëri Dilzi. "Qite djalin në diell. Mos rrini aty se e merrni të kallurit e mushkërive në dyshemenë e ftohtë".

Priste dhe i vështronte ata të dy se si po kalonin nëpër oborr kah drurët e kedrit afër gardhit. Pastaj shkoi në kasollën e saj.

"Mos ia nis tash përsëri", tha Llasteri. "Sot ia ke nxjerr bishtin!" Aty ishte një shregull e bërë nga dërrasat e një fuçie të lidhura me tela. Llasteri u ul për t'u luhatur, ndërsa Beni u nis më tej, pa ndonjë cak e qëllim. Përsëri ia nisi dënesjes. "Boli bre!" i tha Llasteri. "Se vallahi hangre dajak!" U ul mirë në shregull. Beni vërtet s'luante nga vendi, por dëgjohej se si po përloshej. "Epo a e mbyll atë çarapë a çka po kujton?" i tha Llasteri. U ngrit dhe i ra pas Benit të cilin e gjeti të ulur galiç para një grumbulli të dheut. Nga të dy anët e grumbullit me dhe ishin ngulur dy shishe të zbrazta. Në shishe dikur kishte pasur helm. Në njërën prej tyre gjendej tash një tatullë e venitur po e helmuar. Beni po përloshej me disa zëra të paartikuluar. Gjithë duke u përloshur shikonte përreth se mos gjente ndonjë degë,

e si e gjeti e futi, në shishen tjetër. "Pse s'e mbyll gojën njëherë?" i tha Llasteri. "Mu' po m'duket se e ke hak dajakun? E si ia "ban" ti në t'bafsha për ibret?" U gjunjëzua dhe e nxori shishen nga toka duke e fshehur pas shpinës. Sakaq, Beni pushoi së përloshuri. I ulur galiç, e shikonte vrimën e vogël ku ndodhej shishja më parë, e pastaj pikërisht kur Beni po merrte frymë thellë, Llasteri ia tregoi shishen përsëri. "Shshsht!" këlthiti Llasteri. "Mos ia nis avazit tash! Trus! Qe ku e ke. A po e sheh? Këtu. Por, nëse rri këtu, ia nis vigmës përsëri. Hajde, shkojmë të shohim se a kanë fillu t'gjujnë" me top golfi!" e rroku Benin për dore dhe ia prini; shkuan te gardhi dhe u ndalën aty njëri pranë tjetrit duke vështruar mes lozëve të ngatërruara të lulemustakut ende të palulëzuar.

"Qe", thirri Llasteri. "Qe ku po vijnë do! A p'i sheh?"

Zunë të vështrojnë lojën e katër lojtarëve të golfit të cilët po i binin topit nëpër livadh rrotull vrimës dhe jashtë saj, se si sërish shkonin në një grumbull rëre dhe i binin topit. Beni i shikonte duke dënesur dhe duke u përjargur. Teksa katërshi po vazhdonte lojën, ai u ra pas përgjatë gardhit, duke u turrur e duke gjëmuar. Njeri, tha.

"Hej, kedi, sillma këtu strajcën!"

"Hesht, Benxhi", i tha Llasteri, mirë Beni po vazhdante të ecte duke u kolovitur si pata, herë duke e prekur gardhin dhe herë duke dënesur me zërin e tij të vrazhdë dhe të pashpresë. Lojtari i golfit, i binte topit, vazhdonte të ecte, ndërsa Beni e përcillte hap pas hapi përgjatë gardhit derisa gardhi s'kthehej në një kënd të drejtë, teksa ai shi aty ngjitej për gardh dhe i vështronte lojtarët të cilët po largoheshin.

"A pushon bre njiherë?" tha Llasteri. "A po e mbyll qat gojë?" Ia shkundi krahun. Beni ishte kapur për gardh duke uluritur pareshtur. "O allahile, boll "ma", hej, a po ngon?" i briste Llasteri. "Boll se m'shurdhove! A more vesh?" Beni po kundronte përtej gardhit. "Ani mirë" tha Llasteri. "Po get se po lyp sebepin për piskamë". Shikoi mbi supin e tij kah shtëpia. Mandej, i pështpërtiu: "Kedi! Çun! Kedi! Hajt, krisja kukamës! Kedi! Kedi!"

Pas një kohe, në intervalet e shkurtra të uluritjes së Benit, Llasteri e dëgjoi thirrjen e Dilzit. E rroku Benin për dore dhe duke e shpënë nëpër oborr arritën tek ajo.

"A s'të thashë se s'rri urtë", tha Llasteri.

"Mor hajvan", tha Dilzi. "Çka dreqin i "bone" tash?"

"Kurrgja. Thashë si t'i shohë lojtarët e golfit ia kris piskamës!"

"Pa eja tek unë", i tha Dilzi me të butë. "Mos u tut. Mos ki gajle se s'të gjen "gjo"! Mirëpo, ai nuk pashitej, por po përloshej. Kaluan nëpër oborr dhe hynë në kasolle. "Nga e bjere atë këpucë", i tha Dilzi. "Po mos i qit telashe zonjushes Kahlinë nëse të pyet gjo, thuj se po rri me mu'. Hajt. Mos harro se ç'të thashë".

Llasteri doli. Dilzi e çoi Benin në krevat dhe e uli pranë vetes; e mbante të ngjitur për vete duke e lëkundur dhe duke ia fshirë gojën e përjargur me skajin e fustanit të saj. "Pusho, boll ma", i thoshte duke ia përkëdhelur kokën", mos ki dert, këtu e ke Dilzin tande; Mirëpo, ai po gjëmonte sërishmi ngadalë, mjerueshëm, pa pikë loti, ishte një këlthitje e thellë, e patëkeqe e asaj dhimbjeje memece nën diellin tonë. Llasteri u kthye duke e mbajtur pandoflen e bardhë nga sateni. Tash ajo ishte zverdhur, ishte grisur dhe ndyer dhe kur ia dhanë Benit në dorë, ai pushoi menjëherë. Ndonëse, ende po përloshej, pas një copë here ia dha sërish ulurimës.

"Qysh po thu', a mun' e gjen kund T. P.-në?" pyeti Dilzi Llasterin.

"Dje tha se sot shkon në Sen Xhon. Tha se kthehet në katër".

Dilzi po e lëkundte Benin duke ia përkëdhelur kokën.

"Sa kohë do t'pres, o Jezu Krisht!" bëri Dilzi. "Prita shumë".

"Mami, po unë vetë mund ta vozis çejzen!" tha Llasteri.

"Qysh jo, e ta theni qafën të dytë", ia ktheu Dlzi. "Çka s'të bie në mend! E di se ti je budallë për aso punësh. Veç disi s'ta kam besën. Boll ma, boll", tha ajo. "Hajde, boll de!"

"O, jo s'na gjen "gjo", jo", i thoshte Llasteri. "Unë i mbaj frerët sa herë që udhëtoj me T. P." Dilzi e lëkundte Benin duke e mbajtur. "Zonjusha Kahlinë thotë në mos kosh i zoti qi ta pashitësh, çohet ajo vet pi krevetit dhe ia mbyll gojën".

"Boll, shpirt", thoshte Dilzi, duke ia përkëdhelur kokën. "Llaster, loçkë", tha ajo. "A po e ngon ti mamin plakë, apo ia grah me mend çejzes?"

"Po, po, qysh jo, tybe mos grahsha taman si T. P."

Dilzi ia përkëdhelte kokën Benit duke e përkundur. "Unë po bojë çka po m'vjen ndoresh", thoshte Dilzi. "Vetë zoti e di

këtë. Hajt, shko e mbrehi kuajt", tha ajo dùke u ngritur. Llasteri doli me vrap. Beni po e mbante pandoflen duke qarë. "Mos kaj, zemra e lokes, Llasteri shkoi ta marrë çejzen. Të çon në vorreza. S'kemi nge ta marrim edhe kapuçin tand në shpi", po i fliste Dilzi. Shkoi afër dollapit, në qoshk të odës së strukur nga perdja e lëshuar e basmës. Nga ai skutuliq i saj, e nxori kapelen e saj prej feltri të cilën e kishte mbajtur dikur. "Ta dinin gjindja, sa poshtë kemi ra", thoshte Dilzi. "Ani, ti je ferishtja e zotit. Edhe unë "bohem" mbas do kohe, lavdu koftë Krishti! Po, qe besa". Ja rrasi kapelen në kokën e tij dhe ia kopsiti kapotën. Ia mori pandoflen nga dora, e la përanash, mandej dolën. Ndërkohë, ia behu Llasteri me çejze të vjetër që po pjerrej në një anë; çejzen e ngrehte një pelë plakë dhe e bardhë.

"A po i çel mirë sytë, mor haram?" i tha Dilzi.

"Po, mami", ia ktheu Llasteri dhe i ndihmoi Benit që të ngjitej në ndenjësen e pasme. Beni pushoi së qari, ndonëse tash filloi të përloshej.

"Po lypi lule", i shkrepi Llasterit. "Prit se ia gjej nji lule!"

"Rri aty e mos luj", i tha Dilzi. E kapi kalin për kapistre. "Tash nga e gjeja nji lule". Llasteri ngarendi rrotulli shtëpisë, hyri në kopsht dhe u kthye me një lule nerqize.

"E paska karcyellin e thymë", i tha Dilzi. "Pse s'më gjete "nji" lule të mirë?"

"Veç këtë e gjeta", iu gjegj Llasteri. "Ti i këpute t'gjitha të premten, për kishë. Prit se e ndreq unë".

Derisa Dilzi po e mbante pelën, Llasteri bëri njëfarë spice apo kashtalle prej një bujashke dhe dy copave të penit dhe mbasi e rregulloi kërcellin e lules, ia dha Benit. Pastaj, iu ngjit çejzes dhe i mori frerët në dorë. Dilzi ende mbante kalin për kapistër.

"Rrugën e di?" i tha Dilzi. "Bjeri kësaj rruge, mbaja larg sheshit", mandej "fill e n'vorreza, e manejna kthehu drejt n'shpi".

"Ani mirë", tha Llasteri. "Iho, Kuini, jepi!"

"A i çel sytë rrugës?"

"Po, vallahi". Dilzi ia liroi kapistrën.

"Hio, Kuini", briti Llasteri.

"Prit i herë!" i ndali Dilzi. "Ma jep këtu kamxhikun".

"Mo' bre", tha Llasteri.

"Bima kho kur po t'thom", tha Dilzi duke iu afruar rrotës. Llasteri ia dha qartaqefas.

"Tash s'kam si ta ngas Kuinin".

"Mos ki dert", i tha Dilzi. "Se Kuini e di "ma" mirë se ti kah t'shkojë. Ti veç frerët mbaji. Rrugën e di, a apo jo?"

"Po, e di. Asaj rruge shkon T. P. çdo t'dile".

"Shko edhe ti asaj rruge në këtë të dile".

"Bezbeli. A s'e kam kalu' me "qina" herë me T. P.?"

"Mos humb pra", ia bëri Dilzi. "Nisu. Nëse e gjen "gjo" Benxhin, asha zotin, mbetesh n'dorë. Llom t'boj. Robia t'pret, po, unë t'çoj n'robi para kohe".

"Mirë, mirë", tha Llasteri. "Iho, Kuini!"

I ra kalit me dizgjinë dhe çezja zuri të ecte dalngadalë.

"Rueju, Llaster!" i briti Dilzi duke u ndarë.

"Hijo!" thirri Llasteri. Përsëri e qëlloi pelën me frerë. Me një lloj uturime nëntokësore, Kuini u nis rrugës dalngadalë dhe e ktheu drejtimin në rrugën ku Llasteri e shtrëngoi të vepronte ashtu.

Beni nuk po përloshej më. Ishte ulur në ndenjëse dhe në dorë e mbante lulen e drejtë, ndërsa sytë i dukeshin të kthjellta dhe të papërshkrueshme. Para tij koka e rrumbullakët e Llasterit sillej pa pushim derisa s'mund ta shihnin shtëpinë, pastaj ktheu në fund të rrugës dhe kur po e vështronte Beni, zbriti nga çezja dhe këputi një thupër nga gardhi. Kuini e uli kokën dhe zuri të kulloste bar derisa Llasteri u ngjit në çejze, ia tërhoqi frerët përpjetë dhe na dha sërish frerëve që të nisej Kuini; pastaj, i zgjati bërrylat dhe duke e mbajtur thuprën dhe frerët lart, zuri një pozë aq mburrëse e cila ishte në kundërshtim të plotë me trokun e matur të patkonjve të Kuinit dhe me zhurmën e vogël si të organonit të zorrëve të pelës. Pranë tyre kalonin automobilat dhe kalimtarët; atë e vunë re edhe do çapkëna zezakësh:

"Qy, qy, Llasteri! Kah ia mban o Llaster? N' vorreza a?"

"Tung", ua bënte Llasteri. "Po, n'vorreza po shkoj, po jo n'ato ku shkoni ju! Hijo, elefant, përpara!" Iu afruan edhe sheshit ku ushtari i konfederatës po kundronte me sytë e tij të zbrazët, nën dorën e vet të mermertë, erën dhe kohën. Llasteri u krekos edhe njëherë dhe e qëlloi Kuinin javash me thupër e fill pastaj e vështroi tërë sheshin. "Qe ku tek a "otomobili" i zotni Xhezonit", tha ai dhe diktoi edhe një grup

zezakësh. "A' t'u kallëzojmë "atyne" zezakëve se kush jemi, Benxhi? Qysh po thu' ti?" Shikoi pas, Beni rrinte i ulur me lulen në dorë, me shikim të zbrazët, të pashprehje. Llasteri e qëlloi sërish Kuinin me thupër dhe i ra anës së majtë të përmendores.

Në atë çast, Beni u shtang. Pastaj, ia krisi ulurimës. Ulurimë pas ulurime, e zëri i tij zuri të bëhej aq çjerrës saqë mezi i mbet kohë për të marrë frymë. Në atë ulurimën e tij kishte diçka më shumë se çmeritje; ulurima ishte njëfarë lebetie e tmerri; ajo ishte një lloj agonije e verbër dhe memece; ishte, në të vërtetë, njëfarë vigme e kukame. Po në atë çast, sytë e Llasterit iu zgurdulluan asisoji saqë atij i shiheshin vetëm të bardhët e syve. "O zot i madh!" briti ai. "Boll! Shshsht! Pssst! O i lumi zot!" U kthye dhe e qëlloi Kuinin përsëri me thupër. Thupra iu thye, prandaj e flaku, e teksa zëri i Benit sa vinte po bëhej edhe më therës, Llasteri i rroku skajet e frerëve, u përkul përpara, ndërsa në të njëjtën kohë Xhezoni po kalonte me hov nëpër shesh kështu që, sakaq, u përplas për papafingon e çejzes.

Me kurrizin e dorës, e shtyri me vrazhdësi Llasterin përanësh, i rrëmbeu frerët dhe me ndihmën e tyre filloi ta ngiste Kuinin herë andej e herë këtej, i bashkonte frerët dhe i qëllonte me ta ijet e pelës. E godiste pa pushuar, derisa e shtrëngoi që ajo t'ia niste galopit të kalamendur, e fill pastaj mori nga e djathta e përmendores, teksa tërë kohën vigma agonizuese dhe topitëse e Benit po ushtonte rreth e rrotull. Pastaj, ia këputi një grusht në kokë Llasterit.

"Po a s'di ti se s'ke të drejtë të vozitësh majtas?" po i çirrej atij. Paskëtaj, u përkul mbas dhe e qëlloi Benin duke ia thyer kërcellin e lules. "Mjaft! Mbylle gojën! Rrudhe!" i bërtiste. E ndali Kuinin me frerë dhe kërceu nga çejza. "Menjëherë të kthehesh në shtëpi. Nëse edhe njëherë del jashtë pragut të derës së oborrit me të, do të të vras!"

"Po, zotni", tha Llasteri. I mori frerët dhe e qëlloi Kuinin me to. "Hajde! Iho! Benxhi, boll "ma" pashë zotin!"

Benxhi po ulurонte deri në kupë të qiellit. Kuini u nis përsëri, patkonjtë e saj zunë të bëjnë një trok të barabartë, sakaq, papritmas, Beni heshti. Llasteri u kthye vrik dhe shikoi pas, pastaj vazhdoi ta ngiste çejzen. Kërcelli i thyer i lules kishte rënë në shuplakën e dorës së Benit, kurse sytë e tij ishin bërë

sërishmi të zbrazët, të kaltërt dhe të kthjellët, ndërsa kornizat dhe fasadat e shtëpive shkëlitnin edhe një herë nga e djathta në të majtën; shtyllat dhe drurët, dritaret, dyert dhe reklamat, çdo gjë gjendej në vendin e vet të zakonshëm.

SHTOJCË

Kompsonët që nga viti 1699 e deri më 1945

IKEMOTUBE. MBRET I SHFRONËSUAR AMERIKAN. ATË E QUAJTI "L'HOMME" (e ndonjëherë "de l'homme") vëllai i tij i gjetur, kavalier i Francës, i cili, po të mos lindte më vonë, do të mund të bëhej njëri ndër yjtë më të ndritshëm në galaksionin e shkëlqyeshëm të kalorësve kopukë, mareshalëve të Napoleonit, i cili ashtu e përktheu titullin e fisit indian Çikaso që do të thotë "Njeri", këtë përkthim Ikemotube, e bëri vetë; ishte njeri i djallëzuar dhe me imagjinatë të zhvilluar si dhe njohës i mirëfilltë i karaktereve, madje edhe i karakterit të vet, bëri edhe një hap më tej dhe e anglizoi me fjalën "Doom" (dum) ose "fatalitet". Ai ia dhuroi një milje të pronës së tij të lënë në veri të Misisipit, që nga të katër anët ishte kufizuar me këndе si tavolina e bixhozit, (e pyllëzuar asokohe ngaqë ato qenë ditët para v. 1883 kur ranë meteorët dhe kur i tërë Xhefersoni në Misisipi përbëhej nga një ndërtesë njëkatëshe, barake të ndërtuar me dërrasa dhe baltë ku banonte përfaqësuesi i pushtetit mes fisit indian të çikasoit dhe ku e kishte edhe dyqanin e vet e nipit të një të mërguari skocez, i cili e kishte humbur të drejtën e trashëgimit duke e lidhur fatin e vet me njëfarë mbreti të cilin e kishin përmbysur nga froni. Kjo i jepte një lloj të drejte deri diku që të qarkullonte i lirë, pa i hyrë ferrë më këmbë, me çdolloj mjeti që e shihnin të udhës ai dhe të tijët, këmbë ose me kuaj me kusht që të ishin kuaj të çikasoisve, në lëndinat e pashkelura të perëndimit që do të quheshin Oklahoma: asokohe, s'dinin gjë për vajgurin.

XHEKSONI. Babai i Madh i Bardhë me shpatë. (Belaxhi i regjur në duele, shamataxhi, rrjepacak, kopuk dhe harbut, luan i rryer, i cili të mirën e kombit të tij e vinte para Shtëpisë së Bardhë, teksa gjendjen e partisë së tij politike e vinte mbi kombin dhe Shtëpinë e Bardhë, e mbi të gjitha këto, jo gjithaq nderin e gruas së vet, po parimin se duhej mbrojtur nderi, pa marrë parasysh se a duhej mbrojtur nderi apo jo nderi, nderi i saj duhej mbrojtur). Ky i fundit, me dorën e vet e dha tapinë, ia vuri vulën dhe e firmosi tapinë e tokës së dhuruar në tëbanën e tij të artë në Vasi-Taun, pa pasur haber as vetë se aty kishte vajguri: kështu që një ditë prej ditësh, pasardhësit e paplang të atij fatligu të privuar nga trashëgimi, të bërë tapë, të trallisur dhe të shtrirë në shpinë, do të voziten me automobilin e posaçëm ngjyrë të kuqe të funeralit si dhe me automobilin e zjarrfikësve mbi atë grumbull mbeturinash dheu të pluhrosur të eshtrave të tyre.

Këta qenë Kompsonët:

KUENTIN MËKLAÇËN. Bir i një tipografi të Glazgout, jetim i rritur në mesin e farefisit të nënës së tij në Perth, në bjeshkët e Skocisë. Iku në Kërlajn nga moçali i Kallodenit me shpatën e rëndë me dy teha dhe gunën nga e cila nuk ndahej kurrë, me të flinte, si dhe me do cikërrime të tjera. Në moshën tetëdhjetëvjeçare, meqë një herë ishte ngritur kundër mbretit anglez dhe e kishte humbur betejën, duke mos dashur ta përsëriste gabimin e njëjtë, një natë të vitit 1779, iku me të nipin dhe gunën (Shpata dytehëshe u zhduk së bashku me të birin, babain e nipit, një vit para kësaj në një regjiment të Tarletonit në një fushëbetejë në Xhorxhi) në Kentaki ku tashmë ishte vendosur njëfarë fqinji, i quajtur Bun apo Bunë.

ÇARLLS STJUARTI. E degraduan dhe e dëbuan nga regjimenti britanik. I braktisur si i vrarë në moçalet e Xhorxhisë nga ushtria e tij që tërhiqej dhe njëkohësisht me rastin e avancimit të Ushtrisë amerikane, e pandehnin të vrarë, ndonëse gabonin. Ai ende e kishte shpatën e madhe me dy teha dhe kur pas katër vjetësh u kthye me këmbën e drunjtë i befasoi babain dhe të birin në Herodsbërg, në Kentaki,

pikërisht me kohë për ta varrosur të jatin dhe për të mbetur për një kohë të gjatë një personalitet kips dhe i bezdisur duke u orvatur pandërprerë që të bëhej mësues gjë që gjakonte të bëhej, derisa më në fund s'hoq dorë nga ky qëllim dhe u bë bixhozxhi, për ç'gjë kishte prirje, si dhe të gjithë Kompsonët të cilët ishin bixhozxhinj të lindur, me kusht që hyrja në lojë të jetë e vështirë, kurse interesi duhej të jetë i madh. Ia doli mbanë ta rrezikonte jo vetëm kokën e vet po edhe sigurinë e familjes së vet, madje edhe namin e emrit që do ta lërë pas vetes, duke iu bashkuar konfederatës në krye të së cilës ndodhej i njohuri i tij Vilkinson (një njeri me talent të shquar, autoritativ, i zgjuar dhe me pushtet), kurse qëllimi i konspiratës ishte që të tërë luginën e lumit Misisipi ta shkëpuste nga SHBA dhe ta bashkonte me Spanjën. Kur plasi flluska (si e dinin të gjithë, me përjashtim të mësuesit Kompson), ai qe i vetmi komplotist të cilit iu desh të ikte nga vendi: por, jo nga ndonjë shpagë apo hakmarrje, po nga mllefi dhe mëria e papritur e bashkëpunëtorëve të tij të penduar të cilët luftonin për ta shpëtuar veten e tyre. Atë s'e dëbuan nga Shtetet e Bashkuara, po u syrgjynos ngase u tregua zhurmëmadh dhe llafazan me rastin e tradhtisë së tij dhe për shkak se me kopallat e veta shembi çdo urë pas vetes, bile para se të arrinte të ndërtonte ura të reja gjetkë: kështu, për ndjekjen e tij nuk ishin fajtor as hetuesi ushtarak as gjyqi civil, po bashkëfajtorët e tij të komplotit të cilët ç'nuk bënë që atë ta dëbonin nga Kentaki dhe nga Shtetet e Bashkuara, e sikur ta shtinin në dorë, do ta qëronin edhe nga faqja e dheut. Ua mbathi natën, ashtu si ie kishte zakon familja, me të birin, shpatën me dy teha dhe gunën.

XHEZON LI KURGUSI. I nxitur ndoshta nga emri me nam i të et, i pagëzuar me përqeshje nga babai i dëshpëruar, i rreptë dhe me një këmbë druri, i cili në zemrën e vet ende besonte se dëshira e vërtetë e tij ishte të bëhej mësues i gjuhëve klasike, po kalëronte një ditë të v. 1811 shtegut të quajtur Naçez Treis i pajisur me një palë pisqolla shumë të mira dhe me një hebe të vogël në shalën e pelës së ligë që vinte e hollë nga mezi po me nyja të forta, e cila të 400 metrat e para mund t'i kalonte me siguri për më pak se gjysmë minute, kurse për të 400 metrat e tjera nuk i duhej më tepër. Por, kaq i mjaftonte: ai arriti në

përfaqësinë në fisin indian Çikaso në Okatobë (e cila me 1860 ende quhej Xheferson i vjetër) dhe nuk shkoi më tutje. Brenda gjashtë muajve të qëndrimit në atë vend u bë ndihmës i përfaqësuesit, ndërsa pas dymbëdhjetë muajve u bë ortak i tij, i cili zyrtarisht ende hiqej si ndihmës, por në të vërtetë ishte ortaku i tregtizës së madhe plot me mallra të blerë me paratë e fituara në bastet për pelën që merrte pjesë në vrapimet e kuajve të djemve të Ikemotubeoit, të cilët ai, Kompsoni, me kujdes i caktonte deri në katërqind ose më së shumti në gjashtëqind metra; pas një viti Ikemotube u bë pronar i pelës së vogël, kurse Kompsoni u bë pronar i një çerek milje që dikur do të gjendej thuaja në zemrën e qytetit Xheferson, të pyllëzuar që atëherë, e të pyllëzuar edhe njëzet vjet më vonë ndonëse atëherë asokohe më parë dukej si park se sa si pyll, dhe, me kalimin e kohës, i kishte lagjet me robër, ahuret, kopshtet, shëtitoret dhe pavijonet që i kishte projektuar i njëjti arkitekt i cili e kishte ndërtuar shëtpinë me shtylla dhe me portik dhe të cilën e kishte pajisur me mobilie të sjella me avullore nga Franca dhe nga Nju-Orlinsi, teksa më 1840 ai çerek milje akoma ishte i pashkelur (vetëm fshati i bardhë i quajtur Xheferson, zuri ta rrethonte atë pronë dhe së shpejti atë do ta rrethonte tërë qarku, ngase pas disa vjetësh pasardhësit e Ikemotubeit dhe të tijët, do të zhdukeshin, ndërsa ata që do të mbeten s'do të jetojnë më si gjahtarë apo luftëtarë, po si njerëzit e bardhë — si fermenë të pashibla, ose, aty-këtu, si zotërinj e pronarë të plantacioneve si i quanin ata dhe pronarë robësh të padjallëzuar, pak më të ndytë se të bardhët, pak më përtacë dhe më të pamëshirshëm se ata — derisa nga damarët e tyre s'u zhduk ai gjaku i egër që rastësisht të binte në sy në trajtën e hundës si të ndonjë zezaku në qerren e pambukut apo të punëtorit në sharrë të ndonjë traperi apo fokisti të lokomotivës), asokohe ajo tokë quhej Prona e Kompsonit, ngase atëherë ajo tokë ishte e denjë të lindte princa, burra shteti, gjeneralë, peshkopë që t'i merrej haku i drejtësisë për shkak të atyre Kompsonëve të cilët u shpronësuan dhe u privuan nga trashëgimi nga Kallodëni në Kerolajn dhe në Kentaki aso kohe e njohur edhe si shtëpia e guvernatorit, sepse për një mend njëherë e një kohë kishte lindur, apo në të ishte lindur një guvernator — i quajttur përsëri Kuentin Mëklaçën sipas gjyshit zulmëmadh të Kelodenit — atë pronë e quanin

edhe si Prona e Guvernatorit plak, edhe pasi në të (1861) kishte lindur një gjeneral — (i quajtur ashtu sipas pajtimit paraprak dhe miratimit të tërë qytetit dhe qarkut, ndonëse edhe atëherë, bile edhe më parë, e dinin se guvernatori plak ishte Kompsoni i fundit i cili s'do të dështonte në çdo punë të cilës do t'i hynte, pos në jetën e gjatë dhe në vetëvrasje) — gjeneralin e brigadës Xhezon Likurgus II, i cili kishte pësuar disfatë në Shiloh më 1862 dhe pësoi sërishmi disfatë jo aq të rëndë, në Resak më 1864, i cili e vuri hipotekën e parë në çerekmiljen e tokës në Nju-Inglend, më 1866, pasi që qytetin e vjetër e kishte djegur gjenerali federal Smith, kurse qyteza e re zuri të mbushej me banorët kryesisht jo nga pasardhësit e Kompsonëve, po të Snopësve dhe të depërtonte në atë pronë, ta gërryente gjithnjë e më tepër, ndërsa gjenerali i dështuar i kaloi edhe dyzet vjet të tjera duke i shitur ngastrat e tokës së pronës për ta mbajtur hipotekën dhe për ta ruajtur atë që mund të ruhej, teksa një ditë, në vitin 1900, vdiq edhe ai në një barakë ushtrie të kampit të gjahtarëve dhe të peshkatarëve në luginën e lumit Tallahatçi, ku i kaloi ditët e fundit të jetës.

Tash e kishin harruar edhe guvernatorin e ri; nga ai çerek milje kishin mbetur tokat që tash i quanin thjesht toka të Kompsonit — gjurmët plym me barojë të livadheve dhe të shëtitoreve të dikurshme, shtëpia e cila kaherë priste që ta ngjyrosnin dhe ta lyenin, shtyllat e zbërdhylta të portikut ku ngaherë kishte ndenjur Xhezoni III (i shkolluar për avokat, ai e kishte zyrën në atë bina mbi tregun ku në grumbujt e pluhurosur të shkresurinave ishin fshehur disa ndër emrat më të vjetër të qarkut — Holston, Satpen, Grenier, Boshamp dhe Kolfild — dhe nga viti në vit i zbehen në labrintet e pafundme të gjyqit: e kushedi se çfarë ëndrre lindi në zemrën e amshuar të të jatit i cili tash i jepte fund inkarnimit apo ringjalljes së tij të tretë — njëherë si bir i shtetarit brilant dhe të guximshëm, së dyti prisi luftarak i ushtarëve trima, së treti njëlloj Daniell Buni dhe Robinson Kruzoi i rremë dhe i privilegjuar i cili s'iu kthye moshës së rinisë ngaqë as që ishte ndarë nga ajo moshë, — prandaj, ai dëshironte që zyra e avokatit të të birit të bëhej përsëri hajat i pallatit aristokratik të guvernatorit dhe salltanetit të vjetër), i cili nuk ndahej nga shishja e uiskit si dhe nga veprat e çoroditura të Horacit, Livit dhe Katulit, i cili (si thuhej) thurte eulogji satirike dhe shpotitëse për nder të bashkëvendësve të

tij të ndjerë dhe të gjallë dhe, i cili e shiti edhe pjesën e fundit të pronës, pos asaj pjese ku gjendej shtëpia dhe kopshti i tij, ahuret e shembura dhe tëbana e shërbëtorëve ku banonte familja e Dilzit; pronën ia shiti një klubi të golfit, teksa me ato të holla bija e tij, Kandas, do të martohet për bukuri në prill, ndërsa i biri, Kuentini do ta krynte vitin e parë të studimeve në Harvard dhe do të bënte vetëvrasje në qershorin e vitit të njëjtë, 1910; tashmë e njohur si prona e vjetër e Kompsonit Plak edhe gjatë kohës kur Kompsonët banonin në të, në atë muzg të pranverës së vitit 1928, kur stërstërmbesa famëkeqe, fatale dhe e pacipë shtatëmbëdhjetëvjeçare e guvernatorit plak e plaçkiti kushëririn e saj të fundit të shëndoshë (xhaxhanë e vet, Xhezonin IV), duke ia vjedhur paratë e tij të fshehura, pasi zbriti dardhës teposhtë dhe duke ikur me një shitës të cikërrimave të cirkut endacak, bile ende quhet prona e Vjetër e Kompsonëve edhe pas zhdukjes së gjurmëve të Kompsonëve nga ajo tokë: pas vdekjes së nënës së vejë, kurse Xhezoni IV i cili s'kish pse të trembej më nga zezakja Dilzi, e çoi vëllain ■ tij idiot Benxhaminin në çmendinën e Xheksonit, pastaj ia shiti shtëpinë një fshatari i cili e shndërroi atë në njëfarë bujtine për gjyqtarët dhe arbitrat të cilët i jepnin shpërblimet në vrapimet e kuajve si dhe për xhambazët e kuajve dhe të mushkave, madje ende quhet prona e Kompsonit Plak, edhe pas zhdukjes së bujtinës (dhe tash të fushës së golfit) teksa një çerekmiljëshi i vjetër u bë sërishmi i pashkelur, kurse në të radhiten rendet e shumta të binave të vogla të pabanuara private nga druri.

Dhe këta:

KUENTINI III. I cili nuk e donte trupin e motrës së vet, po atë koncept të nderit të Kompsonëve, që me pasiguri dhe (e dinte mirëfilli këtë) përkohësisht e kishte ajo cipëz e saj e brishtë e virgjinitetit si ndonjë replikë miniaturiale e mbarë rruzullit të gjerë që mund të vëhej në tureçkën e fokës së stërvitur. Ai s'e kishte merak incestin të cilin as që mund ta merrte me mend, po e donte idenë e përgjithshme prezbiteriane të ndëshkimit etern; he, e jo Zoti, do të mund ta hidhte si veten ashtu edhe të motrën në skëterrë ku mund ta ruante për jetën e jetëve të virgjër e të paprekur midis zjarrit të

amshuar. Mirëpo, ai që e donte vdekjen, para së gjithash, ai që e donte vetëm vdekjen, dashuronte dhe jetonte thuaja në një pritje koshiente dhe patologjike të vdekjes, si dashnori që dashuron dhe pahiri e përmban veten, me gjithë pritjen e gjatë të pasionuar, skofiare dhe të pabesueshme të shtatit të së dashurës derisa arrin çasti kur nuk mund të durojë më, jo përmbajtjen, po nefsin, kështu që gjuhet, turret, duke e frenuar veten, duke u shkrirë. Bëri vetëvrasje në Kembrixh të Mesaçusetsit, në qershorin e v. 1910, dy muaj pas dasmës së të motrës, duke pritur më parë që të mbaronte viti akademik dhe ta merrte shumën e plotë të të hollave për shkollim, që më parë, jo për arsye se në damarët e tij vlonte gjaku i stërgjyshërve të tij të Kallodenit, të Kerolajnës dhe të Kentakit, po për arsye se ajo ngastra e mbetur e miljes së Kompsonit Plak që u desh të shitej për shkak të martesës së motrës dhe të studimit të tij njëvjeçar në Harvard ishte gjëja, të cilën pos motrës dhe zjarrit, kishte marak të madh të bënte sehir vëllai i tij më i vogël, i lindur idiot.

KANDASI (KEDI). Ishte femër fatale, prandaj ajo ishte pajtuar me kobin e saj të zi pa iu shmangur atij. E donte vëllain e vet për inati e donte jo vetëm atë, po në të e donte edhe atë profet plot pezëm dhe gjyqtar të paepur të atyre gjërave që ai i konsideronte si nderin dhe ogurziun e familjes, ashtu edhe ai pandehte se e donte, por urrante inë të atë që e hiqte për vazën delikate të krenarisë familjare dhe mjetin e përdhosur të koritjes së familjes; jo vetëm kaq, ajo e donte atë jo për vetë faktin, po për shkak të faktit se ai nuk ishte i aftë për dashuri, duke u pajtuar me faktin se ai lypsej mbi të gjitha ta çmonte e ta nderonte jo atë, po atë virgjinitet të cilin e mbronte ai, për të cilin ajo as që e çante kokën: ishte një membranë e brishtë, e dobët fizike për të cilën ajo nuk jepte as pesë para. E dinte se i vëllai e donte vdekjen, para së gjithash ndaj nuk ishte xheloze për këtë, bile ajo (e ndoshta edhe këtë rol e luajti kur e bëri hesap ashtu martesën e saj) do të mund t'ia jepte eventualisht zehrin e qikutës. Kishte dy muaj që ishte me barrë me fëmijën e dikujt tjetër, të cilin pa marrë parasysh nëse do të lindte vajzë apo djalë ajo tashmë e kishte pagëzuar Kuentin, sipas emrit të vëllait të cilin të dytë (ajo me vëllanë) e dinin se kishte vdekur

kur ajo ishte martuar (1910) me një djalë shumë të mirë nga Indiana me të cilin ishin njohur ajo me të ëmën teksa ndodheshin verës në pushim në Ilixhat e Frein Likut. U shkurorëzua nga ai më 1911. Më 1920 u martua me një magnat të ri të filmit nga Holivudi në Kaliforni. Edhe nga ky i fundit u shkurorëzua me marrëveshje reciproke, në Meksikë, më 1925. U zhduk në Paris gjatë okupimit gjerman më 1940, kur ishte ende e bukur, e sipas të gjitha gjasave edhe ende e pasur, ngase askush s'e kishte parë më pas moshës dyzetetetëvjeçare në këta pesëmbëdhjetë vjetët e fundit. Ndërkaq, në Xheferson ishte një femër, bibliotekarja e bibliotekës, e vockël sa mini dhe zioshe, e cila s'ishte martuar kurrë dhe e cila kishte frekuentuar dikur klasën e njëjtë të shkollës së qytetit me Kandas Kompsanin dhe e cila tërë hisen tjetër të jetës e kaloi duke u orvatur të fshehte veprën *"Qelibar i amshuar"* me inkarnacionet e radhitura të veprës, pastaj *"Jurgenin"* dhe *"Tom Xhonsin"* që të mos u binin në dorë nxënësve e klasave të ulëta dhe të larta të gjimnazit, të cilët mund t'i merrnin duke u ngritur në majë të gishtërinjve nga raftet e pasme ku i fshehte ajo duke hipur mbi arkë. Një ditë në v. 1943, tërë javën e gjatë ajo zonjusha qe aq e shqetësuar saqë dukej se kishte shkalluar, me ç'rast vizitorët gjenin se si fët e fët po e mbyllte me nervozizëm syzën e tavolinës së vet dhe se si po e kyçte atë me çelës (kështu që kjo u ra në sy grave që vinin shpeshherë aty, grave të bankierëve, të mjekëve dhe të avokatëve disa nga të cilat ishin moshatare me Kedin, kurse tash, pasditeve, bredhnin andej këtej me nga një kësombëll të *"Qelibarit të amshumr"* si dhe me romanet e Thorni Smithit, të mbështjella me fletët e gazetave të Memfisit dhe të Xheksonit, pandehnin se ajo ishte në zgripc të çmendisë, e bile se ndoshta kishte luajtur nga kondaku) e kishte mbyllur bibliotekën në mesditë dhe me një çantë nën sqetull dhe me dy njolla të vendimit në fytyrën e saj të zbërdhylët, ajo kishte hyrë në dyqanin e fermerëve ku Xhezoni IV e kishte filluar karrierën e tij si çirak, teksa tash e kishte dyqanin e vet si blerës dhe tregtar pambuku, duke ecur me siguri nëpër atë shpellë të errët ku hynin vetëm meshkujt — ishte ajo si një lloj shpelle plym me çdo gjë, me mure, ku ishin varur pllugjet, disqe, leqe, litarë, kapistra për mushka, kofsha mishi, këpucë të lira, fasha për lidhjen e plagëve të kuajve, miell, shurup të pakulluar, shpella dukej e errët, sepse

mallrat në të ishin gati të gjitha të mbuluara, meqë furnizuesit e fermerëve në shtetin Misisipi, ose të paktën fermerët zezakë të Misisipit të cilëve u jepnin mallin për bereqet, nuk dëshironin, para të korrave dhe para se të llogaritej përafërsisht vlera e tij, t'ua tregojnë myshterinjve atë që do të mund t'iu nevojitej, po vetëm në saje të porosive të tyre i furnizonin vetëm me atò gjëra pa të cilat nuk kishin të gjallë — ajo po ecte me guxim në kthinën e veçantë të Xhezonit në skajin e dyqanit: ajo ishte një kthinë e mbyllur me grila, plot e përplot me rafte dhe me dollape ku me gjilpëra ishin ngjitur thithëset e pluhurit, të mbeturinave të pambukut, recetat e Xhimit, librat e kontabilitetit, mostra të llojeve të pambukut të cilave u kundërmonte era e djathit e përzier me erën e kerozinës dhe të vajit të takëmeve të kalit, aty ishte edhe stufa e stërmadhe nga hekuri, ku kishin pështyrë duhanin e përtypur thuaja më se njëqind vjet: ajo kaloi pranë banakut të gjatë e të pjerrët pas të cilit ndodhej Xhezoni dhe, pa i vënë re njerëzit me kombinezon, të cilët, me ta diktuar atë pushuan së foluri bile pushuan edhe së përtypuri, ajo, me një dëshpërim të lëmekur, ▪ hapi çantën, nxori mezi diçka nga ajo dhe e la në banak duke qëndruar aty, duke u dridhur si purteka dhe duke marrë frymë me nxitim teksa Xhezoni po shikonte — një fotografi në kolor, me gjasë e grisur nga ndonjë revistë zbavitëse — një fotografi plym me luks, të holla dhe me diell — në sfond gjendeshin malet e Kanebierit, palmat, qiparisat, veturat sportive, deti, fytyra e një gruaje pa kapele mes një shalli shumë të bukur dhe të peliçes nga lëkura e fokës, fytyrë e freskët dhe e bukur, e ftohtë, e kthjellët dhe fatale; afër saj ishte një mashkull shtathedhur më moshë të mesme, me shiritat dhe gajtanët e gjeneralit të shtabit gjerman — dhe lënesha e vockël si miu e me ngjyrë të muit, duke u dridhur e llahtarisur nga pafytyrësia e saj, duke shikuar mbi të beqarin e pafëmijë me të cilin po mbaronte skota e gjatë e njerëzve të cilët patën në vete pak bujari dhe krenari, ndërsa, madje pasi filluan ta shkelin nderin, teksa mburrja iu shndërrua në kotësi dhe vetëmëshirë: rodi që fillonte nga ai stërgjysh i arratisur nga vendlindja me kurrgjë send, por i cili s'e pranoi disfatën, nëpër atë tjetrin i cili dy herë e rrezikoi jetën e vet dhe namin e vet, i cili e humbi betejën dy herë e megjithatë s'deshi se s'deshi të pajtohej me disfatën, vazhdonte me atë i cili vetëm në saje të një pele të mençur dhe

të vogël të vrapit në një çerek milje ia mori hakun babait të shpronësuar dhe gjyshit dhe arriti ta ketë nderin dhe pozitën e princit, rod që vazhdonte edhe me atë guvernatorin brilant dhe trim dhe me atë gjeneralin i cili, vërtet, s'u shqua si prijës luftarak i djemve fisnikë dhe trima, por të paktën e rrezikoi jetën në atë disfatë, e deri tek ai pijaneci mendjemadh i cili e shiti ngastrën e fundit të tokës së trashëguar, po jo për të blerë pije për vete, po së paku duke u orvatur që t'ia siguronte lumturinë e vërtetë njërit djalë të vet.

"Kjo është Kedi", pëshpëriti bibliotekarja. "S'kemi çare pa e shpëtuar!"

"Po, vërtet, Kedi", tha Xhezoni. Fill pastaj, ia plasi gazit. Po qeshte ashtu në këmbë mbi fotografinë, mbi fytyrën e ftohtë po të bukur e cila tash ishte e zhubravitur dhe me vija nga palosja, ngase një javë kishte qenë në syzën e tavolinës dhe në çantë. Bibliotekarja e dinte pse qeshte ai njeri, të cilin për më se tridhjetë e dy vjet s'e quante ndryshe pos zotëri Kompson, që nga ajo ditë e vitit 1911 kur Kandasi, e braktisur nga burri, ▪ solli të bijën në shtëpinë e prindërve, e la ferishten aty, zuri trenin dhe iku dikah që të mos kthehej kurrë më dhe, jo vetëm gjellëbërësja zezake, Dilzi, po edhe bibliotekarja instiktivisht merrte me mend se Xhezoni edhe jetën ▪ fëmijës si dhe gjendjen ilegjitime të fëmijës i shfrytëzonte për t'i bërë shantazh nënës së fëmijës, në mënyrë që ajo të mos kthehej në Xheferson për të gjallë, po njëherësh që atë ta caktonte kujdestarin e vetëm të të hollave që do t'i dërgonte ajo për mbajtjen e fëmijës dhe ajo kishte refuzuar të fliste me të që nga ajo ditë e v. 1928 kur e bija ishte lëshuar nga dardha dhe e kishte marrë arratinë me shitësin e cikërrimave, pjesëtarin e cirkut.

"Xhezon!" briste ajo. "S'kemi çare pa e shpëtuar! Xhezon! Xhezon!" — ende po bërtiste edhe kur ai e mori fotografinë në dorë dhe ia flaku asaj në banak.

"Kandasi, kjo?" tha ai. "Mos më bëni të qesh! Kjo lavire s'i ka mbushur as të tridhjetat. Kurse ajo i ka mbushur tash të pesëdlhjetat".

Dhe biblioteka ishte ende e mbyllur të nesërmen gjithë ditën kur në orën tre të pasdites, me këmbë të lodhura dhe e rraskapitur, por prapëseprapë e fortë dhe me çantën e shtrënguar nën sqetull, ajo hyri në oborrin e vogël e të

rregulluar në lagjen e zezakëve të Memfisit, pastaj u ngjit shkallëve të një shtëpize komfore, i ra ziles, deri u hap dhe një zezake ie moshës së saj disi e shikoi atë me gjakftohtësi. "Ju jeni, Froni, apo jo?" tha bibliotekarja. "A s'ju kujtohem — Melisa Mik nga Xhefersoni"—

"Po", bëri zezakja. "Urdhëroni brenda. Me siguri dëshironi të shiheni me Mamën". Ajo hyri në dhomë, në dhomën e fjetjes së rregulluar po përplot me sende të zezakes, ku kutërbonte era e pleqve, plakave, zezakëve pleq ku në një karrige luhatëse ishte ulur ajo zezakja plakë afër vatrës, ku edhe pse ishte muaji qershor ishte ndezur një zjarr bubulak — dikur ajo kishte qenë grua shtathedhur tash kishte veshur një fustan të vjetër të zbehtë prej pambuku me një çallme të pastër rreth e rrotull kokës mbi sytë e turbullt që tash nuk shihnin ndoshta — dhe fotografinë e prerë me çipe tashmë të thyera, bibliotekarja ia futi në duart e zeza, të cilat, ashtu si edhe te gratë e racës së saj, ende ishin të shkathëta dhe dielikate, ashtu si kishin qenë kur ajo ishte tridhjetëvjeçare ose njëzetvjeçare apo edhe shtatëmbëdhjetëvjeçare.

"Kjo është Kedi!" tha bibliotekarja. "Po, ajo është! Dilzi! Dilzi!"

"Çka tha ai?" pyeti zezakja plakë. Dhe bibliotekarja e dinte se kënd e nënkuptonte me atë "ai" dhe as që çuditej, jo vetëm ngase bibliotekarja e dinte se kënd mejtonte me atë "ai", po me atë se zezakja plakë e pat të qartë menjëherë se ajo ia kishte treguar fotografinë Xhezonit.

"A s'dini se ç'tha?" tha bibliotekarja. "Sikur të merrte vesh se është në rrezik, do të thoshte se është ajo, edhe po të mos e kisha fotografinë për t'ia treguar. Mirëpo, si mori vesh se dikush, kushdoqoftë, madje edhe unë, dëshiroja ta shpëtonte Kedin, të paktën do të përpiqem ta shpëtoj, ai menjëherë konstatoi" se nuk ishte ajo. Por, po, ajo është. Shikojeni fotografinë!"

"Shikojini sytë e mi", tha zezakja plakë. "Si mund ta shoh këtë fotografi?"

"Thirreni Fronin!" i thirri bibliotekarja. "Ajo do ta njohë". Mirëpo, zezakja plakë e palosi fotografinë ngadalë dhe ia ktheu bibliotekares.

"Sytë s'i kam kurrqysh", tha ajo. "S'mund të shoh".

Me kaq kishte marrë fund biseda. Në orën gjashtë ajo po e

çante me mundim rrugën nëpër tollovi deri në stacionin e fundit të autobusit, me çantë të shtrënguar nen sqetull, teksa në dorën tjetër mbante biletën për vajtje dhe ardhje, kështu që e hodhën në platformën anësore të autobusave në baticën e ditës disa civilë të moshës së mesme, kurse aty më së shumti kishte ushtarë dhe marinarë të cilët ishin në rrugë, në pushim apo shkonin për raste vdekjeje, kishte edhe femra të reja të paplangta, përcjellësit e tyre të cilët ka dy vjet që jetojnë nga dita më ditë nëpër autobusat pullmanë dhe nëpër hotele, në paçin fat, por, në mos paçin fat, atëherë jetën e çojnë nëpër vagonë të zakonshëm, autobusa, stacione, salla të pritjes dhe pushimoret publike duke u prehur vetëm në ndonjë strehimore bamirëse apo në ndonjë stacion policor, e pastaj e vazhdonin rrugën, kështu ajo shtyhej në autobus, më e vogël se çdo femër e asaj ane, kështu që këmbët e saj vetëm nganjëherë e preknin dyshemenë, derisa dikush (një mashkull me uniformë ushtaraku, por ajo as që qe në gjendje ta diktonte, ngase ia kishte krisur vigmës), u ngrit, e rrëmbeu atë dhe e uli në ulëse pranë dritares, prej nga ende duke qarë me zë të ulët, mund ta vështronte qytetin që po i shkiste, sulej dhe ngecte, teksa ajo së shpejti do të jetë në shtëpi, shëndosh e mirë, në Xhefersonin e saj ku po ashtu zien jeta me atë nxitimin, rrëmujën, mjerimin, mllefin dhe dëshpërimin e saj të pashpjegueshëm, por atje të paktën në orën gjashtë, mund t'i mbyllësh kapakët e dritareve dhe vetëm dora e lehtë e fëmijës mund ta kthente atë krijesë shëmtaqe dhe të thjeshtë në raftet eterne dhe ta mbyllte me çelës gjithë natën te gjatë e të pagjumë. Po, mendoi ajo, duke qajtur ngadalë *ashtu kishte ngjarë ndonëse ajo s'kishte dashur ta shihte në ishte ajo Kedi apo jo sepse e dinte se Kedi nuk dëshironte të shpëtonte s'kish mbetur më asgjë që vlente të shpëtonte, ngase asgjë s'vlente të humbte nga ajo që mund të humbiste ajo.*

XHEZONI IV. Kompsoni i parë i shëndoshë para Kallodenit dhe (meqë mbeti beqar) ai që edhe i fundit. Logjik, praktik, i përmbajtur, bile edhe filozof i traditës stoike: për zotin nuk mendonte asgjë as ashtu as kështu, teksa ndaj policisë kishte konsiderata, kështu që ai ia kishte drojën dhe respektin vetëm asaj zezakeje, të cilën e kishte armike të përbetuar që nga dita

e lindjes së tij si dhe nga ajo ditë e v. 1911 kur me largpamësinë e saj të thjeshtë ia qëlloi se ai po e shpërdorte disi gjendjen ilegjitime të mbesës së tij të vogël për t'i bërë shantazh nënës së saj, e cila ia bënte gjellët. Xhezoni, jo vetëm që u mbrojt nga Kompsonët dhe e ruajti dinjitetin e tij individual ndaj tyre, po bile në ruajtjen e pavarësisë së vet mund të matej edhe me Snopsët të cilët e pushtuan qytezën në fillim të këtij shekulli, kur Kompsonët dhe Sartorisët dhe nami i emrave të tyre u zhdukën nga ajo qytezë, (jo Snopsët, po vetë Xhezon Kompsoni, i cili si i vdiq e ëma — mbesa ndërkohë ishte lëshuar nga dardha dhe ishte zhdukur, kështu që Dilzi nuk kishte më mundësi ta zinte ngushtë — e përcolli vëllain e vogël idiot në çmendinën shtetërore, dhe këso dore e boshatisi shtëpinë e vjetër, më parë duke i shndërruar dhomat e mëdha e të shkëlqyeshme në ato që ai i quante apartmane e pastaj të gjitha këto ia shiti një fshatari i cili në atë shtëpi të vjetër hapi një pension), ndonëse kjo s'qe punë e vështirë për të, meqë për të tërë qyteza dhe bota, bile edhe raca njerëzore, përveç vetë atij, ishin Kompsonë, vërtet të pashpjegueshëm, por aq mendjelehtë saqë njeriu s'ka si t'u besojë. Meqë tërë shuma e të hollave nga shitja e livadhit u shpenzua për martesën e së motrës si dhe për shkollimin e të vëllait në Harvard, Xhezoni i përdori të hollat e pakta të kursyera nga rroga e tij e vogël e ndihmësit tregtar që të shkollohej edhe vetë në Memfis, ku mësoi ta klasifikonte dhe ta dallonte pambukun, e në këtë mënyrë zuri edhe vetë të merrej me atë biznes, teksa pas vdekjes së të et pjanec, e mori tërë barrën e familjes së kalbur në shtëpinë e kalbur, duke e mbajtur vëllanë idiot për hatrin e nënës, duke e sakrifikuar kësodore harenë jetësore që do t'i përkiste një beqari tridhjetëvjeçar si me të drejtë ashtu edhe me drejtësi e nevojë, vetëm e vetëm që jeta e së ëmës të mbetej pak a shumë e atillë çfarë ishte edhe më parë; këtë s'e bënte ngase e donte atë, por (ai gjithmonë ishte njeri me mend në kokë) thjesht vetëm e vetëm pse ia kishte drojën asaj gjellëbërëses zezake, të cilën nuk mund ta dëbonte, bile as atëherë kur u mundua t'ia ndalte pagën: dhe, edhe përkundër të gjithave, ia kishte ndalë mbanë t'i kursente afro tre mijë dollarë (2840,50 dollarë si deklaroi atë natë kur ia vodhi e mbesa) në monedha prej dhjetë, njëzet dhe pesëdhjetë sencësh të kursyer me mund dhe me koprraci, që i mbante jo në bankë,

ngaqë për të çdo bankier ishte një Kompson tjetër, por shumën e kishte mbajtur të kyçur në një arkë të çeliktë në dhomën e tij të fjetjes krevatin e të cilit e shtronte dhe e rregullonte vetë teksa derën e saj e mbante gjithnjë të kyçur me çelës pos kur hynte në të. Pas orvatjes së pagdhendur të dhunimit të një vogëlusheje që kalonte afër shtëpisë, nga ana e vëllait idiot, e bëri veten kujdestar të idiotit pa i thënë nënës, kështu që e çoi vëllanë ta tredhin, para se të merrte vesh nëna se ai s'ishte në shtëpi dhe i cili pas vdekjes së të ëmës, më 1933, ia doli mbanë që t'i shporrej përgjithmonë jo vetëm vëllait idiot dhe shtëpisë së prindërve, po edhe zezakes, duke u shpërngulur në lokalet e zyrës së dyqanit që ishin të ngjitura me deponë me disa shkallë mbi të, ku i mbante regjistrat kryesorë të tregtisë dhe mostrat e pambukut, që tevona i kishte shndërruar në dhomë fjetjeje, kuzhinë dhe banjo, ku gjatë uikendeve gjindja mund të shihnin sesi aty hynte dhe dilte një femër shtathedhur, e këndshme dhe e lezetshme, leshverdhë, e cila s'ishte edhe aq e re, me kapelë rrethgjerë, dhe (kur ishte stina), mbante edhe njëfarë imitimi të palltos së gëzofit, kështu që ata të dytë, blerësi i pambukut në moshë të mesme dhe femra të cilën në qytet thjesht e quanin miken e tij nga Memfisi, shkonin në kinemanë e qytezës të shtunave, teksa të dielave pasdite i shihnin sesi u ngjiteshin shkallëve që shpinin në banesë duke mbajtur qese letre nga dyqanet, me samune, vezë, portokaj, supë me konserva, si shtëpiakë, të pateklifë, si dy bashkëshortë derisa dikur vonë pasdite të dielën ajo kthehej me autobus në Memfis. Tani, Xhezoni ishte emancipuar. Ai ishte i lirë. "Më 1865", thoshte ai, "Eb Linkolni i çliroi zezakët nga Kompsonët. Më 1933, Xhezon Kompsoni i çliroi Kompsonët nga zezakët".

BENXHAMINI, i pagëzuar Mauri, sipas emrit të vetëm të vëllait: ishte një beqar i pashëm mburravec dhe përtac i cili merrte hua thuaja prej çdokujt, bile edhe prej Dilzit, ndonëse ajo ishte zezake, duke ia shpjeguar teksa e nxirrte dorën prej xhepit se ajo ishte njësoj si anëtare e familjes së motrës së tij, jo vetëm për të, por se atë do ta hiqnin për zonjë kudo që të ndodhej. Kur, më në fund edhe e ëma e Benxhaminit e pat të qartë se çfarë ishte ai, nguli këmbë duke vajtur që t'i ndërrohej emri, kështu që vëllai i tij Kuentini, e pagëzoi sërishmi si

Benxhamin (Benxhamini, sugari ynë, i shitur në Egjipt). Ai i donte tri gjëra: livadhin që e shitën për t'i hequr shpenzimet e dasmës së Kandasit dhe për ta dërguar Kuentinin në Harvard, motrën e vet Kandasin dhe flakën e zjarrit. Asnjë nga këto nuk i humbi, ngaqë motra nuk i kujtohej, po vetëm humbja e saj, teksa flaka e zjarrit ishte për të dukuri e njëjtë e ndritshme si të biesh në gjumë, kurse livadhin e kishin shitur me çmim më të mirë se po ta shisnin më parë, ngaqë tash ai dhe T. P. jo vetëm që mund t'i përcillnin kur t'u tekej lëvizjet e lojtarëve të golfit përgjatë gardhit, po atij aq i bënte se a i lëviznin shkopinjtë e golfit krijesat njerëzore; T. P. mund t'i shpinte ata në tufat e barit ose të barojës ku papritmas në duart e T. P. dukeshin topthat e vegjël që mateshin me gravitacionin dhe ligjet e tjera që nuk ndërroheshin, e, të cilët ai s'i njihte fare, e pastaj i përballonin ato ligje kur ai i lëshonte nga dora në dyshemenë me dërrasa ose në murin e oxhakut apo në trotuarin nga betoni. E trodhën më 1913. E dërguan në çmendinë shtetërore në Xhekson më 1933. As atëherë nuk humbi gjë, si me rastin e të motrës, atij nuk i kujtohej livadhi po vetëm humbja e tij, teksa flaka e zjarrit mbetej gjithnjë për të trajta e vezulluar e ëndrrës.

KUENTINA. E fundit. Ishte bija e Kandasit. Mbeti pa baba nëntë muaj para lindjes, e paemër në lindje dhe e dënuar të mbetej e pafejuar që nga çasti që vera e ndarë e përcaktoi gjininë e saj. E cila në moshën shtatëmbëdhjetëvjeçare, në të njëmijëenëntëdhjetëepesëvjetorin e ringjalljes së Salvuesit tonë, ishte lëshuar nëpër ullukun e dritares së dhomës ku e kishte mbyllur xhaxhai në mesditë, e kishte thyer dritaren e dhomës së tij dhe kishte hyrë nëpër të në dhomën e mbyllur dhe të zbrazët të fjetjes së xhaxhait të vet, pastaj me mashën e xhaxhait, e kishte thyer dorëzën e derës së dollapit të tij, e kishte hapur syzën e kyçur dhe i kishte marrë të hollat (nuk kishte pasur as 2840,50 dollarë, por kishte pasur afro shtatë mijë dollarë, prandaj kjo e mbushi Xhezonin me mllef, me atë mllef e duf të padurueshëm i cili atë natë si dhe herave të tjera që e kaplonte herë me hov e herë edhe jo aq me hov në të pesë vjetët e ardhshëm, e shtrëngonin të pandehte se në ndonjë çast të papritur do ta fikte atë, se do ta grinte aty për aty si plumbi ose rrufeja; se, ndonëse ia kishin grabitur jo për nja tre mijë

dollarë po thuaja shtatë mijë dollarë, ai s'mund t'ia zinte ngoje këtë askujt, meqë ia kishin grabitur shtatë mijë dollarë në vend të tre mijë dollarëve ai jo vetëm që nuk mund të kishte justifikim — atij nuk i duhej ngushëllimi — nga fatkëqijë të tjerë të cilët e kanë motrën kurvë, e edhe mbesën lavire, por ai s'kishte si të ankohej as në polici, ngase i kishte humbur katër mijë dollarët që nuk i përkisnin, ai as që ishte në gjendje t'i kthente të paktën ata tre mijë dollarë të tij, sepse ata katër mijë dollarët e parë ishin jo vetëm prona legjitime e mbesës së tij, si pjesë e të hollave që ia kishte dërguar e ëma për gjashtëmbëdhjetë vjet për mbajtjen dhe ushqimin e saj, por ato të holla as që kishin ekzistuar, meqë ishin të regjistruara si të shpenzuara në raportet e tij vjetore që ia paraqiste kryetarit të gjyqit të qarkut ashtu si kërkonin nga ai garantët si i besuari dhe garanti i tyre: kështu që ia kishin vjedhur jo vetëm të hollat që i kishte vjedhur, po ia kishin grabitur edhe të hollat e kursyera, bile ato ia kishte grabitur pikërisht viktima e tij, atij ia kishin plaçkitur jo vetëm katër mijë dollarë për të cilët ai kishte qenë në rrezik të binte në burg, po edhe ata tre mijë dollarë të tjerë që i kishte mbledhur me vetëmohim dhe sakrifica, nga pesë apo nga dhjetë sencë, brenda një periudhe prej afro njëzet vjetësh; madje jo vetëm që ia kishte vjedhur viktima e tij po edhe një axhameshë e cila ia kishte vjedhur menjëherë, pa ndonjë parapërgatitje apo plan, bile edhe pa pasur haber dhe pa e vrarë mendjen sesa do të gjente kur e thyente syzën; tash, as që mund të kërkonte ndihmë nga policia: ai i cili ngaherë i kishte respektuar policët gjithmonë, i cili s'u kishte hapur kurrë telashe, i cili e kishte paguar tatimin vjet me radhë dhe i kishte mbështetur në përtacinë e tyre parazitore dhe sadiste; jo vetëm kaq, ai *vetë* nuk kishte guxuar ta ndiqte vajzën, sepse mund ta shtinte në dorë teksa ajo do të mund të fliste, kështu që ngushëllimi i vetëm për të ishte ëndrra e kotë të cilën e shihte net me radhë duke u djersitur dhe duke u çuar peshë gjatë më se dy, tre madje edhe katër vjetëve pas asaj ngjarjeje, edhe kur duhej ta harronte këtë: sesi e kapte papritur e pakujtuar, sesi i gjuhej në errësirë, para se t'ia shpenzonte të gjitha të hollat, se si e vriste atë para se të mund të bënte ajo as gëk as mëk) dhe sesi po lëshohej nëpër ullukun *e* njëjtë në errësirë dhe ia mbathte me atë palaçon e cirkut të cilin e kishin dënuar tashmë për bigami. Kështu u zhduk ajo; çfarëdo okupacioni që t'ia

behte ajo s'do të ndodhej në "Mercedesin" e kromit; në asnjë fotografi të saj, nuk do të qëllonte gjenerali i Shtabit.

Këta ishin ata. Ata të tjerët, nuk ishin Kompsonë. Ishin zezakë:

T. P., i cili në rrugën Memfis Bill mbante rroba të lira, të vezullueshme të cilat ia kishin bërë nergut pronarët e dyqaneve të rrobaqepësve të Çikagos dhe të Nju-Jorkut.

FRONI, e cila u martua me portierin e vagonit të pullmanit dhe shkoi në Sent-Luis për të jetuar, kurse më vonë u kthye në Memfis për të bërë një shtëpi për të ëmën meqë Dilzi nuk donte të shkonte më tutje.

LLASTERI, një djalë 14-vjeçar, i cili jo vetëm që nuk ishte i aftë për t'u kujdesur tërësisht për sigurimin e një idioti dy herë më të moçëm se ai dhe tri herë më të madh se ai, por dinte edhe ta zbaviste.

DILZI.
Ata qëndruan.